ka lenë shume kohë para se me u mbyllur kompania. Punën e ka lenë kur e ka pa qe nuk janë duke shkuar punët ne rregull. Ka biseduar me E. ajo i ka thene se nuk ka asnjë probleme dhe ky e ka lenë. E ka pa se punët nuk po shkojnë mirë klientët vinin ne zyre puna nuk ecte. Ka menduar se nuk është për aty prandaj e ka lenë. Ata nuk kane biseduar me te, por kane biseduar me E. por ky e ka pare qe nuk është ne rregull kur janë ndalur punimet. Klientet i ka dërguar ne lagjen “ M. . “ ne vend punishte i kujtohet kur ka qene duke u ndërtuar hyrja e pare diku 5 – 6 kate, nuk e di se cilët klientë i ka dërguar, por i ka dërguar atë qe ka pasur nevojë dhe atë qe i është urdhëruar për me dërguar. Ka pasur klientë qe kane shprehur pakënaqësi, por ky ju ka siguruar me shkuë te E. . I kujtohet qe klienti F. G. ka qene ne zyr e ka marrë veturën Sh. derI. E. te ja ktheje obligimet qe ka pasur ndaj ti dhe kjo veturë ka qene ne emër te ti. Vetura ka qene e kompanisë është blere për kompani por ka qene e regjistruar ne emër te ti. I është marrë edhe nje banese ne lagjen T. H. nga një klient i E. dhe E. i ka thënë se ai do te rri aty deri sa ky te kthehet pasi qe ky kishte marrë një banese me qera afër T. B., për shkak se fëmijët i ka pasur te sëmur dhe ajri ishte me i pastër. Ky person qe qëndron ne baneset e tij është Q. dhe është deklaruar edhe vete. Sa i përket deklaratës se ti te dhëne ne polici me dt. 12.09.2014, i njëjti kishte deklaruar se vetura Sh. ka qene e ti, dhe e ka blere duke punuar ne kompanin V.ë o G., vetura kishte kushtuar 26.000 euro e kishte blere me këste, madej kishte deklaruar se vetura është blere ne mars 2011 dhe e kishte mbajtur deri ne gusht 2011 ku E. ja kishte dhëne F.it. I njëjti serisht ka theksuar se vetura ishte ne emerine e ti është përdorur për kompanin nen stop e ka përdor edhe për nevoja te tij derI. E. ja ka dhene F.it. F.it për te mbajtur deri kur te ja ktheje obligimin.

Lidhur me atë se a kishte dërguar te dëmtuarin A.M. edhe te lokacioni i dyte, i akuzuari V. ka deklaruar se është e vërtete qe e ka dërguar te lokacioni i dyte dhe aty veç pat filluar nje grop dhe pat qel temelin ne nje vend tjetër. Me tutje ka deklaruar se paga e ti mujore ka qene 700 euro, nuk e di arsyen pse i ka marrë kesh , por e di se ne atë kohe ka qene e lejuar me marr kesh kontributet nuk i janë paguar. Sa i përket e kredisë i njëjti ka theksuar se kredia është marrë ne emrin e ti por e ka paguar E.. Ky ja ka dhene parat e ti e pastaj E. i ka dhene për kredi. Bashkëshortja e ti është T. B. dhe nuk ka njohuri qe ndonjë klientë ka paguar ne llogari te T. B.. Ne Prokurori ne deklaratën e dhene me dt. 03.04.2015, ka thene se me vone është informuar se një klientë ka bere pagesën përmes llogaris e se T., ajo deklaratë është e vërtete dhe qëndron pranë saj. Dhe nese e ka berë pagesën ne emër te T. i ka thene E..

I akuzuari B.V. ne mbrojtjen e ti ne seancën e dt. 11.03.2022 ka shfrytëzuar te drejtën e tij për të qëndruar ne heshtje.

I pandehuri B. V. në mbrojtjen e tij dhenë në lokalet e Prokuroris Speciale me datën 31.03.2015 në prezencën e mbrojtësit të tij avokatit Behar Ejupi nder të tjera ka deklaruar se: që nga viti 2000 ka filluar me punën në organizatën A. në A. për gjashtë muaj, pastaj ka punuar në K. S., në M. B. rreth dy vitëve, pastaj për 6 vite ka punuar si zyrtar D. gjerë në vitin 2007, pasi që është larguar nga D. ka filluar të punoj si ndërmjetësues i patundshmërive pa biznes të regjistruar gjerë në vitin 2009, në vitin 2009 gjatë një ndeje me shokun e tij S. S. është takuar dhe njoftuar me E.Bn, gjatë ndejës E. kishte shfaqur interesim për me gjetë një pllac për ndërtimin e një kompleksi banesor, pasi që është marrë me ndërmjetësimin e patundshmërive e kishtë një orientim se ku mund të gjendet një pllac për ndërtimin e atij kompleksi. Pasi që e ka gjetë nje pllac të përshtatshëm është takuar me E., se bashku me të kanë shkuar te trojet ku mund të ngritët kompleksi, për këtë pasi që E. i ka konvenur ai vend ka preferuar që ti takojnë pronaret e parcelave , pasi që në atë potëz janë 7-8 pronar të parcelava nga 5-6 ari, e gjithë kjo procedurë

kishte zgjat një muaj deri sa kanë arritur deri tek marrëveshja të cilën e kanë bërë gjatë një darke në një lokal në P., të pranishëm kishin qënë pronaret, E., B.i , S.i e nuk i kujtohen të tjetër. Më tej i pandehuri shton se me sa e din lidhur me këto troje janë bërë dy kontrata për ndërtim të përbashkët, në një kontratë kanë hyre tre persona që kanë qënë pronar po thuaj të gjysmës se truallit dhe ata persona i kanë pasur dokumentet e gatshme ndërsa kontrata tjetër është bërë me persona të tjerë që nuk i kanë pasur dokumentet e gatshme ku me këto kontrata ishte parapare që pronaret të kompensohen me 29% - 30% duke përfshirë lokalet e biznesit dhe banësat dhe garazhet. Për punën e tij pasi që ka sigurua truallin E. për ngritjen e kompleksit të banesave përafërsisht pas një muaji e pak ma tëpër me datën 23.09.2009, e njëjta i ka dhënë një deklaratë të vërtetuar në Gjykatën Komunale Dega në Graçanice në të cilën thekson se për ndihmën që i ka ofruar rreth gjetjes se truallit dhe angazhimit për lejen e ndërtimit ia ka premtuar një banesë, lokal dhe një garazh në Lagjen M. . në P., po ashtu duke pasur parasysh vlerën e premtimit ka konsideruar se prej datën 23.09.2009 është i punësuar në biznesin e E.Bt pasi që edhe gojarisht i ka thënë që të punon për të se të paguaj. E. ka filluar që ta paguaj nga data 06.12.2010 deri në muajin e pestë vitit 2011 në vlere prej 449 euro për çdo muaj, pastaj nuk e ka paguar me duke i thënë muajin tjetër muajin tjetër kështu që me radhë me nuk e ka paguar më. I pandehuri B.V. deklaron se tek E. ka punuar si mbikëqyrës i vend punishte apo kujdestar pasi që në vend punishte ka qënë një kiosk dhe aty ka qendruar kohën me të gjatë në orar të punës, E. nuk i ka lëshuar kurrfarë dokumenti që e vërteton krijimin e marrëdhënies se punës, E. e ka trajtuar si punëtorë të vetin kryesisht për mbikëqyrje dhe kujdestari gjatë punës në objekt.Nuk ka pare kontratë ku thekson se është si zyrtar i shitjes, ka qendruar ndonjëherë në zyre ka pare E., T. V.in edhe E., ndërsa sa i përket xhpit i pandehuri B.V. shton se nuk e din si është arrit marrëveshja mirëpo E. e ka posedua një automjet V. ngjyrë hiri, fillimisht nuk e ka ditur mirëpo me vonë e ka kuptuar që e ka marre si kompensim nga një blerës, makinën ja ka dhënë E. me regjistruar në emrin e tij pasi që ajo nuk ka pasur leje për me drejtuar, duke i thënë ta shfrytëzojmë për punë, dhe se deklorohet se ka shkuar me e marr automjetin sipas rekomandimit të E., ndërsa lidhur me V.i B.n thekson se i njëjti ka lëvizur ndonjëherë ka ardhur tëk objekti me klient për blerje të banësave, ndërsa T. B.n përpos që e ka pare në zyre nuk e din çka ka punuar pasi që ato kanë qënë në fafëfis kunata në mes veti.

I akuzuari XH.A. ne mbrojtjen e ti te dhenë para gjykatës me dt. 11.03.2022 ka deklaruar se merret me pune private kane bizenset e tyre dhe ky personalisht merret me hoteleri. J. me vëllezër dhe me djem, i kane 5 biznese te tyre dhe obejkte qe i kane me qera. Ka pasur furrën bukës “te B. “ ne P.. Fabriken e prodhimit te plastikes “ A. “ ne P., Depo te barnave dhe farmaci qe nuk i kujtohet emri ne atë kompani, Mini gurthyes ne fshatin G. firma “K. K. “ furrën e bukës dhe depon e barnave i kane mbyllur. Ka pasur restoran “M. “ dhe “P. ..” dhe lokalin “R. “. Me E. B. është njohur ne vitin 2007 apo 2008 nëpër mes B.V. te cilin e ka vendas dhe ai ka treguar se bashkëpunon me E.. Ne atë kohe janë njoftuar me E. dhe kane vazhduar biseda raportet kolegiale dhe shoqërore. Ne bisede e sipër i ka treguar se çka është tu pretenduar me pune. E. ne atë kohe ka qene duke punuar ne R. B. dhe ky personalisht ka qene ne zyrën e saj ne R. B. Edhe E. ka qene ne atë kohë ne P. bashke me B.V.n dhe drejtorin e B.ës A. I.

Ne fillim ajo i ka treguar se i ka dI. pretendime për dI. toka qe janë ne R. b. për ndërtime te larta, opsioni i dyte ka qene se ka qene ne bisedime me pronar te tokave për objektin ne lagjen M. ., dhe i ka treguar se ka pretendime me filluar me ndërtim te lart. E. i ka kërkuar te holla si tip huazimi dhe ja ka huazuar dhe jo fort gjatë ka vendosur për ndërtimin ne M. .. Ky ja ka huazuar 400 mij euro. Ajo ja ka kthyer 50.000 euro dhe e kane mbyllur obligimin për pjesën tjetër me blere te sipërfaqes prej 1000 metra katrore. Parat ja ka dhënë me 3 - 4 keste nje here 200.000 euro nje here 70.000 euro , nje here 50.000 euro, një here

10.000 euro, një here 20.000 euro, dhe sipas nevojës. Ajo nuk ka pasur obligim me ja kthyer te hollat sepse ka pasur me i dhënë banësë, ose një pronë që ka pasur te V., ose një pronën kur ka ndërtuar te M... Kur është përfunduar objekti e kanë mbyllur obligimin me një deklaratë gjyqësore ku ka qene e parapare me u ndërtua katër objekte dhe e kanë mbyllur obligimin si parapagues i banesave për 1000 metra katrore. Ka qene e parapare që për tri vite me u mbyll cikëli i ndërtimit, ka pasur njohuri se ka pasur leje urbanistike dhe se nuk ka pasur leje te ndërtimit. E njëjta pat filluar ndërtimin po pastaj ka ngec. Puna ka ngecur kur pat filluar me heke dheun ne lllamellen 2 do te thotë ne objektin e dyte nga se ju a shfaqur një probleme serioz lidhur me një gyp te ujit. Pastaj ka pasur probleme me pronar te tokave, është munduar me bo zgjedhje për atë gyp, por problemet me pronar te tokave kanë arritur ne nivel serioz ata ja kanë dhënë një mundësi për me vazhduar ka filluar prape me ndërtim dhe prape ka qene opcioni për me u heke ai gyp, nga se inspektoriat i Komunes i kanë thene për me heke gypin. Atë problem nuk e kanë marrë për sipër as urbanizmi i P.s e as Ujësjellesi i P.s.

Pronaret e tokave ja kanë sjellur një person i cili ju ka kërkuar 250.000 euro, e di që nuk ka mundur me e pranuar nga se ka qene pare e madhe, dhe aty ka arritur konflikti me pronaret e tokave ne nivelin me te lartë. Interesi i ti ka qene që puna me vazhduar pronaret e tokave kanë bere kërkesa për rrënimin e objektit dhe E. e patën ndaluar me huje te ai objekt. Pastaj e ka thirr E. dhe i ka ofruar mundësin me investuar ne atë objekte por ky nuk ka pranuar i ka kërkuar vetem mjetet e ti sepse ishte qregulluar çdo gjë. Pas dy jave e ka thirr prape E. i ka thene se ti dine me bo zgjidhje me pronaret e tokave, pastaj ky ka shkuar te pronaret e tokave ka biseduar ju katreguar gjerat reale te ti, dhe vetem L. G. e ka ditur se ky ka pasur mjete aty. Pronaret e tokave fillimisht nuk kanë pranuar. Kur është angazhuar ky objekti ka qene 5 katë dhe me kalimin e kohës ka marrë pëlqimin e pronareve te tokave dhe bashkarishte te gjeje një kompani që do ti filloi punimet. Pronaret e tokave e kanë dit që E. ju ka shitur banesa edhe personave tjere dhe me dI. i ka shkëputur kontrata, dhe për kete i kishte informuar ky pasi që E. e kishte ftuar ne zyre dhe ja kishte treguar kontrata te cilat i kishte shkëputur, nga se ja kishte treguar diku 30 ose 40 kontrata te shkëputura dhe që ka bere kontrata te reja. Pastaj e kanë gjetur kompanin “A. G.” pas dI. takimeve me D. B.n kanë arritur ujdj.

Me tutje i akuzuari XH.A. ka theksuar: ne objektin e pare e ka marrë kompensimin ndërsa ne objektin e dyte akoma. E. ndërtimin e objektit deri ne katin e 5 e ka bere me mjetet e ti. Nuk ka njohuri se E. te kete paraqitur fakte te rreme, apo te jete marrë me ndonjë aktivitate kriminal. E. i ka besuar si një njëri për shkak te afërsisë që ka pasur me te , besimit ne sinqeritete dhe si një e punësuar ne R. B.. Me tutje i njëjti ka deklaruar se te hollat E. ja kishte dhënë ne vitin 2008 - 2009, te hollat ja kishte dhënë me këste për një periudh kohore 3 mujorshe dhe diku ku ja kishte dhënë këstin e fundit ka pas filluar veq se me punime. Shumen prej 50.000 euro E. ja ka kthyer diku ne vitin 2010 ku ka qene kati i pare ne ndërtim. Ne atë kohe ka qene kati i pare i ndërtimit dhe ne atë kohe e ka mbyllur marveshjen ashtu që ne shumen prej 350.000 euro E. do ti merrte banesa si kompensim e ka nënshkruar kontrate ne Gjykate dhe e kanë vërtetuar. Në atë lokacion kanë pasur me u ndërtuar katër objekte, dy objekte kanë pasur me u ndërtua përmbi gyp dhe janë vonuar me vite. Kur ka filluar me ndërtuar Komuna rrugën katër kaheshe atëherë ka nderhyre Komuna dhe e ka heke gypin, as investitori i dyte nuk ka mundur me u ndërtua. Ne atë lokacion kanë pasur me u ndërtua katër objekte dhe janë ndërtua vetem dy. Dy te tjera nuk janë ndërtuar për shkak se pronaret e tokave janë shpartalluar, “A. G. “ i ka bere vetem dy ndërtesa. Me tutje i njëjti ka deklaruar se nuk i kujtohet se a ka dërguar prova ne prokurori lidhur me bizneset që i ka pasur, ndërkaq i njëjti sërish ka deklaruar se që nga vitin 2003 e

deri në 2010 e ka pasur f. e b., kafiteri P. ..., kafiteri tjetër R. që është edhe sot aktuale ka qenë restorant M. ne objekte personale familjare, fitnesi ... metra katrore më paisje, N.. B.e në objektin e ti me qera, po ashtu edhe 10 zyre të shpendicionit në objektin familjare të ti me qera, në atë kohe e ka pasur edhe lokalin ku është marrë ribitalizimin e baterive industriale, është marre edhe me barna po qe e ka mbyllur ne vitin 2006 -2007.

Në seancën e dt. 11.03.2022 i akuzuari V. O. ne mbrojtjen e ti ka deklaruar se E. e ka njohur ne qytet ne P. ajo ka qene duke punuar ne R. B.. Është e vërtete se ne vitin 2009, 2010, 2011 ka pranuar te holla nga E. ne shumën prej 16.000 euro. këto te holla i ka pranuar ne periudhe brenda 3 vite për shkak se ne atë kohë ka qene i sëmuar, dhe e ka thirr E. a ke mundësi me me kthye borxhin pasi qe ky me pare ato te holla ja kishte dhënë E., ky ne atë kohe ka qene ne lidhje me E.. Te hollat i ka pranuar përmes W. U. dhe dedikimi i tyre ka qene kthimi i borxhit. Është e vërtete se te A.B. ky i ka marrë te hollat dhe ja prue E.. Ai person ka qene ne S. nuk ka mundur me ardh dhe te hollat ja ka dhënë këtij. Keto te holla kane qene për E. për shkak se ai kishte blere banese. Nga A. B. njëherë i ka marrë 10.000 euro, dhe hera e dyte ka qene ne D. kur e ka thirr E. ne telefon dhe i ka thene se A.B. ka me ti prut te hollat. Është takuar ne S. me te dhe ja ka dhënë 4.600 euro ky këto te holla ja ka prue E.. Te gjitha kane qene për blerje te banesës. Xh. H. ka qene i E. ky ka qene si nje lloj shoferi dhe ku ka pasur nevojë me shkue ky e ka qu. Xhipi ka qene i regjistruar ne emër te ti dhe ky e ka vozitur sa here ka ardhur ne K. Ndonjehere e ka vozitur edhe F. ku ka pasur nevojë. Pastaj E. e ka thirr ne telefon i ka thene po me vyen kerri ky ja ka dorëzuar dhe nuk e di ne emër te kujt është apo kujt ja ka dhënë. E. nuk ka pasur leje prandaj xhipi është regjistruar ne emër te ti. Gjate kohës sa e ka vozitur kete xhip ky ka qene ne lidhje me E.. Trollin ne fshatin L. e ka blere ne vitin 2007 pa e njohur E. dhe atë e ka blere prej N. K.. Trualli prej 5 ari te cilin e ka blere ne vitin 2007 është ne emrin e ti, dhe ka qit ne emër te ti ne vitin 2012 nga se nuk ka pasur legalizim. Nga te akuzuarit te tjere e njuh vetem vëllain e E. V.in edhe F.n qe e ka vëlla te tjerët te akuzuarit i ka pa vetem ne seanca. Asnjehere nuk ka rastis qe ky ti dërgoi blerësit ne vendi ku është objekti.

Lidhur me problemet qe i ka pasur E. nuk ka biseduar asnjëherë sepse ne momentin qe kane dal problemet E. është terhjekur prej ti dhe ne asnjë rrethane nuk ka biseduar. Me tutje ka deklaruar se ne vitin 2009 te hollat prej 16.000 euro ja ka dhënë E. ne form te borxhit kesh, dhe ato te hollat ka filluar me ja kthyer pas nje viti apo dy. Xhipin H. e ka përdor për nevojat te veta te ti dhe për nevojat te E. pasi qe kane qene ne lidhje. Xhipin e ka përdor diku 7 muaj apo 1 vitë. Gjate asaj kohe ka jetuar edhe ne Kosovë edhe ne shtetet S. Gjate kohës kur ky ka udhëtuar automjeti ka qëndruar ne parking në shtëpi. Lidhur ne deklaratën e dhënë ne prokurori ne vitin 2015 i njëjti ka deklaruar se është e vërtete ajo qe ka deklaruar ne prokurori nga se E. nuk ja ka que parat te gjitha përnjëherë por një here ja ka que një here 1000 euro, një here 500 euro, një here 4.000 euro, një here 2.000 euro sipas nevojave. E. këtij ja ka pasur 16.000 euro borxh por nuk ja ka kthyer përnjëherë por pjese pjesë. Ne lidhje me deklaratën qe ka dhënë ne prokurori kur E. ja ka kthyer për 3 vite 16.000 euro i akuzuari ka deklaruar se ne atë kohe ka pasur shume stres, ka pasur probleme shendetesore por prokurori A. R. ka mundur edhe ndryshe me shkruet. Lidhur me veturën qe ka qene ne emër te tij i njëjti ka deklaruar se E. veq e ka thirrte i ka thene se nuk kam patent shoferi a ban me qit ne emër tendin dhe E. e ka marrë veturën prapë. I njëjti ka theksuar se qysh ne vitin 2002 ka shkuar ne D. se janë katër vëllezër dhe kane biznes market, është biznes familjare edhe ky si femi ka punuar aty. Edhe sot i kane gjitha pasurit që i kanë pasur ne vitin 2009 kane pasur ne D., te tregu i gjelbert, biznesin market me banesa dy kate janë market dhe dy kate janë banesa. Kanë pasur nje person me qera ne lokal qe ka qëndruar shume vite me tutje i njëjtit ka theksuar se është e vërtete qe ka dhene deklarate ne prokurori me dt.

04.09.2015, ndërkaq ne polici nuk ka dhënë deklaratë. Ky personalisht nuk ka bere bisede me blerësit e banesave Gj. P. e njeh i ka ra me pi kafe me te.

I akuzuarit F.O. ne seancën e dt. 04.05.2022 ne mbrojtjen e ti ka theksuar: E. B. për here te pare e ka takuar ne Gjykatën K. ne P. nuk i kujtohet viti, ky ka qene ne cilësi te dëmtuarit. Xh. A. për here te pare si figurë e ka pare ne gjykate lidhur me ket e rast. Po ashtu edhe B. V. për here te pare e ka pare ne Gjykatën Si familje me babain e ti dhe vëllezërit kane punuar dhe kane pasur punetore dhe ajo pune ka qene ne tregun e Gjykatën dhe ka vazhduar deri ne vitin 1996, ku ne atë fillim vit e kane hapur lokalin NP “ V. I. “. Kane punuar deri ne fillim te bombardimeve pastaj janë kthyer kane filluar te njëjtën veprimtari ne “ V. I. “. Para lufte kane punuar edhe me tekstil dhe rroga qe i kane sjelle prej T. ne Kosovë, e kane pasur edhe tezgën ku kane shitur rroba, kane punuar edhe me lule dhe te gjitha ato i kane importuar prej Sht. Kane punuar edhe ne pune sezonale ne G. kur kane bere veprimtare te shitjes se lëngjeve dhe te bukës. Për trojet ne lagjen “ Q. “ kane qene te interesuar edhe para vitit 2009 sepse dëshira e tyre dhe e nenes se tyre se katër vëllezër te jetojnë bashke te ken shtepiat afër njeri - tjetrit. Në atë kohe kane qene ne bashkësi familjare ky ka qene bashke me V.in dhe e kane pare pllakën e truallit e kane mare numrin e telefonit e kane thirr dhe ju lajmerur J. Gjykatën Mbas andej e kane lene kohen kur me shkue me i kqyer trojet e kane pare trollin te gjithë anetaret e femiljes,. Januzi ja ka ulur çmimin dhe këta e kane mare kane shkuar ne Gjykatë për me qit ne emër te tij kane bere pagesën ne shumen prej 80.000 euro. Kontraten e kane vërtetuar ne Gjykatën K. ne P. me dt. 30.09.2009.

Ndërtimin e shtëpive e kane filluar ne vitin 2010 V. I. fitime vjetore pas lufte i ka pasur 15.000 euro, edhe para lufte kane pasur para te kursyera dhe parat i ka mbajtur nena e tyre , këta janë katër vëllezër A. , F., V.i dhe G. për momentin janë duke punuar ne marketin “ V. I. “. V.i punon ne D. qe 30 vite, vëllai G. kohet e fundit është duke i ndihmuar, vëllai i ti A. e udhëheq V. I.s ndërkaq edhe ky është aty punon qe 30 vite, prej pasurisë kane nje shtëpi ne lagjen D. 400 metra katroe me 6 – 7 ari truall. Një shtëpi te tregu i Gjykatën ne rrugën “ L. e P. “ qe është 5 kateshe i ka 850 metra katrore me lokal dhe banim. Kanë nje arë ne fshatin L. 5 ari qe është prone e familjes. Renovimin e shtëpisë e kane bere ne vitin 2000 me një pjese te mjeteve qe i ka pasur edhe para lufte. S. K. ia ka lëshuar nje lokal ne shfrytëzim ky lokal është shfrytëzuar nga ana e tij K.sh. qe nga fillimi i vitit 2002 dhe ka qëndruar deri ne fund te vitit 2004 si qeragji qeraja përfaqishte ka qene 1.000 euro e diçka, V. V. është personi qe ka qen pronar i furrës “ D. “ ja ka lëshuar me qera nje lokal ne vitin 2006 deri ne vitin 2008 aferisht ka qëndruar 3 vite dhe këto lokale te lëshuar me qera ka qene V. I.

Me dt. 01.01.2000 e deri ne 07.04.2021 neper mes W. U. i ka qua para vëllai i tij G. O., nje pjese tjetër i kane shkuar prej kolegeve te ti qe i kane paur borxhe. Prej vitit 2004 deri ne 2010 nje shume prej 37.500 euro dhe shumen prej 6.000 euro ja ka dërguar vëllai i ti G. O. pasi qe kane qene ne bashkësi familjare. Trualli ne fshatin L. është ne emër te V. O. dhe është blere ne vitin 2007. Parat qe i kane pasur para lufte kane qene ne Marka qe ato para nje pjese i kane nderuar ne B.e dhe nje pjese te tregu i devizave. Pranori i firmës “V.I.” ka qene A. O.. Ne vitin 2009 e ka pasur nje automjet golf 5 e kane ende ne emër t G. O.t, ne vitin 2009 kane pasur kombi M. V., ne vitin 2009 ka pasur A. .. ne emër te A. O. po ashtu a. .. ne emër te A. O.t. Ne atë kohe e ka pasur edhe nje f. F. por qe nuk i kujtohet se ne emër te kujt ka qene. Xh. h. e ka pasur ne shfrytëzim vëllai i tij V.O. te cilin kur ka shkuar ne D. e ka lene ne oborr. Nuk e ka shfrytëzuar ky atë automjet vetem e ka dhez për shkak te baterisë. Nuk e di si është blere ajo veturë beson se kete e ka

shpjeguar V.i, nbuk e di sa kohe e ka pasur ne shfrytëzim, i kujtohet se V.i i ka treguar se ja ka kthyer E. dhe sa e di V.i e ka vozitur si një lloj shoferi E. B.. E di qe E. ka qene pronare e xhipit dhe V.i ka qene ne lidhje dashurie me E.. Nuk i kujtohet qe V.i i ka treguar se ka huazuar para nga E.. Por i ka treguar V.i se ka mare para nga E. përmes W. U.it ne eme te borxhit kur ai ka qene ne D.. V.i ne atë kohe ka qene i sëmurë pej zemre dhe i ka pasur 2 - 3 intervenime. Ne fshatin LL. 5 ari toke i kane blere prej N. K., kur e kane blere ate toke kane bere bisede me N. K. te cilin e kane pasur kojshi dhe kur kane biseduar me te kane qene te gjithë vëllezërit dhe nena e tyre dhe parat te cilën e kane blere atë trull kane qene te familjes. Kontraten kur e kane blere pronene ne fshatin LL. e ka nënshkruar V.i dhe është vërtetuar ne Gjykatë. Te hollat për pronën ne fshatin LL. janë bartur nepër mes B.ës ka qene viti 2007 nderkaq parcelat ne lagjen Q. janë ne emër te tij dhe janë vërtetuar ne G. Prona ne fshatin LL. është arë, ndërkaq ky është duke banuar ne Lagjen Q. ne shtëpinë tim ne pjesën e ti, ne hyjre tjetër banon vëllai A. nga se aty janë dy shtëpi nga dy hyrje.

Fjala përfundimtare e palve

Ne seancën e datës 10.06.2022 është dëgjuar fjala përfundimtare e palëve.

Prokurorja e Prokurorisë Speciale ne fjalën përfundimtare ka deklaruar: Bazuar në provat të cilat u siguruan paraprakisht, por edhe provave tjera të cilat u siguruan dhe u administruan gjatë shqyrtimeve të mbajtura pranë këtij frupi gjykues, konsideroj se pa mëdyshje u vërtetua dyshimi i bazuar mirë, se në veprimet e të akuzuarve janë manifestuar elementet e veprave penale siç janë përshkruar ne aktakuzën e lartcekur.

Se në veprimet e të akuzuarve janë manifestuar elementet e veprave penale u vërtetua nga provat qe u administruan në shqyrtim gjyqësore dhe atë:

Nga deklaratat e te dëmtuarve- dëshmitareve Sh.P., F. E., A.S., S.M., M. K., G.H.i, M. B., H. K. K. M. etj etj (ngase janë me qindra dëshmitare të dëmtuar) dhënë pranë këtij trupi gjyqësor vërtetohet shumë qartë se E. B., përmes kompanive të sajë NSHN "E." dhe "V.-O-G." Sh.p.k., janë njoftuar qytetarët e ndryshëm se e njëjta kishte filluar ndërtimin e banesave me qëllim të shitjes me çmime shumë të volitshme. PO ashtu, vërtetohet se të dëmtuarit e kishin kontaktuar personalisht E.Bn, nga e cila janë mashtruar dhe janë joshur me çmime shumë të volitshme dhe për mundësinë e pagesës me këste. E njëjta fillimisht i ka udhëzuar të dëmtuarit për të nënshkruar para kontratë për blerjen e banesave nga e dëmtuara E. B.. Tutje, nga dëshmitë e dëshmitarëve rezulton se para nënshkrimit të para kontratës, të dëmtuarit kanë zhvilluar bisedë personalisht me te akuzuarën E.B lidhur me kohën e përfundimit të këtyre banesave. Të dëmtuarit vërtetuan se E.B iu kishte caktuar një afat kohor për ndërtimin e banesave përafërsisht 1 deri 2 vite. E akuzuara E. fillimisht ka kërkuar nga të dëmtuarit që ata të paguajnë një shumë të caktuar në emër të blerjes së banesës në xhirollogarinë e kompanisë "V.-O-G." apo edhe kesh tek vet E.. Tutje e akuzuara E., të dëmtuarve iu kishte premtuar se në rast të mos përfundimit të punëve të filluara rreth këtyre banesave, e njëjta do të bartë shpenzimet për pagesë të qirasë për secilin të dëmtuar. Lidhur me bartjen e shpenzimeve në emër te pagesës se qirasë të dëmtuarit dhe e akuzuara E. kishin hartuar edhe kontratën në formë të shkruar. Çmimi i pagesës së qirasë kishte qenë në shumë prej 200€ për muaj.

Nga dëshmitë e këtyre të dëmtuarve dhe provave që janë siguruar dhe janë administruar pranë këtij trupi gjykues, vërtetohet edhe fakti se E.B, menjëherë pasi ka kuptuar se ndonjëri nga të dëmtuarit ka bërë pagesën përmes xhirollogarisë, ka udhëzuar ndonjërin nga punëtorët e stafit që të shkoj dhe tërheq ato të holla. Të dëmtuarit po ashtu kanë deklaruar se pas një kohe të

shkurtër kanë kuptuar se nuk qëndrojnë premimet e E. lidhur me ndërtimin e banesave, çdo herë lidhur me këtë çështje të dëmtuarin bisedonin personalisht me E. dhe e njëjta iu premtoj se banE. do të ndërtohen në afatin e paraparë në para konfratë. Të dëmtuarit gjithashtu vërtetuan faktin se gjatë negociatave për ndërtimin e këtyre banesave, E. i kishte mashtruar se ka plotësuar dokumentacionin e nevojshëm për ndërtimin e këtyre banesave dhe se e njëjta është pajisur edhe me lejen e ndërtimit. Por, të dëmtuarit vërtetuan edhe fakün se pas kalimit të afatit të paraparë sipas para konfratës, edhe përkundër faktit se banE. në fjalë kishin filluar të ndërtohen, ato asnjëherë nuk kishin përfunduar. Të dëmtuarit vërtetuan faktin se të njëjtit kohë pas kohe kërkuan kthimin e të hollave që të njëjtit i kishin paguar në emër të pagesës së këstit të banesës, por asnjëherë nuk kanë arritur që ta bindin të akuzuarën E. që t'ua kthej të hollat. Përkundër këtij fakti, një pjesë shumë e vogël e të dëmtuarve kanë arritur që shumën e të hollave që ia kishin paguar të akuzuarës në emër të këstit të banesave ta marrin nga e akuzuara. PO ashtu, të dëmtuarit vërtetuan faktin se e akuzuara E. pas një kohe të gjatë ishte arsyetuar se mos realizimi i ndërtimit të objekteve sipas kontratave me të dëmtuarit ishte shkak i dI. pengesave teknike, por të njëjtëve u kishte premtuar se shumë shpejtë e njëjta do të filloj ndërtimin në një objekt tjetër dhe përsëri të njëjtëve u kishte siguruar se është pajisur me leje ndërtimi në një objekt tjetër.

Ndërsa, të dëmtuarit vërtetojnë se te akuzuarit V.B dhe B.V. kanë bërë fransportimin e tyre nga kompania "V- O-G." për t^Xi njoftuar me vend punishten ku gjëja se po ndërtohen banE.. Mirëpo, ndërtimi i atyre banesave as në lokacionin e parë e as në të dytin nuk ka ndodhur asnjëherë. Të dëmtuarit vërtetuan faktin se meqenëse banE. në lokacionin e parë nuk janë ndërtuar, të njëjtit përsëri kishte arritur mashtror e akuzuara E. me premtimin se do të ndërtojmë në një objekt tjetër këto banesa dhe iu ka ofruar nënshkrimin e para kontratave të reja. Mirëpo, të dëmtuarit kanë deklaruar se me shpresë se ndoshta kësaj radhe nuk do të jenë të mashffuar, kanë nënshkruar para kontratat e reja. Se e akuzuara E. iu ka shkaktuar dëm material në vlera të mëdha vërtetojnë të gjithë të dëmtuarit duke i prezantuar dëshmitë e pagesave përmes xhirollogarive B. are apo duke dëshmuar edhe lidhur me pagE. tjera që janë bërë kesh në kompaninë e të akuzuarës E.B. Ndërsa këtë fakt se të njëjtit kanë bërë pagesa edhe përmes xhirollogarisë B. are edhe me para në dorë tek e akuzuara në asnjë moment nuk e ka kontestuar as vet e akuzuara E..

Dëmi i shkaktuar te dëmtuarve nga veprimet e të akuzuarve të sipërcituar, nuk kontestohet as me deklaratimet e vet të akuzuarës E.B, por një gjë e tillë vërtetohet edhe nga mendimi i ekspertit financiar.

Nga dëshmitë e dëshmitarit B. G. të dhënë pranë në gjykatë, vërtetohet se i njëjti është njohur me E., ngase e njëjta kohë rënë parë kishte blerë një parcelë në lagjen Q.a, në P. në të cilën parcelë prindërit e sajë kanë ndërtuar shtëpi dhe kanë jetuar aty. Nga dëshmia e dëshmitarit B. G. , vërtetohet se i njëjti e njeh si blerëse te akuzuarën E.B, nga se ka blere materiale ndërtimorë ne vitet 2011- 2012. Tutje , ka deklaruar se kemi pasur raporte shitës _blerës, me një projekt ne P., si familje prindi i saj A. B. e ka blere një truall prej meje, ne vitin 2008 ose 2009, dhe kjo ka qenë para rastit kur kjo është paraqitur si blerëse, në kohen kur A.u e ka blere truallin unë E. nuk e kam njohur, trualli ka qene ne Q., Komunën e P.s, aty është ndërtuar një shtëpi, por nuk e di se kush banon. Çmimi është paguar në tërësi dhe ju ka përkthyer krejt ne rregullt. PO ashtu nga ky dëshmitar vërtetohet se njihet edhe me te akuzuarin V.O., ngase i njëjti ka qene blerëse i një parcele dhe e njoh si blerëse njëjti si A. B..Se i njëjti ka blere një parcelë rreth 8 ari afër A. B., mbrapa tij për afërsisht 2 Vite pasi qe A.u ne ka blere parcelën.

Nga dëshmia e dëshmitarit B. M. të dhëne pranë këtij trupi gjykues, vërtetohet se ishte njohur me të akuzuarën E. dhe se kishte freguar se kishte rënë në insulventë dhe kishte biseduar lidhur

me mundësinë e daljes nga kjo situatë. Pastaj i njëjti me qëllim që ti ndihmoj, kishte biseduar me të akuzuarën E. dhe kishin lënë një takim edhe me palët e dëmtuara. Në këtë takim kanë rënë dakord që E. ta siguroj një leje ndërtimi, pastaj të dëmtuarit shumën e mjeteve të papaguara ta bëjnë në emër të tij, i njëjti do ta merr përgjegjësinë për ndërtimin e banesave sipas para kontratave që janë lidhur në mes të E.B dhe të dëmtuarve. Por, nga ky dëshmitar vërtetohet se deri tani E. nuk i ka ofruar ndonjë vend të caktuar me leje të ndërtimit, andaj, ka deklaruar se është në gjendje që edhe tani të merr përgjegjësinë për ato objekte nëse i sigurohet leja e ndërtimit.

Nga dëshmia e të dëmtuarit S.h B., u vërtetua se i njëjti ka një kontratë me të akuzuarën E.B, sipas asaj kontrate ka qene marrëveshje qe dhe qe do te hiqet nga kompania për ndërtim te bartet ne pronën e te dëmtuarit S.h. Ndërsa, nëse nuk e heq dhe ka me paguar 5.000€ qira, mirëpo pas dy muaj nuk mu ka Iajmëruar. Tutje ka deklaruar se jam i dëmtuar nga veprimet e te akuzuarës E.B dhe se nuk mundë te vlerësohet kërkesa për demin ngase për heqjen e dheut duhet te paguan diku rreth 60-70 mijë euro.

Një gjendje e tille faktike vërtetohet edhe nga dëshmia e dëshmitarëve S. S., I. D., L. G. , S. Z. , A. V. , D.B. të dhenë pranë këy trupi gjykues nga të cilat vërtetohet se E. B. kishte arritur marrëveshje me pronarët e tokës që të investoj me projekte të caktuara dhe kishin arritur marrëveshje rreth përqindjes që do të përfitonte secili. Po ashtu nga dëshmia e këtyre dëshmitarëve, shumë qartë vërtetohet se të njëjtit kishin pasur marrëveshje me E. se e njëjta fillimisht të pajiset me leje të ndërtimit, pastaj të fillohet me ndërtimin.

Po ashtu nga provat materiale të cilat janë administruar pranë këtij trupi gjykues, vërtetohet se e akuzuara E. B. me datë 15.04.2009 kishte lidhur konffatë për ndërtim të përbashkët të kompleksit të lokaleve afariste dhe banesave me pronarët S. S., I. D., L. G., S. Z. dhe A. V.. Gjithashtu, vërtetohet se me datë 08.09.2009 lidhur me këtë ndërtim të përbashkët është lidhur deklaratë mbi participimin e përbashkët në mes E.B dhe XH.A.t.

Para kontratat e lidhura në mes të dëmtuarve dhe E.Bt, deklaratat, konfirmimet e transaksioneve, kopjet e dokumenteve identifikuese, urdhërpagE. dhe ankeskontratat pa mëdyshje vërtetojnë se në mes të dëmtuarve dhe te akuzuarës E.Bt janë lidhur para kontratë për blerjen e banesave në të cilat para kontrata janë specifikuar tek secili i dëmtuar kushtet e ndërtimit, specifikat tjera si dhe mundësitë e pagesave me këste. Po ashtu, vërtetohet se e akuzuara E. ka marrë obligim me shkrim që po qe se ndërtimi i këtyre objekteve nuk përfundon në kohën siç është paraparë në kontratë, e njëjta do ti bartë shpenzimet në emër të qirasë për secilin të dëmtuar.

Ndërkaq, vërtetohet se me datë 12.05.2010 është bërë pezullimi i kontratës lidhur me investimet e përbashkëta në mes E.B dhe XH.A..

Një gjendje e tille faktike është vërtetuar edhe nga provat materiale dhe atë:

- Nga kontrata për ndërtimin e përbashkët të kompleksit të lokaleve afariste dhe banesave - pronaret (I. D., L. G., S. Z., A. V.) dhe E.B, e datës 15.04.2009; Njoffimi për pezullim të kontratës së lidhur për bashke investim në ndërtimin e përbashkët të kompleksit të lokaleve afariste dhe banesave, i datës 12.05.2010; Marrëveshja mbi shkëputjen e kontratës për ndërtimin e përbashkët të kompleksit të lokaleve afartiste dhe banesave I. D., E.B dhe XH.A., e datës 07.05.2009; Marrëveshje mbi shkëputjen e kontratës ne mes te B. B. E.B dhe XH.A., datë 27.05.2009; Aktvendim i caktohet kompensimi për rregullimin e tokës ndërtimore: B. M., A. V., B. B., I. D., B. M., S. Z., L. G., A. S., dhe N. S. si dhe investitori V. O G., datë 25.06.2010; Konkluzion A. G. dhe NPN H., datë 01.03.2012; Autorizim V. O GRAQANICE - XH.A., datë 03.06.2011; Deklarate ne mes te E.Bt dhe XH.A., datë 01.08.2011; Marrëveshje mbi shkëputjen

e kontratës për ndërtimin e përbashkët ne mes te I. D., E.B dhe XH.A., datë 15.06.2011; Kontrate mbi ndërtimin e përbashkët ne mes te I. D., L. G., S. Z., A. V., datë 06.03.2012; Aktvendim u lejohet ndërtimi i objektit ne mes te I. D., L. G. S. Z. A. V. me investitor A. G.E,me përfaqësues D.B., datë 12.02.2013; Aneks kontrate I. D.,L. G., S. Z., A. V., B. M. , N. S., A. S., I. D., B, B, dhe E. B., datë 15.04.2009; Kërkesë, datë 14.05.2013; Informim lidhur me kërkesën e kompaninë ndërëmor V. O G. te përfaqësues nga E.B, datë 21.05.2013; Informate nga Plani rregullues M. ., datë 10.06.2009; Konkluzion para projektit, datë 11.08.2009; Konkluzion - zgjedhja e projektit ideor si faza e pare ne kompleksion V. O G., datë 05.12.2009; Leje urbanistike, datë 07.08.2009; Deklarate mbi participimin e ndërtimin e objektit afaristo banesor ne mes te probnareve te tokave, E.B dhe XH.A., datë 08.09.2009; Kontrate - marrëveshje per kompenzim ne mes te A. G. dhe XH.A.t, datë 10.10.2012; Leje ndërëmi, datë 11.06.2010; Kërkesë për marrjen e inforM.ve, datë 14.06.2013; Procesverbalet mbi marrjen ne pyetje te dëshmitarit S. Z., L. G., N. S., I. D., datë 24.10.2014 dhe, datë 23.10.2014; NjofHm nga ARBK, datë 25.06.2013; Përgjigje për kërkesë nga ATK - V. O G., , " E." N.SH.N dhe Hamburger "E.", datë 25.06.2013; Informim nga K. e P.s, datë 05.06.2014; Kërkesë për marrjen e informatave, datë 14.06.2013; Certificate e regjistrimit te biznesit V. O G., datë 08.05.2012; Kontrate për transferimin e pronësisë dhe shuarjen e borxhit ref. ...-./....., Para kontratë për shitblerjen e banesës, datë 24.10.2007; Kontratë mbi shitblerjen e patundshmërisë ne mes te B. G. dhe A. B. 23.06.2008; Aktvendim i caktohet taksa ne transaksion te pronës se patundshme ne shume prej 150 euro A. B., datë 14.08.2008; Kopje e planit - Drejtoria e Urbanizmit , Kadastrit dhe te mbrojtjes dhe mjedisit, datë 10.09.2008; Transaksion ne mes te E. B.t dhe V.O.t W. U., datë 05.11.2007; Fletë dërgesë, datë 23.05.2013; Certificate martese ne mes te A. B.t dhe Xh. B.t, datë 20.04.2011; Kontrate mbi shitblerjeje e patundshmërisë ne mes te XH.A.t dhe M. T., datë 10.04.2015; Marrëveshje ne mes te F.H. Xh. dhe E.Bt, datë 22.05.2013; Kontrate për ndërëfinim e përbashkët te kompleksit te lokaleve afariste dhe banesave M. B. dhe E.B, datë 02.03.2009; Kontrate për ndërëtim te përbashkët te kompleksit te lokaleve afariste dhe banesave ne mes te N. S. A., R.je H. A. dhe E.Bt, datë 19.04.2012. Nga ekspertiza e ekspertit financiar si dhe nga raporti final i ATK-së.

Sa i përket pikës I te dispotivit te aktakuzës, një gjendje e tille vërtetohet edhe nga mbrojtja e të akuzuarës E.B, por edhe nga provat materiale dhe nga deklarata e te pandehurve, dëshmitareve të dëmtuarve , vërtetohet se e njëjta fillimisht ka hapur firmën RTP "E.", pastaj duke e parë se me SHPK po lejohet ndërërimi i lartë, ka hapur firmën e re SHPK "V. O G." diku në vitin 2010 dhe se në atë firmë ka punësuar fillimisht B.V.n i cili kishte për detyrë që ti merrte klientët prej zyrës dhe ti dërgonte në vend punishte që ka qenë në lagjen M... tek objekti që ka pasur të ndërëtohej. I njëjti ka qenë u punësuar me kontratë dhe pagesa i është bërë përmes xhirollogarisë Bankare. Po ashtu vërtetohet se në pozitë të njëjtë sikurse B.V. ka qenë edhe V.B. E akuzuara E. ka deklaruar se fillimisht ka qenë duke punuar në R.B. kur e ka njohur të akuzuarin B.V. i cili në atë kohë është marrë me ndërërmjetësimin e shit-blerjes së pronave. Nga e njëjta vërtetohet se përveç dy të akuzuarve B. dhe V., në kompaninë V. O G.ka qenë e punësuar edhe T. B. e cila ka qenë e autorizuar që ti tërheq mjetet nga B.a dhe se e njëjta çdo herë ka vepruar sipas autorizimit të akuzuarës E., po ashtu ka qenë i punësuar edhe arkitekti Xh. I. i cili iu ka shpjeguar klientëve projektin që ka qenë i vendosur në mur. Nga e akuzuara vërtetohet se i akuzuari B.V., për gjetjen e një lokacioni ku do të ndërëtohen banesa iu kishte premtuar nga E. se në përfundim të atij objekti do të përëfitonte një banesë, një lokal dhe garazh, të cilat premtime nuk janë realizuar. Por nga e njëjta vërtetohet se me pronarët e tokave në lokacionin e parë është njoftuar përmes B.V.t, por, marrëveshjet dhe çdo gjë tjetër rreth ndërëtimit i ka bërë vet E.. Se lokacioni i parë ka qenë në M. ., se kontrata me pronarët e tokave në lokacionin e parë janë vërtetuar në Gjykatën Themelore në P. dhe se pas parashtrimit të kërkesës në Komunën e P.s, duke ia bashkëngjitur dokumentacionin e nevojshëm, të njëjtës i është lëshuar leja urbanistike, nga e

njëjta vërtetohet se ka filluar ndërimin e objekteve, por ka hasur në pengesa për shkak të një gypi që e kishte vendosur KFOR-i N. e që anashkalimi i këHj gypi kishte kosto shumë të lartë, ndërkohë kishin filluar mosmarrëveshjet në mes E. dhe pronarët e tokave, sidomos I. kërkuar që e njëjta të mos vazhdoj punën ngase të njëjtit do të gjejnë një kompani tjetër për ndërtim I. D., L. G., I. G. dhe G. Z. me ç'rast edhe i kishin ndërprerë kontratat me të akuzuarën E..

Andaj, duke pasur parasysh se në pikën e I-re të dispozitivit sipas Aktakuzës E.B, V.B dhe B.V., janë akuzuar se kanë kryer veprën penale Krim i organizuar nga neni 274 par. 1 lidhur me par. 2 e në raport me E.B par. 3 të KPK-së (i vjetri), lidhur me veprën penale Mashtrim nga neni 261 par. 1 lidhur me par. 2 të KPK-së (i vjetri), nga provat e lartcekrua , pa mëdyshje vërtetohet se ne veprimet e te pandehurve E.B, V.B dhe B.V., janë manifestuar elementet e veprës penale Krim i organizuar nga neni 274 par. 1 lidhur me par. 2 e në raport me E.B par. 3 të KPK-së (i vjetri), lidhur me veprën penale Mashtrim nga neni 261 par. 1 lidhur me par. 2 të KPK-së (i vjetri). Kjo ngase për ekzistimin e kësaj vepre penale duhet të përmbushen katër karakteristika mandatore që pa këto nuk do të mund të ekzistoj krimi i organizuar, si dhe së paku dy nga karakteristikat alternative të cilat formojnë krimin e organizuar. Këto katër karakteristika bazë për të ekzistuar krimi i organizuar janë: 1. Përfshirja e tre apo më shumë personave si gup i organizuar kriminal; 2. Për periudhë të gjatë ose të pacaktuar kohore; 3. Të dyshuar apo të dënuar për vepra penale të rënda për të cilat përcaktohet dënim me katër vite burgim apo më shumë si dhe 4. Qëllimi i përfitimit material.

Në rastin konkret , nuk ka dilemë sa i përket qëllimit te përfitimit material, se në rast-in konkret janë të përfshirë në këtë vepër penale tre persona. Po ashtu , u gjatë seancave gjyqësore u vërtetua se ky G. është formuar me qëllim për të vepruar për një periudhë të caktuar kohore edhe përkundër faktit se ky G. ka vepruar, mund të thuhet se ky G. ka vepruar në një periudhë të gjatë kohore për ta ushtruar këtë veprimtari kriminale. Pra, u vërtetua se kanë vepruar për një periudhë kohore si G. i organizuar, edhe pse ne lidhje familjare, ky G. mund të cilësohet si ndërmarrësi kriminale në drejtim të kryerjes së një vepre të një natyre të caktuar apo veprave të natyrave të ndryshme kriminale dhe me qëllim te vetëm përfitimi material. Kjo ngase ky G. i përberë prej tre te akuzuarve E.B, V.B dhe B.V., me paraqitjen e fakteve të rreme , gjoja se është pajisur me lejen e nderimit, kanë mashtruar të dëmtuarit , duke iu paraqitur oferta të volitshme për blerjen e banesave pa i siguruar fare leje të ndërtimit, pastaj të akuzuarit V.B dhe B.V. duke vepruar sipas sugjerimeve të akuzuarës E. B., në bashkëveprim kanë dërguar të dëmtuarit në lokacionin ku ishte vend punishtja për ndërtimin e banesave, pastaj e akuzuara E.B ka lidhur kontrata të favorshme për të dëmtuarit në atë mënyrë që në vazhdimësi iu ka shkaktuar dëm të dëmtuarve në shuma të mëdha – ndryshme, më tuje prokurorja e ka paraqitur shumat për secilin të dëmtuar veç e veç, ashtu që të akuzuarit kanë përfituar shumën prej 1.872,719.00 euro, në mënyre te kundërligjshme .

Andaj, pika e I-re e aktakuzës sa i përket përffimit te te pandehurve precizohet ne ketë shume 1.872,719.oo euro.

Sa i përket pikës II kundër te akuzuarve E.B , Xh. A. , B.V. , V.O. dhe F.O. , provat e lartcekura po ashtu vërtetojnë se në veprimet e të akuzuarve, janë manifestuar elementet e veprave penale siç janë përshkruar në diapozitivin e kësaj aktakuze, kjo ngase:

-u vërtetua se XH.A. ne bashkëveprim me te akuzuarën E. B. objektin të cilin e akuzuara E. e ka filluar ta ndërtoj me mjete financiare të përfituara me aktivitet kriminal, i njëjti nga e akuzuara E.B ka pranuar autorizimin i vërtetuar ne Gjykatën Themelore Prishtinë - Dega ne Graqanice i datës 01.08.2011, me të cilin e autorizon të akuzuarin XH.A.n që në mënyrë gjeneralë dhe pa kufizime të përfaqësoj në emër personal dhe në emër të firmës "V. - O – G." me pronaret e tokave sipas kontratave për patundshmëritë lidhur me ndërtimin e banesave, pasi qe e akuzuara

E. kishte krijuar obligime ndaj pronareve të truallit. Ashtu që i akuzuari XH.A.n, vërteton se heq dorë nga implementimi i Kontratës për ndërtimin e banesave dhe lokaleve afariste të legalizuara pran Gjykatës Komunale në P. VR. Nr..... dt., Vr. nr./.... .., vr. Nr./.... dt., dorëheqjen e bene ne favor te te akuzuarit XH.A., ndërsa obligimet ndaj blerësve të banesave, dhe pune kryerësve mbesin obligim i të akuzuarës E.Bt, dhe ne fund që te humbet gjurmët edhe me shume i akuzuari Xh. A. me datë 16 Janar 2012 nënshkruan marrëveshje për Investime të përbashkëta me biznesin "A. G.SH.A" me pronar D.B. për ndërtimin e banesave dhe lokaleve afariste të cekura si më lartë;

-u vërtetua se i akuzuari B.V. ne periudhën kohore të përshkruar si nën piken 1 të këuj dispozitivi, duke ditur se E. B. dhe vet, mjetet financiare i kanë përfituar me aktivitet kriminal, me qellim që ato mjete financiare ti konvertoi, transferoi pasurin me qellim të fshehjes, apo te maskimit te natyrës, B.it, vendit dispozicionit të mjeteve financiare, nga e akuzuara E.B ka pranuar një banesë, një automjet V., një dhome fjetje, shpenzimet për dasme, shpenzimet për pushime verore dhe shpenzime tjera.

Ndërsa, po ashtu u vërtetua se i akuzuari V.O. ne periodën kohore te përshkruar si nen piken 1 te këtij dispozitivi duke ditur se e akuzuara E.B mjetet financiare i ka përfituar me aktivitet kriminal me qellim që ato mjete financiare ti fshehi, maskoi me qellim te ndihmës nga e akuzuara E. B. me datat te ndryshme gjatë viteve 2009, 2010 dhe 2011 përmes xhirollogarisë personale pran W. U. ne D.ë ka pranuar mjete financiare ne vlerë prej 16.000,00 euro, pastaj me datën ne D.ë ka pranuar shumen e te hollave në vlerë prej 14.600.00 euro nga A.B., ne emër te pagesës se borxhit për blerjen e një banese, po ashtu nga E., me datën 29 01 2010 pranon një veturë xhip H. i X. në vlerë prej 35,300.00 euro dhe nga mjetet financiar te përfituara nga e akuzara E. B. , V.O.t ka blere një truall ne fshatin LL. K.e P.s, ne sipërfaqe prej 5 ari (500 m2).

Ppo ashtu u vërtetua se i akuzuari F.O. dhe V.O. , me datën 30 Shtator 2009 ne Lagjen Q. ne P., duke ditur ose ka pas arsye që ta di se mjetet financiare te E.Bt me te cilat është blere ffualli kane B.in nga aktiviteti kriminal si nen piken I te këtij aktvendimi një pjese te mjeteve financiare ka konvertuar dhe transferuar me qellim te ndihmës duke tentuar që te fshehe gjurmët e mjeteve financiare pranon dhe bartë në pronësi të veten truallin e blere nga E.B. Ketë e bene përmes nënshkrimit te konfratës ne mes te B. G. dhe F. O. me te cilën kontratë ka pranuar truallin për ndërtimin ne sipërfaqe prej 7,5 ari ne në te cilin truall janë ndërtuar dy shtëpi dykatëshe me nga dy hyrje.

Përkundër fakün se ekspertiza e eksperiti fiancair ka konstatuare dhe shumat që këta te pandehur i kane nga përfitimet e tyre, nuk është kontestuese as fakti se me datat te ndryshme gjatë viteve 2009, 2010 dhe 2011 përmes xhirollogarisë personale pran W. U. ne D.ë ka pranuar mjete financiare ne vlerë prej 16000,00 euro, pastaj me datën 04 Shtator 2010 ne D.ë ka pranuar shumen e te hollave në vlerë prej 14.600.00 euro nga A.B., ne emër te pagesës se borxhit për blerjen e një banese, po ashtu nga E., me datën 29 01 2010 pranon një veturë xh. H. i në vlerë prej 35,300.00 euro.

Sa i përket pikës III kundër te akuzuarës E. B. , provat e lartcekura po ashtu vërtetojnë se në veprimet e të akuzuarve, janë manifestuar elementet e veprave penale siq janë përshkruar në diapozitivin e kësaj aktakuze, kjo ngase:

-nga provat te cilat i administruan pa mëdyshje u vërtetuar se akuzuara E.B, si personi përgjegjës në organizatën e biznesit e cila, ka ditur për paaftësinë pagese të organizatës së biznesit dhe me shpenzimin joracional të mjeteve apo transferim, me marrjen përsipër të detyrimeve jo proporcionale, ka shkaktuar falimentimin subjektiv të saj biznesi "V. O G." SH.P.K me nr.,

te regjistruar me, duke vepruar me kapacitet e saj si personi përgjegjës ne organizatën e biznesit te saj duke ditur paaftësinë ndërtuese te organizatës se biznesit, ka lidhur para kontrate me çmime të ulëta, duke ju ofruar kushte të favorshme klientëve për blerjen e banesave, e nga të cilët ka argëtuar shuma të konsiderueshme parash duke mos i përdorë për qëllim te parapare, ndërtimin e objektit banesor të ofertuar klientëve, e akuzuara E.B, duke e ditur paraprakisht që me veprimet e saja do të jete pamundur kostoja e ndërtimit të banesave dhe realizimin i marrëveshjeve me para konfrata, e me te cilat veprime praktikisht ka shkaktuar falimentimin e biznesit te saj "V. - O – G." të cilin biznes e akuzuara e kishte themeluar me qëllim të realizimit të përfitimeve financiare të kundërligjshme.

Sa i përket pikës IV kundër te akuzuarës E.B , provat e lartcekura po ashtu vërtetojnë se në veprimet e të akuzuarve, janë manifestuar elementet e veprave penale siç janë përshkruar në diapozitivin e kësaj aktakuze, kjo ngase:

-nga Raporti i ekspertizës financiare dhe Raporti Final nga ATK , pa mëdyshje u vërtetuar se nga data 01. Janar 2010 der me 31 Dhjetor 2012 duke ofruar përmes biznesit te saj privat "V. - O-G.", SH.P.K me nr..... ne rruga "R. L." /. P., me aktivitet kryesor ndërfitimi i ulte dhe i larte e njëjta iu ka shmange tatimit, me qëllim te fshehjes te përsëritshme te obligimeve buxhetore, ne emër te pagesës se tatimit te te gjitha llojeve qe kërkohen me ligj ka prezantua te dhëna te pavërteta lidhur me te ardhurat e biznesit te saj për gjendjen ekonomike dhe fakteve tjera relevante rreth gjendjes financiare, kështu qe ka bere shmangie tatimit ne vlere prej 80.610,50 euro.

Andaj i nderuari trupi gjykues, meqenëse në veprimet e të akuzuarve janë manifestuar elementet e veprave penale të lartcekura, duke pasur parasysh se të njëjtët janë penalisht përgjegjës, ngase nuk ekziston asnjë rrethanë e Cila e përjashton përgjegjësinë e tyre penale, duke vlerësuar edhe rrethanat e kryerjes së veprës penale si ato lehtësuese po ashtu ato rënduese, të njëjtit të shpallen fajtor dhe të dënohen siç parashihet me KPRK si dhe bazuar ne dispozitën e nenit 458 te KPP-se , duke pasur parasysh se ne rastin konkret demi qe i është shkaktuar secilit nga te dëmtuarit është përcaktuar në ekspertizën e ekspertit financiar, por edhe nuk është kontestuar as nga vet e akuzuara E.B, propozojnë që gjykata te shaplla fajtor te akuzarit dhe tu shqipton dënimit sic parashihet me KPR, si dhe ti obligoj te akuzuarat qe të te dëmtuarve t\ua kompensoj shumën e demit te shkaktuar.

Andaj, propozojmë që konform nenit 284 par. 1 dhe 3 të KPPK-së, të konfiskohen asetet të cilat janë specifikuar në Aktakuzën PPS nr. 04/2015 të datës 12 maj 2016.

Te dëmtuarit ne fjalën përfundimtare kane deklaruar: S. H., deklaron se e mbështes fjalën përfundimtare te prokurores dhe kam kerkese për dëmshpërblim te cilën e kam paraqitur me pare ne gjykate.

E dëmtuara A. K. e mbështes fjalën përfundimtarë te prokurores , kërkon qe ti kthene mjetet e saj dhe po ashtu deklarohem edhe plër motrën time V. M., për mjetet e qe i ka dhene.

E dëmtuara F. Sh. e mbështes fjalën përfundimtarë te prokurores , kam kerkese për dëmshpërblim, përveq asaj qe kam paraqitur une kërkoj edhe dëmshpërblim edhe per vuajtje qe me ka shkaktuar.

I dëmtuarit S. B. deklaron e mbështes fjalën përfundimtarë te prokurores se shtetit, dhe deklaratës te cilën e kam dhene me përpara i kerkoj mjetet e mija materiale me mi kthyer me kamat ligjore.

I dëmtuari L. e mbështes fjalën përfundimtarë te prokurores, te gjitha deshmit qe i ka pasur i kam dorëzuar ne polici dhe pas kësaj kam parashtruar padi pë kthyerjen e mjeteve.

I dëmtuari Gjykatën B., e mbështes fjalën përfundimtarë te prokurores, kërkoi kthimin e mjeteve ne baze te kontratës qe e kemi nënshkruar me palën e akuzuar, dhe ne kerkesn tim janë te gjitha te specifikuar te gjitha dëshmitë e pagesave përmes B. R. Kerkene për demshperlëbim e kam paraqitur ne seancën e me pareparme.

I dëmtuari I. R., e mbështes fjalën përfundimtarë te prokurores, qëndroi pranë dëshmisë qe ekam dhjenë ne kete salle dhe kërkoi qe te me kthene mjetet.

I dëmtuari H. K. e mbështes fjalën përfundimtarë te prokurores, qëndroi pranë dëshmisë time qe e kam dhene paraqitur, kërkesën për demshperlbim, dhe obligimet te cilat i ka marrë ne baze te para kontratës.

I dëmtuari A. M., e mbështes fjalën përfundimtarë te prokurores, kërkoi mjetet e mija ne shumen prej 23.000 euro qe përfshinë mjetet e mija dhe kamatën.

I dëmtuari V.K. e mbështes fjalën përfundimtarë te prokurores, dhe kërkoi vetem te hollat e mija, asgjë me shume.

I dëmtuari I. A., e mbështes fjalën përfundimtarë te prokurores, kërkoi qe te me kthehet shuma me demshperlbim për shkak se te hollat i kam pasur kredi, kërkesën e kam paraqitur parapçrakishte por tani kërkoi edhe kërkesën për demshperlëbim sipas para kontratës per pagesën e qiras, te gjitha janë te foto kopjuar.

I dëmtuari R. N. e mbështes fjalën përfundimtarë te prokurores dhe kërkoi kthimin e mjeteve qe i kam dhene

I dëmtuari I. A., e mbështes fjalën përfundimtarë te prokurores, dhe kërkoi kthimin e mjeteve te cilat i kam dhënë.

E dëmtuara M. H., e mbështes fjalën përfundimtarë te prokurores, kërkoi paret te cilat ja kam dhene E. dhe te gjitha kompozimet morale dhe materiale qe mu kane shkaktuar si pasoje e veprime te saj.

I dëmtuari O. S. përfaqësues i të dëmtuarit Sh.S. ka deklaruar se mbështes fjalën përfundimtarë te prokurores, dhe pres kthimin e mjeteve qe i kam dhene, para kontratën dhe pagesën ne R. e kmi dorezur paraprakisht. Dhe shuma është 11.200 euro.

I dëmtuari Gjykatën S. e mbështes fjalën përfundimtarë te prokurores, kërkoi kompozimin e demit dhe ate mjetet e mija, dhe dëmshpërblim me kamat ligjore

I dëmtuari Q.K. e mbështes fjalën përfundimtarë te prokurores, dhe mbetem pranë deklaratës qe kam dhene ne polici, meqenëse për momentin jame ne banese te E., dhe qëndroi pranë deklaratës qe te qendoi ne ate banese, nese vendoset ndryshe atëherë te me kthete investimi i nevojshëm qe kam bere ne banese.

I dëmtuari N. M. e mbështes fjalën përfundimtarë te prokurores para gjykatës kërkoi banesën sipas kontratës nese nuk ka banese atëherë te me kthehen mjetet te cilën e kam deklaura ne rast te dhenjes se deklaratës.

I dëmtuari F. G. e mbështes fjalën përfundimtarë te prokurores po ashtu kërkoi kthimin e mjeteve dhe ne rast nena është e dëmtuara nena e ndjer S.M., e te cilën është deklaruar edhe vëllai im dhe shume e kërkuar është 10.000 mije euro.

E dëmtuara Sh. H., e mbështes fjalën përfundimtarë te prokurores, mbes pranë deklaratës qe kam dhene këtu, kërkoi kompozimin e mjeteve mjeteve qe i kam dhene.

Mbrojtësi i te akuzuarës E. B. *av. L.T ne fjalën e tij përfundimtare* ka deklaruar se fjalën përfundimtare e ka paraqitur me shkrim, të njëjtën e ka lexuar ku dhe ka theksuar:

Në piken e parë të aktakuzes ku e mbrojtura ime akuzohet për veprat penale "Krim i organizuar " nga neni 274 par. 1 me par. 2 dhe me par 3, të KPK- së (i vjetri) lidhur me vepren penale " Mashtrimit " nga neni 261 par. 1 lidhur me par. 2, të KPK- së (i vjetri), konsideroj se pretendimet e prokurorisë sa i perket krimit të organizuar nuk qendrojnë për shkak se prokuroria në asnjë rast nuk mund të provojë se personat e tjerë, kanë kryer veprime qe ju kanë ofertuar blersve për blerjen e banesave, kjo vertetohet dhe me faktin se te gjith deshmitaret — demtuarit deklarojne se per oferten kane degjuar nga B.e te ndryshme — e kanë pasur dikend të afërt qe e ka bërë marrveshje për blerjen e banesave por ne asnje moment, asnje nga ta nuk deklarone se ka negociuar, ka bërë marrveshje me dikend tjetër perpos E. B. të mbrojtures time, me asnje prove tjetër materiale nuk deshmon se eshte negociuar me dikend tjetër, po ashtu dhe në aktakuzë, në faqen 35 rreshti 41 e deri ne ftnd të paragrafit thuhet se V.B dhe B.V. vetem i kanë bartur klientat deri në vendpunishte dhe as prokuroria nuk pretendon qe kanë bërë diçka tjetër dhe vetem me këtë veprim të tyre konsideron qe kanë kryer krim të organizuar ku per punet tjera asnje njohuri nuk kanë pasur njohuri, si duket prokuroria vetem për ta permbushur kushtin prej 3 personave qe nevoiten per kete kualifikim i ka futur keta dy si emra.

Vepra tjetër qe nderlidhet me krimin e organizuar - " Mashtrimit " nga neni 261 par. 1 lidhur me par. 2, të KPK- së (i vjetri), fillimisht konstatimet e prokurorisë lidhur me mashfimin janë të pa sakta ku ne aktakuzë faqe 35 rreshti 27 thuhet se blesit tani sipas aktakuzes të demtuar kanë degjuar se E.B permes kompanisë "V. O G." po nderton dhe po shet banesa me çmim të volitshëm (çmimi nuk ka qenë i pa mbulueshem per ndertimin e banesave per shkak se 650 euro m2) negociatat dhe marrveshjet janë bërë me E.B. ku veprimet që i ka nderrmar E. nuk tregojnë qe ka pasur per qellim mashtrimin per arsye semarrveshjet - parakontratat me të gjith blesit perveqse i ka perpiluar me shkrim vullnetarisht ka bere deklarata te vertetuara ne gjykate se secili klient sa i mjete ka dhene dhe se cka ju detyrohet, si mundet dikush qe e ka per qellim mashtrimin ta beje nje gje te tille e po ashtu dhe menjhere pas kesaj E.B permes kompanise se sajë ka konfraktuar lokacionin e ndertimit te ketyre objektve te parapara sipas planit, po ashtu ka aplikuar dhe e ka marre lejen urbanistike per kete ndertim (ku leja urbanistike ne ate kohe ka lejuar te mirren veprime ndertimore deri sa te mirret dhe leja e ndertimit punimet kane filluar. Tentimi per te marrur lejen e ndertimit, gjate punimeve siç pohohet ne deklaratat e dhena ne shqyrtim gjyqesor të dates 31.11.2021 dhe nga vet pronaret e tokes ku ka filluar ndertimi, pranojnë se gjatë punimeve është paraqitur nje gyp i ujit i cili ka shkaktuar problemin e mos realizimit te ndertimit sipas planit dhe prishjes se raporteve mes E.B. dhe pronarve te kesaj toke.

Qe ka qene problem heqja e gypit te ujit ne deklaraten e dhene ndertuesi i mepastajem ne kete lokacion se gypi eshte hequr vetem pas 6-7 viteve dhe se mos ndertimi i objektit deshmohe se ka pasur pengesa reale dhe te provuara, qeshtje tjetër per te cilen prokuroria pretendon eshte nderrimi shpesht i zyreve te kompanise e qe nuk e kuptoj per deri sa ka pasur kontakt nga te tri zyret me klient si mund te pretendohet se eshte bere me qellim te mashtrimit, mashtrim do te

ishte po te ikte ose tentonte te ikte, e jo nderrimi i lokacionit. Pas problemeve të lidhur me gypin dhe pronaret ne lokacionin e pare E.B sikur te kishte qellim mashtrimin ka pasur mjete te mjaftueshme nuk do te gjente lokacion tjeter per realizimin e marrveshjes per ndertimin e objekteve banesore sipas planit ku e ka bere marrveshje me pronaret e lokacionit tjeter per ndertimin e objekteve banesore sipas planit dhe sipas marrveshjes me blersit. Ne lokacionin e dyte jane paraqitur probleme reale qe e kane nderprere punen — kontesti i pronarve te tokes me persona te trete lidhur me kete prone ku ka filluar ndertimi me vendim mase ndalimi dhe pastaj procedura e hetimit dhe ndjekjes penale ndaj te mrojtues time dhe tjerve, andaj me provat e propozuara nga prokuroria nuk mund te provohet se e mbrojtura ime eshte pergjegjese per veprat penale si ne piken e pare.

Në piken e dytë të aktakuzes është akuzuar se ka shkelur ligjin Parandalimin e Shperlarjes së Parave dhe Financimin e Terrorizmit konkretisht vepren penale Shperlarje e Parave nga neni 32 pika 2.1, 2.2, 25, dhe 2.6, në bashkëkryerje lidhur me 31 të KPK- së, se bashku me Themelore A., B.V., V.O. dhe F.O., ku Xh. A. se bashku me E.B.n pretendohet se me rastin e autorizimit te E. per Xh. A.n te negocioi me pronaret e tokes me- qellim qe te shkeputet kontrata mes tyre per arsye se raportet me E.B. ishin perkeqesuar dhe se Xh. A. ka kryer nje sherbim të cilin se nga ka mundur te ndodh shperlarje e parave nuk eshte qartë, ndersa autorizimin per te gjetur ne ate lokacion investitor tjeter nga Xh. A. nuk ka perfltuar asnje mjet financiar vetem se investimi qe eshte bere ne ate lokacion i eshte Ilogaritur investitorit te ri per aq sa ka pasur ndertim, sepse Xh. A. ka pasur marrveshje si te gjith te tjeret per te blere banesa dhe lokale, shperlarja si ka mundur te ndodh? kur Themelore A. ka negociuar me investitorin e ri me ndertimin qe eshte bere e jo me rnjete monetare dhe si rrjedhoje nuk ka logjike per shperlarje te parave. Kurse per B.V.n ka qene marrveshja qe ta gjeje lokacionin per ndertim dhe si shperblim ti takoj nje banese dhe pasi qe nuk eshte ndertuar B.V. ka mbetur pa banese ndersa sa i perket shpenzimeve te dhomes se fJettes dhe pushimeve dhe dasmes kur behet fJale per vlere milionshe e te shperlahen parate - po e zeme dhjet mije euro, nuk eshte akuze serioze. V.O. se bashku me E. akuzohen se kane shperlare para permes W. U. V.O. ka pranuar nje here 16 mije dhe nje here 14 mije e gjashqind euro nga A. B. i cili eshte bleser i baneses tek kompania e E.Bt dhe jane dhene per pagesen e nje pjese te baneses. F.O. ka blere nga B. G. truall dhe ka ndertuar shtepi me dy hymje ne lagien Q. ndersa prokuroria pretendon se jane blere me para te te demtuarve sipas aktakuzes dhe se nuk e fakton kete pretendim me asnje prove te vetme madje F.O. e provon se me mjetet te cilat eshte blere kjo prone jane prone e familjes se tij — ku e verteton dhe B.in e tyre dhe prap prokuroria nuk heq dore nga ky pretendim i pa provuar, ku me keto pretendime nuk mund te vertetohet se ka pasur shperlarje te parave sipas pikes dy.

Në piken III të akuzohet se ka kryer vepren penale Shkaktimi i Falimentimit nga neni 234 të të KPK- së (i vjetri), ku ne pretendimin e prokurorise thuhet se E.B si personi pergjegjes ne organizaten e bimesit e Cila duke e ditur paaftesine paguese te organizates se bimesit, me shpenzim joracional te mjeteve apo transferin e tyre me cmim tejet te ulet, me ngarkim te tepruar me borgj, me marrjen persiper te detyrimeve jo proporcionale, ka shkaktuar falimentimin e subjektit te saje bimesor "V. O G." SH.P.K. prokuroria nuk e paraqet asnje fakt te vetem se si e mbrojtura ime ka bere marrveshje te pa favorshme dhe si e verteton mos aftesine paguese kur nuk eshte bere asnje ekspertize se sa do te kushtonin objektet banesore ne teresi, sipas planit te parapare dhe se nese cmimet kane qene aq te ulta sa kushton kostoja per etazhe ndertimi — banese , sa ka qene koha e planifikuar e ndertimit, sa mjete do ti siguronte deri ne ndertimin e objektit ne teresi dhe nese do ti mbuL.te ndertimin me ato mjete te cilat i ka pasur ne dispozicion, prokuroria gjykata e akuzon E.B. ndersa nuk ka bere asnje vlersim te investimeve te bera ne te dy lokacionet ku eshte ndertuar aq sa eshte ndertuar dhe se nuk ka asnje procesverbal mbi nivelin e ndertimit dhe sendeve te luajshme te cilat kane qe te gatshme per ndertim dhe vlere e tyre. Pas

arrestimit të sajë në objektin e dytë nuk është siguruar dhe vlersuar sasia dhe vlera e investuar andaj pretendimet e prokurorie janë të bazuara në supozime të cilat nuk mund të provojë.

Në piken IV akuzohet se ka kryer veprën penale Shmangeje nga Tatimi neni 249 par. 1 lidhur me par 2 të KPK- së (i vjetri) prokuroria pretendon se me vet faktin e mos deklarimit ose mospageses së obligimeve tatimore konsumohet kjo veprë penale gjë që nuk është e vertetë, për shkak se ky nen kërkon kushdo që me qëllim i shmanget pjeserisht ose teresisht pA.it të tatimit, tarifave apo kontributeve jep të dhëna të pa verteta e që në këto rast ka pasur vetëm mospermbushje të detyrimeve tatimore.

Konsideron se nuk ka as një provë që në mënyrë të prerë dhe bindëse vërtetojë aktakuzën dhe fajësinë e të mbrojturës time, nuk ka fakte që mbështesin përgjegjësin penale - eventuale të sajë për veprat me të cilën akuzohet sipas aktakuzës kështu që mendoj me bindje të plot se i mbrojtura ime është plotësisht e pafajshme dhe kërkoj nga gjykata që ta liroj nga aktakuza sepse nuk është provuar se ka kryer veprat penale "Krim i organizuar " nga neni 274 par. 1 me par. 2 dhe me par 3, të KPK- së (i vjetri) lidhur me veprën penale " Mashtrimit " nga neni 261 par. 1 lidhur me par. 2, të KPK- së (i vjetri). Në piken II të aktakuzës është akuzuar se ka shkelur ligjin Parandalimin e Shperlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit konkretisht veprën penale Shperlarje e Parave nga neni 32 pika 2.1, 2.2, 25, dhe 2.6, në bashkëkryerje lidhur me neni 31 të KPK- së. Në piken III të akuzohet se ka kryer veprën penale Shkaktimi i Falimentimit nga neni 234 të të KPK- së (i vjetri).

Ndërsa në piken IV akuzohet se ka kryer veprën penale Shmangeje nga Tatimi neni 249 par. 1 lidhur me par 2 të KPK- së (i vjetri).me të cilën ngarkohet sipas aktakuzës.

E akuzuara *E. B. në fjalën e saj përfundimtare* deklaron: e mbështes fjalën përfundimtare të avokatit tim L.T, dhe ende i përmbahem kthimin e mjeteve për klientëve që i kanë dhënë për ndërtimin e banesave se bashku me dëshmitarin B. M. që ka qene dhe ka dhene deklarate.

Mbrojtësi i të akuzuarit *V.B av. Murat Demolli në fjalën e tij përfundimtare* ka deklaruar: se fjalën përfundimtare e kam përgatitur me shkrim, të cilën fjale do të elaburoi sot në këtë seancë.

Trupi gjykues në këtë çështje penale ka mbajtur seancat e shqyrtimit gjyqësor. Provat dhe faktet e proceduara në shqyrtimin gjyqësor.

Dihet së gjykata e bazon aktgjykimin vetëm në faktet dhe provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor (neni 361 par. 1, KPPK-ës).Provat të cilat janë proceduar në këtë shqyrtim gjyqësor, sipas propozimit të prokurorit nuk e vërtetuan tezhën e aktakuzës së i mbrojturi im V.B ka kryer veprën penale: Krimi i organizuar nga neni 274 par.1 lidhur me par.2 e në raport me E.Bn par.3 të KPK-ës(i vjetri)lidhur me veprën penale : Mashtrim nga neni 261par.1 lidhur me par.2 të KPK-ës(i vjetri).

Gjatë tërë procesit gjyqësor prokurori nuk ofroi prova bindëse pran këtij trupi gjykues së i pandehuri V.B ishte kryes i veprave penale krim i organizuar. Gjatë procesit gjyqësor që nga fillimi e deri në fund të këtij procesi asnjë provë nuk u paraqit pran këtij trupi gjykues se i pandehuri ka qenë i përfshir në krim të organizuar ashtu siq është përshkruar në pikën 1 të aktakuzës.

I mbrojturi im V.i asnjëhere nuk ka nënshkruar ndonjë parakontratë me palët e dëmtuara dhe nuk ka pranuar mjete nga palët çoftë në kesh apo përmes Ilogarisë B. Kjo u vërtetua edhe nga deklaratimet e palëve të dëmtuara të cilët u morën në pyetje nga prokurori dhe nga trupi gjykues dhe palët e tjera.

I pamohushëm është fakti së i pandehuri ka qenë në marrëdhënie pune në kompanin V.- o- G. i përcaktuar në detyrat e punës : Në cilësinë e zyrtarit të lartë për marketin G. Prandaj kuptohet së çdo punëtor i cili është në marrëdhënie pune është përgjegjësi e tij që të i zbatoi urdhërat e punëdhënësit i cili jep urdhëra për kryerjen e punëve e në rastin konkret ka pasur urdhër që me palët e interesuara të i dërgoi dhe të shohin përseafërmi të ju tregoi vendin dhe objektin ndëltimor,i cili ka qenë duke u ndërtuar po njëashtu edhe pozita. Çdo punëtor i cili është në marrëdhënie pune çoftë në sektorin publik apo privat ai është përgjegjës për kryerjen e punëve që i cakton punëdhënësi t'i kryej punët që i ka të caktuara në bazë të kontratës së punës. Për punën që e ka bërë i mbrojturi im V.B, ka marrë pagën mujore dhe pagesa është bërë përmes Ilogarisë B.

Shtrohet pyetja si mund të cilësohet veprë penale dhe atei përfshirë krim i organizuar, kur punëtori i cili është në marrëdhënie pune dhe palëve të interesuaraju tregon vendin ku është duke u ndërtuar objektin banesor, si mund të cilësohet veprë penale ku asnjë parakontratë nuk është e nënshkruar nga i mbrojturi im V.i dhe palëve të dëmtuara.

Po ashtu si mund të cilësohet veprë penale i pëfshirë në krim i organizuar ku nga asnjë palë nuk ka pranuar mjete financiare as në kesh e as përmes Ilogarisë B..Do të thekësoja se i mbrojturi im nuk ka jetuar në bashkësi familjare me E.B., por ka jetuar në banesën e vet me bashkëshorten dhe dy fëmijët.

Procesi gjyqësor i cili u zhvillua që nga fillimi marrja në pyetje e palëve të dëmtuara dhe të bashkëakuzuarëve të cilët u morën në pyetje nga ana e Prokurorit dhe mbrojtësve dhe nga trupi gjykues asnjëhere asnjë i dëmtuar nuk u deklarua për ndonjë mashtrim apo marrje të mjeteve financiare nga i mbrojturi im V.B.

Nga të gjithë të dëmtuarit të cilët u morën në pyetje lidhur me parakontratat asnjë nga ata nuk ka deklaruar së i mbrojturi im ka nënshkruar ndonjë parakontratë dhe as që ka qenë prezent në zyrën e kompanisë në kohën kur janë nënshkruar këto parakontrata në mes E.B dhe palëve të dëmtuara.I mbrojturi im nuk ka pasur qasje në asnjë rast të nënshkrimit të parakontratave dhe as në Ilogarin B.are të B. , nuk ka bërë transaksion apo tërheqje të mjeteve financiare.

I mbrojturi im V.B në seancën gjyqësore e Cila u mbajt me datën 11.03.2022 u mor në pyetje nga mbrojtësi i tij dhe nga prokurori dhe i dëmtuari A.M. dhe trupi gjykues.Në të gjitha pyetjet që ju parashtruan dha përgjigje dhe ishte korrekt dhe real në deklaratimet e tij dhe këto përgjigje nuk e inkriminojnë që është kryes i veprës penale sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Kosovës.

Nga të gjitha provat të cilat i ka sjellë prokuroria nuk e vërtetuan tezën e fajësisë se i mbrojturi im nuk është i pëfshirë në veprën penale:Krim i organizuar nga neni 274 par. 1 lidhur me par.2 e në raport me E.B par.3 të KPK-ës(i vjetri) lidhur me veprën penale:

Mashtrimi nga neni 261 par. 1 lidhur me par.2 të KPK-ës,(i vjetëri).

I mbrojturi im V.B J. në kushte të vështira ekonomike,nuk ka banesë të vetën edhe atë që e ka pasur ia kan marrë dhe tani J. me qira. Me në fund i propozon gjykatë që ti analizonj mirë provat

e propozuara të cilat gjinden në shkrE. e lëndes, të i keni parasysh sjelljet e të akuzuarëve gjatë gjithë procesit gjyqësor të merrni një Aktgjykim të drejtë Lirues në favor të tij.

I akuzuari *V. B. ne fjalën e tij përfundimtare* ka deklaruar: se mbështes fjalën përfundimtare të avokatit.

Mbrojtësi i te akuzuarit *B.V. sipas autorizimit zëvendësuese av. Fitim Limani, ne emër të mbrojtësit me autorizim av. Behar Ejupi ne fjalën e tij përfundimtare* të paraqitur me shkrim ka theksuar.

Prokuroria, me provat e propozuara në aktakuzë e që janë administruar në shqyrtim gjyqësor, nuk ka arritur të dëshmoj se i mbrojturi im ka qenë i përfshirë në kryerjen e veprave penale për të cilën akuzohet. Për më tepër të gjitha këto prova, vetëm se e dëshmojnë atë që ne e kemi prezantuar që nga fillimi i këtij shqyrtimi gjyqësor, se *B.V.* nuk ka të bëjë asgjë me veprën penale e Cila i vihet në barrë.

Prokuroria aktakuzën e Cila ka qenë Objekt trajtimi në këtë shqyrtim gjyqësor e ka mbështetur në deklaratat e të dëmtuarve, dëshmitarëve si dhe provat tjera materiale ashtu siç potencohen në propozimin e aktakuzës.

Të gjitha këto prova të propozuara në aktakuzë, e të cilat u administruan në shqyrtimin gjyqësor të kësaj çështje, e provojnë vetëm një gjendje faktike, atë që me ngulm e kemi prezantuar që nga fillimi i këtij shqyrtimi gjyqësor se *B.V.* është tërësisht i pafajshëm lidhur me këtë çështje.

Sa i përket veprës penale Krimi i Organizuar thekson se karakterizohet me këto veçori: Struktura organizative e fortë, profesionalizmi i lartë, Hierarkia midis anëtarëve të Grupit., Disiplina e rreptë, Dëgjueshmëria dhe lojaliteti i pakundërshtueshëm, Fitimi Financiar, Korrupsioni, si formë e veprimit për të përfituar zyrtarët e lartë shtetërorë të të gjitha strukturave dhe niveleve, Lidhja fafëfisnore-familjare, Përdorimi i dhunës.

Prokuroria Speciale nuk i tregon cilat prej këtyre 8(tetë) karakteristikat i atribuohen *B.V.*. Prokuroria nuk tregon çfarë pozite ka pasur në hierarkinë si anëtarë i Grupit kriminal të organizuar. Nuk tregon se kënd e ka pasur "BOS" *B.V.*, apo ka qenë Bosi vetë. Prokuroria nuk tregon se a ka përfituar materialisht vetëm edhe një cent të vetëm *B.V.* e që është pjesa më vitale e një Grupit kriminal të organizuar përfitimi pasuror dhe i anëtarëve të Grupit. Sa i përket Përdorimit të dhunës, le të na tregoj Prokuroria se ndaj kujt ka përdorur dhunë *B.V.*.

Sa i përket veprës penale të mashtrimit nuk ekziston kjo vepër penale. Mashtrimi është një vepër penale e orientuar kundër pasurisë (së luajtshme dhe të paluajtshme), duke përfshirë edhe të drejtat dhe interE. pasurore. Veprimi i kryerjes së kësaj veprë penale qëndron në paraqitjen e rrejshme të fakteve a duke i fshehur faktet. Me paraqitjen e rrejshme të fakteve nënkuptohet pohimi për ekzistimin e ndonjë fakti që nuk ekziston, përkatësisht paraqitja e fakteve ndryshe nga ajo që vërtet ekziston, (ajo që ekziston tregohet jo saktësisht). Fshehja e fakteve ekziston kur kryerësi, ndonjë person, e mashtron për mosekzistimin e fakteve ekzistuese apo e hesht ekzistimin e tyre, përkatësisht përmbajtjen e tyre, nëse ka ekzistuar detyrimi i tij që ato fakte t'i tregonte.

Në bazë të dëgjimit të dëshmitarëve të dëmtuarve në shqyrtim gjyqësor, cili prej tyre, ka vepruar apo e ka mashtruar ndonjë person, përkatësisht ndonjë person e ka dëmtuar pasurin e tij me veprimet e *B.V.*.

Sa i përket veprës penale shpërlarja e parave Prokuroria në aktakuzë pretendon se B.V., nga e pandehura E.B ka pranuar një banesë, një automjet- V., një dhomë fjetje, shpenzimet për dasme, shpenzime për pushime dhe shpenzime tjera. Ky pretendim i Prokurorisë më shumë është absurditet i llojit të vetë, se i bazuar në prova. Kur e them këtë kam parasysh faktin se si ka mundësi të thuhet se ka përfituar një banesë kur ndërtimi i banesave ka dështuar, dhe pikërisht për këtë akuzohet E.B. Po ashtu cila është ajo prove qoftë deklaratë e të dëmtuarve, dëshmitarëve se që është administruar në shqyrtim gjyqësore se B.V. ka përfituar, përkatësisht ka shpërlarë para.

Andaj, duke u bazuar në elaborimin e lartcekur, konsideroj se prokuroria përgjatë këtij shqyrtimi gjyqësor nuk ka arritur ta përmbush standardin e mjaftueshëm për të provuar përtej çdo dyshimit të bazuar fajësinë e të mbrojturit tim B.V. e si rrjedhojë Gjykatës Themelore në Pejë i propozoj që në përputhje me nenin 364 par. I nënpar 1.3 ndaj tij të nxjerrë Aktgjykim lirues, për faktin se nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari B.V. ne fjalën e tij përfundimtare deklaron: se e mbështes fjalën përfundimtare të mbrojtësit në përpikmëri, dhe e mbështes fjalën e mbrojtësit të avokatit E. B. ne pjesën ku unë përmendem gjithashtu shtoi se në këtë proces sqarohet të gjitha deklaratat e dëmtuarve dëshmitarëve, e po ashtu vlen të theksohet se as kush nga këta nuk drejton gishtin nga unë dhe nuk dëshmon se unë e kam mashtruar apo dëmtuar. Shpresoi dhe besoi në drejtësi që pas shqyrtimit të gjithë këtyre materiale të me shpallë të pa fajshëm.

Mbrojtësi i të akuzuarit XH.A. av. N. R. ne fjalën e tij përfundimtarë të paraqitur me shkrim e të elaboruar para gjykatës ka theksuar se:

-Prokurori i shtetit nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës me datën 12 maj 2016 kishte ngritur aktakuzën ndaj Xh. A. me të dhëna si rënë lartë duke pretenduar se i njëjti në bashkëkryerje me E.B, B.V., V.O. dhe F.O. ka kryer veprën penale "Shpërlarja e parave" nga neni 32 pika 2.1, 2.2, 2.5 dhe 2.6 sipas Ligjit për Parandalimin e Shpërlarjes së parave dhe Financimit të Terrorizmit në bashkëkryerje lidhur me nenin 31 të KPK-së.

Prokurori i shtetit nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës në aktakuzë ka potencuar se: në kohën, vendin dhe mënyrën përshkruar si në pikën 1 të këtij dispozitivi (duke filluar nga data 02 Shtator 2009 me zyre në tri lokacione të ndryshme në P. e Gjer me 15 Maj 2014), pasi që janë përfituar mjete financiare në vlerë rreth 2.000.000, 00 euro, e duke e ditur se mjetetfinanciare të cilat kanë buruar nga aktiviteti kriminal të pandehurve si në pikën I të dispozitivit duke tentuar të konvertonin, transferonin, me qëllim të fshehjes apo të maskimit të natyrës, B.it vendit, dipozicionit, levizjes ose pronësisë së asurisë: në bashkëkryerje kanë bërë shpërlarjen e parave, ashtu që i pandehuri XH.A., fillimisht me datën 03 Qershor 2011 ka vepruar në atë mënyrë që duke i mundësuar të pandehurës E.B fshehjen e gjurmëve të pasurisë, objektin të cilin e pandehura E.B e ka filluar ta ndërtoj me mjete financiare të përfituara me aktivitet kriminal, i njëjti nga e pandehura E.B ka pranuar autorizimin i vërtetuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë.-dega në Graçanice i datës 01/08/2011 me të cilin e autorizon të pandehurin Xh. A. që në mënyrë generale dhe pa kufizime të përfaqësoj në emër personal dhe në emër të firmës "V.-O- G. " me pronarët e tokave sipas kontratave për patundshmëritë lidhur me ndërtimin e banesave. Pasi që E. ka pas obligime ndaj pronarëve të truallit. Pastaj i pandehuri XH.A. me datën 01 Gusht 2011 nga e pandehura E.B pranon një deklaratë të vërtetuar në Gjykatën Komunale Prishtinë.-Dega Graçanice Vr.Nr.../.... vërteton se heq dorë nga implementimi i Kontratës për ndërtimin e banesave dhe lokaleve afariste të legalizuarapranë Gjykatën Komunale. në Prishtinë. Vr.Nr..... të datës 05/09/2009, Vr.nr,..../..... 07/05/2009, Vr.nr/2009

të datës 27/05/2009, dorëheqjen e bënë në favor të të pandehurit XH.A., ndërsa obligimet ndaj blerësve të banesave, dhe punë byerësve mbesin obligim i të pandehurës E. B., dhe në fund që të humbet gjurmët edhe naë shumë i pandehuri XH.A. me datën 16/Janar 2012 nënshkruan marrëveshje për investime të përbashkëta me biznesin "A. G. Sh.A " me pronar D.B. për ndërtimin e banesave dhe lokaleve afariste të cekura si naë lartë.

Prokuroria kishte propozuar që në shqyrtimet gjyqësore të ftohen dhe të dëgjohen si dëshmitarë 89 persona pa specifikuar se nga kush janë të dëmtuar dhe se si janë dëmtuar dhe të dëgjohen 4 dëshmitarë po ashtu duke mos specifikuar se çka do të dëshmojnë dhe ndaj kujt do të jenë ata dëshmitarë.

Ku në këtë proces gjyqësor janë dëgjuar thujse të gjithë të dëmtuarit dhe dëshmitarët e që asnjëri nga ata nuk e ka përmendur fare Xh. A.n dhe se nuk e kanë njohur fare, apo ndonjëri nga ata që e kanë njohur Xh. A.n e kanë njohur vetëm si njeri të mirë, të sjellëshëm e punëtor dhe kontribues për vendin dhe shoqërinë.

Kur E. B. kishte qenë punëtoare në R. B. ajo kishte kërkuar një huazim nga Th. A. me qëllim fillimisht të kthimit por me mundësi edhe të kompensimit me sipërfaqe banesore me çmim rënë të volitshëm ashtu siç e mundësojnë ndërtuesit për blerësit filestar.

Pra Xh. A. i kishte dhënë E.Bt shumën prej katërqind mijë (400,000.00€) e që më pas ia kishte krrhyer pesëdhjetë mijë 50,000.00€ e që më pas kanë bërë marrëveshje për kompensim me sipërfaqe banimi prej 1000 m² në objektin ku ishte duke ndërtuar E.B.

Meqenëse në objektin ku kishte qenë duke ndërtuar E.B kishte pasur vështirësi në vazhdimin e punimeve për shkak të një gypi të madh të ujit që kishte dalur se kaL.te nëpër atë pjesë të tokës dhe kosotja e largimit të atij gypi kishte qenë e lartë dhe vështirë i evitueshëm, E.B kishte pasur ngecje në ndërtim e që lidhur me këtë pronarët e tokave në të cilat kishte filluar punimet E. kishin shorehur skepticizëm se E. do të arrinte që t'i përfundonte ato ndërtime ata kishin këmbëngull që të shkëpusnin kontratën me E. duke kërkuar nga njejtja që t'i ndërpresë menjëherë punimet që ajo kishte realizuar deri në atë kohë e që në atë Objekt kishin qenë diku 4-5 katë ndërtim i vrazhdë të ndërtuara.

Pas kësaj, pasi që pronarët e tokave nuk kishin dashur më ta lejonin E. të punonte fare në ato objekte dhe se i kshin kërkuar të njejtës që të shkëpusnin kontratën dhe t'ua largonte E. të gjithë barrën tjetër siç ishin blerësit e banesave E.B kishte filluar shkëputjet e kontratave edhe me blerësit potencialt të banesave ku i kishte shkëputut parakontratit me shumicën e atyre blerësve, ndërsa një pjesë tjetër i kishte kompensuar me para.

Më pas Xh. A. duke qenë njëri nga borxhlinjtë më të mëdhenjë të E. ai ka bërë përpjekje që të vazhdonte projekti i nisur nga E. me pronarët e tokave I. D., L. G., S. Z. dhe A. V., por ata nuk kanë pranuar në asnjë formë që E. të vazhdonte tutje me ndërtim në atë vend. Ata përfundimisht kishin shkëputur kontratën me E..

Meqenëse E.B i kishte borxh Xh.A. shumën prej treqind e pesëdhjetëmijë (350,000.00€) ajo i ka kërkuar Xh. A. që ai të gjejë ndonjë ndërtues që do të vazhdonte me ndërtimin e objektit dhe nëse do të pranonin pronarët e tokave Themelore A. të realizonte sipas marrëveshjes me pronarët e tokave apo me ndërtuesin e ri të realizonte kompensimin e tij respektivisht të merrte sipërfaqen e kontraktuar në këmbim të shumës të dhënë te E.B në shumën prej treqind e pesëdhjetëmijë (350,000.00€).

Pasi që Xh. A. kishte biseduar me pronarët e tokave dhe se nga të njejtit ka kërkuar që të gjejnë një ndërtues të ri i cili do të vazhdonte me punimet në atë Objekt dhe se ata kanë pranuar që Xh. A. të vazhdojë me ndonjë ndërtues të ri pasi që Xh. e kishte njoftuar se E. kishte shkëputur një pjesë të kontratave me blerësit e banesave dhe se ajo kishte lidhur kontrata të E.B i kishte bërë një autorizim të përgjithshëm Xh. A. për të vazhduar punët me pronarët e tokave e që Xh. së bashku me pronarët e tokave e kishin gjetur kompaninë A. G. e Cila kompani para së gjithash kishte shkuar në zyre të E. ku e kishte pyetur se a ka ndonjë problem e që më pas përfaqësuesi i A. G.D.B. kishte shkuar së bashku me Xh. A. dhe pronarët e tokave në dI. takime ku kishin arrit edhe marrëveshje. Pra A. G. kishte lidhur marrëveshje me pronarët e tokave ndërsa Xh. A. në atë marrëveshje kishte qenë si ndërmjetësues por ai kishte pasur marrëveshje me kompaninë A. G. që në ftnd të kompensohet me sipërfaqe banesore në barasvlerë me paratë që i kishte dhënë E..

Ne gjatë shqyrtimit gjyqësor kemi propozuar që në cilësi të dëshmitarëve të dëgjohen edhe pronarët e tokave ku E.B kishte pasë një kontratë të përbashkët me I. D., L. G., S. Z. dhe A. V. sui dhe pronari i kompanisë A. G. D.B. i cili kishte vazhduar me ndërtimin e objektit dhe se pasi që E.B kishte pasur vështirësi që të vazhdonte me projektin aty kishte vazhduar A. G. në marrëveshje me pronarët e tokave dhe më pas Xh. A. me D.B. n kishte realizuar kompensimin e tij.

Gjykata kishte aprovuar propozimin tonë edhe pse atë e kemi bërë të pjesëshëm pasi që kemi dëgjuar vetëm dy nga pronarët e tokave dhe pronarin e kompanisë A. G. D.B..

Me datën 30/11/2021 në gjykatë janë dëgjuar dëshmitarët D.B., L. G. dhe I. D. të cilët kanë dhënë dëshminë e tyre para të gjitha palëve në procedurë por edhe para gjykatës.

Dëshmitari D.B. në pyetjet që ne ia kemi parashtruar por edhe të tjerët ai ndër të tjera ka deklaruar se ka qenë pronar i kompanisë A. G., të akuzuarin XH.A. thot se e njeh kur janë takuar dhe kanë folur e që qëllimi kryesor i kontaktit ka qenë objekti për shkak se objekti ka qenë i falimentuar dhe fillimisht ai është takuar me XH.A. n dhe me E. dhe pastaj edhe me pronarët e tokave, pastaj kanë pasur të gjithë pëlqimin me vazhduar. Ai shtonë se ka bërë kontratë me Xh. n, si dhe me pronarët e tokave për ndërtim.

Ne me lejen e trupit gjykues i kemi përkujtuar dëshmitarit kontratën e lidhur me datën 06/03/2021, e vërtetuar në Gjykatën K. në P. e lidhur në mes të I. D., L. G., S. Z., dhe A. V. të specifikuar si palë I, dhe në anën tjetër A. G. si pala 2, duke e pyetur dëshmitarin nëse i kujtohej. Dëshmitariri përgjigjet: "po ashtu është atajanë pronarë të tokave",

Ai deklaron se vendi ku ka ndërtuar ka pasur ndërtim paraprak dy- tre kate, ndërsa kur ne e kemi pyetur se Xh. A. farë cilësie ka pasur ai është përgjigjur se Xh.A. ka qenë i autorizuar dhe ai është kujdesur që me u ba kompenzimi i atyre dy-tri kate që kanë qenë të ndërtuara në bazë të letrave dhe se ai shton se Xh. A. është kompensuar

Dëshmitari tutje shton se ai ka pasur njohuri se ka pasur kontrata të lidhura në mes të E. dhe personave të tjerë por ai shton se nuk ka pasur të bëjë me ata. Tutje shton se objekti ka përfunduar në tërësi por me vonesa të mëdha nga se ka qenë një gyp dhe i kujtohet se ka pasur probleme me atë gyp të ujit por në vitin 2017 ose 2018 ka përfunduar ai problem.

Evitimi i problemit me gypin dëshmitari thotë se u ka marrë kohë diku 6-7 vite dhe se leje ka pasur urbanistike, por gypi ka qenë në mes, dhe ka pasur pengesë sepse aty është menduar me

u ndërtuar 4 banesa, me të njëjtit pronar që janë marrë vesh ata i kanë ndërtuar dy Objekte ndërkaq me pronaret tjerë ka ndërtuar firmë tjetër, ai shton se leje ndërtimore nuk ka pasur por ata e kanë marrë lejen.

Dëshmitari kur është pyetur nga prokurori i shtetit se pse është dashur që ai të ndërtoj kur aty ka pasur një ndërtim ai deklaroi se aty kishin falimentuar duke pasur qëllimin tek E.B.

Në pyetjet e të akuzuarës E.B dëshmitari përgjigjet se ka pasur rrëmihje afër objektit të parë për nisje të objektit të dytë dhe shton se i kujtohet se gypin e kanë gjetur të shpluar dhe e kanë mbuluar.

Dëshmitari L. G. në seancën e datës 30/11/2021 u është përgjigj pyetjeve të mia fillimisht e më pas edhe pyetjeve të të tjerëve i cili ndër të tjera ka deklaruar se: në vitin 2009 ka lidhur një kontratë për ndërtim të përbashkët me E.B dhe se ndërtimi në atë pjesë ku ai ka qenë pronar i tokës, veç se kae filluar, nuk i kujtohet saktësisht por kanë filluar punët 3-4 muaj më së largu 5 muaj pas lidhjes e kontratës me E.. Më tutje ai shton se e kanë prishur kontratën për shkak se nuk ju ka përmbajtur kushteve (E.) të cilat kanë qenë të precizuara në kontratë, dhe kushti kryesorë ka qenë që asnjë hap të mos ndërmerret pa u marr leja e ndërtimit nga Urbanizmi.

Në pyetjen tonë se; "kush ka parashtruar kërkesë të mos ndërmerret asnjë hapa u marrë leje"? Dëshmitari deklaroi se; "të gjithë pronaret që kemi qenë aty ne jemi kanë pajtimi që asnjë hap të mos ndërmerret pa u marrë leja e ndërtimit".

Ndërsa kur ai pyetet për lejen urbanistike ai deklaroi se; "të jemi shumë i sinqertë në atë kohë ka qenë ligji për ndërtim ka qenë pak më nmyshe, dhe është dashur me u marrë kushtet urbanistike, dhe unë sa e di kushtet urbanistike kanë lejuar që të ndërmerren hapa vetëm sa i përket pjesës së dheut, që i bjen përgatitja e terrenit porjo edhe e ndërtimit".

Dëshmitari shton se së bashku me pronarët tjerë e kanë shkëputur kontratën me E. pastaj meqë është hyje në teren dhe është punuar edhe në pjesën ndërtimore, dhe sa i kujtohet aty ka filluar dI. here ndërtimi dhe është ndërpre dhe kanë parë që nuk po merrej leja atëherë ata e kanë shkëputur kontratën. Dëshmitari tutje deklaroi se XH.A.n e ka njohur para se me lidh kontratën, ka rastisur me njoftë në rrethana tjera dhe XH.A.n në këtë projekt, ai shton se e kanë njohur kur është marrë vendim me shkëput kontratën me E., XH.A. është paraqitur se është pjesë e projektit edhe ky ka investuar, i ka lutur që të mos shkëputet kontrata, të gjendet një zgjidhje. Dëshmitari shton se ata (pronarët e tokave) kanë kërkuar që kontrata të bëhet pa tjetër dhe ata kanë qenë të gjithë kategorik që të shkëputet kontrata, dhe kanë qenë të gatshëm se në çfarë do varianti çoftë nga pala investitorë çoftë nga pala e pronarëve e Cila duhet të bëjë një kontratë të re që nga fillimi.

Ai shton se XH.A. ka shkuar me një investitor tjetër, dhe kërkesa e tyre ka qenë të gjendet një investitor dhe kërkesa e tyre ka qenë që të zgjidhet një zgjidhje e Cila do t'i mere të gjitha obligimet me raport me investitorin paraprak. Në pyetjen time se; "në çfarë shume kishte investuar Xh. A." Dëshmitari deklaroi se; "XH.A. nuk ka qenë pjesë e kontratës, nuk ka qenë vetëm XH.A. që është paraqitur, ata kanë qenë investitor, por ata (pronarët e tokave) kanë pasur kontrata vetëm me E.B",

Kur dëshmitari është pyetur se; "Cila ka qenë arsyeja se nuk ju ka përmbajtur kushteve E.B, ai shton se; "normal e kem shkëputur kontratën nga se ka pasur vonesa në ndërtim nuk është marrë leja, me arsyetim se ka pengesa në komunë, dhe për këto na të Withë pronarët kemi qenë të pajtimit që të shkëputim kontratën".

Ky dëshmitar kishte deklaruar ndryshe nga ajo që kishte deklaruar në polici kur kishte sqaruar se Xh. A. kishte qenë njëri nga investitorët te E.B dhe se ai kishte paguar diku 200-300 mijë euro por në shqyrtimin gjyqësor atij nuk i kujtohej se çfarë kishte deklaruar më parë.

Dëshmitari I. Dukai po ashtu është dëgjuar në seancën e datës 30/11/2021 i cili fillimisht ka filluar tu përgjigjet pyetjeve të mia e më pas edhe të të tjerëve me ç'rast ai ndër të tjera deklaroi se; Kanë lidhur kontratë me E.Bn për ndërtimin e përbashkët, kanë filluar punët në pronën e tij dhe se punimet ia ka treguar E., ai kujton se kanë qenë 2-3 kate, nuk mundet me thënë saktë, ndërsa sipas tij arsye e ndërprerjes së punimeve ka qenë se shqetësimi i tyre ka qenë leja e ndërtimit, ai shton se kur kanë dashur me investuar kanë kërkuar leje, dhe leja nuk iu ka prezantuar, sepse ata nuk kanë dashur me pas probleme me shtetin dhe absoL.sht kanë qenë kundër asaj.

Dëshmitari deklaroi se; "gjatë kësaj kohe na kemi kërkuar leje, dhe duke u gjendur në këtë situatë aty ka ndërhyrë XH.A. dhe e jona ka qenë se po punohet pa leje, shqetësimi jonë ka qenë sepse po punohet pa leje, dhe nuk është punuar sipas projektit që është prezantuar, atëherë kërkesa e jonë ka qenë me ndërpre punimet sepse nuk mund të vazhdohet pa leje, dhe punimet janë ndërpre, ka vazhduar dI. herë, kontrata është prishur e objektit të cilat kanë qenë pjesë, çka ka punuar kjoju është bartur z. XH.A.t edhe A. G.t, dhe A. G.i ka thënë se unë e kryej objektin dhe marr lejen na nuk e kemi kundërshtuar sepse jemi kanë të interesuar me marrë leje dhe me vazhduar objekti nuk kemi pasur ndonjë interes tjetër".

Ai vazhdon se kanë lidhur kontratë me A. G. pas tërheqjes së E., ai shton se kanë qenë pronar të tokave, mirëpo për ata ka qenë e rëndësishme se është ndërtuar një Objekt dhe atëherë kanë qenë pronar të atij objektit.

Dëshmitari deklaroi në atë pronë ka kaluar një gyp i ujësllësimit të P.s, se çfarë përpjeke ka bërë E. ata nuk e dijnë mirëpo gypi ka qenë në një vend tjetër jo aty ku ka pasur me u bë ndërtim, por nuk e ka paguar E. me ndërtuar.

Në seancën e datës 11/03/202 në gjykatë ka paraqitur mbrojtjen i akuzuari Xh.A. i cili ndër të tjera ka deklaruar se; Ai është nga P.dhe se i njëjti mirret me bimes me punë private i kanë bizneset e tyre dhe se ai personalisht merrem me hoteleri vazhdon se ai J. me vëllezër dhe me djem, për momentin i kanë 5 bimese të tyre dhe objektet e tyre që i kanë me lira.

Ai numëron bizneset e tij të rregullta si; "furra e bukës te B.në P., prodhimi i plastikës, A. K. në P., Depoja e barnave dhe — farmaci, gur thyes në fshatin G., firma K.K., me përjashtim që dI. nga ato tani i kanë mbyllur dhe nuk funksionojnë si furrat e bukës dhe depon e barnave. I akuzuari Xh.tutje deklaroi lidhur me hotelet dhe kafiteritë që ka në posedim dhe ai shton se; restorant M., P. ..., R., ndërsa shton se me E. është njohur në vitin 2007 -2008, me E. është takuar për herë të parë nëpërmes B.V.t, dhe në bisedë e sipër ai i ka treguar se po bashkëpunon me E. dhe aty ka fillu biseda, në atë kohë janë njoftuar edhe me E. dhe kanë vazhduar bisedat raporte kolegjiale, shoqërore dhe në biseda e sipër ajo i ka treguar dI. gjëra se çka është duke pretenduar me punar, se në atë kohë ka qenë duke punuar në R. B.ë, ai shton se E. ka qenë në restuarantin e tyre në P., po ashtu shton se E. ka qenë 4-5 herë te ata dhe ka qenë me B.V.n, dhe ka qenë nëse nuk e ka gabuar emrin ka qenë edhe A. I drejtor i R. B..

Raporti me E. sipas tij lindi kur ajo i ka treguar se i ka dI. pretendime për dI. prona që janë në R. B. për ndërtime të larta, dhe opsioni i dytë ka qenë se ajo ka qenë në bisedime me pronarët e

tokave që bëhet fjalë për objektin M. .. dhe i ka treguar se çka kanë pretendime dhe me filluar lëmin e ndërtimit të lartë.

Xh.tutje shton se E. nga ai kishte kërkuar mjete financiare si tip huazimi dhe ai i ka huazuar me kalimin e dl. ditëve jo fort të giata kur Xh. ia kishte dhënë paratë, ajo ka vendosur për ndërtimin M. . dhe nga Xh te E. në total kanë qenë të huazuara 400.000 mije euro dhe në atë periudhë E. ia ka kthyer 50.000 mijë euro, dhe më pas për paratë e tjera e kanë mbyllur obligim me blerjen e banesën në sipërfaqe prej 1.000 metra katror.

I akuzuari Xh.deklaron se ka pasur edhe marrëveshje të shkruar me E. po dhe kur është përfunduar objekti e kanë mbyll obligimin me një deklaratë gjyqësore, ku ka qenë e paraparë 4 objekte në ato parcela dhe me deklarata gjyqësore e kanë mbyllur obligimin si parapagues i banesave për 1.000 metra katror.

I akuzuari Xh. A. në vijim shton se: E. ka ngec në ndërtim ka qenë në pyetje llamella 2, ka qenë duke e ndërtuar objektin e parë, pastaj kur ka filluar llamella 2, ai e ka parë me sytë e tij e ka pa që e kanë hjek dheun, dhe ka filluar me ndërtimin e objektit të dytë, aty ju ka shfaqur një probleme serioz lidhur me një gyp të ujit, dhe atehere janë shfaq edhe problemet serioze me ish pronaret e tokës, edhe Xh. ka marrë pjese në ato bisedime, është munduar edhe ai për me i ba zgjedhje për atë gyp gjë qe ka qenë e pa mundshme, atëherë janë shfaq probleme me pronarë të tokave, kanë aTitur në nivel serioz të problemeve të E. me pronarët e tokave.

Ai shton se ja kanë dhënë edhe një mundësi pronarët e tokave me vazhduar, ka filluar prap me ndërtim, dhe prap ka qenë opcioni për me u hjeke ai gyp, që i kanë thënë inspektorati i komunës i kanë thënë me hjeke gypin, dhe atë problem nuk e ka marrë përsipër as urbanizmi i P.s dhe as ujësjellësi i P.s, pronarët e tokave ja kanë afruar një person i cili ja ka kërkuar 250.000 mijë euro, dhe ai thotë se e din se ska mundur me pranuar se ka qenë pare e madhe dhe aty ka lindur konflikt me pronaret e tokave me E. dhe kane pasur mosmarrëveshje në pikën më të naltë.

Xh. në deklarinimin e tij sqaron se se: -interesi i tij ka qenë me vazhduar puna mos me u ndal sepse ka pasur mjete të investuara, për shkak të mosmarrëveshjeve nuk kanë mundur me vazhdua më, dhe pronarët e tokave kanë bërë kërkesa në gjykatë për rrënimin e objektit dhe E. e patën ndaluar për me hyjë te objekti dhe pasi që atë (E.) e eliminuan, pastaj personalisht e ka thirr E. në zyre Xh.n i ka ofruar mundësinë në atë objekt për investimin e tij dhe absoL.sht Xh. në fillim nuk ka pranuar i ka kërkuar vetëm mjetet e tij sepse u ërregullua ëdo gjë, kanë kalur dy jave dhe e ka thirr prap E. dhe e ka lutur në mënyrën rnë të mirë dhe i ka thënë që asaj nuk i ka mbet vend aty, duke shpresuar se Xh. si biznesmen i sukseshëm din më bo zgjidhje me pronaret e tokave, i është lutur me u barana ai me E. sepse situata që i ndodhi E. ajo kishte rënë në giendje të keqe.Më pas sqaron se si ka shkuar te pronarët e tokave, ka biseduar me ata ua ka treguar gjërat reale të tij, vetëm L. G.e ka ditë sepse ka pasur rast më herët që ai e ka informuar se ka mjete aty, dhe aty kanë qenë afër 10 pronarë të atyre parcelave, një kohë nuk e kane pranuar Xh..Kur Xh. ka hyrë për të nxjerrë paratë që ia kishte dhënë E. ka qenë e bler pllaka e 5 dhe me kalim të një kohe të shkurtër me pëlqim të pronarëve ka marë mirëkuptim, nëse nuk është E. aty hemaili ta merr përsipër që me bashkëpunim me ata ta gjejnë një kompani që do t'i filloi punimet.

Xh. A. shton se:- pronarët e tokave e kanë ditur që E. kishte lidhur kontrata për shitjen e banesave por e kanë ditur edhe që i ka shkëputur ato kontrata sepse i kishte informuar Xh. pasi që E. e ka ftuar në wre, ia ka freguar para kontratat të cilat i ka shkëputur, paraprkisht i ka treguar kontratat që i ka bërë te një pjesë tjetër të ndërtimit ku ka filluar, edhe për këtë Xh. është

detyruar me i informuar pronarët e tokave që objekti të jetë i pastër pa asnjë problem, qysh atëherë E. edhe ia ka ofruar mundësinë për autorizim me të cilin ai ka mundur me i shkëput kontratat në gjykatë me pronarët e tokave dhe e kishte mundësinë që paraprakisht me pronarët e tokave me gjet kompaninë tjetër. Kështu që Xh. me pronarët e tokave kanë gjetur kompaninë A. G. e Cila kompani ka shkuar në zyre te E. dhe e ka pyetur në mënyrë gjenerale se a ekziston ndonjë problem sepse e kanë këtë ofertë prej këtyre personave, paraprakisht ka marr përgjigje pozitive nga E., më pas A. G.me pronarët dhe Xh.n janë takuar dhe pas dy-tri takimeve kane arritur ujdi.

Xh. gjithnjë sqaron se ai ka qenë si ndërmjetësues aty për hirë të obligimeve të tij të cilët i ka njoftuar se çka kërkon nga aty dhe cili është interesi, pronaret e tokave kanë pranuar, kompania e Cila ka hyrë për ndërtim Xh. ia ka kërkuar mjetet e veta dhe ata nuk ia kanë kthyer mjete por ata i kanë thënë se mund t'ia kompensojnë me banesa dhe ai ka pranuar dhe aty ka vazhduar procedura sipas rregullave.

Gjatë dëgjimit të Xh. A.t edhe njëri nga të dëmtuarit deklaron për njohuritë që ka për Xh.A.n, pra i dëmtuari I. R. deklaron se; "për hirë të korrektësisë e thëm se na ka furnizuar me bukë, dhe them se ky e ka pasur furrën e bukës, edhe në kohën e luftës".

Xh.A. nuk ka pasur njohuri asnjëherë që E. gjatë punës së saj ka paraqitur fakte të rreme, apo që E. është hasur në ndonjë aktivitet kriminal për të cilini atij nuk do t'i lejohej që të komunikonte me të apo t'i realizonte mjetet e tij nga ajo.

Ndaj të njetit në shqyrtimin gjyqësor nuk kishte asnjë pyetje sfiduese prokuroria apo nuk kishte ndonjë provë që të ballafaqonte Xh.n apo nuk kishte diç të kundërt me atë që ka deklaruar vetë Xh.i, pra Xh. A. nuk i ka mundësuar E.Bt asnjëherë fshehjen e gjurmëve të pasurisë financiar të përfituara me aktivitet kriminal sepse ka pasur njohuri asnjëherë se E. ka përfituar diç me aktivitet kriminal edhe që në fakt ajo nuk kishte përfituar deri në atë kohë asgjë me aktivitet kriminal.

Edhe E.B në shqyrtimin gjyqësor ka sqaruar se si ajo ka filluar të ndërtojë, punën që ajo ka bërë, vështirësitë që i ishin paraqitur dhe në ftnd ndërprerjen e punimeve nga pronarët e tokave. Lidhur me aktivitetin e saj ajo ka deklaruar se parakontratrat që ajo i ka bërë me blerësit e banesave dhe pagE. që ka realizuar kanë qenë përmes Ilogarisë B. dhe se ka qenë çmim për blerje të banesave e asesi nga ndonjë aktivitet kriminal. Pra Xh. A. nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës është akuzuar se ai ka kryer veprën penale "Shpërlarja e parave" nga neni 32 pika 2.1, 2.2, 2.5 dhe 2.6 sipas Ligjit për Parandalimin e Shpërlarjes së parave dhe Financimit të Terrorizmit në bashkëkryerje lidhur me nenin 31 të KPK-së.

Neni 32 i Ligjit për Parandalimin e Shpërlarjes së parave dhe Financimit të Terrorizmit ku rregull. veprën penale të tillë shkruan se kur kruhet kjo vepër penale dhe çka nënkupton me shpërlarje të parave duke shtjelluar si më poshtë;

Kushdo që, duke e ditur ose që ka arsye për të ditur se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, pasuri .kjo e Cila në të vërtetë fitohet me vepër penale apo kushdo që, duke besuar se pasuria e caktuar fitohet nga ndonjë formë e aktivitetit Iviminal bazuar në përfaqësimet e bëra si pjesë e një hetimi zbulues të zhvilluar në pajtim me Kapitullin XXIX të Kodit të procedurës penale të Kosovës më tutje kishte paraqitur dispozitën ligjore

Xh. A. nuk ka kryer asnjërin nga veprimet e parapara me dispozitë ligjore dhe se ai nuk ka pasur asnjëherë njohuri se cilado pasuri buron nga aktiviteti kriminal e në rastin konkret pasuria

apo ndërtimi që kishte bërë E.B ngase ai nuk kishte buruar nga aktiviteti kriminal e as nga ndonjë vepër tjetër penale.

Pra përkundër asaj që prokuroria nuk ka afruar asnjë provë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë se Xh. A. ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë në vazhdimësi e kemi kundërshtuar aktakuzën e prokurorisë por as në shqyrtimin gjyqësor nuk u shpalos asnjë provë që dëshmon se Xh. A. ka kryer një vepër të tillë.

Në anën tjetër i pandehuri nuk ka obligim ligjor që ta dëshmojnë pëfajësinë e tij meqenëse ligji ka specifikuar se çdo person konsiderohet i pafajshëm përderI. të dënohet me aktgjykim të formës së prerë, por prokurori i shtetit obligohet që ta provojë fajësinë përderI. e akuzon dikë dhe e ngarkon me veprën penale konkrete dhe krahas obligimit për ta vërtetuar fajësinë ka edhe obligimin ligjor ta vërtetojë edhe pafajësinë e personit që e akuzon, kur neni 48 i KPPK-së obligon prokurorin e shtetit ndaj të pandehurit ku thuhet: “Gjatë hetimit të veprave penale, prokurori i shtetit detyrohet të analizojë provat dhe faktet fajësuese dhe shfajësuese dhe të sigurojë që hetimi të kryhet duke respektuar në tërësi të drejtat e të pandehurit”.

Në situatën konkrete dhe në rastin konkret, prokuroria nuk bëri asnjë përpjekje që të nxjerrë prova shfajësuese, përkundër kësaj që nuk kishte prova ta drejta dhe reale që dëshmojnë kryerjen e kësaj veprë penale nga Xh. A..

Prokuroria e paragjykoj dhe e supozoi dyshimin e bazuar se kinse Xh. A. ka kryer veprën penale e Cila i vihet në barrë madje prokuroria nuk ka arritur që të krijojë edhe mëdyshje ndaj Xh.t, por edhe po të krijonte mëdyshje në këtë situatë, mëdyshjet do të interpretoheshin në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij

Neni 3 i KPPK-së në paragrafin 2 ka paraparë: "Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës “.

Në situatën e tillë nuk janë krijuar mëdyshje fare, sikurse të kishte mëdyshje gjithsesi së do të duhej të interpretoheshin në favor të të pandehurit dhe të drejtave të saj, por në rastin konkret prokuroria i ka interpretuar në disfavor të të pandehurit dhe të drejtave të tij duke u paragjykuar dhe supozuar qështjen në tërësi por për atë arsye mbahet edhe shqyrtimi gjyqësor për ta bindur gjykatën me pretendimet që ka prokuroria dhe në anën tjetër me qëndrimin e të akuzuarit dhe të drejtën e tij për sqarime dhe mbrojtje.

Ne procesit gjyqësor të stërzgjatur dhe të mbi ngarkuar nuk kemi parë e as dëgjuar asnjëherë asnjë indicje që mund të na shpiente tek ndonjë provë se Xh. A. ka kryer këtë vepër penale e që në fakt në shqyrtimin gjyqësor do të duhej vërtetuar me saktësi kryerja e veprës penale. Por gjykata aktgjykimin duhet ta bazoj vetëm në fakte dhe prova të administruara në shqyrtim gjyqësor dhe të shqyrtoj me ndërgjegje.

Në rastin konkret nuk ka asnjë dyshim se bazuar në të gjitha dispozitat ligjore Xh. A. duhet të shpallet i pafajshëm, ndonëse prokuroria me detyrimet e saja që ka edhe ndaj të pandehurit do të duhej të tërhiqet nga aktakuza ndaj Xh. A..

Po ashtu një obligim dhe detyrim për organet që janë të veshura me autorizime dhe kompetenca dhe që kanë forcën e shtetit të cilat zhvillojnë procedurën, neni 7 i KPPK-së ka bërë një detyrim

të posaçëm për to ku në paragrafin 1 ka paraparë se; "Gjykata, prokurori i shtetit dhe policia të cilët marrin pjesë në procedurën penale detyrohen që saktësisht dhe tërësisht t' i vërtetojnë faktet të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm".

Në rastin konkret pra nuk është vërtetuar asnjë fakt i vetëm se Xh. A. e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë madje është absurditeti më i madh për një punëtor dhe biznesmen siç është Xh. A. të cilësohet dhe akuzohet se ai ka bërë pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit i cili si një punëtor i madh dhe i sukseshëm gjatë gjithë jetës së tij ka kontribuar për vendin dhe shoqërinë.

Andaj e nderuar kryetare e trupit gjykues, të ndëruar anëtar nga të lartëcekurat, kërkojmë ngaju që të analizoni të gjitha shkresat e lëndës duke vlerësuar me kujdes secilën provë për këtë çështje e që prokuroria pretendon se ka prova për Xh. A. ta ndërlidhë me ndonjë veprë penale e që në fakt nuk ekziston asnjë shkresë që mund të ketë fuqi provuese në drejtim të veprës penale, andaj kërkojmë nga ju që të veproni mbi bazën e arsyes e ndërgjegjes duke u mbështetur në dispozitat ligjore aobigative, po ashtu duke marrë për bazë parimin e drejtshmërisë, ligjshmërisë, humaniteti dhe ekonomizimit për të nxjerrë një vendim të drejtë e të ligjshëm ju në mbështetje të nenit 364 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të KPPRK-së të nxirri aktgjykim lirues ndaj Xh. A. ngase e themi me bindje të lartë dhe siguri të plotë se nuk është provuar se Xh. A. si i akuzuar ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Duke shtuar se do të komentoi fjalën përfundimtarë të Prokurorisë Speciale të R. Kosovës. i njëjti thekson se para se gjithash ne emër tim personal dhe po ashtu edhe ne emër të akuzuarit Xh. A. shprehim keq ardhje për të gjithë të dëmtuarit që janë prezent por edhe tek ata që nuk janë prezentë por figurojnë në shkrE. e lëndës si të dëmtuar, duke e bindur se cilin nga ata që asnjëri në asnjë moment nuk është i dëmtuar nga veprimi i Xh. A..

Ne fjalën përfundimtarë të prokurorisë e të cilën e mbështeten të gjithë të dëmtuarit që janë prezent lidhur me të akuzuarin Xh. A. në faqen 10 të kësaj fjale përfundimtare prokuroria ka bërë një përshkrim prej 16 rreshtash ku e përshkruan si veprim inkriminues të XH.A. një autorizim të dhënë nga E. B. me qëllim që i njëjti të realizoi investimin apo pagesën e tij të bërë e që deri në atë moment apo deri në realizimin e një pjese të kompensimit nga ai ndërtim që kishte filluar edhe Xh. A. po ashtu ishte i dëmtuar. Pra nuk ishte veprim i vetëm i përpjekjeve të E. B. për të kompensuar ata që kishin paguar të e njëjta Xh. A. por në këtë proces gjyqësorë është vërtetuar se E. B. ka kompensuar edhe dI. persona të tjerë të cilët kishin qene të dëmtuar.

Çuditërisht në këtë aktakuzë prokuroria ka akuzuar tre të akuzuar me veprë penale krimi i organizuar nga neni 274 i Kodit të Përkohshëm Penal të R. Kosovës, kinse ata kanë kryer veprë penale të krimit të organizuar lidhur me veprë penale mashtrimit nga neni 261 i po të njëjti ligj Ne juristet e kuptojmë fare mire se çka nënkupton se të kryhet veprë penale krimi i organizuar e që kemi literature e praktike të mjaftueshme për tu bindur se kur ekziston krimi i organizuar por do të specifikojë neni 274 prg 7 pika 3 e KPK-se, e përshkruan se krimi i rend do të thotë veprë penale që dënohet në burgim prej se paku 4 vitesh, pra para se gjithash për tu konsideruar se dikush kryen veprën penale të krimit të organizuar duhet të vërtetohet se ka kryer jo një po dI. vepra penale që kanë një minimum të dënimit 4 vitesh e lartë. E në rastin konkret është pretenduar se krimi i organizuar është kryer në lidhje me veprën penale mashtrimit e cila veprë nga neni 261 par 1 është e dënueshme deri në 3 vite, maksimumin e dënimit nuk e ka 4 vite, lidhur me këtë i mbrojtur im z. Xh. A. nuk ngarkohet me këtë veprë penale por rrjedhimisht me vepra të tjera kinse burojnë nga kjo veprë penale e gjithë një me veprimet e E. B..

Prokuroria ne fjalën përfundimtare ku përshkruan veprimet kinse inkriminuese te XH.A. e përshkruan prape se kinse ai i ka fshehur gjurmët e pasurisë se E. B., por ne mesin e atyre te pasaktave fatbardhësisht nuk shkruan se pasurin qe ka buruar nga aktiviteti kriminal siç është ne aktakuzë. Për me tutje te nderuar trupi gjykuese kërkoi qe te elaburoni fjalën time te cilën e kam dorëzuar me shkrim e te cilët do te elaburoi tani shkurtimisht aq sa kemi mundësi te përmbliidhi.

I akuzuari XH.A. në fjalën e tij përfundimtare deklaron: pajtohem me fjalën e avokatit ndihem i pa fajshëm kam besim ne gjykatë te me shpalle te pa fajshëm, dhe paraprakisht ju kërkoi falje palëve te dëmtuarve edhe pse nuk kam pasur asgjë me te.

Mbrojtësi i te akuzuarit V.O. av. Ramiz K. ne fjalën e tij përfundimtare te paraqitur me shkrim e te elaburuar para gjykatës ka theksuar se:

-Vepra penale për të cilën akuzohet V.O., hynë në grupin e veprave penale, ku detyrimish kërkohet aktivitet shumë intensiv i personave të dyshuar.Nuk mund të jetë temë debati në gjykim, se çka është shpërlarja e parave, me përshkrimin alternativ që e ka bërë prokurorija në këtë aktakuzë , se si kryhet kjo vepër. Tendenca e prokurorisë është që në gjykatore të bëhet debati për këtë temë. Kjo vërtetohet edhe nga fakti se në cilën prej katër apo pesë situatave, përcaktohet prokuroria se është bërë shpërlarja e pretenduare parave nga V.O., e që këtë prokuroria nuk e ka bërë , sepse kjo nuk ekziston, as nga vet shkrE. e lëndës, as nga administrimi i provave e as nga koncepti i aktakuzës, madje as nga fjala përmblyllëse e prokurores.

Vepra e individualizuara në këtë aktakuzë, për V.O.n, fare nuk ka as përafërsisht përshkrimin e elementeve qensore në pajtim me dispozitat materiale, me çka tendenca e prokurorisë është pamundësimi i paraqitjes së mbrojtjes efektive, sepse të përgjigjesh në abstrakten rne konkrete, nënkupton , tendencën e bartjes së barrës së të provuarit nga akuzatori në të akuzuarin.

Vërtetë çfarë thotë aktakuza për V.O.n?Aktakuza thot at që nuk e thonë provat.Aktakuza fletë për at që nuk ka ndodhur.

Situata e parë për të cilën përcaktohet prokurorja se kemi të bëjme me pastrim parash në raport me V.O. është kjo: V.O. e paska ditur që E. B. merret me pastrim parash, ashtu që E.B në periudha të ndryshme gjatë viteve 2009, 2010 dhe 2011, përmes xhiorlogarisë B. are në W., në D.ë, ka pranuar shumë prej 16 mijë euro. Por Cila është e vërteta lidhur me këtë rast. Unë nuk dua të flasë se cilat ishin raportet në atë kohë në mes të E. dhe V. Por, një gjë është e sigurt. Edhe E. edhe V.i kurrë nuk e kanë mohuar këtë që e thot aktakuza. E. ka thënë se V. në periudhat të ndryshme ia ka dërguar këtë shumë parash, përmes W.U. Por këto para ja ka dërguar në emër të një borxhi që V.i ia kishte huazuar të njëjtës më parë. Këto para, janë dedikuar si këthim borxhi. Edhe V.i e deklaron të njëjtën gjë. Tregon se para vitit 2009, E. i ka huazuar para borxh në shumë prej 16 mijë euro. E njejta ia ka këthyer përmes W.U, me dedikimin, kthim borxhi, sepse ajo ishte e vërteta. Ia ka këtyre, me kërkesë e V.it, sepse ai kishte probleme shëndetësore. Edhe V.i e pohon këtë qe e thot E.. Po tani, kjo që e thotë prokurori, për këtë situatë, kur e akuzon V.O.n, pse ky ka pranuar para nga E.B, në emër të kthimit të borxhit, pse tani kërkon që E.B, tua kthej borxhin edhe të tjerëve. Sipas kësaj logjike, çdo kush që nga E.B, pranon para në emër të kthimit të borgjit, rrëshqe në vepër penale.

Situata e dytë është edhe më interesant: Thuhet se V.O., me 4 shtator 2010, nga A.B., ka pranua shumë e të hollave prej 14. 600 euro, në emër të pagesës së borxhit për blerjen e një banese.

Por në aktakuzë nuk thuhet se nga kush e ka blerë këtë banesë A.B., dhe nuk thuhet se kujt ia ka sjellë këto para V.O.. Edhe këtë situatë e ka shpjeguar V.O. dhe E.B. Kanë treguar se A.B., ka blerë banesë nga E. B., dhe meqë i njejtë J.te në S., ndërsa V.O ishte në D., E. e ka porositur që nga i njejtë të marr një shumë parashë nga A.B.. Dhe, përmes telefonit janë takuar dy her me A.B., dhe E. ja ka sjellur parat e marra nga i njejtë. Atëher pse nuk keni një aktakuzë edhe ndaj A.B. se paka bërë pastrim parsash kur EB ia ka paguar një shumë parash, në emër të blerjes së banesë nga E., me të vetmen arsye se këtë ja ka sjellë V.O..

Situata e tretë thotë: V. nga E. ka pranuar një Xhip H., në vlerë prej 35,000 euro. Edhe kjo është shpjeguar gjërë e gjatë edhe nga V. edhe nga E.. Xhipi ishte i E., dhe meqë e njejtë nuk kishte leje, këtë xhip e ka kaluar në pronësi të V. i cili edhe e ka vozitur, edhe me E. edhe pa te. Ky xhip, me kërkesë e E. i është këthyer të njejtës, sepse ajo ishte pronare e tij. Dhe tani cili është krimi këtu?

Situata e katër. E. i ka blerë 5 ari tullë në LL.. Ky konstatim në aktakuzë nuk me befason, sepse nënshkruese i aktakuzës është përpjekur që kërjt pasurën e vëllëzëve O., ta paraqes se është blerë nga E.. Por, asnjë provë e vetme nuk është ofruar e as nuk është administruar që të vërtetohet këtë pohime të prokurores. Vet E. ka thënë se as nuk e di ku gjendet kjo tokë, as nuk e njeh N. K., as nuk e di kur është blerë dhe unë asnjë cent nuk ia kam dhënë askujt për te. Atëher shtrohet pyetja se në bazë të cilave argumente akuzon prokuroria. Sigurisht jo me argumente juridike. Gjykatës i intersojnë vetëm argumente juridike. Jo të tilla nuk ka! Andaj, propozojmë që i njejtë në mungesë provash të lirohet nga aktakuza.

I akuzuari V.O. *ne fjalën e tij përfundimtare* ka deklaruar: e mbështes fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij dhe nuk kam diçka për të shtuar.

Mbrojtësi i te akuzuarit F. O. *av. Selmon Bogiqi ne fjalën e tij përfundimtare* Ka deklaruar: - fjalën përfundimtar e kam paraqitur me shkrim të cilën në pika të shkurtra do të elaburoi.

Me asnjë nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor nuk është vërtetuar se F.O. e ka kryer veprën penale e Cila i vihet në barrë, në veprimet e tij nuk ekzistojnë elementet qenësore të kësaj veprë penale, sepse nga gjendja e vërtetuar fakte nuk del se ekzistojnë rrethana, fakte dhe prova të cilat do të tregonin se ky e ka kryer veprën penale të përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, dhe se nga gjendja e provave nuk del se ka ndërmarr çfarëdo veprimi, qoftë të drejtpërdrejt apo të tërthortë për kryerjen e veprës penale e Cila vihet në barrë. Sipas aktakuzës F.O. akuzohet se ka kryer veprën penale Shpërlarja e parave nga neni 32 pika 2.1, 2.2, 2.5, dhe 2.6 sipas Ligjit për Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit, në bashkëkryerje lidhur me nenin 31 të KPK-së.

-Dispozitivin e aktakuzës se Prokurori Special e fill. me supozim se F.O. me datë 30 shtator 2009 në Lagjen Q.në P., duke ditur se ka pas arsye që ta di se mjetet financiare të E.B. me të cilat është blerë truallin kanë B. nga aktiviteti kriminal, një pjesë të mjeteve financiare ka konvertuar dhe transferuar me qëllim të ndihmës duke tentuar që ta fsheh gjurmët e mieteve financiare pranon dhe bartë në pronësi të veten truallin e blerë nga E.. Këtë e bënë përmes nënshkrimit të kontratës në mes të B. G. dhe F.O. me të cilën kontratë ka pranuar truallin me sipërfaqe prej 7.5 ari, në të cilin truall janë ndërtuar dy shtëpi dykatëshe me nga dy hyrie.

Në faqen 34 të aktakuzës Prokurori Special ka propozuar :Që të konfiskohen dy shtëpi dy katëshe me nga dy hyrje në lagjen Q. të cilat janë të ngritura në parcelën në Zonen kadastrale Ç. : Nk.nr/. vendi i quajtur "Sh." me sipërfaqe prej 0.04.00 ha dhe Nk.nr./. vendi i quajtur

"Sh." me sipërfaqe prej (.).03.50 ha dhe Truallin në emër të F.O. në sipërfaqe prej 5 ari (500m2) në vendin e quajtur LL. K. e P.s sipas çertifikatës nr.P-.....-.....-..

-Nga formulimi i tillë i dispozitivit të aktakuzës del qartë se Prokurori aktakuzën e ka bazuar në supozimë dhe thashetheme dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor Prokuroria nuk ka zbuluar asgjë të paligjshme në veprimet e F.O., por vetëm me bindjet e tij personale është bazuar në supozime dhe akuza ishte joprofesionale dhe kundërshtim me dizspozita ligjore në t'uqi.

Prokurori gabimisht ka vlerësuar faktet në dëm të pandehurit. Përkundrazi, Prokurori këtë fakt është dasht që ta vlersojë dhe interpretoj në favor të tij.

-As gjatë hetimit e as gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ka arritur e të vërtetoj tezën e akuzës, nuk ka arritur të vërtetoj se në veprimet e F.O. manifestohen ndonjëri nga tiparët që paraqesin figurën e veprës penale të shpërlarje e parave, ashtu Siq kërkohet me ligj.

-Gjatë shqyrtimit gjyqësor prokuroria nuk ka arritur të vërtetoj ekzistimin e dy kushteve themelore sipas dispozitave ligjore.

Për të vërtetuar përgjegjesin penale : kushti objektiv kërkon se vepra penale duhet të dëshmohet përtej dyshimit të arsyeshëm ndërsa sipas nenit 240 të KP-së në fuqi, kushti objektiv që për ngritjen e aktakuzës kërkohet që të vërtetohet dyshimi i bazuar mirë, dhe kushti subjektiv që po ashtu duhet të dëshmohet përtej dyshimit të arsyeshëm dyshimit të bazuar mirë se kryesi i veprës penale e ka kryer veprën penale me qëllim si formë të dashjes.

Askush nga të pandehurit apo dëshmitarët të cilët janë dëgjuar dhe kanë dhanë deklartë në shqyrtimin gjyqësor nuk e kanë vërtetuar dyshimin e arsyeshëm së F.O. ka ndërrmar çfardo veprimi të drejtëpërdrejt apo të tërthort në kryerjen e vepres penale në bashkëkryerje.Shumica e dëshmitare të dëmtuarve gjatë helimeve po edhe në shqyrtim gjyqësor kanë deklaruar se nuk e njohin F.O. dhe atë nuk e kanë pa kurrë. Kjo nuk është vërtetuar me asnjë prove material.

-Bashkëkryerja. I mbrojturi im F.O. gjatë deklaramit të tij në shqyrtimin gjyqësor të datës 04.05.2022 ka deklaruar se të akuzuarën E.B për herë të parë e ka pa në Gjykatën Komunale ,në Prishtinë. në seancën te gjyqëtar i procedurës paraprake Vehbi Kashtanjeva ne vitin 2014 deri sa të akuzuarit tjerë nuk ka pas kontakte dhe asnjëherë nuk i ka pa dhe nuk ka biseduar me ta për asnjë çështje.

Prokurori i shtetit në mënyrë të gabuar dhe pa prova e ka ngarkuar të mbrojturin tim që ai në marrëveshje Ine të akuzuarit tjerë ka kryer veprën penale të cekur si rnë lartë.

Duke filluar prej procedurës së hetimeve, deklarateve të tij i dhanë te Prokurori i Shtetit dhe në shqyrtimin ajyqësor nuk ka arrit Prokurori i Shtetit që të vërtetoj faktin se F.O. është në lidhje me të akuzuarit tjerë për kryerjen e veprës penale si më lartë.

-Për bashkëkryerjen praktika thotë: Në kondita të caktuara bashkëkryerja mund të qëndroj edhe në anën e bashkëpjesëmarrësit i cili nuk ka ndërrmarrë vetë veprimin e kryerjes së veprës penale. Në faktë bashkëkryerja qëndron edhe në anën e atij pjesëmarrësit i cili nuk e ka kryer veprimin e kryerjes së veprës penale, nëse në kohën e ekzekutimit te kryerjes ai ka ndërmarr veprimin i cili është ngushtë i lidhur me veprimin e kryerjes dhe me atë përbën një tërësi unike dhe i kontribuon realizmin të saj, kurse të ai bashkëkryes ekziston vetëdija (dashja) mbi veprimin e përbashkët dhe shkaktimin e pasojës dhe vullneti që vepra penale të kryhet si vepër e tij".

Për ekzistimin e bashkëkryerjes është domosdoshme jo vetëm të ekzistoj marrëveshja paraprake apo koshienca (dashja) për faktin se veprohet bashkarisht në drejtim të shkaktimit të pasojës së ndaluar por edhe të ndërrmarret ndonjë veprim tjetër i cili organikisht është i lidhur me veprimet themelore ose në mënyrë tjetër të kontribuohet në shkaktimin e pasojës së ndaluar.

- Në shqyrtimin gjyqësor të datës 31.05.2021, F.nr 6 dëshmitari J. Gj. ka deklaruar se e ka nënshkruar kontratën e shitblerjes të datës 30.09.2009 në emër të B.G.në cilësi të shitësit ndërsa në emër të blerësit e ka nënshkruar F.O. dhe se vlera atyre dy trojeve ishte 80.000 euro, blerësi inkasimin e ka bërë përmes B.. se F. për shitjen e atyre dy trojeve ishte së bashku me vëllaun e tij, së pari kane ardhë për shiqimin e trojeve pas 2-3 dite ka ardh dhe e kemi përpilaur parakontratën, unë në atë kohë kam punuar në sektorin e palujtshmerise se B. G., punoj që 20 vite dhe brenda kësaj kohe janë shitur më shumë se 1000 troje.

-Dëshmitari V.V. në shqyrtimin gjyqësor të datës 31.05.2021, faqe nr. 17 ka deklaruar se prej viti 2006- deri 2008 e kam pas me qira lokalin e A., V. dhe F. të cilët janë vëllezër. Nuk kam pasur kontratë të shkruar por marrëveshje gojore. Lokalin e kam shfrytëzuar për furrë buke "me emrin D.", qiraja mujore ka qenë 650 euro dhe se pagesa është bërë në kesh.Në afërsi të këti lokali ka qenë marketi "V.I." në të cilën kanë punuar A. dhe F., pagesën e qirasë ja kam bërë A.

-Dëshmitari S. K. në proceverbalin e shqyrtimit gjyqësor të datës 31.05.2021, faqe nr. 12 ka deklaruar se F.O. e njeh, se prej F. e ka marrur me qira lokalin dhe e ka shfrytëzuar prej vitit 2002 deri vitin 2006, dhe qiraja ka qenë 1350 e, dhe ky lokal gjithsej kishte një sipërfaqe prej 300 m2 dhe e kam përdor dhe shfrytëzuar për shitie më shumicë të materialit elektrik.

- Mbrojtësi në këtë pik përshkruan deklaratën e dëshmitarit lidhur me të ardhurat e tyre lidhur me atë se E.B. nuk e kishte njohur.

- E pandehura E.B në shqyrtimin gjyqësor të datës 18.02.2022 në faqen nr. 16 ka deklaruar se F.O.n për herë të parë e kam parë në Gjykatën Themelore në Prishtinë. në seancën e shqyrtimit fillestar. Unë kam deklaruar se më F.n nuk kam shkuar më ble token prej B. G. por kam shkuar me V., pasi qe e kam njohur B. nga se ai ishte agjend i shitjes dhe kam shkuar me të që të bëjmë një tolerance për çmim pasi e njihsha atë.Më tutje ka deklaruar se asnjë cent nga të hollat e kompanisë sime nuk kan hyrë në atë truall dhe në atë shtëpi. Për truallin e kam blere nga B. G. në lagjen Q. prej 7.5 ari. E vetmja bisedë me B. G. ka qenë vetëm rreth çmimit.

-I pandehuri V.O. në procesverbalin e vazhdimit të shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se e njeh E.B me të .jamë njoftuar në P., se kam qenë në lidhje me E., se gjipi ka qenë i E., kam qenë si një Ilojë shoferi dhe ku ka pasur nevojë të shkoj une e kam derguar, ky gjip ka qenë i regjistruar ne emer timi dhe e kam vozitun sa here kam ardhun në Kosovë. Më tutje mbrojtësi për shkruan deklaratën e të akuzuarit V. të dhënë para gjykatës si lidhur me blerjen dhe regjistrimit të automjetit H në emër të tij ashtu edhe lidhur me pronën.

-I pandehuri F.O. në proceverbalin e shqyrtimit gjyqësor të datës 04.05.2022 ka deklaruar se E.B për herë të parë e ka takuar Gjykatën Themelore ne Prishtinë. viti nuk rënë kujtohet dhe unë isha në cilësi të dëmtuarit, ajo është hera parë që e kam parë E.B.. Të pandehurit XH.A. dhe B.V. nuk i njoh dhe nuk kam pasur kontakt me ta dhe i ka parë vetëm në gjykatë. Më tutje mbmbrotja ka përshkruar deklaratën e të akuzuarit F. të dhënë para gjykatës.

Lidhur me provat materiale mbrojtësi S. B. ka theksuar :

-Sipas kontratës të shitblerjes të datës 30.09.2009 e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë me numër VR.nr/.... e datës 30.09.2009 rrjedh se në këtë kontratë shitës është B. G. (N.) ndërsa si blerës është F. P. (Q.) nga P..Lëndë e shitblerjes janë nk,nr vendi quajtur "Sh." me sipërfaqe prej 0.04.00 ha dhe nk.nr/ . vendi quajtur "Sh." me sipërfaqe prej 0,03.50 ha.

Në nenin 2 të kësaj kontrate çmimi i shitblerjes ka qenë 80.00 e, e Cila shumë i është paguar i J. Gj. nëpër mes R. B. me datë 30.09.2009, ngase i njëjti ishte autorizuar si përfaqësues për

nënshkrimin e kësaj kontrate nga ana e pronarit të këtyre trojeve B. G.. Sipas dokumentit të "W. U." të datës 27.04.2021 vërtetohet se A. O. ka tërhequr të holla prej 01.01.2000 deri më 27.04.2021 shumën prej 31.000.00 €.

-Nga dërgesa e parave nëpërmes "W. U." në emër të A. dhe F.O. në periudhën nga viti 2004 deri 2010 vërtetohet se të njëjtit kanë pranuar shumë prej 37.500 euro.

-Sipas ekspertizës financiare e datës 26.07.2021, konstatohet se E.B. e kishte regjistruar kompaninë e biznesit "V.- O-G." SH.P.K me nr. biznesi dhe numër fiskal me datë 13.10.2009 në rrugën "R. L." / . P., me veprimtari ndërtimi i lartë dhe i ulët, dhe me të njëjtin kishte vepruar me dy emertime here si "V.- O-G." SH.P.K. e here si " V. -O- G." SH.P.K.

Në faqën 22 të ekspertizës është konstatuar nga ekspertet financiarë se e pandehura E.B. gjatë afarizmit — nga inkasimi i mjeteve nga shitja e banesave të paguara nga blersit dhe avance dhe kiste mujore për vitin 2009 në llogarinë e saj B. kishte gjithsej shumën prej 15.360.00 euro.

Nga gjendja financiare të hyrat e realizuara për vitin 2009, ekspertiza ka konstatuar se në llogaritë rrjedhëse B. E. B. ka poseduar para të gatshme në shumën prej 15.360.00 G.

Sipas analizës së të hyrave të E.B. për vitin 2009 është provuar materiale të cilat konfirmojnë faktin se e njëjta nuk ka poseduar para përveç asaj vlerë të shënuar më lartë. E.B. kompaninë "V.- O – G." SH.P.K. e ka regjistruar me datë 13.10.2009. Nga provat materiale të prezantuara dhe të konstatuara edhe me ekspertizën financiare, E.B. nuk ka pasur mundësi financiare që me datë 30.09.2009. që të paguaj shumën prej 80.000 euro për blerjen e dy trojeve në agjencinë Q. në sipërfaqe ari, nk.nr. 1273/6 dhe nk.nr./, nga arsyet se e njëjta në atë kohë nuk e ka pasur të regjistruar kompaninë e saj "V.- O- G.", edhe nuk ka realizuar mjete financiare nga shitja e banesave siq rezultojnë nga aktakuza dhe fjalatë përfundimtare e Prokurorisë së Shtetit.

Pagesa e trojave të theksuara me lartë ka ndodhur 14 ditë para se të regjistrojë E. B. kompaninë "V.- O- G." dhe nuk ka pasur mundësi reale që ajo të paguaj shumën prej 80.000 e për blerjen e trojeve ngase në llogarinë e saj B. për vitin 2009 gjithsej ka poseduar në llogarinë shumën prej 15.360.000 G.

Nga kjo gjendje e fakteve nuk është vërtetuar teza e aktakuzës, dhe me asnjë provë Prokuroria gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e ka dokumentuar se këto dy troje janë blerë me para që kanë B. nga aktiviteti kriminal. Prokuroria nuk ka ofruar prova se trojet i ka blerë E.B. se i mbrojturi im në asnjë mënyrë nuk e ka ditur se në çfarë forme mjetet financiare i ka realizuar E.B., nuk ka pasur kurrfarë njohurie për transfere, konvertim të mjeteve financiare të E.B., e po

ashtu Prokuroria nuk ka arritur të paraqes veprimet e bashkëkryerjes së të mbrojturit tim me qëllim të ndihmës apo fshehjes së gjurmëve të mjeteve financiare të E.B.

Po ashtu gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar teza e aktakuzës se ajo pronë është blerë me mjete të fituara nga aktiviteti kriminal i E.B.

Nga provat materiale të administruara, e të paraqitura edhe në këtë fjalë përfundimtare siq janë fitimet e realizuara nga puna e sigurt e F.O. dhe vëllezërit e tij para luftës dhe pas luftës është konstatuar se fitimi me ndërrmarjen private "V.I." prej viti 2000-2009 është në shumën prej 210.634.94 €, ndërsa të hyrat tjera përmes qirave dhe të dërguara nëpërmes "W. U." dhe të hyrat e fituara nga vëllau i tij në D. janë në shumën prej 97.552.04 euro.

Nga kjo rrjedh se B. i i të hyrave për periudhën 2000-2009 është në shumën prej 414.668.98 euro.

Ndërsa B. e të të hyrave për periudhën 2010 deri në mars të vitit 2021 nga biznesi "V.I." në P. është në shumë prej 515.118.50 e, duke përfshir edhe të hyrat e dërguara nëpërmes "W. U." të datës 14.10.2021 në shumë prej 3000 €, dhe të hyra të tjera të realizuara nga vëllau i tyre në D. në shumë prej 187,039.31 € .

Të hyrat totale për periudhën 2010 I-III -2021 B.i i të hyrave totale është në shumë 705.157.81 e. Kjo gjendje dhe ky B. i të hyrave në mënyrë të hollësishme është paraqitur në faqen 26-27 të ekspertizës financiare.

Parat të cilat janë paguar me datë 30.09.2009 për blerjen e këtyre dy trojeve kanë qenë të familjes O., e që posht ekspertiza financiare konstaton në mënyrë të hollësishme fitimin dhe realizimin e të ardhurave të N.T.P "V.I." e regjistruar me nr. biznesi datë 05.07.2000. me adres L.e P. nr. ... P..

-Nga të ardhurat vjetore nga veprimtaria e ushtruar përmes biznesit për vitet 2000-2009 është në shumë prej 210, 634.94. Të hyrat përmes "W. U." për periudhën 2004-2009 është shuma prej 34.500.00 €.

-Të hyrat nga qiraja- S. K. për periudhën 2002-2004 shuma prej 48.600.00 €. Të hyrat nga qiraja- V. V. për periudhën 2006-2008 është shuma prej 23.400.00 €. Të hyrat e vëllaut në D.ë për periudhën 2003-2009 është shuma prej 97.552.04 €. Të hyrat në totalë për periudhën 2000-2009 janë në vlerë prej 414.686.98 €

-Ekspertiza ka siguruar edhe B.in e të hyrave për periudhën 2010 deri në mars të vitit 2021 dhe ka gjetur se me realizimin -fitimin e parave të cilat i ka realizuar V.O. në shumë prej 187.039.31 e. Te hyrat në totali prej vitit 2010-2021 janë 705.157.81 €.

-Të pandehurit e përfshirë në këtë, e po ashtu edhe i mbrojturi im ka deklaruar se këta persona nuk i ka njohur më parë nuk ka bashkpunuar me ta nuk ka kryer kurrfar transaksioni, duke deklaruar se edhe të pandehuren E.B nuk e ka njohur më herët përveç në zyrën e gjyqetarit V.K. në vitin 2014.

Andaj as që është vërtetuar bashkryeria siq e ka paraqitur prokuroria e shtetit aktakuzën e datës 12.05.2016.

Kryetarit të trupit Gjykues, duke u bazuar në të gjitha provat e administruara i propozoj që në kuptim të nenit 364 pika I par. 1.3 të KPPK-së të merr aktgjykim lirues për të mbrojturin tim F.O. sepse nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

Trupit gjykues i propozoj që ta refuzon propozimin e Prokurorisë për konfiskimin e dy shtëpive dy katërshe me nga dy hyrje në lagjen "Q." të ndërtuara në .

c) Nk.nr/. vendi i quajtur "Sh." me sipërfaqe prej 0.04.00 ha dhe

d) Nk.nr./. vendi i quajtur "Sh." me sipërfaqe prej 0.03.50 ha

Truallin në emër të F.O. në sipërfaqe prej 5 ari (500m2) në vendin e quajtur LL. Komuna e P.s sipas çertifikatës nr.P-.-.....-.....-

Mbrojtja kosideron se sa i përket propozimit te Prokurorit të Shtetit për konfiskimin e dy shtëpive dy katëshe në lagjen "Q." dhe një trualli në fshatin LL., nuk ka arritur që ta vërtetoj tezën e aktakuzes dhe në këtë shqyrtim gjyqësor nuk ka paraqitur asnjë provë materiale për të bindë gjykatën se trojet janë blerë me parat e E.Bt, dhe nuk ka arritur ta vërteton bashkryerjen e të

mbrojturit tim. Siq kam theksuar më lartë në këtë fjalë përfundimtare parat në shumë prej 80.000 € janë nga B.i i të ardhurave të fituara nëpërmes N.T.P "V.I." ne P.s dhe një pjesë të parave të cilat të cilat i kanë fituar nëpërmes biznesit deri në fillim të vitit 2009.

Më hollesisht fitimi i këtyre mjeteve financiare është paraqitur edhe në ekspertizën financiare të ekspertëve të autorizuar dhe të cilët janë angazhuar nga Gjykata për dhënjen e mendimit për mënyrën e B.it të të ardhurave nëpërmes N.T.P " V.I." dhe fitimeve tjera të cilat janë të përshkruara në ekspertizë.

I akuzuari *F.O. në fjalën e tij përfundimtare* deklaron: e përkrahi fjalën përfundimtare të avokatin tim, për ndryshe për blerjen e truallit dhe ndërtimin e shtëpive nuk kam pasur nevojë askush me na blere neve truall nuk kemi qene ne atë dregje kemi pasur banim sa dush kemi pasur shtëpi, kemi blere me djersën ton me gjakun tone, dhe këto që po them jam të vërtetuar edhe në ekspertizë të gjykatës dhe nëse edhe ju gjeni ndonjë njeri që thotë se F.O. me familjen O. ja ka marrë ndonjë vetëm një cent unë jap përgjegjësi penale. Deri me tash asnjë i dëmtuar dhe askush nuk ka mundur me argumentuar që na i kemi marrë dikujt parë me blere atë truall e me se paku E. B. i kemi pasur të gjitha mundësit për me blere truall. Kërkoj nga ju të nderuar Gjykatës, e nderuar panel që të vlerësoni shumë drejtë këto të thëna tona, dhe të më dënonin nëse ka fakte, ose të më lironi nga aktakuza.

* * *

Gjykata pas administrimit të provave të cekura si më lart, i ka vlerësuar të njëjtat një nga një dhe në lidhmeri reciproke me njëra tjetrën dhe ka gjetur se e akuzuara E. B. V.B dhe B.V., janë fajtores për shkak të veprës penale " krim i organizuar " nga neni 283 par 1 të KPRK-se, e në raport me E. B., para 2 të KPRK-se, e lidhur me veprën penale të mashtrimit nga neni 335 par 5 lidhur me par 2 dhe par 1 të KPRK-se, me gjendje faktike të përshkruar si në dispozitivin e parë të këtij aktgjykimi. Të akuzuarit E. B., Gj. A., B. V. V.O. janë fajtores për shkak të veprës penale " shpërlarja të parave " nga neni 32 pika 2.1 , 2.2 , 2.5, dhe 2.6 sipas ligjit për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit e terrorizimit e lidhur me nenin 31 të KPRK-se, në përshkrim të gjendjes faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

E akuzuara E. B. duhet të lirohet nga aktakuza për shkak të veprës penale shkaktimi i falimentimit nga neni 234 të KPRK-se, dhe veprës penale shmangie nga tatimi nga neni 249 par 1 lidhur me par 2 të KPRK-se me përshkrim të gjendjes faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

I akuzuari F. O. lirohet nga aktakuza për shkak të veprës penale shpërlarja e parave nga neni 32 par 2 pika 2.1 , 2.2, 2.5 , 2.6 të Ligjit për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit e terrorizimit lidhur me nenin 31 të KPRK-se me përshkrim të gjendjes faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjykata e ka vërtetuar në provat e administruara në shqyrtim gjyqësor të cekura si më lart, për të cilat do të paraqes arsyet një nga një.

Deklaratat e dëshmitarve dhe dhe të dëmtuarve të dhëna para gjykatës dhe vlerësimi i tyre

Dëshmitari *L. G.* ne seancën e dt. 30.11.2021 ka deklaruar se: ne vitin 2009 ka lidhur nje kontrate për ndërtim te përbashkët me *E. B.*, dhe kane qene edhe pronaret e tjere dhe kane qene diku 70 ari toke dhe nuk e di gjithsejt sa pronar. Ne atë pjese te tokës ku ka qene ky pronar, kishin filluar punimet diku 3 - 4 muaj ose 5 pas lidhjes se kontratës me *E.*, ndërtimi ka qene minus 1 dhe temel me përdhes. Me *E.* e ka prishur kontratën dhe kushti kryesore ka qene qe asnjë hap te mos ndërmerr pa u marr leja e ndërtimit nga urbanizmi. Ne atë kohe ka qene ligji pak me ndryshe dhe është dasht me u marr leja për kushte urbanistike, dhe kushtet e urbanistike kane lejuar qe te ndermerren hapat vetem sa i përket pjese se dheu qe i bjen pergaditja e terenit por jo edhe ndërtimi. E kane prishur kontratën me *E.* pasi qe është punur, janë ndërprerë punimet, kanë filluar punimet dI. here por ndërtimi është ndërpre kemi pare qe nuk po merret leja, atëherë dhe e kemi shkëputur kontratën. Si pronareve te tokave i ka percjelle pikat e kontates te cilat i ka pasur për obligim dhe njëra prej tyre ka qene leja e ndërtimit, dhe obligim i tyre ka qene me percjelle çeshtjen e lejes. *Xh. A.* e ka njohur para se me lidh kontrate ka rastisur me e njohur me rrethanat e tjera. Është marrë vendim me e shkepur kontratën me *E.* dhe *Xh. A.* është paraqitur duke i thene se është pjese e projektit edhe ky ka investuar i ka lutur qe te mos prishet kontrata por te gjendet nje zgjidhje. Pastaj te gjithë kane qene kategorit qe te shkeputet kontrata. Keta kane kërkuar kur është paraqitur *Xh. A.* qe te gjendet nje investitor i ri, dhe pastaj *Xh. A.* ka shkuar me nje investitor tjetër dhe kërkesa e këtyre ka qene qe investitori i ri ti merr te gjitha obligimet ne raport me investitorin paraprak. Pastaj këta kane lidhur kontratë me *D.B.* pronar i “*A. G.*” dhe *Xh. A.*. Ky nuk ka ditur se kush kujt çka ika borxhe. Blloku i par është përfunduar ndërkaq blloku i dyte ka vanuar shume mirëpo tani ka përfunduar. Shkeputja e kontratës është bere për shkak se ka pasur vonesa ne ndërtim dhe për shkak se nuk është marrë leja. Objekti i pare ka përfunduar ne vitin 2017 apo 2018 nderkaq objekti i dyte ka përfunduar ne vitin 2021. Nuk e di nese ka pasur pengesa te tjera përpos lejes. Nderkaq gypi ka qene problem te dy objekte ndërkaq te dy objektet e tjera nuk ka qene problem, por *E.* qeshtjen e gypit e ka ditur me kohe. Këta nuk e kanë ditë se çështja e gypit është probleme për marrjen e lejes.

Dëshmitari *I. D.* ne seancën e dt. 30.11.2021 ka deklaruar se ka dhënë deklaratë ne prokurori nuk i kujtohet se çka ka deklaruar. I kujtohet se me *E. B.* kane lidhur kontratë për ndërtimin e përbashkët. Kane filluar ndërtimet dhe *E.* ja ka treguar punimet nuk kane qene pjese e involvuar për me pa se çka ka ndodhur dhe kane qene 2 – 3 kate te ndërtuara por nuk i kujtohet saktë. I kujtohet si arsye kryesore e shqetësimit te tyre ka qene se nuk ka pasur leje te ndërtimit dhe kur kane dashur me investuar i kane kërkuar lejen dhe lejen nuk ju ka prezantuar. Kishte kaluar nje kohe e gjatë dhe këta kishin kërkuar me ja paraqit lejen. Projekti ka qene i filluar vetem podrumi. Meqë leja nuk i është prezantuar dhe ndërtimi nuk është bere ashtu siq është parapare me dy kate garazhd këto kane qene shqetësime për ta. Gjatë kohës sa kanë kërkuar leje nga *E.* aty ka nderhyre *XH.A.* dhe shqetësimi i tyre ka qene se po punohet pa leje, dhe nuk po punohet sipas projektit qe është prezantuar. Janë ndërpre punimet ka vazhduar dI. here. Pastaj është prishuar kontrata dhe objekti ku ka punuara *E.* ju është bartuar z. *Xh.A.* dhe “*A. G.*”. Te njëjtit kane premtuar se do te merr lejen dhe këta nuk e kane kundërshtuar, sepse kanë qenë të intersuar me marrë leje dhe me vazhduar objektin. Nuk kanë pasur ndonjë interes tjetër. Nuk e di sakt se cili ka qene interesi i *XH.A.*t këta kanë lidhur kontrate me *A. G.* pas terheqjes se *E.*. E di qe ka ekzistuar nje marrëveshje. Ky nuk ka njohuri qe *E.* ka pasur marrëveshje me personat e tjere, ngase nuk ka pare persona te tjere qe kane shkuar te objekti pasi qe vete shume rrallë ka shkuar atje. Ka pasur njohuri qe ne pronën ku ka pasur me u bo ndërtimi ka pasur nje gyp, nuk e di se çfarë përpjekje ka bere *E.* mirëpo gypi ka qene ne nje vend tjetër e jo aty ku ka pasur me ndërtuar *E.* dhe nuk e ka penguar *E.* me ndërtuar. Problem per ndërtim nuk ka qene gypi. Askush nuk

ka shkuar me ju thane se këtu nuk ban me u ndërtuar nga se këtu për kete ka qene nje kallëzim penale. E. asnjëherë nuk e kane lejuar me punuar pa e pasur lejen, por ajo njëherë ju ka thene se ka leje, pastaj këta ja kane kërkuar deshmin me shkrim dhe ajo nuk ju ka prue dëshmi dhe nuk ju ka prezantuar lejen, dhe kjo mund te vërtetohet edhe ne Komune se kur është leshur leja për ate objekt. A. G. dhe firma H. kane ndërtuar ne atë pjese dhe janë ndërtuar tri hyrje nje pjese e pronareve te tokave kane shkuar te firma H. dhe nje pjese te A. G., nje hyrje nga firma H. ka mbetur pa u ndërtua. Nuk mund te di sakt se XH.A. a ka aty objekt.

I deshmitari L. G. ka deklarua në prokurori ka theksuar se gjate vitit 2009 kam vendosur me gjet e investitor për ndertim te lart jam takuar me E. dhe e njejta ka pasur fjalë te forta është prezantuar si punonjese e B. R. dhe ju ka thene se projekti do te finacohet nga kjo B.e dhe do te jen përfitues Policia e Kosovës. Kane lidhur kontrate me te dhe kane insituar qe te respektohen kushtet e kontrates. E. i kishte mashtruar duke ju thene se leje e ndertimit është provcedure por do te siguroi, por qe nuk e ka siguar. E. nuk ka respektuar kontraten vazhdimisht ju ka premtuar dhe ju ka genjyer. E. i ka ndërruar kompanit ndertuese gati çdo kat, kompania N. I kishte ndertuar dy kate dhe ishte larguar për shkak te mos pangese, kompania A. kishte ndertuar dy kate. Pastaj me qene se e njejta nuk e ka prezantuar lejen kane mare vendim me e shkeputur kontraten. Pastaj është paraqitur Xh. A. si nje klient i E. qe kishte dhene te holla 200.000 – 300.000 euro, dhe pastaj Xh. I ka marrë obligimet e E. vetem sa I perket ndertimit por jo edhe obligimet ndaj paleve te treta. Xh. e kishte angazhuar A. G. in për ndertim dhe nje pjese tjeter e kishte mare kompania H.. Për ndertimin e objektit A. E. nuk ka pasur kurrfare pengese teknike, sa here qe jam takuar me E. ka qene I pranishem B.V. po ashtu ka qene I pranishem V. dhe E. pra dy vellezerit e E. ka qene I pranishem edhe nje person qe i kanë treguar qe është I dashuri I saj por nuk e ka ditur rolin e ti.

Në deklaratën e dhënë në polici I. D. kishte deklaruar se për herë të parë me E. ishte takuar gjate vitit 2009 kane qene te gjithë bashkepronaret e tokave. Gjate bisedese E. ju ka dhënë premtime te medha. Kane lidhur kontrate me E. dhe I kane percaktuar kushtet. I ka filluar gërmimet I ka kryer dI. pune te vrazhda dhe ka arritur deri ne katin e III. Te gjitha punet I ka kryer me nderprere dhe dI. firma qe I ndrronte. Dhe kur e kane pytur se pse është stopuar puna ajo i ka thene se i kane shkuar arkitektat ne pushim etje. Ne parcelen ku kishte filluar te ndertoit nuk ka pasur asnje pengese sa I perket gypit te ujesjellesit. Ajo nuk ju ka prezantuar leje te ndertimit. Ne pranevere te vitit 2010 e kam verejtur se ajo është duke I mashtruar, dhe se e njejta nuk kishte paguar për leje te ndertimit, me vone si GRAQANICE kane vendosur qe te terhiqen prej marrëveshjes dhe pas asaj kane lidhur marrëveshje te ndertimit me nje kompani tjeter dhe ate NTP “H. “. Gjate kontaktkeve me te ne zyret e saj ka qene present vllai I saj V.B si dhe B. V. ata kane qene rregullisht staf i E., çdo her e kane marrë pjese ne bisedat e tyre.

Në deklaratën e dhënë në prokurori dëshmitari I. D. kishte deklaruar se ishte interesuar te gjeje investitor për ndertimet e larta pasi qe aty ku kishin pronen lejohet ndertimi I lartë. Si pronar te tokave kane lidh kontraten me E. B. dhe I kane lidhur dy kontrate njera me dt. 15.04.2009, e tjetra nuk I kujtohet data. E. I kishin besuar sepse I kishte thene se bashke investitor dhe garantues ishte B.a R. ne P.. Ajo I kishte thene se ka shume bleres nga Institucionet e Kosovës. Ne shtator te vitit 2009 E. kishte filluar ndertimet kishte hap temelinet dhe kishte vendosur nje pllak te podrumit, deri ne muajin maj te vitit 2010 nuk ka ndertuar asgje. E. nuk ju kishte prezantuar leje te ndertimit dhe keta nuk kane dashte me vazhduar pa leje. Ja kane lene nje afat prej 30 diteve me nje shkrese dhe pastaj E. ka

premtuar se do ti plotesoi te gjitha kushtet për leje ndertimore dhe kishin lidhur edhe një aneks kontratë. Ajo pastaj kishte vazhduar punimet dhe duke se ishte serioze pasi qe ndertohej nga kompania A. Pastaj ka nderpre punimet dhe ka degjuar se nderprerja është bere për shkak te mos pangesa ndaj kompanisë. Ne nentor te vitit 2010 I kam thene E. se do te shkeputim kontraten pasi qe ajo nuk kishte paguar për leje ndertimore. Prej bashkepunetoreve te E. me se shumti jane takuar me B. V. dhe vellerit e E. V. dhe E. B. Takimet I ka mbajtur ne zyren e E. A., por ka ndodhur qe takimet I ka mbajtur ne restorane dhe aty kane qene edhe V. e B.. Kur e ka nenshkruar marrëveshje për nderprere te kontrates ka qene present vellai I saj V. I ka thene V. se nuk mund te vazhdojme ne këtë mënyrë dhe ai ju ka thene se do te ju ktheje një pergjigje por nuk ua ka kthyer. Keshtu qe keta e kane shkeputur kontraten por paraprakisht Xh. A. kishte kerkuar qe E. te ja japin edhe nje mundesi mirepo keta nuk kane pranuar dhe pastaj Xh. A. ju ka sjelle investitorin e ri A. G. kane bere marrëveshje me investitorin e ri dhe ne vitin 2013 e kishte përfunduar ndertesën e nisur.

Nga dëshmia e dëshmitarit S. Z. të dhënë në të dhënë në prokurori me dt.24.10.2014 vërtetohet se: ishin angazhuar I. D. dhe L. G. për dhenien e tokës ne ndërtim dhe ky kishte marrë pjesë dhe gjate vitit 2009 ishte takuar me E. B. . Është e vërtete ne vendin ku ka pasur me u ndertuar objekti A2 kaL. nje gyp I ujesjellesit mirepo E. ka qene e njoftuar për ketë qysh para lidhjes se kontrates dhe ka thene se do te zhvendos. Gypit fare nuk ka qene arsye e mos ndertimit sepse E. nuk e ka ndertuar as objektin A1 për te dal te objekti A 2. Pasi qe ka pa se ka deshtuar realizimi I kontratës atehere kane kerkuar nderprerjen e kontrates dhe G. I tyre kane vazhduar me investitorin A. G. e G.i tjetër me firmen H., e ndien veten te demtuar.

Dëshmitari N. S. në deklaratën e tij të dhënë në prokurori me dt.23 .10.2014 kishte deklaruar se bashk me pronarët e tjerë ishin të interesuar për ndërtime larta pasi që lejohej. I. D. kishte njoftuar se kishte gjetur një investiture E.Bt. Për here te pare me E. ishte takuar gjate vitit 2009 kane qene te gjithë bashkepronaret e tokave. Gjate bisedese E. ju ka dhënë premtime te medha dhe I ka thënë se ka kontaktuar shumë banes me policing dhe FSK-në dhe po ashtu ju ka thënë se pas saj qendron Raiffezen B.. Ka lidhur kontrate me E. dhe I kane percaktuar kushtet. I ka filluar germimet I ka kryer dI. pune te vrazhda dhe ka arritur deri ne katin e III. Te gjitha punet I ka kryer me nderprere dhe dI. firma qe I ndrronte. Dhe kur e kane pytur se pse është stopuar puna ajo I ka thene se I kane shkuar arkitektat ne pushim etje. Ne parcellen ku kishte filluar te ndertoit nuk ka pasur asnje pengese sa I perket gypit te ujesjellesit. Ajo nuk ju ka prezantuar leje te ndertimit. Ne pranevere te vitit 2010 e kam verejtur se ajo është duke I mashtruar, dhe se e njejta nuk kishte paguar për leje te ndertimit, me vone si G. kane vendosur qe te terhiqen prej marrëveshjes dhe pas asaj kane lidhur marrëveshje te ndertimit me nje kompani tjetër dhe ate NTP “H. “. Gjate kontakteve me te ne zyret e saj ka qene present vllai I saj V.B si dhe B. V. ata kane qene rregullisht staf I E. , çdo her e kane marrë pjese ne bisedat e tyre.

Nga deklaratat e dëshmitarve - pronarve të tokave të cekura si më lartë të dhëna para gjykatës dhe në procedurë paraprake që ishin në përpushje me kontratat e lidhura, vërtetohet se me E.B. kishin lidhë kontrata për nderimin të përbashkët.

Nga deklarata e tyre u vërtetua se nuk ishte ndërtohej sipas marrëveshjes. Të njëjtit e kishin kundërshtuar, pasi që nuk po ndërtohej sipas marrëveshjes dhe se e akuzuara nuk kishte siguruar leje të ndërtimi si kusht i paraparë në kontratën për nderimin e përbashkët. Ajo dI. herë kishte filluar dhe pastaj e kishte ndërpre, kishte angazhuar kompani ndertimore nuk i kishte paguar.

Gypi i ujit nuk kishte qenë pengës, dhe së paku dy objekte kanë mundur të ndërtohen pa problem por e njëjta nuk kishte ndërtuar dhe për atë pjesë që kishte filluar ndërtimin në objektin e parë nuk e kishte respektuar marrëveshjen. E. kishte qenë e njoftuar me kohë për ekzistimin e gypit. Aty ishte paraqitur pastaj XH.A. i cili ju kishte lajmëruar si investitor dhe më pas kishte siguruar një investitor dhe ishte ndërtuar objekti i parë e objekti i dytë ishte ndërtuar por më von. Nga këto deklaratat u vërtetua edhe pjesëmarrja dhe roli i të akuzuarve E.B B.V. dhe V.B. Ku B.V. kishte qenë ai që e kishte ven kontaktin e të akuzuarës me pronarët e tokave, kishte qenë vazhdimisht prezent gjatë bisedimeve, se të njëjtit qenë prezent dhe ishin takuar B.V. dhe V.B pra ishin bashkë punëtor të E..

Dëshmitarja - *demtuara K. T.* në dekaratën e saj të dhënë para gjykatës se me dt. 03.03.2011, kishin shkuar ne zyrën e kompanisë V. O G. ku ishin takuar me V. dhe E. B. ndërkaq kjo kishte qenë bashkëshortin e saj. Dhe për shkak se kishin kushte të vështira dhe përjetim të keq gjatë luftës donin të shpërngulenin ne një vend tjetër posaçërisht për shkak të fëmijëve e bashkëshortit të saj kishin shkuar për të biseduar me E. dhe V. për një banesë. Dhe bashkëshorti i saj i kishte besuar shume V. pasi që ishte sjelle mire dhe po atë dite me dt. 03.03.2011 ishte bere edhe nënshkrimi i kontratës. Te njëjtën dite të shoqëruar me z, V. B. kane shkuar te Raffaizen Bank.e dhe kane bere transferimin e 7.500 euro, dhe për këtë i ka dëshmitë të cilat i ka dorëzuar. V. B. ja kishte dhene edhe vizit kartën të cilën e kane ruajtur. Kontraten e kane bere me vete deshire pa presion dhe me gjithë premtimin i kane besuar. Pasi e kane bere pagesën e larte cekur kane vazhduar te bejen pagesën me këste. Pagesa e pare është bere me dt. 06.04.2012 ne Raffaizen Bank.e, po ashtu me dt. 27.06.2012, dhe kane vazhduar me paguar deri sa e kane pare ne televizion se nuk po vazhdojnë ndërtimet. Nuk kane pasur asnjë lajmërim për këtë. Mirepo këta kane pasur kontakte me E. dhe kane pyetur se a po ndërtohet pastaj ajo ju ka thene po. Pastaj kane vazhduar kontakte nepermjete numrit fiks ne zyre dhe ju kane thene se po ndërtohet edhe një vit edhe një muaj edhe dy muaj. Pastaj ju kane thene se është ndërtuar një objekte ka shkuar deri ne katin e 4 por kanalizimin i qytetit është nen ate objekt dhe nuk po na lene me vazhduar. Objekti ka pasur me u ndërtua ne lagjen M. ., nuk ka qene e caktuar emri i rrugës afati për përfundim i objektit ka qene 12 deri 15 muaj nga nënshkrimi i kontratës, dhe për çdo vonim do të paguaj blerësit deri ne 200 euro qeran. Jane mundur te kenë kontakt me V. por nuk kane mundur pastaj kane kontaktuar E. nuk ju ka thene se po ndërtohet por ka thene se një vend tjetër na jep komuna dhe do të fillojnë këtu apo aty por kurrë nuk ka vazhduar. Ne vitin 2012 gjendja e tyre ekonomike është vështirsuar dhe E. e kishe marr te punon si pastruese ne zyrën e saj dhe ate per dy muaj, dhe aty është bindur se gjithqka ka qene lojë e E.. Nga se aty vinin musafir dhe E. i ka thene del jashte mos dëgjon dhe një zhgënjim ka qene kur ja ka dhene 5 euro me ble një numer te telefonin ne emër te saj dhe me e shfrytëzuar ajo. Si pasoj e kësaj burri ka pësuar infrakt. Ka kerkese për dëmshpërblim vetem shume te cilën e ka paguar dhe atë shumen prej 10.412euro.

Nga dëshmia e *dëshmitarit K. G.* si përfaqësues i nënës se tij S.M., vëreteohet se nena e tij është e ndjere dhe ajo kishte lidhur një kontratë për blerjen e banesën me E. B.. Ky ka qene i ri, dhe pasi janë komplikuar punët dhe as këta si familjare nuk e kane ditur se çka po ndodh nena ju ka treguar se ajo gruaja i ka thene se nuk po mundet me ja nise nga se ka falimentuar. Nena kishte marrë kredi 10.000 mij euro ne Raffaizen Bank.e, por këto para me kamat i ka paguar gjithsejt 15.000 mij euro. Nena e tij kishte pasur disa here takime me E. dhe pas takimeve ka thene se nuk ka shpresë se ka me u ndërtuar duke pasur parasysh se objekti nuk ka filluar fare. I njëjti ka kerkese për kompensim te parave ndërkaq qeshtje tjera janë qeshtje te gjykatës. Nuk i është kthyer asnjë pjese e te hollave. Kontrata është e

lidhur ne vitin 2011 metrat katrore janë te cekuara ne kontratë. Shuma e përgjithshme për banese ka qene 46.000mij euro është e shënuar ne kontratë.

Nga dëshmia e dëshmitarit-dëmtuarit L. E. vërtetohet se ka dhene deklarate me dt. 16.03.2015. ne vitin 2009 kam menduar me rehubalitur me aspektin e banimit dhe përmes personit S. tek i cili rregullisht e ka dërguar veturën për ta rregulluar dhe i njëjti e kishte njoftuar se nje person me emrin E. është një ndërmarrëse qe merret me ndërtimin e banesave dhe i ka thene se mund te ven ne kontatë me te për nje banese me çmim te volitshme. Bashke me S. kane shkuar te E. dhe takimi ka qene te lokali i E. qe gjendet ne Qendren tregatre mbi F. T., kane bisedura për projektin dhe kushtete e banese dhe se kur dot e përfundonte objektivisht objekti. I kane pre planet e objekteve kane shkuar e kane pare vendi ku do te ndërtohet aty ku ka shkuar ka qene diku kah rruga . por atëherë ka qene livadh nuk ka pasur rruge e as asgjë. E. e ka bindur se do te kryhet shpejte. Për me lidh nje parakontrate i është kërkuar shuma prej 10.000 mij euro, por nuk kam pasur mundësi, ngase mundësit e tyre kane qene vetem 4.000 euro, dhe pas dI. komunikimit E. ka pranur qe para dhenja te jete 4.000 euro, çmimi i ishtblerjes ka qene 33.000 mij euro, sipërfaqja ka qene 67 metra katror banese dy dhomeshe. Pagesa duhet te behej ne tri rrata . Rarta e dyte duhet te përmbante me shume se 50 % ndërkaq rata e trete duhet e paguhet kur do te merreshin qelE.. Kur e kishte vizituar vendin se ku do te ndërtohet objekti e ka pare se perveq nje grope e madhe nuk kishte ndodhur asgjë. Pasi e kane kontaktuar për shkak te mos ndërtimit ajo kishte nderuar lokacionin e zyrave dhe ajo ju kishte shpjeguar e mos ndërtimi ka qene si pasoje e dI. mos marrëveshjeve qe ajo kishte pasur dhe ka vendosur qe objekti te ndërtoi ne nje vend tjetër dhe këtyre ju kishte ofruar nje çmim me te volitshme se herën e pare. Për kete objektin e dyte ju ka treguar se ka leje prej Komune se këtu ka shume pjestare te Policisë së Kosovës si blerse sepse ju ka mundësuar atyre me kushte me te volitshme dhe për kete ka qene ky elemente i besueshëm nga se aty po blenin banesa persona te punuar ne Intitucionet e sigurisë së shtetit, prape i ka pare planet dhe prape ka shkuar me pare vendin ka qene vendin ne te njëjti regjion me afër rrugës kryesore dhe si lokacion me i përshtatshëm. Dhe aty i kam pare edhe dI. persona tjere qe i kam njohur si familje. Dhe kete here edhe me shume i kam besuar pasi tani konsideronte si familjar dhe ne çdo takim ju ka drejtuar me fjalët se ju jeni te mitë. Dhe tani kane lidhur para kontratë te re dhe kane pasur oferte te re për dy banesa me dy garazhda e qe gaazhda llogariten ne çmimin e banesave. BanE. kane pasur siperfaqee 65- 67 metra katrore dhe ka mbetur se nese nuk i konvenon pozita apo sipërfaqja atëherë mund te marrin edhe me te madhe. Metri katror është llogaritur diku 500 euro, por nuk i kujtohet saktësisht por serisht i është kërkuar paradhanje, ne kete para dhenje i është llogaritur 4.000 euro te me hershme qe i ka dhene si dhe shumen prej 11.000euro nëpërmes B. dhe 9.000euro i ka dhene kesh dhe atë me deklarate ne Gjykatë, tërësisht shuma qe ka paguar deri me dt. 29.02.2012, ka qene 24.000 mij euro.

Objekti ka pasur me u përfunduar ne shtator te vitit 2012, dhe nese nuk përfundohet do ti paguhet qeraja nga 200 euro për çdo muaj deri ne dorëzimin e objektit. Keta kane shkuar e ka vizituar objektin dhe kane pare qe po lëvizin gjerat do te thotë ka filluar ndërtimi, e kane kontaktuar E. ajo ka thene se do te ndërtohet patjetër dhe kjo është bere gjate periudhës deri ne vitin 2014 kur kane dal dI. njerëz ne televizion duke kërkuar qe E. te ja ktheje parat dhe duke kërcënuar E.. Atehere E. ju ka thene se nese ndodh diqka juve ju kam te mijte dhe ju te paret jeni qe do te ju ktheje parat. Ne vitin 2013 kane komunikuar me E. gjate gjithë kohës dhe e njëjta ka thene se është ne bllokad dhe nuk po mundet me çbllokuar gjirologarin dhe po i vyen 5.000 euro, për tri dite, dhe pas 3- 4 here qe ja kishte kërkuar parat ky i ka thene se 2.500 euro mundet me i marrë diku borxh me shume nuk mundet. Dhe ja kane dhene këto para ne parking para banesës se ku banon dhe e njëjta i

ka thene se për 3 dite do te ja ktheje, por ajo nuk ja kishte kthye asnjëherë. Këto para kur ja dhene se duke ndihmuar E. e ndihmon procesin. Për këto para nuk ka dëshmi por besoi se E. e dinë sepse ka qene ne mirëbesim. E. gjate kësaj periudhe disa here e kishte nderuar numrin e telefonit. Edhe pasi qe kishte dal ne televizion e njëjta ka thene se banesa do te kryhet por nga nje kompani tjetër ndërtuese dhe shumicën e blerësve i ka mbledhë dhe ai ndërtuesi ka premtuar se për hir te E. do te merr për obligim me e përmbushur obligimin qe kishte E. ndaj tyre. Por ka kërkuar ti paguhet një e treta e dytes apo edhe nje shume caktur për me mujt me filluar punën por ky nuk ka pranuar, ndërkaq te tjerët nuk e di a kane pranuar. Përsoni qe i kishte tubuar dhe qe donte te vazhdon ndërtimin e banesave për ti ndihmuar E. e ka pasur emrin M.. I njëjti ka kerkese për dëmshpërblim ne shume prej 25.600euro.

Nga dëshmia e dëshmitarit-dëmtuarit A. Ç. vërtetohet se ka dhene deklarate ne polici me 24.04.2013 dhe mbetet pranë deklarates shumen e te hollave qe është paguar i është bere E. B. por ne emër te kompanisë “ V.- O G. “ , prej kur është bere para kontrata dhe deri kur e ka ndërpre pangesen ka qene shuma prej 17.500 euro. Pagesa është bere ne te holla kesh ne gjyrollogari te kompanisë dhe për çdo pagesën e ka flet pagesën dhe kopjen. Kane shkuar me parë objektin mirëpo objekti nuk i është treguar asnjë here hapsiren e ka pare ne dy vendi te ndryshme. Ne herën e trete u ka then se është duke ndërtuar nje kompanin e quajtur “ Ç. “ dhe ne takim me E. ka qene edhe pronari i kompanisë qe une nuk e kam njohur. Pronari i kompanisë u kishte thene se gjithqka është ne rregulle por jeni duke bere presion te tepruar dhe ate E. e kishte sjelle për te bere presion ndaj nesh. Dhe prej asaj dite E. kishte vazhduar për te ju premtuar dhe një vite rresht se ka me jav kthyer te hollat pasi qe ndërtimi ka dështuar, e njëjta ju ka thene se nuk i ka te hollat por kompanit qe kane ndërtuar kane me ja kthyer te hollat dhe ajo ka me jav kethyer këtyre. E. kur ua kishte treguar vendin i cili shihej se nuk ka ndërtim, por hapsire shihej se nuk ka ndërtime ka qene nje eskavator por nuk ka pasur njëres. Ne para kontrate e kishte pasur te caktuar parcelën dhe e akuzura u kishte thene se ajo parcelle është shitur dhe duhet me filluar diku tjetër. Para kontrate e dyte nuk ka nënshkruar por gojarisht ju ka thene se është nderuar vendi i ndërtimit dhe kur e ka par ky qe nuk është bere ndërtimi atëherë ky ka kërkuar qe ti kthehen te hollat, dhe i ka thene se nuk dua banese mo pasi qe nuk po ndertohej sipas para kontratës dhe vazhdimi e ka kërkuar kthimin e mjeteve. I njëjti ka kerkerese për dëmshpërblim ne shumen prej 17.500 mij euro, pasi qe 5.000 euro ja ka paguar fillimisht pastaj ka vazhduar me rata.

Nga dëshmia e dëmtuarit - dëshmitar A. B. vërtetohet se me dt. 21.11.2014 ka dhene deklarate ne polici dhe me dt. 05.02.2015 ka dhene deklarate ne prokurori dhe mbetete pranë atyre deklaratave. Ne fillim ja ka dhene 10.000 euro, E. i ka bere vete kontrata dhe ja ka prue me nënshkruar pastaj ky ka vazhduar pagesën kah 200 euro, dhe për te gjitha i ka fakturat, shuma e përgjithshme e paguar është 13.400 euro. Kontratat nuk i kane prishur pasi qe e njëjta ka premtuar qe do ti realizoi dhe ndonjerehere nuk u ka qel as telefonin kur kane shkuar ne zyrë e kane gjetur aty vazhdimisht ju ka thene se këto dite ose kete muaj ose kete vit dhe ato shkuan vite vite. E njëjta u ka thene se do te paguan qira pas 15 muajve, dhe shuma për ira ka qene 200 euro. Për këtë bashkëshortja e tij kishte dëgjuar se kompanin V. – O-G., E po ndërtonte banesa me kushte te volitshme, pastaj kane shkuar te E.. Për me shkuar te E. ka qene procedure dhe kur kishte shkuar aty e kishte pare V. por qe nuk ja kishte ditur emerin. Kur ka pa qe nuk po ndërtohet i ka kërkuar te hollat mirëpo ajo nuk kishte pranuar dhe ju kishte se thene se do ti ndërtoi banesa.. Banesa ka pasur me u ndërtua ne lagjen M. . dhe kur ky e ka pare ka qene dy kateshe veq nese kjo e ka qar diku tjetër me kqyer banesa tjera. Fillimisht ka pasur me u ndërtuar ne nje vend por tani u ka thene qe do te ndërtohet ne vendin tjetër, do te thotë aty ku kishte filluar ndërtimi

podrumi dhe dy kate. Vetem njëherë e ka nënshkruar kontrate dhe herën e dytë i ka njoftuar se po ndërrohet vendi. Fillimisht ne vendin kur ka pasur me u ndërtuar dhe është kontaktuar banesa ka qene ne katin e VII, dhe ajo u ka thene se nese pranoni ne vendin tjetër ku po ndërtohet do te jete ne katin e IV por do te kete vonese me shume, por ne kemi pranuar qe ndërtimit te behet ne vendin tjetër.

Nga dëshmia e te dëmtuarit - dëshmitar I. B. se ka dhene deklarate me dt. 03.06.2014 ne Stacion policor dhe qëndron pranë deklaratës se tij. I njëjti ka theksuar se për shitblerjen e banesës faktikisht ka qene parakontrata e lidhur ne muaj prill 2010, me V. O- G. e te përfaqësuar nga E. B. dhe ka qene e parapare qe dorëzimi i banesës te behet brenda vitit. Kontrata e lidhur ne V. o G. ne rrugën “R. L.” objekti ka qene ne Lagjen M. . kati i III hyjra A1, banesa ka pasur 55 metra katror. Pastaj e kane bere ndryshimin e metrazhit te banese ne 71 metra katror. Pas një viti e kishte thirr E. dhe ju ka thene se a jeni te pajtimit te nënshkruani kontrate te re ne nje lokacion te ri, pasi qe objekti ku ka qene i parapare me u ndërtua nuk ka mundur me vazhduar. Edhe pse nuk i ka besuar shume E. e ka nënshkruar kontratën e re me dt. 17.05.2011. Kur e kam lidhur kete kontrate kam qene ne zyre tjera. I ka dhene te hollat dy here nje here 6.000euro, ne emër te avansit dhe nje here tjetër 4.000euro, ngase ka qene parakusht pagesa 20% te objektit. Pagesa janë bere përmes Bankës ne emër te E. B.. Pastaj ka paguar çdo muaj kah 142 euro sipas kontratës se lidhur dhe shuma e paguar ka arritur 11.420euro. Me E. ka pasur nje marrëveshje qe nese i dërgon klient me te cilët do te nënshkruhet kontrata valide do te thotë shpërblehem për secilin klient nga 1.000euro, edhe pse i ka dërguar klient nuk i ka paguar diçka. Prandaj shuma e cekur ne polici prej 17.000euro. Ky i ka dërguar 5 klient. Mirepo ky ka kerkese vetem shumen te cilën e ka paguar qe e ka cekur me lart, ndërkaq shumen prej 5.000euro me E. me kontrate e kam bere si zbritje me çmimin e banese deri me tani nuk kam marrë as banese e as te holla. Kur e kane lidhur kontratën për objektin e pare e njëjta e ka pasur planin rregullativ te lejuar dhe te pranuar. Nderkaq për objektin e dyte nuk i ka kërkuar dokumentacion sepse i ka besuar. Te hollat nuk ja ka kërkuar E. me ja kthyer dhe ne vazhdim ka insistuar qe te merr banesën sepse ka pasur nevojë për nje qati diku dhe kjo ka qene arsyea. Me pas ka bere kallëzim penale pasi qe shumica ka bere kallëzim penale. Te akuzuarin V.B e njeh nga se e ka pa kur e ka nënshkruar parakontraten dhe disa here e ka takuar ne zyre e V. O G.. B.V. e njeh pasi qe për here te pare kur ka pasur kontakt me te i ka treguar vendin përkatësisht lokacionin e objektit se ku do te ndërtohet ne Lagjen M. . rruga .. Me B.in ishin takuar përmes Esrides dhe e kane lene nje takim ne rrugën B, tani ku gjendet marketi V., dhe ai ka thene se ky është lokacion dhe ky është objekti dhe sa i kujtohet ka qene podrumi dhe pllaka e betonit. Xh. A. nuk e njeh, ndërkaq V.O.n e njeh nga se e ka pare nje here apo dy here ne zyrën e E. me te njëjtit ka biseduar shkurt por nuk ka pasur diçka te beje me kontrata apo me objekt. F. O.n nuk e ka para dhe as nuk e njeh. Ky ka shkuar dI. here te lokacioni i pare dhe te lokacioni i dyte me pa ndërtimin. Te lokacion i dyte e ka pare qe aty është bere nje grop dhe ka filluara nje ndërtim. Këto dy lokalcioni qe kane pasur me ndërtuar kan qene larg njëra me tjetër 200 metra me vije ajrore. Aresyet e mos përmbysjes se kontratës nga E. gjithmonë kane qene financiar.

Nga dëshmia e te dëmtuarit – dëshmitar I. R. vërtetohet se ne Stacion Policor ka dhene deklarate dhe qëndron pranë asaj deklarate. E. e njeh ka shkuar me ble nje banese dhe ate ne zyrën e saj ne Lagjen M. . . Me vone zyra e saj është shpërngulur perballe G. dhe pastaj prape e ka nderuar zyre. Kjo kompanin është quajtur V. O G.. Kjo ka ra ne kontate për mes nje shokut te tij N. Ll. kane shkuar kane biseduar për banese kane ra ne ujdj dhe e E. është paraqitur si pronare e kompanisë se ndërtimit. Janë marrë vesh për çmimin dhe

a ka qene 600 euro metri katrore , i duket se ka qene 70 metra katror ne katin e trete apo te katër, dhe këto janë të shkruara ne kontratë. Marveshja e pagese ka qene 10.000 euro si parakontrate dhe këto i dhene përmes Bankes ne emër te E. B., pjesa tjetër ka qene 200 apo 250 euro mos gabofsha kisti mujore. Nuk ka filluar me paguar menjëherë nga se nuk ka pasur me tutje ka shkuar dhe ka biseduar me te shpesh here rreth ngjarjes dhe ka pare qe ka probleme me njerëz tjetër. I kujtohet se nje here ka qene ne gjendje shume te keqe ka qene e shqetësuar, ja ka kërkuar 500 euro duke i thene se po me vyen dhe ky shi human ka shkuar dhe i ka marrë 500 euro dhe ja ka dhene por me vone ja ka kthyer 450 euro, por ato 50 euro qe nuk ja ka kthyer ja ka bo hallall. Me njerëz ka pasur probleme sepse vazhdimisht e kane thirr dhe kete ja ka rrëfyer E.. I ka thene se është e kërcënuar prej njerëzve qe ju ka marrë paratë dhe hala lejen nuk po muj me marrë. Ky i ka besuar E. dhe është interesuar ti kthehen parat. Te pandehurit te tjere nuk i njeh.

Nga dëshmia e te *dëmtuarit - dëshmitar Rr. B.* vërtetohet se i njëjti ka dhene deklarate ne polici dhe qëndron pranë asaj deklarate, po ashtu ka dhene deklarate ne Prokurori dhe qëndron pranë asaj deklarate. Me E. është njohur nga kontrati qe ka pasur me rastin e dorëzimit t e lidhje se parakontrates se shitblerjes se banese e cila nuk është lidhur asnjëherë para kontratën e ka lidhur ne vitin 2011 e lidhur me E. B. si përfaqësuese e kompanisë V. O G., ne zyret e saj. Te gjitha rrethanat me te cilët janë marr vesh janë shënuar ne parakontrate qe është dorëzuar ne polici. Çmimi për metër katrore ka qene 600 euro, banesa ka qene mbi 100 metra katrore ne emër te paradhenje i ka deponuar ne gjyrollogari e E. B. ose V.-O-G., shumen prej 10.000euro, pjesa tjetër është dashur te paguhet me këste ne vlere prej 250 euro ne muaj deri ne përfundimin e plote te shumes se kontaktuar. I ka paguar edhe tri këste do te thotë 750euro dhe posa ka vërejtur se nuk ka ndonjë zhvillim pozitiv ne drejtim te realizimit te projektit e ka ndërpre pagesën e kësteve. Ka pritur disa vite qe te kete zhvillime me shprese se projekti do te realizohet dhe posa ka kuptuar nga palët e tjera ka ngrit kallëzime penale te bindur se ka ra pre e mashtrimit edhe ky ka ndekjur rrugën e njejte. Ka kërkuar shpjegime prej E. dhe pergjigjet me te shpeshta te saj kane qene se projekti do te realizohet por kishte pengese me kontraktoret e tjere te cilët po vonoheshin me punën e kryer. Te hollat e i ka kërkuar verbalisht disa here, kane bere edhe marrëveshje për anulim te parakontrates me te cilën vete E. B. me nënshkrimin e saj dhe me vulën e kompanisë V. – O. G., është zotuar se shumen prej 1.100 euro do te me dërgon ne llogarin time Bankare deri me dt. 30.05.2013 dhe kjo nuk është realizuar asnjëherë. Me te pandehurit tjere nuk ka pasur kontakt. I njëjti deklaroi se ka kerkese për dëmshpërblim ne shumen prej 10.750 euro, si dhe kerkese e parapare ne kontratë qe E. do te duhet te paguaj nga 200 euro ne muaj ne emër te gjiras si rrjedhoje te mos dorëzimit te qelesave te banesës. Te E. ka pare shembuj te parakontratave qe kishte lidhur me bletsit e tjere. Ky personalisht kishte shkuar ne Departamentin e Urbanizimit për te kërkuar informata ne lidhje me kete projekt dhe t e njëjtit i kane thene se plani ideor nga Komuna e Prishtinës për ket e projekt është aprovuar nga Komuna dhe gjithqka ishte ne rregull sa i përket dokumentacion dhe procedurës se lejes se ndërtimit, e cila pritej te jepet se shpejti, leja nuk ishte marrë nga se V. O G. as nuk e ka nis procedurën për me marrë lejen, dhe se nuk është paguar taksa komunale për marrjen e lejes. Për këto është informuar pas disa viteve pasi qe është dëmtuar. Ku kishte shkuar me pa vendin se ku do te ndërtohet banesa ka pare qe ka filluar me ndërtuar është vendosur pllaka e betonit baza e kati përdhes dhe aty e kishte dërguar nje fqinje i tij i cili me tha se kishte lidhur nje kontrate me kete kompani për nje banese për djalin e tij.

Nga dëshmia e te *dëmtuarit - dëshmitar J. D.* vërtetohet se ka dhene deklarate ne polici dhe mbetet pranë asaj deklarate. E. e ka njohur për here te pare kur ka shkuar ne zyrën e saj

me lidh kontrate. Fillimisht ka biseduar ne zyre pastaj kane shkuar te objekti ku ka filluar me ndërtua do te thotë te punishtja, aty ka qene vëllai i saj V.i. Oferta ka qene parapA.i 10.000euro, pjesa tjetër ka qene me rata nga 200 euro ne muaj, si dhe kushtet e tjera qe na u kane përshtat për me lidh kontratën. Vendi ku ka pasur me u ndërtua ju ka pëlqyer çmimi ka qene i volitshme rata mujore ka qene e përballueshme për familjen e tyre, dhe kisht edhe familjare te tjere qe kishin marrë banese dhe kjo ka qene nje shtytje qe edhe këta te blejnë. Pasi qe e kane lidhur parakontrate 10.000euro i ka dorëzuar ne llogari te V. O G.nëpërmjet Raffaizen Banke te gjitha deshmit e pagese i ka por qe i ka dorzuar ne polic dhe ne prokurori. Ka paguar edhe për tri rata për tre muaj te cilat i kane transferuar për mes Bankës dhe për këto janë dëshmitë. Punet nuk kane vazhduar siq janë marrë vesh ne parakontrate dinamika e punës ishte zero dhe aty lindi diqka qe firma nuk është ne rregull. Kam shkuar ne zyre te saj ka pasur premtime qe ka me vazhduar por nuk ka vazhduar. Kur këta kane dasht me shkëputur kontratën dhe e njëjta ju ka premtuar se od te vazhdoi ndërtimi mirëpo nuk ka vazhduar dhe tani pavarësisht se a do te vazhdoi puna apo jo dhe pavarësisht se çka premtinin ata fjalën e ka për E. dhe V.in këta kane dashtë me shkëput kontratën.Pastaj janë marrë vesh me E. me shkëputur kontratën dhe E. me deklarate me vule dhe nënshkrim te saj thotë se ne afat me se largu prej dt. 01.deri me 15 .12.2011 do e kthehen parat ne llogari Bankare qe e ka shënuar ne atë deklaratë. Parat ju kane kthyer 5.000 euro ndërkaq i kane mbetur 5.600euro borxh. Pastaj E. del me nje deklarate qe me se laragu ne muaj Prill te vitit 2012 do te kthehet ose transferohet kjo shume por kjo nuk ka ndodhur asnjëherë. Pastaj e kane kontaktuar nepër mes telefonit por parat nuk mi kane kthyer asnjëherë i ka thene se i boj duhte me prit nuk e di arsyen pse nuk ja ka kthyer parat edhe pse ja ka kërkuar arsye. Ka kerkese për demshperblim ne shume prej 5.600euro. Po ashtu ka kerkese për demshprlbim për shqetësimin e tij dhe familjes se tij si dhe shumen e qeras për qdo muaj kah 200 euro siç është shënuar ne parakontrate nga se gjere ne vitin 2017 deri sa ka blere banese ka paguar qera. Ne lidhje me kontrate ne lidhje me pagesën ka folur me E. ndërkaq për punën e tjera, kur kane shkuar te zyra i ka pritur V.

Nga dëshmia e të *dëmtuarit - dëshmitar A.M.* vërtetohet se ka dhene deklarate ne polici me dt. 08.01.2014, dhe qëndron pranë asaj deklarate. Me E. ka bërë kontrate pasi qe bashkëshortja punon ne polici dhe ajo i ka thene se po shiten banesa. Fillimisht ka shkuar bashkëshortja ka lidhur kontratën pastaj ka shkuar edhe ky nga se ka menduar se nese me ndodh diçka ky mund te merret me te sepse ka me shume kohe. Kontrata është lidhur për nje banese ne katin e II 72 metra katrore dhe çmimi për metër katrore ka qene 600 euro. Kane arritur pajtimin qe te deponojnë shumen prej 10.000 euro përmes Bankës ne emër te E. pasi qe është ndërpre punimi arsyea sipas E. ka qene e është nje gyp para banesës dhe për kete arsye është ndërpre punimi. Pas nje kohe i ka thene se ndërtimi do te vazhdo ne nje vend tjetër, nuk ka qene larg diku 100 metra. Ku ka kërkuar te gjithë dokumentacioni me se është dashtë te ndryshohet kontrata. Kur është ndërpre puna e ka ditur qe nuk është diçka ne rregull, ka shkuar te pronari i tokës dhe i ka thene se E. nuk ka te beje me ta nuk ka asgjë këtu. Tani është interesuar dhe ka gjetur kompanin ndërtuese qe po ndërtonte po ne atë vend dhe ju ka thene se për kete vend ku po ndërtohet banese ky e ka nënshkruar kontratën dhe ju ka treguar kontratën. Te E. nuk ka shkuar pasi ka kuptuar këto për shkak se ka qene vështire me e kontaktuar. Kur e kishte kontaktuar e njëjta çdo gje e ka pranuar çdo gje e ka nënshkruar ka premtuar se do ti ktheje te hollat por nuk i ka realizuar. Te hollat nuk ja ka kthyer. V. e ka pare ne zyre dhe i njëjti ka punuar aty. Nderkaq te akuzuarit e tjere nuk i ka pare dhe nuk ka biseduar me te. Te akuzuarin V. dhe F.O. i ka njohur familjarisht sepse kishin shkuar ne dyqanin e tyre si myshteri. Ka kerkese për dëmshperblim ne shumen prej 10.000 euro.

Nga dëshmia e te *dëmtuarit - dëshmitarit A. M.* vërtetohet se ka dhene deklarate ne Stacion Policor me dt. 17.06.2014, dhe qendron pranë deklaratës. Vëllai i tij i cili ka punuar ne restoran C. R. P. afër R. e kishte ftuar pasi qe ky ishte i interesuar me ble nje banese. Vëllau paraprakisht kishte ra ne kontakt me B.V. dhe janë takur disa here deri ne kontakte me E.. Përshtetisht nuk ishte takuar deri sa i ka dhene parat sepse vëllai me E. dhe B. kane bere nje kontrate gojore. Megjense ishte ne pune nuk kishte marrë pjese ne takime përveq ditën e fundit kur i kishte dorëzuar te hollat. Si parakusht ka qene qe ti jap 10.000 euro parakesh E. ne zyrën e saj qe gjenden te N. D. ne te majtë pastaj çdo 6 muaj ka qene marrëveshje te jap nga 3.000 euro. Për kete e kane bere nje marrëveshje me shkrim te cilën e ka dërguar ne polici. Banesa ka qene 65 metra katror kati i II objekti A1. Pastaj me dt. 04.03.2010 ne gjirollogari private te E. ja ka deponuar 3.000 euro, banesën nuk e ka marrë asnjëherë, direkt me E. nuk ka pasur kontakte përveq kur ka lidhur kontrate dhe kur ja ka derguar te hollat ne gjirollogari. Eshtë interesuar se a po bohet apo nuk bohet ka shkuar dhe e ka pare se a është bere gërmimi është bere gërmimi është ngrit dy kate ndoshta edhe i treti dhe është ndepre puna. Ka nisur me u shqetësuar si familje. Vëllai i tij ka kontaktuar me E. disa here dhe arsyt kane qene jo kemi probleme financiar jo leja, por nuk e dije sakte se çka është folur tjetër. Te hollat i kane kërkuar nuk u janë kthyer. Tani nga V. - O GRAQANICE i ka edhe dy deklarata nga e cila konstatohet se e njetja ka pranuar me i kthyer mjete, njera deklarata është e vërtetuar ne Gjykatën Themelore ne Prishtinë., e tjetra është e shënuar me dore. Ne baze te marveshjes e njetja ka pasur për obligim qe nese vonon ndërtimin e banesës duhet te paguaj qeran. Arsyet te mos realizim te kontratës kane qene se nuk kemi mjete jemi bllokuar. B. V. ka qene urdhe lidhëse ngase i ka vu ne kontakte vëllain tim me E. dhe se realisht B.i do te thotë na ka qit ne kontate dhe do te thotë se ai është aksionar apo sakte nuk e di. Ky personalisht nuk e ka takur B.V. por me siguri vëllai i ti po. E ndien vetem te dëmtuar ne vlere prej 13.000 euro. Ne zyrën e E. ka qene edhe punëtori i E. Y. J. i cili ka qene shoku i shokut te ti, por nuk e ka ditur qe punon aty deri. e ka parë. Ne lokacionin qe është cekur ne kontrate është bere ndërtimi por tani është bere ndërtimit dhe ne ate ndertes është A. Impeks, nuk e di se kush e ka ndërtuar por ne banoret janë ne banese.

Nga dëshmia e të *dëmtuarit- dëshmitarit S.B.* vërtetohet se i njëjti ka dhene deklarate ne polici dhe qëndron pranë deklaratës. Ne zyrën e E. ka bere kontratë për banese dhe i kishte kërkuar 20 % fillimisht. Për te këto banesa kishte kuptuar prej kolegeve te ti te punës ne Shtepi te shëndetit, dhe ju ka dokur çmimet e volitshme kishin shkuar ne zyret e saj. Ajo ju kishte treguar te gjitha kushte dhe si kusht avansi ka qene ne shumen prej 10.000 euro. para kontratën e ka lidhur ne vitin 2011 pastaj shuma prej 10.000 euro ishte paguar ne gjirollogarin e saj me dt. 26.04.2011 pastaj me 09.11.2011 ka paguar avansin edhe per garazhde ne shume prej 1.500 euro, pagE. ja ka bere nëpërmjet R. B.e, objekti ka qene i parapare me u ndërtuar ne periudhën 2 vjeqare. Nuk është ndërtuar ka dëgjuar se ky projekt ka dështuar, dhe se ka pasur njerëz edhe ka 2009 por qe kane bere pagesën por qe nuk janë ndërtuar. E. e kishte dërguar te nje objekt me nje temel dhe pas kësaj ky i kishte besuar qe ka filluar me u ndërtuar. Parcela nuk ka pasur as numer e as rruge, kushte këto qe kane qen te parapare me ndërtim, leje nuk kane kërkuar, por e njëjta u kishte qitur nje plane përpara e ju kishte treguar nje punetore e saj e cila quhet T., dhe inzhinjerit nuk ja kishte ditur emerit, dhe ne baze te kësaj i kishin besuar. Plani fillestar qe u kishte treguar ka qene po thuajse i ndërtuar vetem dritaret nuk i kishte pasru, ajo u ka thene se për dy vite ka me u ndërtua objekti për te cilët posdon edhe fotografi. Ky kisht shkuar për ti kërkuar te hollta por E. kishte nderuar zyrën. Pastaj e kishin gjetur lokalet kur dhe kishin pare se ka qene ne Breg te Diellit, E. i kishte thene se parat i ka dhe kishte filluar ndërtimin dhe te

githa janë desinformime. E. u kishte thënë se kush don t'ia kthejë të hollat në afat prej 60 diteve por asnjëherë nuk ua kishte kthyer. Shuma totale që ja ka paguar E. në gjyrlloari është 11.500 euro. të gjitha kontratat kanë qenë bllanko dhe ato i ka shkuar E. dhe janë vërtetuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë.. Por mendon se janë vërtetuar në Gjykatën Themelore në Graçanicë. Ky nuk ka qenë në Gjykatë kur janë vërtetuar kontratat. Edhe pse në kontratë shkruan se për çdo informacion mund të kontaktoni V.B ose E. B., ky nuk i kishte kontaktuar deri sa kishte ardhur në Gjykatë. Ka kërkesë për dëmshpërbim në shumë prej 11.500 euro që është paguar në gjyrllogari, po ashtu ka kërkesë që t'i paguhet kamata si dhe shpenzimet e rrugës ardhja dhe shkuarja.

Nga dëshmia e të dëmtuarës – *dëshmitare A. K.* se ka dhënë deklaratë në Stacionin Policor në P. me dt. 30.05.2014, dhe qëndron pranë asaj deklaratë. E. e njeh në baze të blerësjes së banesës. Ishte informuar nga rreth shoqërore që është një afariste dhe ndërton banesa. Një i afermt i tij e kishte informuar se ka bërë një kontratë dhe ish-in kushtet e mira. Pasaj kjo ka shkuar në P. dhe është takuar me E. ja ka treguar kushtet, fillimisht i ka thënë se duhet të bëjë një avans prej 10.000 euro, pastaj 12 - 15 muaj kanë synim të kryejn ndërtimin e banesave. I ka treguar vendin në Lagjen M. ., e ka informuar se ishte banesa dhe e kanë parë banesën ku ishte një banesë 5 – 6 kateshesh e kryer vetëm ndërtimi i vrazhde. Aty afërka qenë edhe një temel tjetër i nisur pllaka ka qenë e shkruar V. O Graçanicë, kushtet e ju kanë pëlqyer dhe si mësim dhënëse i kishte bërë disa kursime dhe pasi që fëmijët kishin me shkuar në fakultet dhe pas bërjes së një llogari delke se me llogari kemi me blë një banesë për fëmijët në P. se sa me paguar qera. Oferta ishte shumë e mirë për 15 vite me paguar, dhe në baze të kësaj kanë bërë marrëveshje. Kjo dhe E. e kanë nënshkruar para kontratës në zyrë me dt. 29.12.2010 dhe brenda ditës kanë paguar avansin në shumën prej 10.000 euro përmes Bankës R.. Avansi është paguar në emër të firmës V. O Graçanicë pastaj marrëveshja ishte që prej muaj shkurt të paguaj nga 200 euro çdo muaj. I ka bërë 3 muaj pagesën nga 200 euro, pastaj është hapur në mënyrë interene fjala se diçka nuk është në rregull se nuk ka filluar puna, dhe dyshimet e para ish-in andaj e ka ndërpre pagesën. Gjithsejt do të thotë ka paguar 10.600 euro. E. u kishte siguruar se nëse brenda 15 muaj nuk realizohet kontrata do të paguaj kah 200 euro në emër të qeras. Kur kanë shkuar të objekti me motrën e saj V., E. nuk ka qenë me to, por këto e kanë ditur se ku është objekti sepse aty ishte pllaka në emër të V. O Graçanicë, banesa ka qenë e parapare të jete në katin e VI objekti A4 71 metra katrorë. Kur pasi që 6 persona kanë thënë se nuk ka diçka serioze me atë firmë dhe kur kemi shkuar të objekti pastaj kemi parë se nuk ka qenë e vendosur pllaka që ishte e vendosur paraprakisht. Pastaj ka kërkuar sqarim nga E. e cila i ka dhënë arsyet e veta i ka thënë se ka nderuar truall nuk me kanë nënshkrua Komuna e diçka kështu. Ja ka kërkuar të hollat i ka thënë se nuk kam se ka probleme të mëdha. Me të i ka nënshkruar tri aneks kontrata po e njëjta merrte përsipër se do të përgjigjet kërkonte kohe të njëjtës i kam besuar për faktin se është femër. Asnjëherë nuk i ka kthyer të hollat ka shkuar disa here në zyret e saj. Është në kredi prej 22.000 euro për shkak se i ka dy studenta. Ka kërkesë për dëmshpërbim në shumën prej 10.600 euro, nga se kanë qenë të hollat të kursimit të saj dhe bashkëshortit të saj si dy mësim dhënës. Dhe kanë një gjendje ekonomike të keqe.

E dëmtuara dëshmitare *V. M. në sancë gjyqësore* ka deklaruar se ka dhënë deklaratë në polici dhe qëndron pranë deklaratës së saj. E. e njeh, ka blerë banesë. Ishte informuar përmes motrës së saj, e cila kishte dëgjuar me parë se ishte një mundësi për banesë. Ka shkuar të E. në një lokacion mbi Grand ka qenë me shkallë ajo kishte fotografi të projekteve të banesave të shfaqura neper zyra, kam biseduar për kushtet ka qenë për një kohe 15 vjeqare me paguar nga 200 euro në muaj, mirëpo paraprakisht është dashur t'i paguaj 10.000 euro

ne konto te V. O Graqanice. Kan bere pagesën ne Raffaizen Bank.e ju kishte treguar nje objekt si temel ne lagjen M. ., kishte shkuar me motrën e saj ju ka thene se do te behete prej 12 deri ne 15 muaj, dhe nese nuk arrin me përfunduar për ket e kohe do te ju paguan qera nga 200 euro ne muaj. Pagesen e kësteve kane pasur me filluar prej muaj shkurt ku dhe kane filluar e kane paguar 3 muaj. Do te thotë kane paguar gjithsejt shume prej 10.600 euro, me dt. 29.10.2010 i ka paguar 10.000 euro dhe banese nuk kane marrë, ka kërkuar prej E. me ja kthyer te hollat, pasi qe nuk po ndërtohej asgjë, ka marrë arsyetime gjate gjithë kohës nga ana e saj me vonë shkojmë me vone por asgjë garantuese nga ajo se do te na ktheje. Është arsyetuar me pa mundësi te ndërtimit nuk kishte pasur kontrate drej për drejte me E. por e ka autorizuar motrën sepse kishte mësim pas dite dhe nuk kishte mundësi me u takur me E., gjithmonë ju ka premtuar se me vone dote ju jap na ka lene me shkrese dhe pastaj kane shkuar ne polici. Vetem E. ka qene be zyre, i kujtohet se ka qene edhe nje inzhinjer e por ai nuk ka biseduar asgjë. E. ka pasur afetesi dhe na ka bindur qe me qene te sigurt dhe me i hy kësaj pune, pasi qe kemi pasur interes për nje banese. E. ju ka thene se ka me i nderuar se nuk ka probleme me ndërtuar, se është ne urbanizen ate pjese te tokës e kane paguar dhe nuk ka probleme me ndërtuar. Banesen e ka pasur ne katin e VI por me mundësi se nese dikush e liron me poshtë me mujt me zbrit ne kate te tjera. Banesa ka qene 71 metra katrore dhe shuma e përgjithshme qe ka pasur me paguar ka qene 46.000euro. Ka kerkese për dëmshpërblim ne shume prej 10.600euro.

I dëmtuari - dëshmitar A.K. në deklaratën e tij të dhënë para gjykatës ka deklaruar: se E. B. e njeh nga dita kur e ka lidh parakontraten, ne ate kohe zyret i ka pasur ne Prishtinë. te sheshi te kino A... Një shokë i ti ka tenuar me ble nje banese por ne pamundësi pasi qe vëllezërit nuk ja kane dërguar paret ky e ka pytur se çka don me ble, dhe ai pastaj ka treguar për ofertën e V. O Graqanice: Ja ka dhënë numrin e telefonit pastaj ky ka thirr dhe nuk e di a është përgjigjur B. V.i. Atë ditë ka shkuar ka bere marrëveshje ne zyre nese nuk gabon ka qene V.i dhe menjëherë e ka dërguar ne zyre te E.. Me te ka biseduar rreth kushteve ajo u ka thene se oferta është vetem për policë por i ka thene se meqenëse po insiston dhe ajo ja ka dhënë mundësin pasi qe i ka treguar se edhe nje shok i ti ka blere banese aty. Oferta ishe qe nëpërmes Bankës me bo nje pagese dhe ky i ka paguar 11.500euro. Dhe pastaj ka bere nje marveshje e B.e qe ky me paguar çdo muaj shumen prej 140euro. Ka bo pagesën për çdo muaj dhe ka paguar gjithsejt 13.600 euro, apo 13.740euro, sepse nuk osht i sigurt a ka paguar 15 muaj apo 16 muaj. Cili ka qene objekti nuk e di, dhe nuk i kujtohet se a ka que V.i apo B.i. Dhe nga zyra e E. kane shkuar te vendi me automjet, aty ka qene nje shenje V. O Graqanice dhe ka qene nje grop. Kontraten e pare e ka nënshkruar ne vitin 2010 ka pasur banesën ne katin e pest. Ne parakontraten e dyte janë vendosur ne katin e dyte. Arsyeja pse është bere ky ndryshim ishte sepse kur e kam bere parakontraten e par E. ka filluar me thane se ka probleme me ujin e nuk po mundet me ndërtua. Ne atë vend tani i ka banesat firma H.. Arsye se pse nuk po ndërtohet ka qene se për shkak se nuk mundet me marrë lejen për shkak te gypit te ujit. Komuna ja ka dhene nje vend tjetere qe nuk ishte larg prej vendit te me parshem. Jane pajtuar me kete edhe pse nga ai moment e ka dite qe nuk ka asgjë nga kjo pune. Nga E. ka kërkuar parat ose banesën. Përgjigja e saj ka qene se paret nuk kthehen. E. ju ka thene se nese insistoni shum me ju kthyer paret mund te ju ktheje deri ne 50 % ose 60 % me pak sepse projektet e filluara nuk mund ti anuloi. Sa here ka shkuar ne zyre E. ka qene vetem ndërkaq E. aty i ka pasur edhe dy vëllezër te cilët i ka prezentuar E. dhe ka thene qe merren me pune te arkitektave dhe me banesa. Kur ka shkuar ne zyre te E. vëllai i tij ka qene ne nje zyre tjetër dhe është dasht me kaluar nje korido dhe vëllai i saj V.i ka marrë dhe te ka dorëzuar te E.. E. ne zyre i ka pasur disa plane se si ka me u dukur banesa. Për me u bind E. u ka thene se deklarata i vërteton ne Gjykatë, dhe për kete e ka deklaraten e vërtetuar ne Gjykatën Themelore ne

Prishtinë. - dega Graqanice, ky nuk ka qene ne Gjykatë por E. vete i ka vërtetuar. E. fillimisht ua kishte prezentuar B. V., V.B dhe nje tjetër me mbiem B.. B.V. i ka dërguar me vetur te vendi ku ka me u ndërtua objekti. E. i ka thene me shkue me kqyer vendi sepse ajo ka qeen Drejtoresha apo pronarja e V. O Graqaniceit, ndërkaq me persona te tjere kur ka hyre ne zyre ka pasur vetem përshëndetej, ka kerkese për dëmshpërblim ne shumen prej 13.600 euro.

E dëmtuara—deshmitare E. U.i, para gjykatës ka deklaruar se E. B. e e njuh për mes blerjes se banesës, banesën e ka blere ne sipërfaqe prej 71 metra katror ne katin e gjashte, ne vitin 2011, me dt. 16.05.2011 është nënshkruar parakontrata për shitblerjen e banese ne mes saj dhe E. te hollat ja ka qit me dt. 13.01.2011. Para se me nënshkruar kontratën kan pasur kontakt. E. i ka nderua zyret vazhdimisht. Fillimisht ka qene nje ofertë kinse për polici me jep dl. para ne dore, dhe vjehri i saj ka punuar polic kjo e ka dëgjuar ofertën prej te tjerëve dhe i ka konvnuar. Ka biseduar me prindin pasi qe prindi ja ka dhene te hollat ne shume prej 10.000 euro për te bere pagesën. Paraprakisht kishte biseduar me E. ku kishte shkuara me babain e saj dhe vjehrin e saj. Ajo ka qene vetem ne zyre, aty ka pasur edhe persona tjere te cilët janë ende, por këta kane biseduar vetem me E.. Oferta ka qene me ja dhene te hollat ne shume prej 10.000 euro, dhe shumen prej 166 euro me paguar për 15 vite çdo muaj, pa kamatë kjo shumë duhet te paguhej ne gjirrollogarine e saj, vlere totale e pagese qe duhet bere ka qene 40.000euro. 10.000 euro ne dore e 30.000 euro për 15 vite. Banesa ka qene ne katin e gjashte ne sipërfaqe prej 71 metra katror objekti A1. Ne parakontrat ka qene e shënuar sipërfaqja prej 100 metra katror, vlere 40.000euro, ndërsa ne deklaratën e saj ka qene banesa ne sipërfaqe prej 71 metra katror. Ka shkuar me pa vendin me E. vëllain e saj V. sepse V. me shume ka marrë pjese , i ka dërguar ne nje vend ku tani ka ndërtuar firma H., aty ka qene nje vend i gropuar dhe si çdo njeri qe ka nevojte për shtëpi jam bind dhe kam paguar shumen prej 10.000 euro. 8.000euro ja ka qit me dt. 13.01.2011 e pastaj 2.000 euro me dt. 27.04.2011, si dhe i ka paguar dy këste secilin ne shume prej 170euro. Banesen nuk e kane marrë, u ka thene se nuk po bene me u ndërtuar nga se aty nuk ka kanalizim dhe u ka thene se po dalim ne nje vend tjetër. Zyren e ndërron afër obejktit tjetër. Aty kane filluar dl. teme, çdo dite ka shkuar ka vizituar sepse ka qene afër me banese me qera, çdo dite i ka thene se do te ndërtohet. Me dt. 17.05.2012 ka deklaruar se do te ja ktheje shumen prej 10.440 euro ne afat prej 60 diteve, dhe ja dhene letrën me nënshkrim dhe vulën. Me dt. 26.07.2012 E. ka deklaruar se do ti kthehen 11.000 euro, dhe kinse për te ja paguar dhe qeran, dhe prape ka qene edhe nje deklarate tjetër që është vulosur edhe nga Gjykata themelore ne Prishtinë.. Ku deklarohet se do ti kthehet vlere ne shume prej 12.500euro me dt. 30.03.2013, por nuk i është kthyer asnjë cent. Dhe para se me u dhënë këto deklarata vazhdimisht i ka kërkuar me ja paguar këstet. Ka dite me mashtrure mire sepse ne te paren shkruan 71 metra katror e ne te dytën 100 metra katror ne te njëjtin çmim, paret nuk i ka marrë asnjëherë. E njëjta kërkon qe ti kthehet vlere e te hollave ne shumen prej 10.440 euro aq sa jaka qit edhe pse E. ka dhene deklarate se do te me ktheje me shume ato janë deklarata te rreme. I ka thirr njëherë ne nje banese afër shkollës Pavaresia u ka thene se B.i ka me filluar ndërtimin e banesës, u ka thene se ato pare qe ja kane dhene E. do te zbitete ne çmim dhe vlere tjetër ka me u paguar me këste. Mirepo kjo nuk ka ndodhur asnjëherë.

E dëmtuara - deshmitare A. M. – K. para gjykatës ka deklaruar se E. e njuh nga F. U. burri i tezes se ti. Ai i ka thene se ka nje shoqe qe ndërton banesa, pasi J.in me qera, F. i ka dërguar te E. ne zyre kete dhe burrin e saj kane diskutuar për nje marrëveshje te mundshme, dhe oferta ishte 10.000 euro kesh e te tjerat me këste. Këta nuk i kishin 10.000euro por vetem 7.000euro dhe intervenoi F. dhe E. i ka thene meqë e ka shok F. dhe tha do e

ja jep edhe F. nje banese. F. ishte nje policë ne pension. Ne zyre ka qene edhe vëllai i E.. Aty mbeti qe E. me na thirr ne telefon me na njoftuar se a na jep apo jo banesën për shkak se 3.000euro kishin me dhanë nje jave me vone. E. i ka marrë ne telefon ju ka thene se po ja jap banesën pasi qe jeni familjare te F.. Kane shkuar dhe e kane pare objektin ka qene E. dhe kjo me F. dhe burri nuk e mbanë mend a ka qene dikush tjetër. Objekti ka qene ne lagjen M. . ka qene gjashte kate ndërtim i vrazhde dhe aty afër ka qene nje grop me temel. E. u ka thene se banesa qe na u është shitur neve është ne banesën gjashte kateshe dhe ju ka thene se edhe tri banesa tjera janë ne ndërtim e sipër. Këta janë pajtuar dhe i ka lajmëruar ne telefon se do te nënshkruaj kontaten.

Kontraten e kane nënshkruar me 8 prill 2011 ne mes saj dhe E. dhe 7.000 euro po atë dite i ka paguar ne R., ndërsa shumen prej 3.000 euro i ka dorëzuar me 16 prill 2011. Te dy këto shuma i kane dorëzuar ne gjirollogari ne V. O Graqanice përmes Raiffezien. Bank Kane pasur me i paguar edhe këstet tjera pasi te hynë ne banese, premitimi i saj 12 - 15 muaj me hyje ne banese nese vanohet dote paguaj qeran ne shume prej 200 euro, banesa etyre ka qene ne katin e pest ne sipërfaqe prej 71 metra katrore. Banesen nuk e kane marrë te hollat nuk ua kane kthyer. E. i ka bere dy ose tri deklarate me dt. 08.01.2013 sipas te cilën do te ja ktheje te hollat ne shumen prje 12.000 euro, dhe atë 2.000 euro si dëmshpërblim. Arsye ka qene se ka falimentuar dhe është duke e kalur banesën te dikush tjetër. I ka thirr me u takuar me personin F. M., ai i ka thene se i merr ne përgjegjësi për me i ndërtuar banesa dhe kohe pas kohe u ka dhene deklarata por asnjëherë nuk janë bere banesat. Pastaj E. i ka telefonuar se nje person me emrin B. ka me mare me i ndërtuar banesat. mos u bëni merak. As ai nuk i ka ndërtuar. Këta kane hyre ne nje kredi tjetër dhe e kane mare nje banese kane paguar kesten dhe kamatë, këta nuk i kane humbur vetem 10.000 euro por edhe sa te tjera. V.O. e ka pare te E. njëherë kur kjo kishte shkuar ne zyre, i ka thene kthene diçka prej te hollave sepse i kam pasru tre fmiye dhe kam qene me qera. Ne këto takime e ka pare V. por jo kur është nënshkruar kontrata. E. i ka thene se është e pafajshme dhe me ka thene se nuk mund te beje asgjë, nuk e di pse i ka thene ashtu, i ka thene se i ka duart e lidhur ndihmon dhe kuptom dhe kjo nuk mund te di se a ka pasur rol V.i aty. Por e di se V. disa here e ka pare ne zyrën e E.. I kujtohet qe nje here V.i ka bërtit dhe ka thene çfarë është kjo pune do te beje banesa. Dhe E. kete person e ka prezantuar si vëllain e saj. Dhe kjo ka ndodhur ne kohet e fundit para se te deklaroi se ka falimentuar. Ndersa V.i nuk ka thene diçka vetem se e ka pare aty. Me E. ka pasur komunikim te mire. Për kete çështje ka dhene deklarate edhe ne prokurori. E. ju ka thene se nuk mundet me ndërtuar për shkak e nje gypit te ujit, ndërsa ne atë lokacion ka ndërtua firma H..

E dëmtuara - deshmitare M. H. para gjykatës ka deklaruar se ndihet e dëmtuar dhe se E. ja ka kthyer shumen prej 4.000euro, ja ka paguar 3 qera nga 200 euro, dhe nje here 450euro, nga borxhi kryeros ka mbetur 7.500euro, demi i shkaktuar është shume i madh sepse kjo ka hyje kredi dhe ka paguar kamat, përveq demit ekonomike ka dhe demit moral ka pasur probleme familjare nga se ka mbetur pa pare, nuk kishim me çka me paguar qeran, demin e përgjithshëm nuk mund te caktoi për kredin ne shume prej 11.500 euro ka paguar kamte 4.500 euro. me E. ka lidhur kontrate pasi qe përmes nje kolege M. S. kishte ra kontakt me te edhe ajo është pal e dëmtuar. V. B. e ka pare ne zyre te E. por nuk ka pasur kontakt me te, ndërkaq te akuzuarit te tjere nuk i njeh. Për mos përmbushjete kontratës E. i ka ofruar nje zgjedhje tjetër i ka thene se po ndërton ne nje vend tjetër por kjo nuk ka pranuar. Nuk i ka dhene arsye se pse nuk e ka ndërtuar banese për te cilën kishin lidhur kontrate. Njehere i ka thene se i ka do probleme teknike me do gypa te ujit. Kur ka shkuar me prish kontratën ajo i ka thene se duhet me prue parakontaten ne menyre qe brenda 90 diteve me ja kthyer paret dhe me ba marrëveshje për anulimin e kontratës. Kjo ua ka dorëzuar parakontraten dhe e ka

bere qe brenda 90 diteve me ja kthyer parat. Por kthimin nuk e ka bere. Pas nja dy viteve ja ka kthyer 4.000 euro. E njëjta ka dhënë deklaratat edhe në polici ku pothuajse ka deklarur në mënyrë të njëjtë, dhe se transferin e të hollave ia ka bërë përmes Bankës.

E dëmtuara – deshmitare V. I. para gjykatës ka deklarua se ka dhene deklarate ne prokurori me dt. 05.02.2015, mbetet pranë a saj deklarate nuk ak diçka për te shtuar është e dëmtuara ne shumen prej 19.700 euro, te cilën shume e ka paguar 17 qershor 2011 kur është lidhur kontrata dhe nënshkruar. Ate dite i ka paguar 15.000 euro ne forme te avanse përmes llogarisë Bankare, pastaj ka qene marrëveshja se prej muajti shtatore me vazhduar me pagur me këste dhe i ka paguar 10 keste. Me 8 tetor 2011 i kam ftuar për nje marrëveshje te re te blerjes se garuzhdës aty i kemi paguar edhe 1.500 euro si avans, pjesa tjetër ka mbetur me u kalkuluar bashke me shumen totale te pjese tjetër te banese ose pagese se pegjithshem. Marrëveshja ka qene prë 12 muaj nese nuk bahet banesa ka me na paguar 200 euro ne forme te qeras. Banesa nuk është ndërtuar asnjë here, te hollat nuk janë kthyer asnjëherë, e po ashtu nuk na është paguar as qeraja. Pasi qe nuk është ndërtua banesa kane vazhduar kontakte me E. bashkëshorti i saj i ka vazhduar kontaktet, sepse kjo ka qene shtatezen. E njëjta është arsyetuar se nuk mundet me ba banesa për shkak se ka problme me kompani te ndërtimit, ka thene se ka m,e bo marrëveshje me nje kompanin tjetër, dhe bisedimet kan zgjatur gjate gjithë vitit 2012. Ne maj te vitit 2013 ka paraqitur padi ne Gjykate dhe e njëjta ka filluar qe te mos pergjigjet ne telefon dhe te ju ik kontakteve, atëherë kam paraqitru padi ne gjykate. Ka dëgjuar edhe me nje parcel tjetër e ka pasur me nje rast tjetër si me te tyre. Me E. ka ra ne kontakte për mes koleges se motrës ajo ja ka treguar kushtet banesa ka qene 85 metra katrore shuma totale për pagese ka qene 51.000euro vetem për banese pa garazhd. Aty kane qene edhe vllaznia e saj por këta kane biseduar vetem me E. ka qene V.i dhe nje tjetere qe është me i ri, te akuzuarit te tjere nuk i ka pa.

I dëmtuari–dëshmitar B. Sh. para gjykatës ka deklaruar se e ndien vetem te dëmtuar lidhur me kete rast ka dhene dëshmi me dt. 06.09.2013, dhe mbetet pranë deklaratës se dhënë. Për blerje te banese ka hyje kredi dhe ka paguar deri ne vitin 2017 dhe për te njëjtën kohe është detyruar me pagur qera, përveq demet materiale qe me janë shkaura është demi emocional i familjes se tij dhe fëmijëve nga se nuk ka mundur me ju krijuar kushtete për jetës. I ka paguar 12.600 euro transfere Bankare. Kamatën qe e ka marrë ka qene 6 % ndërkaq qeran e banesës e ka paguar 200 ose 250 euro varësisht se ku ka banuar. Përveç E. ka kontaktuar me vëllain e saj V.in dhe babin e E.. I kujtohet se me V.in ka kontaktuar ne zyre te ta dhe i njëjti e ka marrë me kerr dhe ka shkuar te nje lokacion tjetër kur këta kane pretenduar me ndërtu ndërtesën tjetër prej lokacionit origjinal qe e kane pasur kontratën. Nuk është pajtuar qe te ndërrohet lokacioni por premtime ka pasur qe do te ndërtohet edhe prej E. edhe prej V.it. Menjëherë pas gjashte muajve te pare qe nuk ka pas avansime ne ndërtim e ka kuptuar qe nuk do te ndërtohet. Por ka pasur kushtëzimet e E. se ne çoftë se e ndërpret kontrate para afatit te dorezimit te banesës detyrohemi qe me i ndal 20% te vlerës se kontratës, prandaj edhe e ka pritur afatin e dorëzimit te banesës ne menyre qe te mos dëmtohet me 20 %, banesa ka pasur me u dorezur ne qershor 2011 ky ka pasur propozim qe me u ndërrua lokacion por ky nuk ka pranuar. Ne gusht te vitit 2011 e ka shkëputur kontratën dhe premtimet e tyre kane qene qe brenda dy - tre muajve do te kthehen parat por nuk janë kthyer. Është takuara edhe me babain e E. dhe i ka thene qe vajza ime ju ka mashtruar por ka premtuar se mjetët do te ju kthehen. Deri ne pranvere te vitit 2012 kane vazhduar kontaktet pastaj nuk ka vazhduar me sepse nuk ka pasur vlere. Bashke me kolegun e tij N. Ll. kane shkuar bashke dhe ne kete periudh kohore te dyve bashke ju ka kthyer disa te holla 2.000 deri 3.000 euro ne emër te qeras. Ne fillim E. ju ka thene se është një gyp kryesore dhe e pengon ndërtimin e ndërtesës, e njëjta ju ka treguar lejen e ndërtimit te cilin

pasi qe ja tregon gjykatës dokumentacionet e ndërtimit qe ua ka prezantuar E. si leje te ndërtimit dhe atë një situacion te lokacionit, leje urbanistike dhe konkluzion te vitit 2009 i njëjti deklaroi se ashtu i kemi kuptuar këto dokumentacion si leje, dhe te gjitha këto dokumentacione i kemi dorezur ne polici. Dhe demi material është 36.000euro deri ne 37.000 euro. I njëjti ka deklaruar se te akuzuarit B.V., Xh. A., V. dhe F. O. nuk i njeh. E njeh vetem V.in i cili e ka dërguar te lokacioni i ri, edhe personin F. M. nga i cili kishte marrë premtime se do te jete bashke financues, por qe ky i ka thene se nuk ka pune me te por me E..

I dëmtuari-dëshmitar *Islam Haliti* para gjykatës ka deklaruar se ka dhënë deklarat më parë dt. 10.02.2015, mbetet pranë te njëjtës. Përvq E. gjate gjithë kohës ka qene i pranishëm vëllai i saj qe emrin nuk ja ka ditur por është ai prezent qe është ne gjykatë. Vëllai i saj qe ka qene ne zyre nuk ka ndërmarr ndonjë veprim , kontrata është lidhur ne mes ti dhe E. . Ju kane prezantuar si kompani e ndërtimit V. O G. si drejtoresh e asaj kompanie është prezantuar E. ne fund del qe te jete kompani mashtruese e jo ndërtuese. Objektin kur ka shkuar me pre ka qene vete i ka takuar dy punetor, nuk e di se kush kane qene ata por janë prezantur si puntor te objektit te kompanisë V. O G.. Objekti ishte ne gjendje punim i vrazhde ne ndërtim pese kate. Aty ka shkuar me adrese dhe ata dy punetor ishin për te prezantuar objektin. Kontraten e ka lidhur ne mars te vitit 2011. E. i ka thene se kur te nxehet koha ne prill do te fillojnë ndërtimet por ndërtimet nuk kane filluar kurrë, ka pritur deri ne vitin 2013 deri e ka paditur. Pasi qe e ka paditur E. nuk ka biseduar me me te. Padin e ka bere ne muajin gusht te vitit 2013, para se me bo padi janë mundur këta me bo lojra, kur e theme këta e kam fjalën për kompani ne emër te se cilës ka folur E. ku dhe kane prezantuar punetor. Pas nje kohe i kane thirr te gjithë te dëmtuarit dhe u kane prezantuar nje kompani tjetër qe nuk i kujtohet emrin i duket se ka qene njëfarë B.i i cili e merr për obligim me ndërtuar banesën por ne nje lokacion tjetër. Arsyet e terhekjes nga lokacionit ku ishte banesa thane se do te kaloi nje gyp i ujesjellesit te P. dhe aty pengon banesa dhe duhet me u terhjek prej aty lokalcion dhe me dal ne nje lokacion tjetër, dhe kane kërkuar ndryshimin e kontratave. Nuk e kam ndryshuar kontratën sepse e ka pare jo seriozitetin. Parakontrata qe është bere është nënshkruar ne Gjykate dhe ne baze te kësaj mund te kuptohet se ka leje te ndërtimit sepse aty shkuan edhe numri i lejes. Demi material është 15.166euro. Dhe ne kontrate ka qene e specifikuar se objekti duhet te përfundoj 12 deri 15 muaj, dhe pas këtij afatit kjo kompani ka qene e detyruar me paguar qeran ne vlere prej 200 euro çdo muaj, qe do te thotë qe tash e 8 vite e njëjta është dashtu te paguaj kah 200 euro, mirëpo asnjëherë te hollat nuk me janë kthyer dhe as nuk me është paguar.

E dëmtuara – deshmitare *F. H.* para gjykats ka deklaruar se ka dhene deklarate me pare ne polici me dt. 09.06.2014 dhe qëndron pranë asaj deklarate. Me E. kane lidhur kontrate dhe nuk është realizuar e ka njohur vetem E. dhe me te është takuar, ndërkaq t e akuzuarit tjere nuk i ka njohur. Para kesh i ka paguar shumen prej 10.000 euro, ndërsa me këste ka paguar periferisht 3.000euro, ka ndërpre pagesën e kësteve pasi qe banesa nuk është ndërtuar asnjëherë. Pasi qe nuk ka ndërtuar e ka ndërruar vendqëndrimin e vet, dhe kur e kane gjetur ju ka thene se mos u mërzitni se veq sa na kane dhene leje Komuna dhe këta kane menduar ashtu. Sipas E. ajo bere kërkesës dhe ka marr leje ndërtimit por ajo lejen nuk e ka marrë asnjëherë. Ju ka thene se pas nje viti do te ndërtohen se do te behet gati pas 5 – 6 muaj por do te hyje ne te pas nje viti. Pasi qe kane ndërpre pagesën i kane kërkuar E. me ja kthyer te hollat po ashtu e kane kërkuar edhe dëmshpërblimin kane shkuar te E. me dy tre koleg te tjere por ajo u ka thene se nuk ka te holla por ka premtuar se do te ua ktheje. Shuma te cilën e ka paguar e ka bere përmes Bankës, nje pjese e ka dërguar kesh e nje pjese e ka bere

nepër mes Bankës. Dhe të gjitha dëshmit e B.ës i ka dorëzuar dhe i posedon në gjykatë dhe me vetë.

Nga dëshmia e të dëmtuarit - dëshmitar *V. D.* ka deklaruar se ka dhënë deklaratë në polici më datë 02.06.2014 qëndron pranë asaj deklaratë, E. dhe V.in i njeh përmes një shokut të babait që kishte dëgjuar që po jep banesë me kushte të mira për 15 vjet. Kishte shkuar në zyrë si çdo qytetar për të shiquar se çfarë kushte janë dhe aty e ka njohur E. për herë të parë, ua ka prezantuar kushtet e banesës u ka thënë se 18 muaj do të kryhet dhe pasi që kanë pasur nevojë për banesë i kanë goditur dy banesa edhe ky edhe baba, kanë dhënë para kesh ky i ka dhënë 11.000 euro në R. B.e, ndërkaq baba i ka paguar 10.000 euro. Kur kanë shkuar me E. pa objektin ka qenë duke ndërtuar është zhgënjtur duke thënë jo gypi jo kështu, pastaj ka thënë se ka ndërruar lokalicion dhe ju ka treguar një lokacion tjetër dhe këta janë pajtuar pasi që nuk kishte zgjidhje tjetër. Nuk i kanë kërkuar mjetet që të ja kthejnë duke shpresuar se do të realizohet projekti dhe do të marrin banesat. Nuk kanë hequr dorë asnjëherë pasi që kanë parë që nuk është realizuar dhe në vitin 2014 i ka thirrur Policia e Krimeve Ekonomike. Deri në vitin 2014 ka pritur që kontrata të realizohet. Janë 4 - 5 kolegë që kanë blerë banesë të E. dhe nga 1 kolege janë njoftuar se E. i ka thirrur në takim me u takuar me personin B., kanë shkuar kanë qenë 30 - 40 qytetarë të tjerë që kishin ardhur dhe janë takuar në një zyrë të vogël aty kanë thënë që ky B.i po merr me ndërtim objektin. B.i ishte prezent dhe do të vazhonte sipas asaj kontrate të ndërtimit. B.i ka thënë se e merr përsipër ndërtimin. Nderkaq nuk i kujtohet se a ka thënë diçka tjetër, pasi që i lexohet deklarata e dhënë në polici, ku B.i i kishte përmendur edhe 300.000 euro, i njëjti thotë po është e vërtetë. I njëjti deklaroi se është i dëmtuar nga se i është dashur të paguaj qera tani ky ka blerë banesë por babai ende vazhdon të jete me qera. Është i dëmtuar dhe kërkon se paku të hollat të cilat ja dhënë E..

Nga dëshmia e të dëmtuarit - dëshmitar *H. D.* u vërtetua se se E. e ka njohur përmes një shoku i cili ka thënë se ka banesë me shitje, ka shkuar ka lidhur kontratë ajo ka thënë se banesë do të përfundoi përafërsisht brenda 2 vite, javë ka treguar lokacionin dhe këta janë pajtuar për atë lokacion mandej ja ka paguar shumën prej 10.000 euro nëpër mes Bankës e flet pagesën e ka dorëzuar në polici. Ky personalisht nuk ka shkuar të vendi por ka shkuar djali dhe i ka treguar se ka filluar me u ndërtuar diçka mandej është stopuar. Pastaj ka shkuar dhe ka biseduar me E. ajo ka thënë se se shpejti do të ndërtohet. E kanë parë që nuk po ndërtohet dhe pastaj pasi kanë bërë thirrje policia për Krime Ekonomike i kanë dorëzuar dokumentet që i kanë pasur. Ja kanë kërkuar të hollat por ajo ka thënë se nuk ka me i kthyer por do të bëhet ndërtimi. Njëherë ka qenë në pyetje me u ndërtuar në një vend pastaj është ndërue lokacion ka filluar me u ndërtuar dhe është stopuar. Djali është interesuar dhe nuk i kujtohet se kur ka qenë hera e fundit kur ja kanë kërkuar të hollat. Pasi që kanë dhënë deklaratë në polici për krime Ekonomike ka pirë kafë me E. i ka thënë se po i vyen të hollat por ajo i ka thënë se nuk kam. Nuk e di se a ka pasur leje E. për ndërtim por ka thënë se ka me u bërë leja. Të akuzuarit e tjerë nuk i njeh përveç vëllain e E. që e ka parë figurativisht mirëpo nuk ka pasur kontakte me të, ka kërkesë për dëshmipërblim të kthehen mjetet që i ka dhënë asgjë me shumë e as me pak.

Nga dëshmia e të dëmtuarit - dëshmitar *N. Ll.* i njëjti ka deklaruar se ka dhënë deklaratë në vitin 2015 mund të mos i kujtohet sepse ka kaluar një kohë e gjatë. Ky është takuar me E. dhe familjarët e saj. Me E. janë takuar dhe janë dorëzuar që të prishin kontratën dhe të kthehen mjetet, për shkak se e kanë parë që banesat nuk po ndërtohen, mandej e kanë ndryshuar lokacionin dhe ky në marrëveshje me E. ka hequr dorë nga banesë janë marrë vesh që të ja kthejnë mjetet. Marrëveshja ka qenë që të ndërtohet në M. . dhe ajo banesë është

ndërtuar, nuk e di se kush e ka ndërtuar, mbasandej është nderua lokacion pastaj E. e ka njoftuar se do te ndryshoi lokacionin dhe se ju ka thene se nuk jam me ne atë pjese. E di qe ka pasur pengesa dhe e njëjta ju ka thene qe do te ja ktheje mjete por nuk ja ka kthyer. I ka caktuar disa afate. Ajo ka pasur me ja kthyer 25.000euro, pasi qe ky ja kishte dhënë. Para se me ja filluar E. ja ka prezantuar lejen prej Komunes. Takimi me E. kishte filluar ashtu qe S.in te cilin e ka nip kishte shkuar me E. ne lokalin e ti. Dhe ky i ka besuar S.it . S.i E. ja kishte prezantuar si shoqe si nje afariste e cila ka filluar me ndërtuar banesa. S. i ka thene se une kam marrë banese dhe vëllai jem ka marrë banese. Ky nuk ka shkuar te E., por E. me S.in kishin shkuar ne lokalin e ti, ndërkaq ky ne zyrën e E. kishte shkuar me vone, do me thene prej momentin kur e ka bere pagesën. Sa here ka shkuar te E. ka shkuar me S.in. Ka pasur kontrate me E. por kontratën ja kam kthyer E. dhe ajo ne fletore e ka shkruar se N. Ll. por tërhiqet prej kontratës. Lidhur me deklaratën e dhënë ne prokurori se shumen prej 10.000euro dhe automjetin H. ja ka dhene B.V.. I njëjti ka deklaruar se marrëveshja ka qene qe te hollat te nesërmen ne shume prej 10.000 euro dhe automjetin H. me i que te S.i, kur ka shkuar ne punëtorin e S.it aty kishte ardhur B.i, dhe S.i ka hene se jepja paret B.it dhe qelE. e kerrit. Kjo ka qene edhe pe ky nuk e dit qe aty ka me ardhur B.i. Te hollat e as vetura nuk janë kthyer. B. V. e ka njohur përmes S.it dhe e njeh edhe si vendas te tij. Nderkaq V.in e njeh nga se E. ja ka prezantuar kur ka shkuar ne zyre te ti i ka thene se ky është vëllai V.i, edhe pse me V.in nuk ka bere ndonjë marrëveshje. Me vone është takuar edhe me prindërit e E. pasi qe e ka prishur kontratën. Është i dëmtuar ne shumen prej 25.000 euro dhe i kërkon vetem këto mjete te cilat i ka dhënë.

Nga dëshmia e te dëmtuarit - dëshmitari *F. Sh.* ka deklaruar se i kujtohet se ka dhënë deklarate ne muaj shkurt 2015 banesa ka pasur me u ndërtuar për 12 muaj, marrëveshjen e kane pasur dhe e njëjta ka pasur me ja paguar qeran kah 200 euro ne muaj mirëpo nuk ja ka paguar. Banesa ku ky e ka pasur kontratën ne rrugën C është ndërtuar, por ky nuk e ka marrë atë banese sepse e njëjta disa here e ka thirr ne telefon për me ndryshuar kontratën dhe me dal ne nje objekt tjetër, ky nuk ka pranuar. Kur e ka ber e kontratën ne atë banese ka qene ndërtim i vrazhdë, e ka ditur cila është banesa e ti, ashtu qysh ja ka shpjeguar E. mirëpo ne atë ndretese ka qene kati pest, dhe pamja kah parkingu. Ne atë ndertës tani shkruan A. Graqanice, është ndërtuar complete dhe nuk e di se kush e ka ndërtuar. Kur ka biseduar me E. sepse don me ndërrua lokacionin ajo i ka thene për nje lokacion tjetër nga se atje është me mire dhe me qet. Deri me tash nuk janë kthyer te hollat banesa nuk është ndërtuar dami është 10.000euro sepse i kam marrë kredi dhe i ka paguar për banese. Nderkaq Bankës ky ja ka kthyer 12.986 euro, te gjitha dokumnetacionet i ka dorëzuar ne prokurori. Me E. kishte ra paraprakisht ne kontakt përmes enje kolegu I.H., nga se edhe ai kishte blere banese, dhe përfundimisht i njëjti deklaroi se ka kerkese për demshperblim ne shume prej 12.986 euro.

Dëshmitarja e dëmtuar *S. H.* para gjykatës ka deklaruar se ka dhene deklarat me dt. 04.06.2014. Me E. është njoftuar nepmjet B. S., dhe motrën e B. S., M. S., i ka thene se krejt policia po blejna banesa. Dhe M. i ka thene se meqenëse e ke gjendjen e keq e je pa burr e me tre femije, po te mundësojmë qe edhe ti me hije ne këtë punë sepse e njohim shume mire E.. I ka pasur parat prej 12.000 euro, te D.K., sepse ka pasur me ble banese tjetër dhe ajo kompani ka ndërtuar shume banesa. E. i ka thene se ai është dallavergji hiqi paret prej atyhit se është shume tradhëtar. I ka tërhequr paret, dhe ajo i ka thene vendosi ne llogari ne nje B. është me te sarit sepse emrin nuk ja di, dhe se ajo fare B.e është e jemja. Ajo i ka thene se jam e lidhur me atë B.e dhe milionat i kam aty, i kam njerëzit e mi, brenda 12 muajve ke me hy ne banesë. Pasi qe je me jetima ke me pas ekstra një banese me nenen time ne katin e gjashtë. Dhe atë banese e ke gratis prej

meje, dhe ti e meriton, sepse po jep shume pare, sepse mue me qojke djali pare me qojke motra edhe vete kam punuar. Ajo i ka thene se ndale pune se po merrshe pak 300euro se une kam me ti dhene 500 euro për ne muaj. Une po marrë zyre me 8 dhoma kam me pasur drejtor sekretare etje. Ajo i ka thene se është ekonomisë kontabiliste dhe se ti me duhesh. I ka besuar sepse i ka pasur vëllezërit e zot. Shuma e përgjithshëm qe ja ka paguar është 37.000euro, te hollat ja ka dhene kohe pas kohe ne dore jo përmes gjyrollgoarisë. Nderkaq 8.000euro ja ka derdhur ne gjyrollgoari ne B.e R.. Ja ka dhene ne dore e nëpërmes gjyrollgari sepse ajo i ka thene i ka vulat edhe i ka vulat e gjykatës. Te gjitha i ka te dokumentuar, njëherë 15.000 euro, nje here 8.000 euro, nje here 4.000 euro, disa here ja ka dhene kah 2.000euro, 3.000euro, kah 500 euro qysh ka pasur. Te gjitha provat për kete ja ka dorëzuar prokurorisë.

E. i ka llogaritur te gjitha vete duke përfshire edhe qeran edhe te noteri. E ka thirr vete njëfarë personi H. dhe e ka nënshkruar se i ka nënshkruar 47.000euro. Ate dite kur jam dal prej noterit i ka thane ami 500 euro qe te bona këto te noteri. Kjo i ka thene se nuk ka kishte për qera 200 euro, dhe ato ja ka marrë i ka thene nesër ne ora 11:00/h, do ti ktheje dhe pastaj është zhdukur. Para se me shkue te noteri e njëjta vete e ka thirr ne telefon e njëjta kur ka shkuar i ka thene se çka po don pse ke ardhur. E njëjta i ka thene po ti ktheje te hollat here po behet banesa her e spo bahet ka ndodhur tri here ne dite ka thirre por asgjë. Njehere i ka thirr i ka thene a ban me ti prue ne ora 05:00/h te mëngjesit, ndonjëherë i ka then ti bi ne ora 12 nates, se jam ne kufi, e kjo i ka thene se bjemi se gjithë natën por te pres.

Njëherë i ka thënë me shkue me banuar te F. M. për gjashte muaj. Kjo ka qene me qera duke banuar dhe kur ja kane qit teshat jasht, E. e ka thirr pronarin i ka then se shtinja teashat brenda se une nesër ne mëngjes ja ktheje te hollat, dhe e njëjta është zhdukur. Kjo ka shkuar me banuar me qera te F. M., dhe kjo nuk ka paguar qera për gjashte muaj, por i ka kushtuar shume shtrejte nga se ju ka dashtë me ble ushqim F. M., H. H. i dhe nenës se F. Pas gjashte muajve qe ka banuar aty ata kane filluar me kërkuar qeran 300 euro, kjo e ka thirr E. i ka thene se ku është banesa i ka thene se do te kryhet edhe 6 – 7 muaj, pastaj i ka thene edhe 2 muaj, edhe 3 muaj. Për blerje te banesës ka pasur bisedime vetem me E. dhe vëllain e saj, qe nuk i kujtohet se cili ka qene por e di qe ka pasur nje xhip te zi, ata kane qene te sjellshme me te, deri sa janë zhdukur. Te akuzuarin F.O.n nuk e njeh, kur ka shkuar te E. ka pasur shume njerëz dhe nuk i kujtohet se kënd e ka para se ka harruar, por i kujtohet se nje here ja ka dërguar nje fare B.in dhe ai ju premtuar se do te ja ndërton banesa. te gjithëve ku kane qene me shume se 50 persona dhe te gjithë janë gëzuar. E. ka bere hajgare me te, personat qe i kishte prue kane qene disa firmasha dhe nxitke me e ngaxuar, djemet e saj nuk i ka lene me pas kontakte me te, sepse është frikësuar, sepse E. i ka thene se ti nuk e di se kush jam une krejt gjyqin e kam ne dorë.

Nga dëshmia e dëmtuarës - deshmitare M. C. e njëjta ka deklaruar se mbetet pranë deklaratës te dhen ne polici me dt. 29.05.2014, se është e dëmtuar ne shumen prej 11.400 euro, përveq me E. nuk ka biseduar me askënd tjetër. E njëjta prej vitit 2011, 2012, 2013, 2014, ne vazhdimësi ne telefon i ka thene se do te ndërtoi kete vit ate vit, banesa nuk është ndërtuara, i ka thene se mos u ngut me shkëput kontratën. E njëjta e ka premtuar dhe ja ka caktuar datën për me ja kthyer te hollat dhe data e fundit ka qene 30.mars 2014, por te hollat nuk ja ka kthyer neper mes telefonit i ka thene se veç shpirtin me marrësh se pare nuk kam me te dhënë. Te hollat E. ja ka dorëzuar neper mes gjyrllogarisë për personin me emër R.qe e ka cekur ne deklaratën e dhënë ne polici, nuk i kujtohet tani mire kush është por me siguri ka qene arkitikti i kompanisë. E njëjta me tutje ka deklaruar se mbetet ne tërësi

pranë deklaratës që ka dhënë në polici, ka kerkese për dëshmipërblim por se paku ti kthehen mjetete që i ka cekur me lart.

Nga dëshmia e të dëmtuarit-dëshmitar *L. Sh. para gjykates ka deklaruar se* ka deklaruar se me dt. 17 korrik 2014 ka dhënë deklaratë në prokurori dhe mbetet pranë asaj deklaratë. Me E. ka ra në kontakt neper mes dajallarëve, në lidhje me banesën ka pasur kontakt vetem me E. dhe pagesën e ka bere në kesh e jo përmes llogarisë B. are. Ja ka dhënë 46.150euro, nuk ka mbajtur evidenc dhe nuk ka qene askush prezent por te njëjtës i ka besuar. Banesa ka pasur me u ndërtua brenda 1 viti, ka kontaktuar me te here pas here, e njëjta i ka premtuar se do te ndërtohet. Si kujtohet saktësisht se a e ka nënshkruar kontratën në vitin 2011 apo 2012. E ka prituri ndërtimit e banese deri në vitin pasues dhe pastaj ka vazhduar tuj prit. Nuk i ka dhënë arsye vetem i ka thene se duhet me prit, pastaj kane mbetur punët ashtu siq janë në kete situatë. I ka kërkuar me ja kthyer te hollat, i ka premtuar se ka me ja kthyer. Si arsye per mos ndërtim ka qene vetem prit edhe pak, dhe pastaj nuk ka qene me në kontakte me te, dami i tërësishëm që është 46.150 euro. Ky nuk ka njohuri se për çka kane marrë shtëpi dajt e tij nga E. dhe nuk kam marrë asgjë nga ajo shtëpi.

Dëshmitarja – e dëmtuara *Sh.P.*, në deklaratën e saj të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 22.04.2021, pasi u njoftua me të drejtat e saj konform nenit 125 të KPPRK-së deklaroi se të pandehurit V. dhe E. i njeh, sa i përket të pandehurit V. dëshmitarja – e dëmtuara deklaroi se të njëjtë e ka njohur kur ka shkuar në zyrën e E. por asnjërin prej tyre nuk i ka njohur më parë. Lidhur me rastin dëshmitarja – e dëmtuara deklaroi se kur ka lidhur kontratë me E., gjashtë kate të objektit kanë qenë të ndërtuara por, më nuk kanë vazhduar me punë dhe se kohë pas kohe kanë shkuar për të shikuar a po ndërtohet diçka me ç’rast dI. punëtor aty i kanë thënë se aty është duke ndërtuar një gjakovar e jo E.. Pasi e ka marrë këtë informatë dëshmitarja – e dëmtuara sqaroi se ka kontaktuar me E. dhe janë takuar në zyrën e saj ku e njëjta i ka thënë se Komuna ju ka ndërpre punën për shkak të një gypi dhe se do të kalojnë në një objekt tjetër në lagje tjetër. E njëjta ka sqaruar se banesa e saj ka qenë në katin e katërt dhe nuk ka shkuar asnjëherë për t’u parë nga afër por nga poshtë e ka parë dhe se me E.B., kontratën për blerjen e banesës e ka nënshkruar në dimër të vitit 2010, me nënshkrimin e kontratës e ka bërë pagesën prej 10.000 euro ndërsa, në muajin mars ka filluar pagesën me këste mujore prej 200 euro. Dëshmitarja – e dëmtuara theksoi se meqë nuk është pajtuar me propozimin që të kalojë në objekt tjetër, ka kërkuar kthimin e mjeteve, ka kontaktuar me mesazhe me E. dhe e njëjta ju ka thënë se si t’i jepet mundësia e parë do t’ju kthejë të hollat dhe në Korrik 2012 E. e ka nënshkruar një deklaratë me të cilën ka pranuar t’iu kthejë mjetet brenda 3 muajve mirëpo, pavarësisht kësaj mjetet nuk ju ka kthyer dhe pas kësaj komunikimi me E. ka qenë i pamundshëm e as në kompani nuk kanë mundur t’u gjejnë dhe që nga ajo kohë e deri tani nuk ka pas kontakte me të. E njëjta deklaroi se dëmi që i është shkaktuar me këtë rast është 12.200 euro para të gatshme gjithashtu, marrëveshja ka qenë që t’iu paguhet qiraja nëse brenda 12 deri 18 muaj nuk përfundohet banesa por, nuk ju është bërë asnjë pagesë. Të gjitha të hollat ka kërkuar që t’i kthehen dhe ka sqaruar se të gjitha pagesat i ka bërë përmes Bankës.

Dëshmitari *A.S.*, në deklaratën e tij të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 22.04.2021, pasi u njoftua me të drejtat e tij konform nenit 125 të KPPRK-së deklaroi se nga këtu e pandehura E.B është mashtruar për shkak se me datë 26.10.2010 kanë lidhur një para kontratë për blerjen e banesës me sipërfaqe 71 m2, mënyra e pagesës ka qenë në momentin e lidhjes së kontratës 10.000 euro ndërsa, pagesa tjetër të bëhet me këste nga 200 euro në momentin kur bëhet pranim - dorëzimi i banesës me çelësa. I njëjti ka theksuar se ka paguar shumën 9.990 euro nëpërmjet Bankës Raiffaissen në llogarinë e E.Bt me datë 25.10.2010, disa herë ka shkuar dhe është takuar dhe ka kërkuar sqarime se a po bëhet banesa mirëpo, e njëjta ka premtuar gjithmonë se së shpejti

do të ndërtohet. Më vonë, i njëjti ka deklaruar se E. e ka thirrë dhe i ka thënë se ka ndërruar lokacion dhe i ka thënë se nëse je i interesuar duhet t'a ndërrojnë parakontratën dhe të dalin në objekt tjetër me kushte të njëjta që kanë qenë në parakontratën e parë të nënshkruar në vitin 2010 dhe arsye e këtij ndryshimi E. i ka thënë se është zgjerimi në metër katror dhe sipas saj kjo është më mirë dhe vetëm përafërsisht ju ka treguar se ku do të jetë objekti por, dëshmitari ka deklaruar se e njëjta vetëm përafërsisht ju ka treguar se ku do të ndërtohet objekti ndërsa, kur e kanë nënshkruar kontratën e dytë kanë shkuar te vendi ku pritej të ndërtohej banesa, aty ka qenë një gropë si podrum mirëpo ndërtimi nuk ka filluar edhe pse sipas E. ka pas leje ndërtimi për atë objekt madje, ju ka paraqitë planin e ndërtimit dhe planin urbanistik. Dëshmitari ka theksuar se parakontratën e dytë e kanë lidhur me datë 05.03.2011 dhe dikur i kanë humbur kontaktet andaj, rastin e kanë paraqitur në polici. Sipas tij, nuk i kujtohet data apo viti i saktë por kontakti i fundit me E. ka qenë kur e njëjta i ka ftuar në një takim në rrugën "M.F." dhe aty i ka prezantuar edhe me dy persona të tjerë, ky takim është mbajtur në një banesë në objektin që quhet "T. C." dhe aty E. ju ka thënë se tani ndërtimin do t'a marrin për obligim disa persona të një firme nga M. dhe gjatë atij takimi e njëjta ju ka marrë të gjithëve emrat dhe numrin e letërnjoftimit duke ju dhënë premtimin se do ta marrin atë pjesë të pronës dhe do të fillojnë ndërtimin, kontrata të reja nuk ju kanë dhënë dhe që nga ajo kohë nuk ka pasur mundësi të kontaktoj asnjëherë më me E.. Dëshmitari A.S. deklaroj se dëmi që i është shkaktuar është 9.990 euro dhe si dëshmi gjykatës ia ka ofruar konfirmimin e transaksionit të realizuar në Raiffeisen Bank..

Dëshmitari S. M. në deklaratën e tij të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 22.04.2021, pasi u njoftua me të drejtat e tij konform nenit 125 të KPPRK-së deklaroi se është viktimë e mashtrimit sepse ka nënshkruar kontratë për blerje të banesës dhe ju është thënë se objekti do të përfundoj për 12 deri 15 muaj, kanë filluar ta bëjnë pagesën me këste dhe fillimisht i ka paguar 10.000 euro e pastaj ka filluar me pagesën e shumës prej 200 eurove në baza mujore, gjithsej i njëjti ka deklaruar se i ka paguar 13.500 euro nga Janari 2011 deri në Qershor 2012 dhe sa herë ka ardhur për pushim në Kosovë ka kontaktuar me A.in dhe së bashku kanë shkuar dhe i kanë shikuar punimet por, e kanë parë se në objektin e parë punimet nuk po vazhdojnë pastaj ju ka premtuar një objekt tjetër për të cilin kanë nënshkruar kontrata të reja por edhe aty janë ndalë punimet dhe A.i i ka njoftuar se nuk po punohet pas kësaj, dëshmitari deklaroj se e ka njoftuar E. se më nuk do të paguaj pa u kryer puna dhe për këtë arsye nga muaji Qershor 2012 nuk ka vazhduar me pagesë. I njëjti ka deklaruar se takimi i fundit me E. ka qenë rreth orës 14:00 apo 15:00 dhe kur kanë shkuar aty ka qenë policia dhe ndihma e parë sepse dikush e kishte sulmuar E. andaj, nuk kanë pas mundësi të komunikojnë me të dhe prej atij rasti nuk kanë pasur kontakte më me të. Dëshmitari S. M. deklaroj se dëmi që i është shkaktuar është 13.500 euro.

Dëshmitari M. K. në deklaratën e tij të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 22.04.2021, pasi u njoftua me të drejtat e tij konform nenit 125 të KPPRK-së deklaroi se nga E.B, të cilën e kishte njohur përmes kolegut të tij S. M., ka blerë banesën 82 m2, në Lagjen M. ., kanë ardhur nga Zvicra, janë takuar dy – tri herë së bashku dhe e kanë nënshkruar parakontratën me ç'rast ja ka pagur shumën prej 10.000 euro kesh pastaj, vëllai ka kontaktuar me E. dhe përmes Bankës ja kanë paguar 5.000 euro për të cilën pagesë i posedon fletëpagE. dhe shuma e pëgjithshme e dëmit që i është shkaktuar deklaroi se është 16.338 euro. I njëjti ka theksuar se sa herë ka biseduar me E. ajo i ka thënë se po ka pengesa e pastaj përmes mediave ka dëgjuar se ka qenë mashtrim pas kësaj ka provuar të kontaktoj me E. por nuk ka qenë e qasshme.

I dëmtuari - dëshmitar G. H.i para gjykatës ka dekluar se se me dt. 12.02.2015 ka dhënë deklaratë ne prokurori dhe mbetete pranë asaj deklarate edhe pse nuk i kujtohet mire. Me E. ka punuar ne Raiffazen, dhe neper mjete nje shoqe qe ka punuar ne Raifazne dhe ka ne kontakt me te. Me E. ka biseduar ne zyrën e saj te Teatrit, me dt. 01.prill 2010 e ka bere

transferin e parave, afati me u përfunduar ka qene 24 maj por nuk i kujtohet saktë. Banesa ka qene 72 metra katrore ne katin e katër qmimi nuk i kujtohet por është e përfshire ne kontratë. Meqense kane kaluar me shume se 10 vite nuk i kujtohet saktë, i duket se ka qene 700 euro metri katror, këste ka pasur me i paguar 150euro, periudha për me paguar ka qene 19 vite. Perpos paradhenjes prej 10.000 euro. Vendi ku ka pasur me u ndërtuar ka qene nje ndertese skelet, ka qene e ndërtuar deri ne katin e gjashte. Gjate asaj kohe ka biseduar me E. do te thotë pas nje viti, dhe kur ka biseduar me te i ka thene se ndërruar lokacion. Dhe nderimi i lokacionit është për shkak te lejes se ndërtimit, dhe ky është pajtuar. Diku pas dy viteve ka kuptuar se banE. nuk po ndërtohen. Kestete ky ka vazhduar i ka paguar edhe për nja 10 muaj. Kur eka kuptuar se spo ndërtohet nuk ka pasur qasje me E. dhe nuk ka pasur qasje ne telefon. E. ja ka paguar 10.000 euro, dhe pastaj 10 keste ja ka paguar kah 150euro. Njehere E. e ka thirr ne telefon i ka thene se a mundesh me mi gjete 200 euro se qeragjia po e qet prej shtëpisë ajo ka qene duke qajt ky e ka dite se ajo nuk do te ja kthene por këtij i ka ardh gjunah. Kur ka biseduar me E. V.i ka qene ne zyre por bisedën e ka zhvilluar vetem me E.. Kur i kane thene se ka nderuar lokacion këta nuk kane nënshkrua kontrate te re. Eshtë takuar edhe nje here me B.in por jo për rastin. Ky punën ne R. e ka ndërpre ne vitin 2013 dhe me E. kishte ra ne kontakte për mes nje shoqe edhe pse te dyte ishin puntor te R., por për shkak se E. kishte punuar ne nje ndertese tjetër dhe ky ka punuar ne nje tjetër.

Dëshmitari *M. B.* në shqyrtimin gjyqësor të datës 29.04.2021 ka deklaruar se me E. janë njoftuar përmes një shoku me emër S. B. dhe pas gjithë atyre diskutimeve që janë bërë janë njoftuar me ofertën që i është ofruar, fillimisht banesa ka qenë 67m2 dhe shuma e përgjithshme ka qenë 43.550 euro, për të cilat ka bërë parapagesë dhe e posedon faturën prej 10.000 euro, ndërsa mjetet tjera janë dakorduar në bazë të para kontratës që të paguhen për 15 vite në shumë mujore prej 186 euro. Mjetet e parapagesës prej 10.000 euro i ka bërë me datë 09.03.2010, por të njëjtën ditë me zonjën E. kanë bërë para kontratën e lidhjes së marrëveshjes së shitblerjes, pas kësaj i ka deponuar mjetet nga data 01.Prill.I njëjti disa herë ka shkuar në lokacionin ku ka pasur me u ndërtua banesa ka qenë vetëm një pllakë e vendosur dhe atje ka shkuar deri në vitin 2012 nuk ka pa ndryshime, dhe duke parë se diçka nuk është në rregull ka hezituat ta bëjë derdhjen e tjera të mjeteve, disa herë ka kontaktuar me E. e njëjta ka thënë se do të vazhdojmë. Ka kërkuar që tja kthejnë të hollat, por nuk iu kanë kthyer asnjëherë, për dëmin ka deklaruar vetëm shumën 10.000 euro dhe kohën që ka humbur që do të thotë se hyjnë të gjitha përqindjet në raport në ketë shumë që ende vazhdohet.

Dëshmitari *H. K.* në shqyrtimin gjyqësor të datës 29.04.2021 ka deklaruar se me E. njihet në të njëjtën kohë bashkë me M. K., ngase disa shokë të M. kanë blerë banesa te E., pasi që vëllau i dëshmitarit ka ardhur nga Zvicrra kanë shkuar së bashku, dëshmitari deklaroi se merret me ndërtim dhe ka parë se aty nuk ka kurrgjë dhe i ka thënë vëllaut mos me ble banesën, pasi që vëllau është kthyer në Zvicërr e ka thirr në telefon dhe i ka thënë se e ka blerë banesën, ia ka dërguar 10.000 euro dhe ia ka bë përhapr, pastaj ka shkuar te E. dhe e ka pyet pse nuk po ndërtohen banesat. , ajo e ka lutur që dëshmitari ti dërgoj beton për me fillu objekti dhe i njëjti i ka dërgu beton dikun 300 kubit në vlerë prej 21.000 euro në vitin 2012, dhe paratë ka pasur me ia dhënë me datë 11.05.2012, ka shkuar shumë her me ja kërkuar paret e betonit por e E. jo nesër jo mbas nesër, E. i ka thënë se në qoftë se nuk ti jap paret atëherë do të jap një banesë, atëherë e ka bërë një kontratë dhe banesa është kontraktuar në atë vend ku ka quar beton. Në parakontratë të cilën e kanë lidhur ka qenë e përcaktuar shuma 10.000 euro në Prill, ndërkaq shuma prej 11.000 euro në korrik të vitit 2013 në të kundërtën nëse nuk i kthehet shuma prej 21.000 euro do të fiton të drejtën e pronësisë së banesës prej 71m2, as paret as banesa nuk janë kthyer, ajo banesë ka qenë vetëm bodrumi, ka biseduar disa herë deri sa ajo është arrestuar.

Dëshmitari *F. E.* në shqyrtimin gjyqësor të datës 29.04.2021 ka deklaruar se ka punuar në atë kohë në stacionin Policor Qendra në Prishtinë me një kolege Gj. kanë biseduar rreth çështjes së banimit, ajo i ka thënë se ka bërë zgjidhje të mirë të banimit, dhe bashkë me të kanë shkuar në zyre e E., zyrën e firmës V. G., kanë ra dakord me ia dhënë 5.000 euro parapagesë dhe pjesa tjetër ka qenë me kiste mujore në shumë prej 171 euro për 15 vite, metri katro i marrëveshjes ka qenë 650 euro dhe i ka paguar diku rreth 6000 euro përmes Bankës dhe i posedon të gjitha flet pagesat Me E. i ka dy kontrata në vitin 2010 e ka kontratën e parë për banesën në katin e VIII për shkak se nënën e ka pasur të sëmur prej këmbëve i ka thënë E. a bënë një kat më poshtë, ajo i ka thënë se nuk ka mundësi, pastaj i ka telefonuar dhe i ka thënë se është duke u ndërtuar një objekt i ri në një lokacion afër dhe pasi që je i interesuar me shku me një kate më poshtë do ta mundësoi në objekt të ri. Në lidhje me kontratën e parë ka qenë i ndërtun objekti deri në katin V apo VI, ndërsa kur e ka nëshkruar kontratën e dytë ka qenë i ndërtum vetëm bodrumi. Kur e ka bërë kontratën e dytë motra e këtij dëshmitarit *F. E.* meqë ishte e fejuar i kishte thënë a mundesh me fol edhe për neve për një banesë dhe të gjitha negociata e banesës së motrës këtij dëshmitari i ka kryer bisedën e ka zhvilluar vetëm me E. dhe nuk ka pasur asnjëherë ndërmjetësues përveç koleges Gj. kur ka qenë herën e parë. Me B.V.n janë takuar te rrethi i Standardit në Breg Diell dhe i ka dërguar te vendi ku kishin filluar punimet dhe kjo ka ndodhur para kontratës së dytë dhe pastaj e ka lidhur kontratën. E. ka deklaruar se V.i dhe B.i kanë pasur për detyrë me i dërgu deri te vendi me e pa vendin sepse ajo ka qenë puna e tyre.

E dëmtuara *F. Sh.* ne seancën e dt. 30.11.2021, ka deklaruar se mbetet pranë deklaratës se dhene ne prokurori dhe ne polici, se ka kerkese për dëmshpërblim ne shumen prej 11.800 euro, 10.600 euro i ka dhënë kesh, pastaj 1.200 euro i ka paguar përmes Bankës dhe E. i ka nëshkruar. Kete shume e akuzuara E. B. ja konfirmon gojarisht se ka pranuar ne te njëjtën seancë.

Në seancën e dt. 21.05.2021 si te dëmtuar para Gjykatë kanë paraqitur kërkesën për demshperlbim:

Në ne emër te H. Th. përfaqësuesi i saj i autorizuar av. Kadri Syla. Dhe atë shumen prej 12.550euro, vetem demin kryesore te cilin e ka paguar nëpërmes Bankës.

I. A. ka deklaruar se është bashk i dëmtuar me M. C..

Përfaqësuesi i te dëmtuarit Z. J. babai i tij S. J. shumen prej 15.000 euro qe janë pagur neper mjete transferit Bankare, ndërkaq obligimet te tjera te cilat i ka marrë për sipër këtij e akuzuara nuk i kërkon.

I dëmtuari J. P. ka paraqitur kërkesën për demshperblim ne shumen prej 10.400 euro, dhe a të ne baze te parakontrates qe ka lidhur me dt. 11.01.2011 ku ka qene marrëveshje qe pas tre muajve me filluar puna, dhe pas kësaj ka kërkuar qe te ndërpritet kontrata.

I dëmtuari B. P. ka deklaruar si i dëmtuar se me dt. 21.03.2011 ka bere para kontratë gjashte muaj kam prit dhe nuk është bërë pastaj e ka ndërpre kontratën ka kerkese për dëmshpërblim 16.100 euro te gjitha janë bere me transfer Bankar. Për obligime te tjera nuk ka kerkesë për dëmshpërblim.

Ne cilësi te dëmtuarit Q.K. ka deklaruar se me E. ka lidhur marrëveshje pasi qe ja ka paraqitur kushtet meqë është pjestar i Policisë së Kosovës ajo ju ka thene se avansin e

paguani sa keni mundësi fillimisht i ka pasru 3.000 euro i ka dhënë nëpërmjet Bankës. Nepermjet e Bankës total i ka dhen 18.000 euro ne emër te E. B. dhe ne emër te T. B. e cila është gruaja e V. B., nje pjese i ka paguar me këste kah 200 euro, objekti ka filluar me u ndërdua, ka shkuar dhe e ka pare disa here, por ne realitet nuk është ndërtuar. Dhe se ky është vendosur ne nje banese ku e ka dërguar E. dhe i ka kërkuar edhe 4.000 euro, nga se E. i ka thene se është banesa e vëllai tim, dhe këto 4.000 euro duhet me i derdh ne gjirollogari te T.. Tani E. i thotë se banesa nuk është e imja por është e vëllait tim, i cili ju ka thene se duhet te liroi banesën nga se është e ti. Është i pajtimit qe ky te qëndroi ne atë banese dhe nese ka diqka shtese për te paguar do te paguaj fakturat e rrugës dhe te gjitha fakturat vine ne emër te V.B.

E dëmtuara M. B. ka kerkese për dëmshpërblim ne shumen prej 20.000 euro, 5.000euro ja ka paguar kesh ne dore, e 15.000 euro ja ka paguar nëpërmjet Bankës.

I dëmtuari E. Gj. ka kërkesën për dëmshpërblim ne shumen prej 10.000 euro dhe ju kane paguar nëpërmjet Bankës.

I dëmtuari B. S. ka kërkesën për dëmshpërblim ne shumen prej 12.000 euro, 10.000 euro ju kane dhene si para dhenje ndërkaq 2.000 euro ju kane dhene për çdo muaj kah 200 euro.

I dëmtuari I. H.ka kerkese për dëmshpërblim ne shumen prej 11.400 euro, me 17.mars 2012 e ka ber e para kontratën 10.000 euro ja ka transferuar ne B.e. Pastaj te tjera për çdo muaj.

I dëmtuari Sh.K. ka kerkese për dëmshpërblim ne shumen prej 12.800 euro te gjitha te paguara nepërmjete Bankës. 10.000 euro i ka paguar me parakontratë.

I dëmtuari D. B. kërkesën për dëmshpeerbliom e ka ne shumen prej 15.000 euro te gjitha te paguara.

E dëmtuara S. F. ka kërkesën për dëmshpërblim ne shumen prej 16.800 euro, me dt. 08.05.2010 i ka paguar 10.000 euro, ndërsa 10 muaj ka paguar kah 100 euro, dhe gjithesejte te paguara i ka 11.440 euro, ndërkaq pjesa tjetër e kërkuar është ne emër te qeras ku ka qëndruar me qera prej vitit 2013-2019.

I dëmtuari Gj. S. ka deklaruar se ka kërkesë për dëmshpërblim ne shumen prej 17.292 euro te gjitha nëpërmjet Bankës. Dëshmit i ka dorëzuar ne polici. Ka kerkese edhe shumen prej 5.000 euro dhe humbjet ne shume prej 10.000 euro nga se ka paguar kamatë për kreditin dhe ka paguar qera.

I dëmtuari N. M. ka deklaruar se i ka paguar 5.000 euro mirëpo ky kërkon banesën.

I dëmtuari H. K. kërkon dëmshpërblim ne shumen prej 12.000 euro te paguara ne emër te qeras për banese gjithsejt 19.200 euro.

I dëmtuari Z. H. ka kerkese për dëmshpërblim ne shumen prej 8.000 euro te cilat i ka dhene kesh ne dore, gje qe e akuzuara E. nuk e konteston.

I dëmtuari V.K. ka kerkese për dëmshpërblim ne shumen prej 14.500 euro, te gjitha ja dhene ne kesh, gje qe e akuzuara E. ne te njëjtën seancë nuk e konteston kete kerkese te dëmtuarit.

Ne seancën e dt. 31.05.2021 te dëmtuarit ne lidhje me kërkesën për demshpërblim kane deklaruar:

Pëfaqesuesi i te dëmtuarit F. Xh. av. Adelina Hoxha ka paraqitur kerkese për demshpërblim ne shumen e caktuar si në faktuarave 1.2.3 deri me nr. 9 /2013,
I dëmtuari Z.P. ka paraqitur kërkesës për demshpërblim ne shumen prej 6.500 euro.

I dëmtuari Q.B. ka paraqitur kërkesës për demshpërblim ne shumen prej 13.000 euro.
Q.B. ka paraqitur kërkesën për demshpërblim për vëllain e tij J. ne shumen prej 11.000 euro, te gjitha dokumnetacionet i ka dorezur me pare ne Prokurori Speciale.

I dëmtuarit F. B. dhe ne emër te T. P. B. ka paraqitur kërkesën për demshpërblim ne shume prej 17.500 euro.

I dëmtuari H.K. ka paraqitur kerkes për demshperlbim ne shume prej 15.000 euro mirëpo kjo është e shkruar edhe me shkrim nga ana e E.

I dëmtuarit N. S. ka paraqitur kerkese për demshpërblim ne vlere prej 31.000 euro, pagE. i ka bere neper mes B.ese, nje pagese ka qene 10.000 euro, nje pagese 20.000 euro, dhe nje pagese 1.000 euro te gjitha dokumentacionet i ka paraqitur ne Prokurori.

I dëmtuari Sh.Sh. ka paraqitur kërkesën për demshpërblim ne shumen prej 13.000 euro.

E dëmtuara A. V. ka paraqitur kërkesën për demshpërblim ne shumen prej 10.000 euro, te gjitha dokumentacionit për pagesa i ka dorëzuar para gjykatës.

I dëmtuarit S. B. ka deklaruar se ka kerkese për demshpërblim dhe atë qe nga koha kur kane lidhur kontratën ku e njëjta marrë obligim qe te paguaj kah 5.000 euro qera ne muaj.

I dëmtuari Gj. Gj. ka deklaruar se ka kërkesën për demshpërblim ne shume e cekur si ne polici.

E dëmtuara F. H. ka paraqitur kërkesën për demshpërblim ne shumen prej 7.500 euro dhe te gjitha dëshmitë për pagesën e bere janë dorëzuar ne polici.

Dëshmit e të dëmtuara të dhëna në Prokurorin Speciale.

Dëshmitarja- e dëmtuara M.B. - P. kishte dhënë deklartë e në Prokurorin Spedial me datë 05.02.2015 e njëjta ka theksuar se me nënën e E. B. ka qënë kolege e punës për 10 vitë përmes saj është njoftuar se vajza e saj E. po ndërton banësa për shitje dhe pasi që kishtë nëvojë është vënë në kontakt me E. për blerjen e një banëse. Më tej shton se pasi që është takuar me E. dhe u janë prezantuar kushtët është pajtuar dhe të njëjtat i ka pranuar dhe për këtë me datë 16.05.2011 ka nënshkruar para kontratë për blerjen e banësës me sipërfaqë prej 100m2 me çmim prej 650 euro metrën katror, dëshmitarja ka deklaruar se të njëjtën ditë ka nënshkruar kontratë edhe bashkëshorti i saj N. P. i lindur me dt..... dhe nr. përsonalpër blerjen e një tjetër banëse me dimensionë dhe kushtë të njëjta. Pas nënshkrimit të para kontratave për dy banësat e dëmtuara thekson se në emër të avansit i janë dhen në dorë 5 mijë euro, ndërsa të nësërmen u janë paguar edhe 15 mijë euro në Raiffesen Bankë në Ilogarinë e firmës V. – O. G.. Dëshmitarja e dëmtuara: M. P. më tej shton se sipas para kontratës afat për dorëzimin e banësave ishtë një vit e gjysmë përkatësisht nëntori i vitit 2012. Pas kësaj datë është intëresuar për banësa, ka kontaktuar E. B. n e cila ju është arsyetuar se ka problem me leje dhe kërkontë shtyrjen e afatit edhe për një vit, po

ashtu më vonë u arsyetohej se ja kanë mbyll rrugën. Pas kësaj ngjarje e dëmtuara thekson se janë shkuar së bashku me bashkëshortën në vend punishtë ku janë parë vetëm themelet e objektit, por prap se prap E. ju jeptë shpres se Objekti do të ndërtohet pasi që gjëja ja ka dhënë një kompanie ndërtimore. Dëshmitarja- e dëmtuara ka shtuar se pasi që panë se banësat nuk po ndërtohen kanë kërkuar nga E.B që tu kthej të hollat, këtë e kanë bërë përmes nënës së saj e cila tani është pensionuar, pasi që E.B është paraburgosur e dëmtuar deklaroi se më nuk kanë kontaktuar me të. Ka kërkuar ti kthehen to hollat në vlerën prej 20 mijë euro me kamat prej momentit të pagesës së të hollave deri në momentin e kthimit,

Dëshmitarja- e dëmtuara: A.V. në deklaratën e dhënë me datë 05.02.2015 në Prokurorin Speciale (PSRK) ndër tjerash është deklaruar se me E.B. është njoftuar në baza shoqërore dhe ka mësuar që E.B po ndërton dhe po shet banësa, me tëj shton se pasi që ka qënë duke punuar në G. dhe pasi që pese koleget e punës së saj më herët kishin nënshkruar para kontrata me E.Bn për blerjen e banësave, e dëmtuara thekson se ka shkuar dhe ka kontaktuar me E.B.n. Dëshmitarja - e dëmtuara: më tëj shton që pas kontaktëve me E. nga e njëjta ju është prezantuar oferta dhe kushtët e blerjes se banësës, dhe pasi që kushtët ishin të volitshme e njëjta shprehet se ka pranuar dhe nënshkruar para kontratën për blerjen e banësës dhe pas nënshkrimit të para- kontratës me datën 13.04.2010 e njëjta i ka paguar 10.000 euro të holla në dorë, ndërsa pjesën tjetër të pagesës pasi të ndërtohet dhe ta pranoj banësën, të filloj me pagE. e këstëve për arsye shëndetësore që E. e ka ditur rastin e saj. Dëshmitarja- e dëmtuara : në fund deklaroi se pas një kohe e ka kontaktuar në zyre fillimisht të K. A. pastaj në breg të diellit, pastaj nuk e ka kontaktuar më, me telefon dI. here E. i ka hapur telefonin dI. here jo, dëshmitarja deklaroi se më pastaj ka shkuar në një bllok të ndërtimit në breg të diellit afër M.t, ku E. i kishtë thën se ky bllok është i saj, mirëpo me sa e di unë ajo kishtë gënjyer.

Pastaj ka qënë jashtë vendit për shërim për një vit, më nuk e ka kontaktuar. Me telefon nga Gj. e ka thirr që tja kthej të hollat pasi që i duheshin për shërim, mirëpo e njëjta .veq e gënjentë. Dëshmitarja- e dëmtuara: në fund deklaroi se kërkoi nga E.B që tja kthen shumen prej 10.000 euro të hollat që ja ka dhënë në dore, plus qiranë për 4 vitë që ka paguar e cila më para kontratë është parapa që tija paguan qiran në vlerë prej 200 euro në muaj, nëse nuk ja dorëzon banësën sipas para kontratës, po ashtu dëshmitarja - e dëmtuara: i bashkëngjitet ndjekjes penale pasi që e njëjta e ka dëmtuar shumë.

Dëshmitari: A.G. në deklaratën e dhënë me datë 16.02.2015 në Prokurorin Speciale (PSRK) ka deklaruar se në bazë të disa kolegeve është njoftuar dhe ka ra në dijeni se E.B po ndërton dhe po shet banësa, dhe është takuar me E. në zyrën e saj të K. A., në zyre ka takuar E. dhe kumatën e saj T. B., po ashtu aty ishin edhe vëllezërit e saj V.i dhe E. B. të cilët herë hyshin herë delnin nga zyra. Pasi takimit që kishtë i dëmtuari me E. ja kishtë prezentuar kushtët për blerjen e banësës, e të cilat të njëjtit i kishin konvnuar dhe të njëjtat i kishtë pranuar. Lidhur me këtë i dëmtuari thekson se pas tri katër ditë është kthyer prapë dhe e ka nënshkruar para kontratën dhe atë me datën 20.12.2012, me para kontratë është paraparë banësa në sipërfaqë prej 71m2, kati i 3, me vlerë prej 46.000 mije euro. Po ashtu me para kontratë është parapa pagesa e qiras në vlerë prej 200 euro prej ditës se mosdorëzimit të banësës deri të dorëzimi i saj. Për këtë të nësërmen me datën 21.12.2010 sipas marrëveshjes nga ana e të dëmtuarit në xhirolllogari të V. - O - G., u janë paguar 15.000 euro, pastaj 516 euro janë paguar me këstë çdo muaj nga 172 euro. Pas kësaj Dëshmitari - i dëmtuari: ka deklaruar se në pranverën e vitit 2011 kishe vërejtur se E. nuk është duke punuar seriozisht në ndërtimin e banësave, kështu që fillimisht e kishtë kontaktuar atë në telefon, pastaj kishtë shkuar në zyre të E. me çrast kishe prishur para kontratën, për këtë E. pranoi dhe për këtë hartoi një shkresë "dokument anulim i para kontratës" i datës 25.06.2011 në të cilin thuhej se do të ja kthej të hollat në lartësi prej 15.600 euro. Në fund i dëmtuari deklaroi se E.

pjesërisht ju ka përmbajt anulimit të kontratës dhe fillimisht këstin e parë ja ka kthyer në vlerë prej 10.000 euro dhe ato të holla në dorë në zyre të saj, pastaj 2000 dhe njëherë 500 euro, gjithashtu edhe këto shuma të kthyera në dorë e të cilat i dëmtuari thekson se menjëherë ka shkuar dhe i ka deponuar në B., çka do të thotë që E. i ka kthyer 12.500 ndërsa e njëjta i ka mbetur borgj edhe 3,100 euro, për këtë i dëmtuari deklaron se kërkon kthimin e mjetëve të mbetura në shumë prej 3.100 euro, me kamat B. are prej momentit të pagesës sere në kthimin e mjetëve, po ashtu kërkon që në emër të para kontratës të kompensohet për pages të qirasë mujore në vlere prej 200 prej momentit të dështimit të dorëzimit e deri me sot, i dëmtuari deklaron se i bashkëngjitem ndjekjes penale kundër të pandehurve si në këtë aktakuzë.

Dëshmitari: A. H. në deklaratën e dhënë me datë 10.02.2015 në Prokurorin Speciale (PSRK) ndër tjerash deklaron se nëpërmjet një shoqë të bashkëshortës së tij a në dijeni se E. po ndërton dhe po shet banësa, i njëjti shton se pasi që ishte i interesuar me ble një banës ka kontaktuar dhe është takuar me E. në zyrën e saj të K. A., në zyre me të ishte një person i cili ishte paraqitur si Arkitekt, por thekson se me sa i kujtohet ai ishte V. i B. vëllai i E.. Me tëj Dëshmitari- i dëmtuari: deklaron se pasi E.B ja kishtë treguar kushtët dhe mundësit, të njëjtit i konvuan dhe të njëjtat i kishtë pranuar, pasi që E. i kishtë sugjeruar që fillimisht të nënshkruaj para kontratën dhe pastaj të shkoj ta beje një pagese në vlerë prej 10.000 euro në xhirollogari të V. O G., i njëjti kishtë vepruar sipas sugjerimit kështu që të njëjtën ditë ja ka transferuar 10.000 euro, po ashtu më vonë ja ka paguar edhe 1700 euro me këstë dhe çdo muaj nga 200 euro përpos që muajin e parë që ka qënë 100 euro, që gjithsej kishtë paguar rreth 11.700 euro, po ashtu me para kontratë është parapa që nëse vonohet në dorëzimin e banësës të njëjtit ti paguaj qiranë në vlerë prej 200 euro për muaj. Gjithashtu dëshmitari - i dëmtuari: deklaron që pas pyetjeve të shumta E. se kur po kryhen banësat nga përgjigjja e saj është vërejtur se nuk është serioze në punë dhe e njëjta është duke bërë vetëm mashtrim, për këtë i dëmtuari ka kërkuar nga E. që të ndërpritët pagesave e këstëve dhe ti kthehen mjetët deri në fund të vitit 2012 nëse nuk bohet banësa, për këtë edhe për kundër premtimit se e njëjta do tia kthej mjetët e njëjta nuk i kishe kthyer asnjë cent të vlerës prej 11.700 euro, përkundër se e njëjta i kishe dhënë deklaratën me shkrim se do ti ja kthen të hollat deri në fund të vitit 2012. Për këtë e dëshmitari- i dëmtuari , kërkon që ti kthehen mjetët në vlerë prej 11.700 euro dhe atë me kamatë të rregullt Bankare, pasi që për këto mjetë ka tërhequr kredi nga Raiffeissen Bankë, qira nuk kërkon pasi që nuk ka paguar, po ashtu i dëmtuari deklaron se i bashkëngjitem ndjekjes penale dhe dëshiron që të dënohet sipas ligjit.

Dëshmitari: A. B. në deklaratën e dhënë me datë 05.02.2015 në Prokurorin Speciale (PSRK) ndër tjerash deklaron se nëpërmes mjetëve të informimit publik është informuar se E.B po ndërton dhe shet banësa, për këtë pasi që ishte i interesuar për një bansë është interesuar ka kontaktuar dhe së bashku me shoqën e tij është takuar me E. në zyrën e saj të K. A. Me tëj dëshmitari shton se në takim me E. i ka shfaq interesimin e tij për blerjen e një banëse, pastaj E. i kishtë paraqitur kushtët dhe mundësit dhe se është duke ndërtuar banësa e ka edhe për shitje, ku çmimi për metër katror do të jetë 650 euro, pas kësaj e njëjta i kishtë sugjeruar që së pari të nënshkruhet para kontrata dhe të bëhet pagesa në shumë prej 10.000 euro në dorë ndërsa çdo muaj nga 200 euro. dëshmitari - i dëmtuari më tëj shton që ka pranuar kushtët e saj duke nënshkruar para- kontratën, një para kontratë thekson se e ka nënshkruar me datën 04.03.2011 ndërsa të dytën para kontratë e ka nënshkruar me datën 17.05.2011, për këtë Dëshmitari shton se pas dy muajve E. e ka thirrur me telefon duke i thënë a po pranon me tu vonua banësa për dy muaj dhe me marr në katin e katërt në vend të asaj që ka qënë në katin e 7, për këtë ofertë deklaron se ka pranuar dhe për ata është nënshkruar para-kontrata e dytë, për blerjen e banësës i dëmtuari deklaron se ka paguar gjithsejtë 13.400 euro, 10.000 euro i ka paguar në dorë, ndërsa 3.400 me këstë çdo muaj nga 200 euro, me parakontratë është parapare nëse banësa nuk punohet me kohë me ju paguar qiranë nga 200 euro deri sa tu jepen qële. e banësës, për vonësat e

dorëzimit të banësës dëshmitari . thekson se disa here e ka kontaktuar E. mirëpo ajo ka marr vetëm premtime. Dëshmitari: në cilësinë e të dëmtuarit kërkon nga E. që ti kthej të hollat e paguara në vlerë prej 13.400 euro, në emër të pagesës së qëras për 30 muaj nga 200 euro = 6000 euro.

Dëshmitari: A. A. në deklaratën e dhënë me datë 23.03.2015 në Prokurorin Speciale (PSRK) ndër tjerash deklaron se përmes shoqërisë ka dëgjuar se E.B ka një kompani që po ndërton dhe po shet banësa me kushtë të volitshme për këtë thekson se pasi që është i interesuar ta blejë një banëse, ka kontaktuar dhe ka shkuar në zyrën e saj afër K. A., pas takimin me E. nga e njëjta ju janë ofruar kushtët, të njëjtat i kanë konvnuar, për këtë ka pranuar të hyj në marrëdhënie kontraktuale, në zyre i dëmtuari thekson se ka kontaktuar vetëm me E. e me askënd tjetër nga stafi i saj, i njëjti thekson sa e di fillimisht E. ka kërkuar që të shkoj dhe të bëjë pagesën në xhirollogarinë personale të saj në vlerë prej 10.000 euro pastaj të kthehet dhe ta nënshkruaj para kontratën, për këtë i njëjti shton se ka vepruar si ka kërkuar E.. Objekti i para kontratës është banësa prej 67 metra katror me vlerë prej 36.850 euro, me para kontratë është parapare që çmimi i mbetur të paguhet me kështë nga 149 euro për 15 vitë. Më tej i dëmtuari shton se sipas kësaj marrëveshje ai ka filluar menjëherë që ti bëjë pagE. e kështëve, kështu që i ka bërë dI. pagesa në vlerë prej 149 euro, e të cilat pagesa arrijnë shumën e përgjithshme prej 12.086 euro, për këto pagesa dëshmohet me konfirmim të transaksionit Bankare.

Në fund Dëshmitari- i dëmtuari: deklaron se pasi që kishtë dëshmuar nga shoqëria se E. B. ka dështuar në ndërtimin e banësave ka kontaktuar E. duke i kërkuar sqarime lidhur me vonësat në dorëzimin e banësës, nga e cila fillimisht kishtë marrë arsye të ndryshme lidhur me pengE. në ndërtim, por pas insistimit të dëmtuarit E.B i kishte kthyer gjysmën e të hollave, pastaj me vonë pas insistimit të të dëmtuarit E. të njëjtit i kishtë kthyer të gjitha të hollat përmes vëllait të saj për të cilin emrin nuk i kujtohet.

Dëshmitari: B. H. H. në deklaratën e dhënë me datë 16.02.2015 në Prokurorin Speciale (PSRK) ndër tjerash deklaron se në bazë të farefisit tim ka dëgjuar se E. ka hap informatën se po ndërton dhe po shet banësa, për këtë thekson se pasi që është i interesuar ta blejë një banëse, ka kontaktuar dhe ka shkuar në zyrën e saj afër K. A., pa takimin me E. nga e njëjta ju janë ofruar kushtët të njëjtat i kanë konvnuar, për këtë ka pranuar të hyj në marrëdhënie kontraktuale, në zyre i dëmtuari thekson se ka kontaktuar vetëm me E. e me askënd tjetër nga stafi i saj, i njëjti thekson se në zyre të saj kishtë qënë edhe një femër që i thoshin tëzja B., ajo kishtë qënë si zyrtare e saj që punontë me letra, pas takimin me E. nga e njëjta ju janë ofruar kushtët e blerjes se banësës, të njëjtat i kanë konvnuar, për këtë ka pranuar të hyj në marrëdhënie kontraktuale dhe me datë 13.05.2013 thekson se ka nënshkruar para kontratë dhe të njëjtën ditë në dore ja kam dhënë 10.000 euro në momentin kur ja ka dorëzuar parat E. prezent me të ka qënë qënë edhe daja tij Sh. P. nga F. B. K. e K. po ashtu shton se në të njëjtën ditë e njëjta i ka dhënë edhe një dokument të nënshkruar nga Notëri S.din Blakaj, duke mos qënë ai fare në zyrën e këtij notëri. Në fund Dëshmitari - i dëmtuari: deklaron se posa i ka paguar të hollat është interesuar për vërtetësin e këtij dokumenti të nënshkruar nga notëri S.din Blakaj, për këtë ka shkuar të avokati i popullit, pastaj shton se ka pranuar thirrje telefonike nga e quajtura tëtja B. duke i thënë mos u ngut se banësa do të bëhet. Dëshmitari- i dëmtuari fare në fund thekson që kërkon nga E. që ti kthej të hollat në vlere prej 10.000 euro dhe atë me kamat të rregullt Bankare prej datës se pagesës gjërë në datën e kthimit, po ashtu kërkon që në emër të qirasë që ti paguan vlerën prej 200 euro për muaj prej ditës që e kam bërë pagesën e gjere me tani, për këtë i njëjti ju bashkëngjitët ndjekjes penale.

Dëshmitari: *B.A. B.i* në deklaratën e dhënë me datë 06.02.2015 në Prokurorin Speciale (PSRK) ndër tjerash deklaroi se prindi i tij është i informuar nga një viktime posi në se E. po ndërton dhe po shet banësa, për këtë së bashku me prindin e tij A. kishin shkuar në P. në lagjen B. i D. në zyrën e E., pasi të njëjtit ishin njoftuar me kushtet e blerjes së banësës, me datën 04.10.2011 ishte nënshkruar para kontratë për blerjen e një banëse në sipërfaqë prej 71 metra katror në çmim prej 46.000.00 mije euro, atë ditë që e ishte nënshkruar parakontratën përmes Bankës E. u janë transferuar 10.000.00 euro në xhirollogarinë e saj personale. Po ashtu i dëmtuari shton se për këtë kanë kontaktuar me E. rregullisht ai dhe prindi i tij ku nga e njëjta kanë marr arsytetime se komuna nuk po na lëshontë lejen e ndërtimit pastaj kompanitë e ndërtimit po vonohen etj. Pas këtyre ngjarjeve u pa se E. ka dështuar e njëjta është kontaktuar dhe pas kontaktëve e njëjta ju kishtë ofruar nënshkruar një Anëks kontratë për kthimin e mjetëve në vlerë prej 10.000.00 euro prej datës 19.07.2012 brenda 90 ditëve, mirëpo sot e kësaj parat nuk u janë kthyer. Në fund Dëshmitari- i dëmtuari deklarohet se kërkon që ti kthehen të hollat në vlerë prej 10.000.00 euro, dhe të gjitha tjerat që i parasheh kontrata e sidomos qiran në vlerë prej 200 euro prej ditës se vonësës së dorëzimit të banësës e gjere me sot, për këtë i njëjti deklaroi se ju bashkanëgjitet ndjekjes penale .

Dëshmitari- i dëmtuari: *D. L. B.* në deklaratën e dhënë me datë 10.03.2015 në Prokurorin Speciale (PSRK) ndër tjerash deklaroi se pasi që me E. jem në fafesisni - atë e ka vajzë të tëzes e njëjta i kishtë treguar se po ndërton dhe po shet banësë, për këtë i dëmtuari thekson se pasi që kisha nëvoj për një banëse, kam shkuar në zyrën e saj në B. të D., nga e njëjta është njoftuar lidhur me kushtet e blerjes së një banësë. Pasi që kushtet i kishin konvencuan vendosa që ta blejë një banësë nga E.. Më tej i dëmtuari shton se pasi që i kanë konvencuar kushtet nënshkrua para kontratën me datë 02.07.2011, për këtë me datën 04.07.2011, u janë transferuar i transferova në xhirollogarinë e V. O G. shuma prej 15.000 euro, me këtë parakontratë është parapa që ta blehej banësa në vendin Lagja M. .. Kati i 2 me sipërfaqë me 71 metra katror me çmim prej 46.000 euro, me afat të dorëzimit mbas një viti, në qoftë se nuk bëhet pranim dorëzimi në afatin e paraparë atëherë të paguhet qiraja në vlerë prej 200 euro. Dëshmitari- i dëmtuari: shton se megjithatë shtyrjet e dorëzimit të banësës ka qëndruar në pritje duke shpresuar që E. të ja dorëzoj çelësat e banësës, pastaj më në fund ka dëgjuar se e njëjta është paraburgosur i kam humbur shprE. që do ta dorëzoj banësën, lidhur me këtë i dëmtuari në fund shton se as nuk ka kërkuar as familjaret e E. nuk i kanë kthyer asnjë cent nga 15.000 euro që i ka paguar në emër të banësës, andaj nga pozita e të dëmtuarit kërkoj që ti kthehet vetëm borgjin bazë në vlerë prej 15.000 euro. Nuk kërkoj asgjë tjetër.

Dëshmitari: *F. Z.* në deklaratën e dhënë me datë 06.02.2015 në Prokurorin Speciale (PSRK) ndër tjerash deklaroi se rastësisht në B. e D. e ka par firmën e kompanisë ndërtimore V. O G., ku ka hyrë në zyre të kompanis dhe ka takuar E. B.n, në bised e sipër e njëjta i ka treguar se bën ndërtimin dhe shitjen e banësave, kushtet e blerjes së banësës, më tej shton se pas një muaji të takimit prap ka hulumtuar tregun e banësave dhe ka vrejtur se e njëjta i ka kushtet më të volitshme për blerjen e banësës kështu që me datën 23.01.2010 i dëmtuari thekson se ka nënshkruar para kontratën në sipërfaqë prej 71 metra katrore me çmim prej rreth 33.000,00 euro, Pasi e ka nënshkruar para kontratën menjëherë në të njëjtën ditë përmes Bankës Raiffeissen i ka transferu E. 3000 euro, ndërsa menjëherë ka filuar me pagu me këstë mujore nga 250 euro, kështu që E. gjithsej ja ka paguar 14.500.00 euro. Dëshmitari: ndërkohë pasi ka vërejt se E. nuk është angazhuar rreth ndërtimit të banësave të njëjtën e ka kontaktuar edhe në zyre drejtpërdrejtë edhe në telefon, ajo përherë përgjigjej se do ti ndërtoj banësat, por pasi që i dëmtuari ka vërejt se blloku i parë që ka filluar me banësa është shitur dhe nuk ka aty banës për të, e ka takuar E. dhe me të me datën 11.01.2012, ka nënshkruar prap një para kontratë për një banësë në objektin tjetër që posa ka filluar tani banësa, thekson se banësa ishte 85 metra katror dhe totali i vlerës se

banësës është 41.000.00 euro. Ai Objekt prej atëherë gjerë me tani është vetëm pllaka e pare mbi tokë, i dëmtuari shton se prapë e ka kontaktuar E. mirëpo e njëjta nuk na ka dhënë përgjigje, me para kontratë është parapa që E. të paguaj qiranë në vlere prej 300 euro. Prej ditës kur ka pas me na dorëzuar banësën e gjerë në dorëzimin e banësës, për këtë ka nënshkruar deklaratë dhe ka vërtetuar në gjykatën komunale Graçanic me datën 18.03.2013, i njëjti në cilësin dëshmitari- i dëmtuari : kërkon që vlerën orej 14.500.00 euro pa kamatë e asgjë tjetër prej saj, çka do të thotë se vetëm ato që ja kam dhënë.

Dëshmitarja: *F. A. i* në deklaratën e dhënë me datë 25.03.2015 në Prokurorin Speciale (PSRK) ndër tëjerash deklaron se: Po motra ime M. A. G. e cila është e martuar për . B. G. tani J. në B. prej vitit, në vitin 2010 kur ka ardhur në pushim vjetor ka dëgjuar se E.B po ndërton dhe po shet banësa me kushtë të favorshme. Pasi që ishte e interesuar për një banësë ajo ka kontaktuar E.Bn dhe me datën 08.09.2010 ka nënshkruar para kontratën për blerjen e një banëse në sipërfaqë prej 65 metra katror kati i dytë me çmim prej 39.000 euro. Pas nënshkrimit të para kontratës me të njëjtën datë motra ime ja ka paguar përmes P.C. B. 8000 euro në emër të vlerës se banësës. Po ashtu me datën 10.09.2010 ka paguar edhe 2000 euro, që gjithsejtë 10.000 euro. Pasi që në kontratë pagesa të behet me kështë, kështu që motra ka filluar prej datës 01.11.2010 e gjer me 25.09.2011 ku ka paguar gjithsejtë 11 kështë në vlere nga 161 euro. Që gjithsejt janë në shume prej 1771 euro plus 10.000 euro që i pa paguar me herët ku gjithsejt ka paguar 11.771 euro. Pasi që E. B. ka dështuar që të ndërtoj dhe fia dorëztoj motrës banësën e që motra përkohësisht J. siç thash me lart jashtë vendit. Me ka lutur dhe kërkuar nga unë që të prezantoj në këtë zyre të tregoj në emër të saj se si ka rrjedhur ngjarja rreth banësës. Motra gjithashtu mi ka dërguar dokumentacionin komplet që unë tani jua dorëztoj. Dëshmitarja shton se pasi që motra e saj ka vërejtë se E. ka dështuar në dorëzimin e banësës, e njëjta ka kërkuar që t'ja kthej të hollat E., pas shume premtimeve E. nuk ja ka kthyer asnjë cent. Për mos përmbushje të kontratës motra me datën 23.11.2012 ka deponuar padinë për kompensimi të dëmit pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Po ashtu dëshmitarja: deklaron se me E. ka nënshkruar para kontratë për blerjen e banësës, vajza saj A. dhe dhënëdri V. D. këta dytë kanë paguar me sa e di unë 12.000 euro as nuk kanë marrë banëse as nuk ju ka kthyer asnjë cent, gjithashtu vjehërria e vajzës A., H. D. ka nënshkruar para kontratë për banësë dhe ka paguar me duket rreth 10.000 euro, Parakontrat ka nënshkruar gjithashtu edhe motra ime L.A. B. se bashku me bashkëshortin e saj I.k B. kanë lidhur para kontratë dhe ka paguar shume prej 11.416 euro.

Dëshmitari: G. M. në deklaratën e dhënë me datë 05.02.2015 në Prokurorin Speciale (PSRK) ndër tëjerash deklaron se: nje shok i tij kishtë treguar lidhur me ofertën e blerjes së banësës nga E.B, i njëjti deklaron se për këtë ka kontaktuar dhe gjetur e saj në zyre afër K. A., i njëjti shton se që në ditën e parë me të dyshova se nuk është e sinqërtë dhe nuk bona kontratë, mirëpo pas dy tri ditë ka shkuar dhe ka kërkuar nga E. që ta kontraktoj një banës në katin e katër, e njëjta e kishtë bindur duke i thanë që nuk do të me mashtroje, për këtë me datën 17.01.2010 ka nënshkruar para- kontratën me të cilën ka blerë banësën në sipërfaqë prej 71 metra katrore me vlerë 46.150,00 euro, të njëjtën ditë përmes Ilogarisë banakare të V. - O – G.it ja kam transferuar deponuar 10.000 euro, dhe pasi që hy në banës ka qënë marrëveshja t'ja paguaj për 180 muaj rwa 250 euro, me para kontratë është parapa që çelësat mu dorëzuar për një vit. Dëshmitari më tej shton se pasi ka dëgjuar se E. ka falimentuar me të njëjtën me datën 17.08.2011 ka nënshkruar deklarata që për 90 ditë të i'a kthej 10.000 euro, por përkundër deklaratës se nënshkruar ajo sot e kësaj ditë nuk i ka kthyer asnjë cent dhe se të njëjtën e ka kontaktuar mbi 100 herë në telefon, si i dëmtuar kërkon që E. të ja kthej të hollat prej 10.000 euro, dhe shton se i bashkëngjitesh ndjekjes penale.

Dëshmitari i dëmtuari: *G. Xh. H.i* në deklaratën e dhënë me datë 12.02.2015 në Prokurorin Speciale (PSRK) ndër të tjerash deklaroi se: përmes një kolege ka ra në dijeni se E.B po ndërton dhe po shet banësa, po ashtu ka qënë një informatë në mesin e punëtoreve të Raiffeissen Bankës që E. po ndërton dhe po shet banësa, i dëmtuari thekson se pasi që ishte i interesuar për një banëse ka kërkuar dhe e gjetur zyrën e E. tëk kino A., më tej shton se në zyre ka shkuar me Xh. që edhe ajo me parë ka punuar në Raiffeissen Bankë, gjatë bisedës E. e njëjta i ka treguar kushtët për blerjen e banësës, e të cilat kushtë i kanë pëlqyer pasi që ishin të favorshme, për këtë thekson se ka nënshkruar para kontratën dhe atë me datën 01.04.2010, për cilën të njëjtën ditë nga Raiffeissen Bankë., ku ka qënë duke punuar, nga Ilogaria personale i ka transferuar shumën prej 10.000 euro në Ilogari të E., po ashtu menjëherë pas një muaji ka filluar nga 150 euro çdo muaj t'ja paguaj që gjithsej t'ia paguaj 1500 euro, e gjithsejtë i ka paguar 11.500 euro, më tej Dëshmitari i dëmtuari: shton se pasi që e ka vërejtur që E. ka dështuar në ngritjen e banësave me vështërsi e kishtë takuar një herë ku e njëjta i kishtë: thënë se banësat do bëhen prap, por mos me ngutë, i njëjti thekson që e kishtë vërejtur se njëjta ka dështuar, për këtë i kishtë thënë se do ta prish parakontratën pasi që ka bler një banës tjetër vendë, po ashtu në kërkesën për prishjen e parakontratës E.B i kishtë thënë se do ti kthej parat por der më tani e njëjta nuk i ka kthyer as një cent, për këtë dëshmitari i dëmtuari: deklarohet se kërkon që E.B të ja kthej të hollat prej 1500 euro me kamat të rregullt Bankare, po ashtu në emër të qiras kërkon që ti kthehen nga 200 euro prej muajit Qërshor 2011 e gjerë në janar të vitit 2015 pasi që ka dalur tani në banësën e tijë, po ashtu shton se ibashkanëgjitet ndjekjes penale.

Dëshmitari: *I. Rr. G.* në deklaratën e dhënë me datë 23.03.2015 në Prokurorin Speciale (PSRK) ndër të tjerash deklaroi se: përmes vëllait të E. E. B.t është njoftuar se E. po ndërton dhe po shet banësa, më tej dëshmitari thekson se pasi që ishte i interesuar për ta blerë një banëse ka shkuar dhe ka kontaktuar me E., për kundër faktit se po ashtu nga E.B. ishte njoftuar me kushtët e banësës në detale dhe po thuaj me të janë marrë vesh për kushtët e banësës, për këtë dëshmitari shton se ka nënshkruar para kontratë, pastaj ka shkuar në B.ë dhe i ka transferuar 5000 euro në xhirollogari personale të E., pastaj sipas marrëveshjes i ka paguar me këstë nga 250 euro që gjithsej 3.500 euro, këtë shumë të fundit thekson se e paguar bashkëshortja e tij L.K.G. Përmes Raiffeissen Bankës që gjithsej i kemi paguar 8.250euro. Më tej Dëshmitari- i dëmtuari: shton pasi që ka vërejtur se E. ka dështuar në ndërtimin dhe dorëzimin e banësave, ka kontaktuar E. dhe E. pasi që prej fillimit me E. ka qënë në kontakt me ta, me qëllim që ta prishi kontratën dhe të njëjtit të bëjn kthimin e parave të paguara për blerjen e banësës, i dëmtuari thekson se pas shumë përpjekjeve dhe maltretimeve E. dhe E. i kanë kthyer 3.500 euro në dorë, çka do të thotë se borgj të njëjtit i kanë mbetur edhe 4.750 euro. Dëshmitari- i dëmtuari në fund deklaroi se kërkon nga E.B që të ja kthej shumën prej 4.750 me kamat Bankare prej momentit të dorëzimit të banësës e deri në momentin e kthimit, edhe pse ishte parapa me parakontrat në emër të qiras e njëjta ti paguaj nuk ka paguar as nuk po kërkon asgjë për këtë, njëherit deklaroi se i bashkanëgjitet ndjekjes penale.

Dëshmitari- i dëmtuari: *I. H. H.* në deklaratën e dhënë me datë 10.02.2015 në Prokurorin Speciale (PSRK) ndër të tjerash deklaroi se: nëpërmes kolege është njoftuar që E.B po ndërton dhe shet banësa, për këtë dëshmitari thekson se pasi që ka qënë i interesuar për ta blerë një banëse ka shkuar dhe ka biseduar me E. në zyrën e saj tëk K. A., aty nga E. ju ishte paraqitur oferta dhe kushtët për blerjen e banësës e të cilat kushtë i kishin pëlqyer dhe pas tri ditë me datë 11.03.2011 ishte nënshkruar para kontrata për blerjen e banësës, në sipërfaqë prej 71 m², kati V në vlerë të përgjithshme prej 45.000 euro me qrastë 9.900 euro të nësërmen u janë paguar në xhirollogarinë e kompanisë V. - o - G., 100 euro u janë paguar kesh në dorë, po ashtu me datë 06.04.2011 përmes Raiffesen Bankës u janë paguar edhe 5.000 euro dhe po ashtu edhe një këst mujor në

vlerë prej 166 euro, më tej i dëmtuari deklaroi se ka shkuar në vend punishtën ku ishte e paraparë ndërtimi i objektit banësor dhe kishtë parë se aty ishte duke u ndërtuar Objekti në katin e V, mirëpo pas një kohe ishte kontaktuar nga E. e cila i kishtë thënë që të bëj edhe një para kontrat për ndërrimin e objektit banësor, gjë për të cilën nuk ka rënë dakord pasi që kishtë vërtetuar se e njëjta nuk është serioze. Dëshmitari- i dëmtuari më tej deklaroi se pasi që ka vërejtë se E. ka dështuar në ndërtimin dhe dorëzimin e banësave, të njëjtën e ka kontaktuar si E. dhe E. pasi që prej fillimit me E., kontaktin e ka bërë me qëllim që ta prishi para kontratën dhe të ja kthej të hollat, dhe në fund pas shume përpjekjeve dhe maltretimeve E. dhe E. ja kanë kthyer 3500 euro në dorë, çka do të thotë se borgji i kanë mbetur edhe 4.750 euro, për këtë shton se i bashkëngjitet ndjekjes penale.

Dëshmitari i dëmtuari: *L.B.* në deklaratën e dhënë me datë 09.02.2015 në Prokurorin Speciale (PSRK) ndër të tjerash deklaroi se: përmes disa kolegeve të punës ka ra në dijeni se E.B po ndërton dhe po shet banësa, me kushtë të volitshme, për këtë thekson se pasi kisha nevojë për një banës e ka kontaktuar dhe ka biseduar me E. në zyrën e saj tek K. A., me tej shton se në zyre të saj aty ka parë përpos E. dhe dy vëllezërit e saj dhe kunatën, (nusia e V.it) V.in dhe E. i kam njohur pasi që të dytë kanë pasur dasmën në hotel V. ku kishtë punuar më parë, në zyre thekson se ka komunikuar vetëm me E., ndërsa vëllezërit e saj dhe kunata punojshin me letra dhe më në fund pasi u arrit marrëveshja V.i i kishtë dërguar deri tek pllaci ku kinse u ndertojshin banësat, tek vendi kur ka shkuar ka parë vetëm një grop e temelit me pas ish ndërtua dikund 2 kat.Dëshmitari i dëmtuari: shton se pasi që i konvencuan kushtët me të njëjtën me datë 01.02.2010 ka nënshkruar para-kontratën për blerjen e banësës në sipërfaqë 70 metra katror, me çmim prej 42.000.00 euro, atë ditë thekson se nuk ka paguar asgjë, mirëpo të nësërmen ja ka paguar në xhirollogari personale të E., 2.000 euro, më pastaj pas 1 muaji edhe 1500 euro ja ka paguar në të njëjtën xhirollogari, pastaj përafërsisht mbas 2 muajve E. në dorë ja ka dhënë edhe 3.700 euro, nga E. me rastin e dhënies së të hollave nga i dëmtuari nuk i është lëshuar dokument apo dëftëse, si vërtëtim mbi pagesën e të hollave. Në fundë i dëmtuari - dëshmitari deklaroi se pasi që ka vërtetuar se E.B po dështon në ngritjen e banësave ka kërkuar nga ajo që ta prishi parakontratën, nga e njëjta ajo është kërcënuar se nëse e prishi kontratën do të humb rreth 30% të shumës së deponuar, dhe pas prishjes se para kontratës E. i ka kthyer 3.700 euro nga pak nga pak, ndërsa 3.500 euro tjera që i'a ka paguar me B.e nuk i ka kthyer asnjë cent, po ashtu shton se E. i ka lëshuar një deklaratë që të hollat do të mi kthej me datën 31.01.2012, gjë që ende nuk janë kthyer, më tej kërkon nga E. që ti kthej të hollat që mi ka marrë në vlerë prej 3.500 euro, njëherit deklaroi se i bashkëngjitet ndjekjes penale.

Dëshmitari i dëmtuari: *L. E.* në deklaratën e dhënë me datë 16.03.2015 në Prokurorin Speciale (PSRK) ndër të tjerash deklaroi se: në vitin 2009 nga shoku i tij S.i me të cilin ka raportë të mira e i cili punon në Auto clinic garazha në B., është njoftuar se E.B po ndërton dhe po shet banësa me çmime të volitshëm, dhe për këtë shton se pai që ishte i interesuar për ta blerë një banëse, se bashku me S.in ka shkuar në zyrën e E. në B. të D., aty pasi që nga E. ishte njoftuar për kushtët, të njëjtat i konvencuan për të cilat kushtë ka pranuar dhe ka hyr në marrëdhënie kontraktuale për blerjen e një banëse, atë ditë thekson se nuk ka nënshkruar para kontratë, mirëpo di. ditë më vonë respektivisht me datën 30.12.2009 ka nënshkruar para kontratën për blerjen e një banëse në sipërfaqë prej 67 metra katror në çmim prej 33.000 euro në kushtë si në parakontrat, pas nënshkrimit të para kontratës E. i ka dhënë kesh në dorë 4.000 euro në emër të avansit, dhe kjo vlerë është çekur në nënin 5 të para kontratës, në zyre kur ka shkuar me S.in kishtë takuar vetëm E., edhe pse nuk i ka takuar E. ka thënë që bashkëpunon me dy vëllezër dhe me kunatën. Më tej dëshmitari deklaroi se përafërsisht pas dy vitë kishtë llogaritur se E. nuk është në gjendje me i ndërtuar banësat, për këtë ka kontaktuar me të me qëllim që ta prishi parakontratën dhe ti tërheqi të hollat e paguara nga ajo, por pasi që ka kontaktuar e njëjta i kishtë thënë se ka marrë një lokacion

të ri për një kompleks të ri prej 4 blloqeve ku njeri prej tyre është i policisë, nga kjo bisede është bind që të hy në kontratë për dy banësa në blloqë të reja dhe të prishi para kontratën e mëhershme që ka qënë për tjetër bllok dhe lokacion tjetër, krejt kjo kishe ndodhur me datë 29.02.2012, pasi që ishin nënshkruar dy para kontrata tani përmes Bankës Raiffeissen u janë paguar 6.000 euro, në të njëjtën datën nëpërmjet TEB Bankës 5.000, 4000 euro kanë mbet prej para kontratës se parë dhe 9.000 euro u janë dhënë kesh në dorë, për çka E. ju ka lëshuar deklaratën e vertëtuar në Gjykatën Themelore në Graçanic kështu që gjithsej janë paguar 24.000 euro, e ku njëra banesë - parakontrat thekson në emër të bashkëshortës të të dëmtuarit M. S. E. ndërsa tjetra në emrin e të dëmtuarit, e ku - për banesën tij ka paguar 10.000 euro ndërsa për banesën e bashkëshortës M. ka paguar 14.000 euro, e për të cilat parakontrat banesat kanë pasur me u dorëzua në shtator të vitit 2012, po ashtu me para kontratë është paraparë që nëse banesat nuk dorëzohen me kohë të paguahet qiraja në vlerë prej 200 euro për banesë deri sa të mos dorëzohen banesat. Dëshmitari - i dëmtuari: thekson se prej momentit që ka pasur me na dorëzuar çelësat prej shtator 2012 gjerë në janar të 2014 sa herë që e ka kontaktuar E. ajo ju ka premtuar që do kryhen banesat dhe juve të pareve do të ua dhe çelë. pasi që ju kam të mit, por kur është vërejt se e njëjta ka dështuar në tërësi nga në është kërkuar që ta prishen parakontratat dhe të na kthen të hollat dhe atë pjesën e qirasë të paraparë me parakontrat, kjo gjë ka ndodhur në janar të vitit 2014, por gjithëherë e njëjta u arsyetontë se parakontratat janë të shkëputura por është duke ndërruar zyrën dhe s'po punon kompjuteri etj, ndërsa të holla ka thënë se nuk ka mundësi që mia kthej që të gjitha menjëherë mirëpo me kështë ku gjer me tani e njëjta nuk ju ka kthyer asnjë cent. Në fund Dëshmitari- i dëmtuari : deklaron se kërkon që të kthehen të hollat në vlerë prej 24.000 euro, po ashtu kërkon nga 200 euro për muaj për mos pagesën e qirasë prej momentit që ka dështuar në dorëzimin e banesës e gjerë me sot, po ashtu kërkon nga E. edhe 2.500 euro që ja ka dhënë në emër të borgjit në shtator të vitit 2013 të cilat ja kishtë kërkuar duke u betuar në prind se do të mi kthej për tri ditë, me arsyetimin siç thoshtë ajo po i nevojiten me deblloku xhirologarinë, të njëjtat para ja kishtë dhënë në parkingun e banesës në kodrën e diellit dhe besoj që nuk e kontëstaton këtë fakt, e ku vlera totale që i është dhënë E. e që kërkon që të u kthej arrin shumën prej 26.500 euro, për të gjitha këto i dëmtuari shton se i bashkanëgjiten ndjekjes penale.

Dëshmitari i dëmtuari: *M. L. i M.* në deklaratën e dhënë me datë 06.02.2015 në Prokurorin Speciale (PSRK) ndër të tjerash deklaron se: në vitin 2009 një shok i imi që unë kam raportë të mira S.i i cili punon në Auto clinic garazha në B., me ka njoftuar se E. po ndërton dhe po shet banësa me çmim të volitshëm. Pasi që isha i interesuar për ta siguruar një banesë. Unë se bashku me S.in shkova në zyrën e saj në B. të D.. Pasi që me njoftoi për kushtët, mua më konvuan ato kushtët dhe pranova që të hy në marrëdhënie kontraktuale për blerjen e një banesë. Unë atë ditë nuk kam nënshkruar kontratë, mirëpo disa ditë më vonë respektivisht me datën 30.12.2009 kam nënshkruar para kontratën për blerjen e një banesë në sipërfaqë prej 67 metra katror në çmim prej 33.000 euro në kushtë si në kontratë. Pas nënshkrimit të para kontratës ja kam dhënë kesh në dorë 4.000 euro në emër të avansit. Kjo vlerë është cekur në nënin 5 të para kontratës. Kur kam shkuar në zyre me S.in kam takuar vetëm E.. Edhe pse nuk i kam takuar E. ka thënë që bashkëpunon me dy vëllezër dhe me kunatën.

Dëshmitari: *M. S.* në deklaratën e dhënë me datë 16.02.2015 në Prokurorin Speciale (PSRK) ndër të tjerash deklaron se: nëpërmjet të miqve dhe fafesisit ka ra në dijeni se E.B po ndërton dhe po shet banësa, për këtë shton se pasi që ka qënë i interesuar për blerjen e një banesë ka kontaktuar E. të cilën e ka takuar në zyrën e saj të H. G., në zyrën e saj ishte edhe vëllain e saj - V.i, po ashtu aty ishte edhe B.i, me tëj thekson se me B.in ka shkuar në Bankë dhe e ka bërë pagesën, para se me nënshkruar parakontratën, po ashtu me B.in ka qënë të pllaci ku kishin filluar banesat dhe në atë fazë aty kishtë qënë vetëm themeli i gërryer, për këtë me datën 24.02.2012 pasi është nënshkruar parakontrat në Raiffeissen Bankë së bashku me B.in dhe ja ka paguar

shumën prej 8000 euro, po ashtu me vonë i ka paguar edhe dy këstë prej 154 euro, e që gjithësejt arrin vlerën e pagesës prej 8.308 euro. Me para kontratë ishte parapare që ta blihej një banës me sipërfaqë prej 55 metra me çmim prej 650 euro për metër katror, në katin e katërt, po ashtu me para kontratë është paraparë që nëse vonohet në dorëzimin e banësës E. të mi paguaj nga 200 euro për muaj të emër të qirasë, prej ditës që duhet të merret banësa. Më tej i dëmtuari shton se përpos V.it dhe E. që i kam parë në zyre të E. T. nuk e ka parë asnjëherë dhe as që ka dëgjuar asnjëherë për të. Dëshmitari- i dëmtuari: në fundë deklaron pasi ka skaduar afati i dorëzimit të banësës e kishtë telefonuar E. shpesh duke u interesuar për banëse, e njëjta gjithmonë u arsyetojke për pengE. në ndërtimin e objektive dhe për atë nuk po mundet të ja dorzontë banësën, por pasi e kishtë kuptuar se E. definitivisht ka dështuar në ndërtimin e banësave dy here është takuar me të në katër sy, e cilia i kishtë thënë se të hollat do t'i kthej nga 1.000 euro për çdo muaj, mirëpo prej sot e asaj ditë nuk i është kthyer asnjë cent prej shumës që ja kam dhënë në vlere prej 8.308 euro, për këtë i dëmtuari kërkon që E. të ja kthej të hollat që ja ka dhënë në vlere prej 8.308 euro, dhe atë me kamat Bankare nga dita e pagesës deri në ditën e kthimit, po ashtu kërkon që ti paguhen në emër të qiras nga muaji maj 2013 e këndeje, shuma në vlerë prej 200 euro për muaj, nëherit deklaron se i bashkanëgjitet ndjekjes penale.

Dëshmitari - i dëmtuari: *N. Ll.* në deklaratën e dhënë me datë 12.02.2015 në Prokurorin Speciale (PSRK) ndër të tjerash deklaron se: përmes një familjari është njoftuar se E. po ndërton dhe po shet banësa, i cili kishtë shkuar në punëtorin tij se bashku me E., e njëjta pasi që i kishtë treguar kushtët, e të cilat ishin të favorshme thekson që kishtë vendosur që ta blejë një banësë nga E., për këtë me datën 25.09.2009 deklaron se ka nënshkruar para kontratën për blerjen e një banëse në sipërfaqë prej 67 metra katror Objekti A3 në çmim prej 500 euro për metër katror, atë ditë që është nënshkruar kontrata apo të e nësërmen i kishtë dhënë në dorë 10.000.00 euro në prezencën e farefisit tim S. S. dhe zyrtarit të E. B. V.t, kjo kishtë ndodhur në B. në punëtori të S.i, të njëjtën ditë E. i dëmtuari thekson që i ka dhënë edhe një automjet Hyundai trajekt të cilin e këna vlerësuar se bashku 10.000.00 euro, të hollat në vlerë prej 10.000.00 euro dhe automjetin Hyundai ja kishtë dorëzuar B.V.t, me E. shton se janë marr vesh që paret ti dorëzoj të S.i në punëtorin e tij në B., ndërsa me datën 31.12.2009 përmes banës ja ka paguar edhe 5.000 euro. Në fundë dëshmitari- i dëmtuari: shton se kur e kishtë vrejtur që E. ka dështuar në ndërtimin e banësave ka filluar që tja kërkoj të hollat, dhe për këtë kanë prish parakontratën me marrëveshje, për të cilën E. kishtë marrur obligim që paret mbrenda 3 muaj të ja kthentë, por prap pas tre muajve kërkontë që ti shtyhej afati, andaj nga E. kërkon që të ja kthej shumën prej 25.000.00 euro pa kamat.

Dëshmitari: *Q.B.* në deklaratën e dhënë me datë 25.02.2015 në Prokurorin Speciale (PSRK) ndër të tjerash deklaron se: nëpërmes disa shokëve është njoftuar që E.B po ndërton banësa për polic, më tej shton se pasi që kishtë nëvojë për banësë është interesuar dhe ka kontaktuar në zyrën e saj E. në B.të D., në bisedë me të e njëjta e kishtë informuar për kushtët se si po i ndërton - shet banësat, oferta e saj fillimisht ishte me dhënë 10.000,00€ për banësë, pastaj me fillua me këstë mujore me e pagua banësën, për këtë dëshmitari thekson se nuk ka filluar dhe nuk ka pagua asnjë cent me këstë, pasi që fillimisht janë marrë vesh me E. mos të paguaj deri sa të hy në banësë, po ashtu shton se pasi që i konvenonin kushtë nga E. ka pranuar që të nënshkruaj para-kontratën për blerjen e një banëse, kjo ka ndodhur në dhjetor të vitit 2010, pasi që e ka nënshkruar par kontratën thekson se ka qënë i obliguar që të i ja paguaj 10.000,00€ E., parat ja kishtë dhënë ditën e nënshkrimit të parakontratës në dorë E., për këtë e njëjta nuk i kishtë dhënë dëshmi apo dëftës lidhur me pagesën e bërë, dhe nuk i ka kthyer as një cent. Gjithasht dëshmitari: deklaron se pasi që vëllezërit e tij J. B. dhe R. B., ishin informuar se kam kontraktuar një banësë në P. edhe ata u interesuar dhe hynë në marrëdhënë kontraktuale për mes meje, përarsye që vllau i madhi J. punon dhe jelon përkohësisht në A.. Me rastin e lëshimit të parakontratës që të dy vëllezërit kanë paguar nga 10.000,00€ po ashtu pagesa është bërë në dorë, mirëpo për dy vëllezërit E. ka

vërtetuar nga një deklaratë në Gjykatën e Graçanicës se i ka marrë të hollat nga vëllezërit e tij, të njëjtëve nuk ju është ka kthyer as një cent, për kundrazi kur u dashtë me prishë parakontratat e vëllezërve me E.ë njëjta ka kërkuar 3.000,00€ gjoja se po i vyn shumë, për këtë i dëmtuari shton se i ja ka dhënë 3.000.00€ dhe më nuk ju kanë kthyer as këto para as parat e banësave, ku gjithsejtë bëjnë 33.000,00€ për banësen e tij dhe të vëllezërve të tij. Në fund dëshmitari - i dëmtuari deklaron se po kërkon që 33.000,00 € në emër të borgjit kryesor, në emër të qirasë pas një viti të nënshkruarit të kontratës e gjer më tani me vlerë prej 200€ në muaj, sipas parakontratës për të tret si të dëmtuar edhe atë me kamatë të rregullt Bankare prej momentit të pagesës deri në kthimin definitiv të të hollave, me çka thekson se i bashkëngjiten ndjekjes penale.

Dëshmitari i dëmtuari: *R. S.* në deklaratën e dhënë me datë 13.02.2015 në Prokurorin Speciale (PSRK) ndër të tjerash deklaron se: në kontakt me E. ka ra në bazë të S. Z. i cili është mik i dhënëdrin e tij, i cili i kishtë treguar se E.B po ndërton dhe po shet banësa, për këtë i dëmtuari shton se pasi që është i interesuar për blerjen e një banëse ka kontaktuar dhe për herë të parë me E. është takuar në restorantin B., ku është së bashku me dhënëdrin e tij B.V. dhe E., në aëe takim E. i kishtë prezantuar ofertën lidhur me kushtet për blerjen e banësës, të cilat kushtë shprehet si i kanë konvnuar dhe për këtë ka rënë dakord që ta blejë një banëse, kështu që pas dy ditë prap janë marrë vesh që në B. të nënshkruajmë dhe ta marrim parakontratën për shitblerjen e banësës e kjo ka ndodhur me datën 14.08.2009, në këtë ditë prezent ishin, S. Z., ndërsa E. është vetun. I dëmtuari më tej deklaron se për këtë para se me u nënshkruar parakontrata ai E. i ka ofruar kerrin Volvo XC 19 i vitit 2004 me regjistrim të Zvicrës në vlerë prej 19.000.00 euro, i cilin automjet është blere në vlerë prej 30.000.00 franga, e cilia e kishtë pranuar këtë ofert dhe të njëten ditë iu është dorëzuar automjeti E., krejt kjo punë sipas referencës se B.V.t, pas një kohe i dëmtuari thekson se kishtë par B.in me kerrin që ja ka dhënë E. duke drejtuar. Po ashtu i dëmtuar deklaron se me datën 03.02.2010 E. i ka paguar edhe 3.000 euro nëpërmjet Bankës Zvicrranë, tjetër pagese nuk i kishtë bërë, ku e njëjta kishtë marr për obligim që banësen me sipërfaqë prej 60 metra katror me çmim prej 650 euro metra katror të ma dorëzoj mbas një viti. Në fund i dëmtuari deklaron se B.V. ka qënë përsone kryesor që ka arrit me nënshkruar këtë parakontratë, ngase me të e ka bërë nëgociata edhe çmimin e banësës dhe për vlerësimin e automjetit, në cilësin e dëshmitari, të dëmtuari kërkon që E. ti kthej të hollat në vlerë prej 22.000.00 euro dhe atë kamat prej ditës se marrjes - pagesës e gjerë në kthimin definitiv. Po ashtu pranoj që e njëjta të ma japi ndonjë banëse me kusht që mia paguaj ndryshimin.

Dëshmitarja e dëmtuara: *Sh. P. H.* në deklaratën e dhënë me datë 16.04.2015 në Prokurorin Speciale (PSRK) ndër të tjerash deklaron se: përmes lidhjeve shoqërore dhe fafëfisnore kishtë dëgjuar se E.B po ndërton dhe po shet banësa me kushtë të volitshme, më tej shton se pai që kishtë nëvoj për një banëse kishtë kontaktuar me E. në zyrën e saj afër kinos A., nga e cila është njoftuar me kushtet e ofertës për blerjen e banësës ku të njëjtat kushtë i konvnuan dhe për këtë kishtë vendosur që të hyjë në marrëveshje për blerjen e banësës në vlerë prej 46 mije euro, me sipërfaqë prej 71 metra katror kati 6 / Al, me para kontratën numr: 96/9 e datës 13.12.2010 ishin paraparë kushtet e pagesës dhe marrjen e çelsave të banësës, po ashtu është parapa që banësa ti dorëzohj për 12/15 muaj prej lëshimit të parakontratës, nëse nuk arrin ta dorëzoj banësen brenda kësaj kohe, e njëjta ta paguaj qiranë në vlerë prej 200 euro deri në mos dorëzimin e çelsave. E dëmtuara më tej deklaron se para se të nënshkruaj parakontratë fillimisht ka shkuar me bashkëshortin dhe me V.Bn në vendin ku është duke u ndërton banësa, pastaj janë kthyer dhe brenda javës e ka nënshkruar para kontratën edhe fillimisht ja ka paguar 8.000 mijë euro, ndërsa 2.000 mije euro i kam paguar me datën 28.12.2010, pastaj në mars të vitit 2011 ka startuar me pagesën e këstit mujor nga 200 euro, çka do të thotë se E.Bt në emër të blerjes së banësës i ka paguar 12.200 euro. Dëshmitarja — e dëmtuara thekson që pasi që kishtë vërtetur që E.B ka dështuar në ndërtimin e banësave kishtë kërkuar prishjen e parakontratës dhe kthimin e të

hollave, e cila fillimisht kishtë reaguuar duke premtuar se do ti ndërtoj banësat dhe do tua dorëzoj me disa arsye ta kota, por e dëmtuara thekson se ajo kishtë insistuar ta prishi parakontratën dhe të hollat të ju kthehen, por për këtë E. i kishtë lëshuar një deklaratë të nënshkruar e cila obligohet në emër të kthimit të hollave, mirëpo e njëjta asnjëherë nuk i kishtë kthyer asgjë gjerë më sot, andaj në cilësi të të dëmtuares kërkon që ti kthen 12.200 euro pa kamat dhe qiranë të ja paguaj prej marsit 2012 e gjerë në fund të vitit 2013, kur është vendosur në banësën që e ka blerë.

Dëshmitari: *Sh.m K.* në deklaratën e dhënë me datë 03.03.2015 në Prokurorin Speciale (PSRK) ndër të tjerash deklaroi se: pasi që një ditë ishte takuar me shokun e tij N. Ll. i cili i kishtë treguar se ai e ka bërë një marrëveshje me E.B lidhur me blerjen e një banëse, dhe unë kundrejt çmimit që e kishtë ofruar E., të njiut i është dukur i arsyeshëm dhe i favorshëm dhe për këtë arsye kishtë qënë i interesuar që të bëjë një parakontakt me të dhe të blej një banësë, dëshmitari- i dëmtuari, më tej shton se së bashku me N. Ll. kanë shkuar në zyrën e E., e cila ju kishtë prezentuar ofertat dhe kushtët në lidhje me banësën dhe të njëjtën ditë me datën 18.09.2009, është nënshkruar parakontratën mbi shit blerjen e banësës me sipërfaqë prej 67metra katror, në katin e tretë, me datën e lidhjes së para - kontratës . të njëjtës u janë paguar 7.000,00€ kesh, pas tri apo katër ditëve, po ashtu keshë të njëjtës u janë paguar edhe 3.000,00€, e cila dëshmohet me anë të një deklaratë të lëshuar nga E.B . me datë 14.12.2010, me të cilën ndër të tjera E.B pranon se ka marrë si avans shumë prej 10.000,00€ lidhur me pagesën e banësës nga Sh.m K.. Dëshmitari- i dëmtuari: më tej deklaroi se E. kurrë nuk e kishtë pranuar dështimin, ajo gjithmonë ka premtuar se do ndërtoj banësat dhe të na dorëzoj duke thënë se momentalisht ka pengesa objektive, mirëpo në fund kur ishte par që ka dështuar në tërësi nga e njëjta i dëmtuari thekson që kishtë kërkuar që ti kthen të hollat, mirëpo të hollat sot e kësaj ditë nuk janë kthyer as një cent, por e njëjta të dëmtuarit i kishtë paguar diku 10 muaj qira me vlerë prej 200€. Në fund dëshmitari- i dëmtuari deklaroi se kërkon që ti kthehen shuma prej 10.000,00€ me kamatë, të rregullt Bankare prej ditës kur i ja ka paguar deri në kthimin e të hollave, po ashtu kërkoj që të më paguhet qiranë rreth tri vitë nga 200€ në muaj, për këtë thekson se i bashkëngjitet ndjekjes penale.

Dëshmitari: *Sh. A.* në deklaratën e dhënë me datë 06.03.2015 në Prokurorin Speciale (PSRK) ndër të tjerash deklaroi se: bashkëshortja e tij është ra në dijeni se E.B po ndërton dhe po shet banësa, për këtë pasi që ishim të interesuar për një banëse ka ra në kontakt me E. në zyrën e saj të kinos A., aty nga e njëjta u ishin prezantuar ofertat dhe kushtët ku të njëjtat ju kishin pëlqyer, për këtë fillimisht ishim të obliguar që nëpërmjet xhirollogarisë private tja bëjmë pagesën në vlerë prej 10.000.00 euro në emër E., pastaj është nënshkruar parakontratë me 22.10.2010, në të cilën ishte parapare që E. në rast të vonimit të dorëzimit të banësës që të paguaj qiranë deri në dorëzimin e banësës në vlerë prej 200 euro në muaj, përpos pagesës prej 10.000.00 euro të njëjtës u janë paguar edhe 800 euro 4 herë nga ka 200 euro. Më tej dëshmitari shton se pasi që kishin vërejtur që e njëjta ka dështuar pasi që e ndërrontë pllacin për ndërtimin e banësës, kanë kërkuar prishjen e para kontratës me të, por e njëjta fillimisht premtonte që do ti kryej, mirëpo ajo definitivisht dështoi. Dëshmitari- i dëmtuari më tej shton se pasi që e kanë prish para kontratën, E. i kishtë kthyer 2.000 euro dhe me një deklaratë, në të cilën thekson se do ti kthej edhe 8.800 euro deri me datën 20.04.2012, të cilat asnjëherë nuk i kishtë kthyer, për këtë kërkon që ti kthehen 8.800 euro, për këtë shton se i bashkëngjitet ndjekjes penale .

Dëshmitari: *S.B.* në deklaratën e dhënë me datë 06.02.2015 në Prokurorin Speciale (PSRK) ndër të tjerash deklaroi se: përmes kolegeve ka ra në dijeni se E. B. po ndërton dhe shet banësa, për këtë shton se pai që ishte i interesuar ka kontaktuar me E. ku nga e njëjta ishte prezentuar oferta dhe kushtët për blerjen e banësës e të cilat kushtë i kishin konvencuar për këtë kishtë vendosur që ta blejë një banëse nga ajo, më tej shton se para se të nënshkruaj parakontratë, E. i kishtë kërkuar që ti paguaj përmes xhirollogarisë B. are 10.000.00 euro, kjo pagë ishte bërë me datën

21.04.2011, ndërsa para kontratën është nënshkruar me datën 26.04.2011, e në të cilën ishte parapar edhe pagesa e qiras prej momentit të mos dorzimit të banësës, e njëjta pas tëtë muaj e kishtë thirrur duke i thënë se a donë me marre garazh, pasi që ishin kushtët e volitshme, i dëmtuari shton se ka pranuar dhe për këtë i ka paguar nëpërmjet Bankës 1.500 euro. Në xhirollogari të kompanisë "V.-O- G.", pastaj ka nënshkruar prap para kontratë për shitblerjen e garazhes, e gjithë pagesa thekson në vlere prej 11.500.00 euro së bashku me garazh. Dëshmitari- i dëmtuari: më tej deklaron se pasi që nga koleget ka dëgjuar se E. ka dështuar në ndërtimin e banësës, të njëjtën e ka kontaktuar ndërsa ajo u arsyetojke se të hollat i ka investuar në banësa, banësat do të kryhen në afat të kryer, të njëjtën përgjigje i kishtë dhënë sa here që e ka kontaktuar, po ashtu i dëmtuari theksoj se disa herë në zyre të saj ka taktuar dy djem të rinjë dhe prindin e saj, por të cilëve nuk u a din emrat dhe me i pa tani nuk i njoh. Në fund dëshmitari- i dëmtuari: deklaron që kërkon nga E. që ti kthej të hollat prej 11.500.00 euro, dhe qiranë që është parapare me kontratë që të ja paguaj në rast se vonohet dorëzimi i banësës, në vlerë prej 200 euro, po ashtu të ja paguaj shpenzimet mjekësore të cilat i ka pësuar kur e ka kuptuar që e njëjta ka dështuar, njëherit deklaron se i bashkanëgjitet ndjekjes penale.

Dëshmitari: V.K. në deklaratën e dhënë me datë 27.02.2015 në Prokurorin Speciale (PSRK) ndër të tjerash deklaron se: përmes shokut të tij S. S. është njoftuar se E. po ndërton dhe po shet banësa, për këtë së bashku me S.in kishtë shkuar dhe takuar me E. në zyrën e saj në breg të diellit, ku aty ishte vërejtur se ishte edhe vëllai i E. që me emër nuk i kujtohet, nga E. u ishin prezantuar ofertat dhe kushtët për blerjen e banësë e të cilat kushtët të njëjtë i konvuan duke bërë kontraktimin e një banëse, keshtu që në datën 06.11.2009 është nënshkruar parakontratën për blerjen e nëe banëse me çmim prej 33.500 euro me sipërfa pre 67 metra katror kati i 3, pas nënshkrimit të parakontratës i dëmtuar shton se E. ja ka dhënë në dorë 10.000 euro në prezencën e bashkëshortës së tij D., shokut të tij S.it dhe vëllaut të E., e që me rastin e dhenjes se të hollave E. nuk i kishtë lëshuar dehtësë për pranimin e të hollave. Më tutje dëshmitari- i dëmtuari: deklaron se pastaj kohe pas kohe kur ka ardhur në P. në vlera të ndryshme i ka dhënë edhe 4.500 euro, po ashtu as në këto rastë nuk ka pranuar asnjëherë dehtësë për pranimin e të hollave, por se sa herë që i ka dhënë E. të holla me të rregullisht ka ishte shoku i tij S.i, e që gjithsejtë i ka paguar E. 14.500euro. Në fund dëshmitari- i dëmtuari deklaron se kërkon që ti kthehen të hollat në vlerë pre 14.500 dhe atë me kamatë të rregullt B. are prej momentit të pagesës dhe gjerë në përfundim të kthimit tjetër gjë nga ajo nuk kërkon.

Dëshmitarja- e dëmtuara : V. I. në deklaratën e dhënë me datë 05.02.2015 në Prokurorin Speciale (PSRK) ndër të tjerash deklaron se: nga rrethi familjar është njoftuar se E.B po ndërton dhe po shet banësa, për këtë është angazhuar dhe intëresuar se bashku me bashkëshortin kanë kontaktuar dhe kanë takuar E. në zyrën e saj të kino A., nga e cila janë njoftuar me kushtët e blerjes se banësës për çmimin 650 euro për metër katror, e të cilat kushtët e dëmtuara thekson se i pranuan duke nënshkruar para- kontratën, me nënshkrimin e kontratës shton se ishin të obliguar që të paguajmë të holla në dorë, atë ditë 15.000 euro, ndërsa kësti mujor ishte që të paguajmë rregullisht 200 euro, për këtë me sa ju kujtohet gjerë me tani . ka paguar rreth 20.000 euro. Më tej dëshmitarja- e dëmtuara: thekson se pasi që kishin vërtur se banësat nuk po ndërtohen ka kërkuar nga E. që tua kthej të hollat, por deri më tani nuk ju është kthyer asnjë cent, për këtë shton se ka ushtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë 16.05.2013, për kompenzimin e vlerës rreth 20.000 euro duke paditur E. për mjetët financiare të cilat ja kanë paguar në emër të banësës dhe banësa nuk na ka dorëzuar, por për këtë anjëher nuk janë njoftuar nga gjykata. Në fund dëshmitarja - e dëmtuara: kerkon që E. ti kthej të gjitha të hollat e paguara në dore dhe të gjitha këstët e paguara në vlere rreth 20.000 euro, po ashtu kërkon që ti paguan qiran prej momentit kur ka qënë dashtë të na dorëzoh banësën e gjere me tani, duke shtuar se nëse E. na i

përgatit banësat nuk i bashkanëgjitet ndjekjes penale, e nëse nuk na ndërton i bashkanëgjitna ndjekjes penale.

Dëshmitari: *V. S.* në deklaratën e dhënë me datë 16.02.2015 në Prokurorin Speciale (PSRK) ndër tëjerash deklaron se në bazë të disa kolegeve të punës është ra në dijeni se *E.B* po ndërton dhe po shet banësa, për këtë thekson se pasi që është i interesuar për blerjen e një banëse ka kontaktuar dhe është takuar me *E.* në zyrën e saj të *Kino A.*, pas takimit nga e njëjta kishtë pranuar ofertën dhe kushtët e saja të prezantuar, e të cilat i kishin konvnuar duke i pranuar, në zyre të *E.* i dëmtuari deklaron se është me vëllain tij *H.*, pasi që po atë ditë me datë 12.08.2010 është nënshkruar parakontratën ndërsa të nësërmen me datën 13.08.2010 nga *Ilogaria e H.* u janë paguar *E.* në xhirollogarinë e saj personale vlerën prej 10.000 euro, me para kontratë është parapa banësa me sipërfaqë 71 metra katror, në vlerë prej 45.000 euro, gjithashtu është parapa nëse vonohet në dorëzimin e banësës, *E.* të na paguaj qiranë në vlerë prej 200 euro deri në ditën e dorëzimit të banësës. Më tej dëshmitari- i dëmtuari: deklaron se pasi që ka vrejtur që *E.* po dështon në ndërtimin e banësave të njëjtën e ka kontaktuar dhe nga e njëjta ka marur arsytetime se ka probleme dhe se do të ndërroj lokacionin dhe arsye tjera, në këto rrethana nga *E.* ka kërkuar kthimin e të hollave dhe asgjë tjetër, për këtë nga e njëjta kërkova një provë me shkrim nga e cila ju është dhënë një anëks kontratë me të cilën vërtëtohet se është bërë anulimi i kontratës dhe kthimi do të behet brenda 90 ditë, për këtë asnjë cent nuk ju është kthyer. Në fund dëshmitari- i dëmtuari : deklaron se kërkon nga *E.* të ja kthej 10.000 euro dhe atë me kamat Bankare nga dita e pagesës gjerë në ditën e kthimit, po ashtu nga 200 euro në emër të qirasë prej ditës se dështimit të dorëzimit të banësës e gjerë me tani.

I dëmtuari *R. K.* i ndëgjuar në lokalet e Prokurorisë Speciale ndër të tjera është deklaruar se: pai që ka shkuar në Raiffeissen Bankë me i shiqur kushtët e një kredie për blerjen e një banëse, një femër aty duke me treguar për kushtët e kredisë, i kishtë treguar se është një kompani që ka ofertë të përshtatshme për ju për blerjen e banësës, dhe për këtë shton që pasi që isha i interesuar për blerjen e një banëse kishtë shkuar dhe kontaktuar me *E.* në zyrën e saj që e ka pasur afër *Kino A.*-, gjatë ati takimi është njoftuar nga e njëjta lidhur me ofertën dhe kushtët e blerjes së banësës, e të cilat kushtë i kanë pëlqyer për shkak të çmimit të volitshëm dhe afatit të pagesës, për këtë me datën 03.02.2011 shton se ka nënshkruar para kontratën për blerjen e banësës, ku parashihej që banësa të jetë në Objektin A 4 kati 6 në sipërfaqë prej 68 metra katror në vlerë prej 44.200 euro, pastaj përmes *B.ës* në xhirollogarinë e kompanis "*V. O G.*" i ka paguar 8.000 euro, në mënyrë që menjëherë të filloj me këstë mujor në vlerë prej 190 euro gjerë sa të paguhet vlera prej 36.000 euro, po ashtu janë paguar edhe dy këstë në vlerë prej 190 euro, sipas marrëveshjes me shkrim *E.* ka qenë dashtë që banësën të ma dorëzoj në Maj të vitit 2012, më tej dëshmitari thekson se pas problemeve me *E.* rreth dorëzimit të banësave ka vendosur që ta anuloj para kontratën, dhe *E.* të ja kthej të hollat në vlerë prej 8380 euro, e cila kishtë bërë deklaratë për kthimin e mjetëve në vlerë prej 8.800 euro, gjer më datë 07.01.2012, dëshmitari shton se prej ditës së anulimit të parakontratës ka kontaktuar dhe dI. here *E.*, mirëpo arsytimi i saj është qënë se nuk ka të holla për momentin dhe se do të ti kthej lidhur me këtë çështje u është drejtuar Gjykatës Komunale në Prishtinë me padi në kontëstin civil kundër *E.Bt* për kthimin e të hollave, të dorëzuar me datën 11.05.2012 me nr. Cl .../... F.S, andaj fare në fundë i dëmtuari kërkon që ati si paditës të kthehen të hollat në vlerë prej 8.380,00 euro.

Të dëmtuarit që kanë dhënë deklarata në Policin e Kosovës.

I dëmtuari - dëshmitari *A.D.* në deklaratën e dhënë në Policin e Kosovës me datë 06.06.2014 ndër të tjerash është deklaruar se: pas dëgjimit të arrestimit të *E.Bt* ka ardhur në Polici të deklaroj se është i dëmtuar (viktim) e mashtrimit nga *E.*, për arsye se ka lidhur kontrat me *E.* për blerjen

e banësës në M. . me sipërfaqë prej 71m² në katin e 5 në objektin, kontratën deklaron se e ka lidhur me datën 04.10.2011, dhe nuk ka vazhduar tjetër kontratë, kontratën shton se e ka ndërpre duke ka kërkuar që ti kthehen të hollat e tij ku për këtë ka nënshkruar edhe nje Anëks Kontratë të datës 19.07.2012 ku E. është dashtë të ja kthej parat në afatin prej 90 ditëve të shënuar në Anëks Kontratë I dëmtuari më tutje vazhdon duke deklaruar se kushtët me kontrat për blerjen e banësës ishin që të paguhet avansi 10,000.00€ dhe pasi që të fillohet ndërtimi i banësave të filloj të paguaj me këstë nga 200 euro në muaj në afat prej 15 vitë, ndërsa afati i përfundimit të banësës ka qënë 12 muaj dhe në rast të mos përfundimit të objektit në afatin e caktuar inventitorja ka pasur për obligim që tua paguaj nga 200 euro çdo muaj për qira të banimit deri në përfundimin e objektit ose deri në hyrje të banësës për banim. Në fundë i dëmtuari deklaron se pai që ka vrejtur dështimin e E. dhe pas lidhjes së anëks kontratës me të njëjtën kanë kontaktuar edhe dI. her por se nga ajo kanë marrur vetëm premtime të kota dhe asgjë më shumë, po ashtu shton se në kohen e lidhjes së kontratës me E. prezent ishtë R. K. (zyrtar i lartë i shitjes se banësave me nr. tël/..., po ashtu thekson se për këtë paradhënie ka hyr në kredi në Bankën TËB ku për çdo muaj paguan ratat nga 260 euro në muaj që tri vitë me radh kështu që edhe dy vitë i kanë mbetur të paguaj këtë kredi dhe gjithashtu çdo muaj paguan qira në P. nga 200 euro në muaj kështu që unë çdo her është duke u shkatërruar tërsishtë gjithashtu në lidhje me këtë rastë dëshiroj të realizoj kërkesën pasurore juridike.

I dëmtuari - dëshmitari A. B. në deklaratën e dhënë në Policin e Kosovës me datë 24.07.2014 ndër të tjerash është deklaruar se: pai që ka dëgjuar për arrestimin e të dyshuarës E.B përmes mediave Klan Kosova ka ardhur të paraqitet se edhe vet është viktimë e mashtrimit nga E. sepse me të njëjtën ka lidhur kontratë me datën 21.07.2011 dhe nr 134/1 për blerjen e banësës në M. . me sipërfaqë prej 71m² në katin e 4 në objektin A-I, e me të cilën kontrat kushtët kanë qënë që të paguhet avansi 12,400.00€ dhe pasi që të ndërtohet banësa të filloj me pA.in e këstëve në shumë prej 200 euro në muaj për 15 vitë, me afat të përfundimit të banësës prej 12- 15 muaj dhe në rastë të mos përfundimit objektit në afatit e caktuar inventitorja ka pasur për obligim që tua paguaj nga 200 euro çdo muaj deri në përfundimin e objektit ose deri në hyrje të banësës që kjo asnjëherë nuk është berë, për këtë kontrat i dëmtuari deklaron se nga ana e tij janë paguar 12.400 euro kurse nga ana e E. nuk ju ka përmbushur kushtët e kontratës, rnë tutje i dëmtuari shton se pasi që E. nuk nuk i përmbushtë kushtët dhe dorëzimin e banësës nga e njëjta ka kërkuar sqarime por e njëjta çdo her kishtë dhënë arsye të kota, për këtë ka anuluar kontratën me datën 31.072012, në fund i dëmtuari shton se në Kohen e lidhjes së kontratës me E. ishin ai, grua e tij M. dhe E., ndërsa vëllau i E. V.i atë e kishtë marr dhe dërguar në vendin se ku po ndërtohet objekti i banësave, për këtë çka i ka ndodhur I dëmtuari thekson se do dëshiron të cek se kërkesen për realizimin e të drejtës se tij pasurore juridike.

I dëmtuari - dëshmitari A. M. në deklaratën e dhënë në Policin e Kosovës me datë 17.06.2014 ndër të tjerash është deklaruar se: pas dëgjimit të arrestimit të E.Bt ka ardhur në Polici të deklaroj se është i dëmtuar (viktim) e mashtrimit nga E., me të cilën ka lidhur para kontratën me kompania „ E. " me Drejtoresh E.B për blerjen e banëse në M...me sipërfaqë prej 65 rn² në katin e 3 në objektin Al me nr. të lejes ..-...../. e datës 03.07.2009, me tëj i dëmtuari thekson që kontratën e ka lidhur me datën 02.09.2009 dhe nuk është vazhduar sepse nuk është pajtuar me tjersim të pronës, me kontrat kushtët ishin që të paguhet avansi 10,000.00€ dhe shuma e kontraktuar prej 14,800 euro të paguhet me këstë çdo 6 muaj nga 3000.00 euro, për dorzimin e banësës afati i përfundimit ishtë 12 muaj nga momenti i nënshkrimit të pra kontratës dhe në rast të mos përfundimit të objektit në afatin e caktuar inventitorja ka pasur për obligim që ti paguaj nga 200 euro çdo muaj për qira të banimit deri në përfundimin e objektit ose deri në hyrje të banësës për banim, që kjo asnjëherë nuk ndodhur që të me paguaj qiran, rnë tu tje i dëmtuari thekson se përveq avansit ka paguar edhe një rat prej 300 eurosh dhe pasi ka vrejtur që E. ka dështuar ka

kërkuar sqarime por e njëjta çdo her kish të dhënë arsye të ndryshme dhe të kota, në fund i dëmtuari deklaroi se E. e kanë njohur nëpërmes B.V.t për të cilin thekson se është çelësi kryesor i kësaj punë të mashtimit, dhe se në kohën e lidhjes së kontratës prezent ish in ai E., një punëtor i saj Y. J. dhe vëllai i tij R., për të gjithë këtë punë deklaroi se ekziston një deklaratë e vërtetuar të notëri në të cilën thekson se E. ju ka borgje 16,000.00 euro, si pasojë e pagese për qira të banësë dhe arsyeja e anulimit të paraktratës mjetët do të kthehen gjerë me datë 07.04.2013, ku edhe nuk janë realizuar asnjëherë, njëherit dëshiron të realizoj kërkesën e tij pasurore juridike.

I dëmtuari - dëshmitari A.S. në deklaratën e dhënë në Policin e Kosovës me datë 03.06.2014 ndër të tjerash është deklaruar se: pas dëgjimit të arrestimit të E.Bt ka ardhur në Polici të deklaroj se është i dëmtuar (viktim) e mashtimit nga E., me të cilën ka lidhur dy kontrata njëra është në emrin tij, kurse tjetra është në emrin e dhënëdririt (Burrit të motrës) S. M. i cili jeton në Zvicër, kontratë e cila është në emrin tij ishte për blerjen e banësës në -M. . me sipërfaqë prej 71m² në katin e 5 në objektin A-1 , kurse kontratë e e dhënëdririt po ashtu ka qënë në M. . me sipërfaqë 71 m² në katin e 6 në objektin A 1, kontratën thekson që e ka lidhur me datën 26.10.2010, e cila është vazhduar në kontratë të re me datë 05.08.2011, sipas kontratës kushtët ish in që të paguhet avansi 10,000.00€ ndërsa pasi që të hyhet në banës të paguhet pjesa tjetër në shuma prej 36.150 euro në afat prej 15 vitë përkatësisht me kështë nga 200 euro në muaj, gjithashtu afati i përfundimit të banësës ishte 15 muaj, në kontratën e dytë që është ripërtri kontratë me datën 05.08.2011 afati i përfundimit të banësës ishte 12 muaj, mirëpo janë berë disa ndryshime në m² prej 71m² në 85 m² si dhe nga kati i pest me zbrit në katin e 4 ndërsa kështë për pages në m² janë rritur 27 euro më shumë se kontratë par kështu që shuma në kështë mujore 227 Euro, në të dyjat kontratata në rastë të mos përfundimit objektit në afatit e caktuar invensitorja ka pasur për obligim që t ju paguaj nga 200 euro çdo muaj deri në përfundimin e objektit ose deri në hyrje të banësës. I dëmtuari më tej deklaroi se a ka paguar 10.000 euro si paradhenje kurse nga ana e E. nuk ju ka përmbajtur kontratës, lidhur me këtë është kërkuar dhe kanë realizuar takime, në fund i dëmtuari deklaroi se lidhur me këtë marrëveshje. për 4 vitë e ka shkatrruar tërsisht dhe gjithashtu në lidhje me ketë rastë dëshiron që të realizoj kerkesen pasurore juridike.

I dëmtuari - dëshmitari B. S. në deklaratën e dhënë në Policin e Kosovës me datë 23.09.2014 ndër të tjerash është deklaruar se: pas dëgjimit të arrestimit të E.Bt ka ardhur në Polici të deklaroj se është i dëmtuar (viktim) e mashtimit nga E., me të cilën ka lidhur para kontratën me datën 22.03.2010 për blerjen e banësë në M. . me sipërfaqë prej 71m² në katin e 4 në objektin A-2, në cilën parakontratë parashiheshin kushtët që të paguhet avansi 10,000.00€, pastaj menjëherë thekson se ka filluar të paguaj kështë prej 197.00 euro në muaj dhe kjo pagës sipas kontratës të paguhet për 15 vitë, po ashtu me parakontratë afati i përfundimit të banësës ishte 12- 15 muaj dhe në rastë të mos përfundimit objektit në afatit e caktuar invensitorja ka pasur për obligim që të ju paguaj nga 200 euro çdo muaj deri në përfundimin e objektit ose deri në hyrje të banësës që kjo asnjëherë nuk është bërë, lidhur me këtë marrëveshjei dëmtuari deklaroi se E. i ka paguar 11.400 euro, kurse nga ana e E. nuk ju ka përmbushur kushtët e kontratës. I dëmtuari po ashtu deklaroi se lidhur me mos përmbushjen e parakontratës nga E. ka kërkuar dhe pasur takime disa her po me premtime e saj të kota duke ju thënë se do ti përfundoj objektin sa me shpejt, si pasojë e kësaj i dëmtuari shton se ka anuluar kontratën me datën 05.11.2011. Në fund i dëmtuari deklaroi se E. e ka njohur nga dy kolegeve të tij L.B.i dhe R. të cilët edhe ata janë viktimë të dyshuarës E.B, gjithashtu thekson se për këtë çka i ka ndodhur dëshiron të realizoj kërkesën tij pasurore juridike.

I dëmtuari - dëshmitari B. H. në deklaratën e dhënë në Policin e Kosovës me datë 25.07.2014 ndër të tjerash është deklaruar se: pas dëgjimit të arrestimit të E.Bt ka ardhur në Polici të deklaroj se është i dëmtuar (viktim) e mashtimit nga E., me të cilën ka lidhur kontratë me datën 01.11.2010 me nr. 99/9 për blerjen e banësës në M. . me sipërfaqë prej 71m² në katin e 4 në

objektin A-4 , me kushtët e kontratës që të paguhet avansi 30,000.00€ dhe shuma prej 14,000.00 euro të paguhet prej 15 vitë përkatësisht 180 muaj në kështë prej 77 euro në muaj duke filluar nga janari të vitit 2011, me afat të përfundimit të banësës prej 15 muaj dhe në rastë të mos përfundimit objektit në afatin e caktuar investitorja ka pasur për obligim që ëe ju paguaj nga 200 euro çdo muaj deri në përfundimin e objektit ose deri në hyrje të banësës që kjo asnjëherë nuk është bërë. Lidhur me këtë marrëveshjei dëmtuari deklaroi se nga ana e tij janë paguar 30.000.00 euro, kurse nga ana e E. nuk ju ka përmbushur kushtët e kontratës, po ashtu përve avansit prej 30.000 euro i dëmtuari thekson se janë paguar dhe kështë mujore 380.00 euro përkatësisht shuma totale është prej 30,380.00 euro, i dëmtuari më tutje deklaroi se pai që ka vrejtur që E. ka dështuar në ndërtimin e banësave ka kërkuar dhe ka pasur takime disa herë me tënjëjtën e cila u arsyetohej se kinse është një gyp i ujit dhe nuk mund të ndërtoj objektin, për këtë i ka premtu se do të ndërtohet një Objekt tjetër dhe do të ju vendosi aty kështu që E. se bashku me vëllain e saj V.in dhe një Arkitekt i ka tregu vendin se ku do të ndërtohet objekti ,për këtë i dëmtuari thekson se e ka anuluar kontratën me datën 25.10.2011.

Dëshmitari Z. P. në deklaratën e dhënë në Policin e Kosovës me datë 13.02.2015 ndër të tjerash është deklaruar se: me E.B është njoftuar para gjashtë viteve, pai që merret me ndërtimtari dhe një shok i tij, M.M., me ka thënë se një investitorë e ka një projekt të fortë dhe po e kërkon një ndërtues, pëe këtë M. i kishtë sjellë projektin e E. me një CD, pastaj janë takuar me E. dhe kanë biseduar rreth projekteve të saja, E. kishtë kërkuar që ajo si ndërtues të investoj parat e tij në dy objektët e para pastaj kur ta ndërtoj objektin e tretë të kryhet pagesa nga ana e E. për objektin e tretë, çka do të thot se dy objektë të ndërtuara - investuara të mbetën brenda pa u paguar, lidhur me këtë dëshmitari thekson se pasi e ka analizuar projektin e ka parë se vetëm nuk mund t'ia dal sepse nuk ka pasur mjetë për finalizimin e tri objektëve deri sa ti bëhet pagesa e një objekti, dhe si përfundim është tërhequr. Pas këtyre ngjarjeve dëshmitari deklaroi se E. i ka kërkuar që ai t'ia gjej një investitor - ndërtues për ndërtimin e objektëve, dhe ai i ka gjetur pëersonin Rr. H. nga Sh. i cili ka pranuar të hyj në këtë projekt, lidhur me këtë punë E. është takuar rreth vitit 2009 në D. në kompleksin "X.", pas bisedës që kanë zhvilluar E. dhe një mashkull i cili J.të jashtë, emri nuk po me kujtohet por ka qënë zeshkanë, i gjatë, me Rr. e ka ftuar edhe atë në një darkë për të festuar arritjen e marrëveshjes për ndërtim, për këtë marrëveshjethekson se ka shkuar në Durrës dhe kanë ngrënë darkë së bashku dhe me janë falënderuar të dy palët për ndërmjetësimin e tij, pastaj thekson se është kthyer për Kosovë kurse E. me atë djalin dhe Rr. kishin vazhduar të qëndrojnë në Durrës, më tutje dëshmitari deklaroi se me sa e di ai punimet i ka filluar Rr.port ë cilat punime nuk kanë përfunduar, nga se Rr. e ka ndërprerë Rinvestimin por nuk e di arsyen, pasi . këtyre ngjarjeve dëshmitari shton se më nuk ka pasur kontaktë me E. vetëm se është kontaktuar nga Rr.i cili i kishtë kërkuar që të kontaktoj E. lidhur me pagesen e borgjit të ndërtimit.

I dëmtuari - dëshmitari E.Xh. në deklaratën e dhënë në Policin e Kosovës me datë 21.08.2014 ndër të tjerash është deklaruar se: pas dëgjimit të arrestimit të E.Bt ka ardhur në Polici të deklaroj se është i dëmtuar (viktim) e mashtrimit nga E., me të cilën ka lidhur parakontartën me datën 08.06.2011 për blerjen e banëse në M.. me sipërfaqë prej 71 rn² në katin e 3 në objektin A1, me kushtët që të paguhet avansi 10,000.00€, ndërsa shuma e mbetur prej 36,000.00 euro të paguhet me kështë për 15 vitë përkatësisht 180 muaj në vlerë prej 200 euro, me afat të përfundimit të banësës prej 12 deri në 15 muaj nga momenti i nënshkrimit të pra kontratës dhe në rastë të mos përfundimit të objektit në afat të caktuar investitorja ka pasur për obligim që të ju paguaj nga 200 euro çdo muaj për qira të banimit deri në përfundimin e objektit ose deri në hyrje të banësës për banim, që kjo asnjëherë nuk ka ndodhur që të me paguaj qiran, lidhur me këtë marrëveshjei dëmtuari deklaroi se ai ka paguar 10,000.00 euro, por për të njëjtën marrëveshje E. ka dështuar se për këtë nga ajo ka kërkuar sqarime, por çdo her pas takimeve me të e njëjta ka pasur

premtimet e saj të kota duke i thënë se do ti përfundoj objektin sa me shpejt. Në fund I dëmtuari deklaroi se pas kësaj ngjarje ai ka anuluar kontratën me datë 26.07.2012 dhe sipas Anëks Kontrata nga E. që shuma prej 10, 000.00 euro të kthehen brenda 90 ditëve prej datës së anëks kontratës 26.07.2012.

I dëmtuari - dëshmitari *F. K.* në deklaratën e dhënë në Policin e Kosovës me datë 20.06.2014 ndër të tjerash është deklaruar se: pas dëgjimit të arrestimit të E.Bt ka ardhur në Polici të deklaroj se është i dëmtuar (viktim) e mashtrimit nga E., me të cilën ka lidhur para kontratat me nr. 114/1 me datën 31.10.2011 nga kompania „ V.- O G." Drejtoresh E.B për blerjen e banësave në M.. me sipërfaqë prej 71 m² në katin e 3 në objektin A1 dhe tjetrën banës me sipërfaqë 71 m² në katinë 3 në objektin A1, me kushtet të paguhet avansi 15,000.00€ për dy banësat dhe shuma e kontraktuar prej 85, 200 euro të paguhet me kështë për 15 nga 394 euro, kështë të fillojnë të paguhet pasi që të hyn në banës, me afat të përfundimit të banësës prej 15 muaj nga momenti i nënshkrimit të para kontratës dhe në rastë të mos përfundimit të objektit në afatin e caktuar inventarja ka pasur për obligim që t ju paguaj nga 200 euro çdo muaj për qira të banimit deri në përfundimin e objektit ose deri në hyrje të banësës për banim, që kjo asnjëherë nuk ka ndodhur që të me paguaj qiranë, i dëmtuari më tutje deklaroi se për këtë marrëveshje E. i ka paguar avans 15,000 euro dhe pastaj pasi që të hyn në banësë të paguhet shuma e mbetur, kurse nga ana e E. nuk janë përmbushur kushtet e kontratës, lidhur me mos përmbushjen e kontratës thekson se ka kërkuar dhe realizuar takime me E. por me premtimet e saj të kota duke ju thënë se do ti përfundoj objektin sa me shpejt, në fund deklaroi se E. e ka njohur përmes R. B. i cili ka punuar me E. dhe mendojmë se është agjenti kryesor i kësaj punë, e i cili është prezent edhe në kohën e lidhjes së marrëveshjes ku është edhe vllau i tij I.

E dëmtuara - dëshmitarja *F.Sh.* në deklaratën e dhënë në Policin e Kosovës me datë 25.07.2014 ndër të tjerash është deklaruar se: pas dëgjimit të arrestimit të E.Bt ka ardhur në Polici të deklaroj se është e dëmtuar (viktim) e mashtrimit nga E., me të cilën ka lidhur kontratë me datën 15.09.2009 për blerjen e banësës në M. . me sipërfaqë prej 65m² në katin e 3, po ashtu thekson se para kontratën të cilën e ka nga E. është me datë 15.06.2009 të cilën e refuzoj sepse unë nuk kam lidhur kontratë në atë kohe, kushtet e kontratës ishin që të paguhet avansi 10,000.00€ dhe shuma prej 15,000.00 euro të paguhet për 75 muaj në kështë prej 200 euro në muaj, me afat të përfundimit të banësës prej 15 muaj dhe në rastë të mos përfundimit të objektit në afat të caktuar inventarja ka pasur për obligim që të na paguaj nga 200 euro çdo muaj deri në përfundimin e objektit ose deri në hyrje të banësës që kjo asnjëherë nuk është bërë, lidhur me këtë marrëveshje e dëmtuara deklaroi se ka paguar 11.800.00 euro kurse nga ana e E. nuk janë përmbushur kushtet e kontratës, deri me tani thekson që ka paguar shumën 10,000.00 euro përmes një shoku të saj S. S. i cili është pronar i Autoservis „ A. K.” B. , këto para i ka dhënë kesh, kështu që edhe E. e ka konfirmuar që këto të hollat i ka pranuar , ndërsa shumën prej 600 euro E. ia ka dhënë kesh ndërsa shuma prej 1,200 .00 euro i ka paguar me kështë 6 muaj nga 200 euro përmes Bankës Raiffeisen B.ë. Në fund e dëmtuara deklaroi se pas dështimit të E. nga e njëjta ka kërkuar dhe realizuar takime disa herë nga e cila ka marrë arsyetimet të kota se edhe do ta paguaj qiranë që kjo nuk ka ndodh asnjëherë .

I dëmtuari - dëshmitari *H. D.* në deklaratën e dhënë në Policin e Kosovës me datë 13.06.2014 ndër të tjerash është deklaruar se: pas dëgjimit të arrestimit të E.Bt ka ardhur në Polici të deklaroj se është i dëmtuar (viktim) e mashtrimit nga E., me të cilën ka lidhur para kontratën me datën 12.04.2010 për blerjen e banësës në M..me sipërfaqë prej 71m² në katinë 2 në objektin A1 ,ndërsa në Anëks kontratë me datë 19.05.2011 të cilën e ka vazhduar për blerjen e banësës në M. . me sipërfaqë 85 m² në katin e dytë në objektin A1 ,kushtet e kontratës ishin të paguhet avansi 10,000.00€ pastaj pasi që të hyj në banesë të paguaj kështë mujore në shumë prej 141.66 € për

15 vitë, me afat të përfundimit të banesës prej 12 deri në 15 muaj nga momenti i nënshkrimit të para kontratës me nr 112/1 dhe në rast të mos përfundimit të objektit në afatit e caktuar inventitorja ka pasur për obligim që të ja paguaj nga 200 euro çdo muaj për qira të banimit deri në përfundimin e objektit ose deri në hyrje të banesës për banim, që kjo asnjëherë nuk ndodhur që të me paguaj për qira, lidhur me këtë marrëveshje i dëmtuari deklaron se nga ana e tij janë paguar avansi 10,000 euro sipas marrëveshjes kurse nga ana e E. nuk jaanë përmbushur kushtet e kontratës, pas dëgjimit të E. i dëmtuari thekson që ka sqarim dhe ka pasur takime disa herë me të njëjtën po me premtime e saj të kota duke i thënë se do ti përfundoj objektin sa me shpejt , dhe do të merr një kompani tjetër dhe do ti përfundoj banesat sa me shpejt. Në fund i dëmtuari shton se në kohën e lidhjes së parakontratës prezent ishtë edhe vllau i E. V.i, për të gjitha atë që u tha më lartë i dëmtuari deklaron se kërkon që ti kthehen parat e tij 10,000 € të cilat i ka paguar përmes Bankës Raiffeissen në xhirollogarinë e V.-O-G. pronare E.B dhe mundësisht ti kompozohet qiraja sipas marrëveshjes se kontratës po ashtu dëshiron të realizoj kërkesën e tij pasurore juridike.

I dëmtuari - dëshmitari I. K. në deklaratën e dhënë në Policin e Kosovës me datë 20.06.2014 ndër të tjerash është deklaruar se: pas dëgjimit të arrestimit të E.B ka ardhur në Polici të deklaroj se është i dëmtuar (viktim) e mashtrimit nga E., me të cilën ka lidhur para kontratat me datën 11.11.2011 me nr. 116/1 nga kompania "V.- O G. " me drejtoresh E.B për blerjen e banesës në M. . me sipërfaqë prej 71 m² në katin e 4 në objekfin A1 , kushtet e kontratës ishin që të paguhet avansi 4000.00€ ndërsa shuma e mbetur prej 38,600.00 të paguhet me këste për 15 nga 197 euro, kështu të fillojnë të paguhet pasi që të hyn në banes, ndërsa afati i përfundimit të banesës ishtë 15 muaj nga momenti i nënshkrimit të para kontratës dhe në rast të mos përfundimit të objektit në afatin e caktuar inventitorja ka pasur për obligim që tu paguaj nga 200 euro çdo muaj për qira të banimit deri në përfundimin e objektit ose deri në hyrje të banesës për banim, e që kjo asnjëherë nuk ndodhur që të paguaj qiranë, lidhur me këtë marrëveshje i dëmtuari deklaron se nga ana e tij janë paguar avansi 4000 euro dhe pasi që të hyn në banesë të paguhet shuma e mbetur, kurse nga ana e E. nuk janë përmbushur kushtet e kontratës, pa që nga ana e E. nuk janë përmbushur kushtet i dëmtuari thekson se ka kërkuar dhe pasur takime disa herë po nga e njëjta ka marur premtime të kota duke i thënë se do ti përfundoj objektin sa me shpejt . Në fund i dëmtuari deklaron se E. e ka njohur përmes R. B. i cili ka punuar me E. dhe mendojmë se është agjenti kryesor i kësaj punë, ku i njëjti ishtë prezent edhe në kohën e lidhjes së parakontratës , nga e gjithë ajo që u cek se që tri vite është me qira ku ka paguan qiran 250. 00 euro në muaj, po ashtu dëshiron të realizoj kërkesën e tij pasurore juridike.

I dëmtuari — dëshmitari I. S. në deklaratën e dhënë në Policin e Kosovës me datë 09.07.2014 ndër të tjerash është deklaruar se: pas dëgjimit të arrestimit të E.Bt ka ardhur në Polici të deklaroj se është i dëmtuar (viktim) e mashtrimit nga E., me të cilën ka lidhur para kontratën me datën 03.03.2011 dhe nr. 104/1 për blerjen e banesë në M. . me sipërfaqë prej 71 m² në katin e 7 në objektin A4 , me kushtet e kontratës të cilat ishin që të paguhet avansi 7,500.00€ të cilat i ka paguar dhe shuma e kontraktuar prej 37,500.00 euro të paguhet me këste për 180 muaj në vlerë prej 208 euro duke filluar prej muajit Prill 2011, me afat të përfundimit të banesës prej 15 muaj nga momenti i nënshkrimit të para kontratës dhe në rast të mos përfundimit të objektit në afatit e caktuar inventitorja ka pasur për obligim që të u a paguaj nga 200 euro çdo muaj për qira të banimit deri në përfundimin e objektit ose deri në hyrje të banesës për banim, që kjo asnjëherë nuk ndodhur që të me paguaj qiranë, lidhur me këtë marrëveshje i dëmtuari thekson se nga ana e tij janë paguar avansi 7,500 euro, pastaj prej 6.05.2011 ka filluar të paguaj këstin nga 208 në muaj kështu që 14 muaj, ku ka paguar rregullisht nga 208 euro në xhirollogarin menë Raiffesen Bankë në emër të Komapnis V. O G., kurse nga ana e E. nuk ishin përmbushur kushtet e kontratës, i dëmtuari rënë tutje deklaron se pas dështimit të E. të njëjtën e ka kërkuar dhe ka

pasur takime disa herë po me premtime e saj të kota duke na thënë se do ti përfundoj objektin sa me shpejt. Në fund i dëmtuari deklaron se për E. ka dëgjuar përmes reklamave të TV ku edhe është edhe nurmi i tel. celular ku në ka arritur të bien në kontaktë me të , gjithashtu thekson se në kohën e lidhjes së kontratës prezent ishin E. , nëna e E. Xh. vellau i saj V.i , kunata T., gjithashtu i dëmtuari deklaron se arsyeja e lidhjes së kësaj marrëveshje ishte se fëmijëve të tij ju ka vdekë e ëma gjatë luftës si viktimë e dhunës po në këtë shtëpinë të cilën është duke jetuar dhe arsyeja është që ka dashtë të largohemi nga kjo shtëpi se bashku me fëmijë për të ju shmangur kujtimeve të këqija dhe traumave të cilën i kanë përjetuar ai dhe fëmijët e tij, po ashtu dëshiron të realizoj kërkesën e tij pasurore juridike.

I dëmtuari - dëshmitari Ismail Revuqi në deklaratën e dhënë në Policinë e Kosovës me datë 30.09.2014 ndër të tjerash është deklaruar se: pas dëgjimit të arrestimit të E.Bt ka ardhur në Polici të deklaroj se është i dëmtuar (viktim) e mashtrimit nga E., me të cilën ka lidhur para kontratën me nr. 135/1 me datën 11.08.2011 për blerjen e banëse në M. . me sipërfaqë prej 71m² në katin e 3 në objektin A-1, me të cilën parashiheshin kushtet e kontratës që të paguhet avansi 10,000.00€ , e cila shumë ju është, dhe pasi që të hyn në banës ka pasur të filloj të paguaj kështë prej 181 .00 euro në muaj për 15 vite përkatësisht 180 muaj, me afat të përfundimit të banësës prej 12- 15 muaj dhe në rastë të mos përfundimit objektit në afatit e caktuar invensitorja ka pasur për obligim që të i paguaj nga 200 euro çdo muaj deri në përfundimin e objektit ose deri në hyrje të banësës që kjo asnjëherë nuk është bërë. I dëmtuari më tej deklaron se në bazë të marrëveshjes me E. të njëjtës i ka paguar 10.00 euro, kurse nga ana e E. nuk janë përmbushur kushtet e kontratës, për këtë thekson se ka kërkuar dhe ka pasur takime disa. her me E. po çdo herë ka marrur vetëm premtime të kota duke i thënë se do ti përfundoj objektin sa me shpejt. Në fund i dëmtuari deklaron se në kohën kur ka lidhur kontrat prezent kanë qënë ai vetëm ndërsa nga ana e E. ka qënë E. dhe vellau i saj V.i i cili i ka sjell deklaratën për blerjen e banësës e vërtëtuat nga Gjykatë në Graçanic, dhe fare në fund thekson se dëshiron të realizoj kërkesën e tij pasurore juridike.

E dëmtuara - dëshmitarja K. T. në deklaratën e dhënë në Policinë e Kosovës me datë 10.07.2014 ndër të tjerash është deklaruar se ka qënë e punësuar vetëm 10 diët në muajin gusht të vitit 2012 si asistntë në kompanin e E.Bt, por që ka punuar si pastruse edhe shërbye kafe E. po ashtu edhe musafirëve të saj , por tash nuk është e punësuar te ajo, arsyeja e punësimit ka qënë se ka shkuar me burrin e saj I. S. për ti kërkuar parat të cilat burri ia ka dhënë për blerjen e banesës ku vlera e parave ka qënë 10,412.00 euro, e ku në atë kohë e dëmtuara deklaron gjendja ekonomike e tyre ishte e vështir, dhe E. për këtë i kishtë ofroj të punoj dhe e cila i kishtë premtuar se do të paguaj me pagë mujore deri në 300.00 euro , kështu që vetëm 10 ditë ka punuar dhe më pas e ka ndërpre punën sepse nuk ka qënë e sigurt të punoja të ajo, po ashtu nuk ka pasur as kontratë të punës, e dëmtuara më tej shton se gjatë kohës sa ka punuar të E. çdo her kanë ardhur klient të mllefosur dhe agresiv, në ato rast thekson se e kishtë se kush ishte E. jo vetëm ata që ishin viktimë të saj por edhe vet ishte viktim, duke e kuptuar se gjithçka ishte gënjeshtër të ajo.

I dëmtuari - dëshmitari L.Z. në deklaratën e dhënë në Policin e Kosovës me datë 25.06.2014 ndër të tjerash është deklaruar se: pas dëgjimit të arrestimit të E.Bt ka ardhur në Polici të deklaroj se është i dëmtuar (viktim) e mashtrimit nga E., sepse babai i tij S. Z. ka lidhur para kontratën me Nr. .../. me datën 08.10.2011 me kompanin V. -O G. nga invensitorja E.B për blerjen e banëse në M. . me sipërfaqë prej 71 m² në katin e 4 në objektin A2 , me të cilën kontrat parashiheshin kushtet e kontratës që të paguhet avansi 10,000.00€ dhe shuma e kontraktuar prej 36,000.00 euro të paguhet me kështë për 15 vitë përkatësisht 180 muaj në vlerë prej 200 euro në kështë mujore, me afat të përfundimit të banesës prej 15 muaj nga momenti i nënshkrimit të pra kontratës dhe në rast të mos përfundimit të objektit në afatit e caktuar invensitorja ka pasur për obligim që të

ju paguaj nga 200 euro çdo muaj për qira të banimit deri në përfundimin e objektit ose deri në hyrje të banesës për banim , që kjo asnjëherë nuk ndodhur që të me paguaj qiran, lidhur me këtë marrëveshje i dëmtuari deklaron se ka paguar avansi 10,000 euro dhe 5 muaj rregullisht i ka paguar këstin nga 200 euro ku gjithsejtë 11,000.00 euro ku edhe e dëshmon me frakturat, rënë tēj i dëmtuari shton se pasi që ka vrejtur që E. ka dështuar të njëjtën e ka kontaktuar dhe ka kërkuar sqarime për çka e njëjta çdo her kishte dhënë vetëm premtime të kota duke ju thënë se kemi pengesa teknike dhe se shpejti do ti përfundoj objektin. Në fund i dëmtuari deklaron se në kohën e lidhjes së kontratës prezent ka qënë E., një punëtor i saj R. ku mbiemri nuk i kujtohet veç e di se është nga P. i cili ka qënë agent i shitjes se banesave, njëherit thekson se dëshiron të realizoj kërkesën pasurore juridike.

I dëmtuari - dëshmitari N. M. në deklaratën e dhënë në Policin e Kosovës me datë 19.03.2015 ndër të tjerash është deklaruar se: pas dëgjimit të arrestimit të E.Bt ka ardhur në Polici të deklaroj se është i dëmtuar (viktim) e mashtrimit nga E., me të cilën ka lidhur kontratën me kompanin „V. O G."me pronare E.B për blerjen e banesës në M. .. -P. me sipërfaqë prej 71m² bruto kati i katërt objekti A-2 , kontratën e parë e kam lidhur me datën 09.08.2010 dhe ka vazhduar kontratë të re me datë 16.09.2011, me kushtet e kontratës që të paguhet avansi 5,000.00€ ndërsa shuma e mbetur prej 36,150.00 Euro të paguhet me kështë nga 120 euro në muaj për 15 Vite me afat të përfundimit të banesës prej 15 muaj nga dita e lidhjes se kontratës, e në rastë të mos përfundimit të objektit në afatin e caktuar inventitorja ka pasur për obligim që të ju paguaj nga 200 euro çdo muaj deri në përfundimin e objektit ose deri në hyrje të banesës si çdo klientit tjetër, lidhur me këtë marrëveshjei dëmtuari deklaron se ai i ka përmbushur kushtet ku ka paguar 5.840.euro, ndërsa nga ana e E. nuk janë përmbushur kushtet e kontratës, për këtë i dëmtuari shton se pasi që ka vrejtur që E. ka dështuar nga e njëjta ka kërkuar dhe realizuar takime por se nga e njëjta ka marrur vetëm premtime të kota duke ju thënë se do ti përfundoj objektin sa me shpejt . Në fund i dëmtuari deklaron se dëshiron të realizon kërkesën pasurore juridike.

I dëmtuari-dëshmitari N. S.hu në deklaratën e dhënë në Policin e Kosovës me datë 24.07.2014 ndër të tjerash është deklaruar se pas dëgjimit të arrestimit të E.Bt ka ardhur në Polici të deklaroj se është i dëmtuar (viktim) e mashtrimit nga E., me të cilën ka lidhur kontratë për blerjen e dy banesave në M. . njëra banesë me sipërfaqë prej 71m² në katin e 6 në objektin A1 dhe tjetra banesë me sipërfaqë prej 65 m² në katin e 6 në objektin A 1, kontratat janë lidhur me datën 13.08.2010 për dy banE., dhe pasi që nuk është realizuar kontrata është vazhduar kontratë të re me datë 18.07.2011 për të dy banE. të cilave E. i ka ndërruar si në m² ashtu edhe nga kati i 6 në katin e 3 dhe që të dyja banesa ishin qënë me sipërfaqë 85m² nr katin e tret në objektin A2 , kushtët e kontratës ishin që të paguhet avansi 30,000.00€ për dy banE., po ashtu u janë paguar 1,000 euro veçmas, afati i përfundimit të banesës ishtë 12-15 muaj dhe në rast të mos përfundimit objektit në afatin e caktuar inventitorja ka pasur për obligim që ti paguaj nga 200 euro çdo muaj deri në përfundimin e objektit ose deri në hyrje të banesës që kjo asnjëherë nuk është bërë dhe për këtë arsye janë anuluar kontratat dhe nga E. ka kërkuar që ti kthehen parat e tija. I dëmtuari më tej deklaron se lidhur rënë këtë marrëveshje ka paguar 31,000.00 euro, kurse nga ana e E. nuk ju ka përmbushur kushtet e kontratës, për këtë shton se pai që ka vrejtur që E. ka dështuar disa her ka kontaktuar me të njëjtën dhe realizuar takime por çdo her nga ajo ka mar vetëm premtime boshe dhe të kota duke i thënë se do ti përfundoj objektin sa me shpejt. Në fund i dëmtuari deklaron se pas tërë kësaj ka anuluar kontratën sepse E. ishtë e obliguar të paguaj 50,000.00 euro plus 10,000.00 euro të kompensimit si dëmshpërblim për pritjen e përfundimit të ndërtesës me datën 15.08.2012, kjo ishtë për tri banesa, pasi që mbesa e tij M. K. e ka marr nje banesë dhe nga ai është ndar me 20 ,000 .00 euro kështu që atij mbeti E. të me paguaj pjesën e mbetur nga 50,000.00 euro plus 10, 000.00 euro të cilën E. e formuloj me 35,000.00 euro për arsye të saj pa nënshkrimin tij, po ashtu i dëmtuari shton se në kohën e lidhjes së marrëveshjeve me E. prezent ishin vëllai i

saj V.i dhe i cili i ka treguar vendin se ku po ndërtohet, kunata e E. T., E., E. si dhe një puntor të cilin nuk i kujtohet emri i tij , dhe fare në fund kërkon dhe dëshiron të realizoj kërkesën e tij pasurore juridike.

E dëmtuara - dëshmitarja S.H. në deklaratën e dhënë në Policin e Kosovës me datë 04.06.2014 ndër të tjerash është deklaruar se: pas dëgjimit të arrestimit të E.Bt ka ardhur në Polici të deklaroj se është e dëmtuar (viktim) e mashtrimit nga E., me të cilën ka lidhur kontrata me nr. .../. me datën.19.05.2011 me E.B për blerjen e banëse në M. . me sipërfaqë prej 85 m² në katin e 4 , kushtet e kontratës ishin që të paguhet avansi 47 ,000.00€ dhe anjë obligim tjetër ndaj saj për këtë e dëmtuara shton se nga ana e saj janë përmbushur kushtet e kontratës kurse nga ana e E. asnjë kushtë nuk është përmbushur, duke u paguar Avansi 47.000. 00 euro , 8,000.00 i ka dhënë përmes Raiffesen Bankës, një pjesë të parave prej 15,000 .00 € kurse tjerat çdo muaj i ka dhënë në shuma të ndryshme në kesh, për të cilat E. nuk i kishtë dhënë asnjë faktur pagese që ajo i ka dhënë këto para, por vetëm para kontratën që e ka lëshuar dhe vërtëtuat nga E.. E dëmtuara më tutje deklaron se pasi që ka vrejtur se E. nuk po i përmbush kushtet e marrëveshjes nga ajo ka kërkuar sqarime duke pasur edhe kontaktë por çdo her ka marrë vetëm premtime të kota duke i thënë se do ti përfundoj objektet sa me shpejt. Në fund e dëmtuara deklaron se kur ka lidhur kontrat me E. prezent kanë qënë Estirda me vllaun V.i dhe kunata T., gjithashtu shton se E. i ka paguar edhe shuma prej 200 € para 4 muajve nga se H. (Kontabilisti i E.) i kishtë thënë që E. t'ia jap 600 Euro sepse në po të ndihmojmë për banesë që ti ke me marr të E. , por që e dëmtuara i kishtë pasur vetëm 200 euro të cilat ja kishtë dhënë, për të gjitha këto ngjarje e dëmtuara ndihet e gënjyer nga E. për çka kërkon të realizoj kërkesën pasurore juridike .

E dëmtuara - dëshmitarja S. M. në deklaratën e dhënë në Policin e Kosovës me datë 02.06.2014 ndër të tjerash është deklaruar se: pas dëgjimit të arrestimit të E.Bt ka ardhur në Polici të deklaroj se është e dëmtuar (viktim) e mashtrimit nga E., me të cilën ka lidhur kontrat me të për blerjen e banëse me datën 04.03.2011 në M.. me sipërfaqë prej 71m² në katin e 7 në objektin A-4, kushtet e kontratës ishin që të paguhet avansi 10,000.00€ dhe pasi që të hyhet në banës të paguhet nga 200 euro në muaj për 15 vitë, afati i përfundimit të banesës ishte prej 12 -15 muaj nga momenti i nënshkrimit të parakontratës me nr 110/1 dhe për çdo vonës pas afatit 12-15 muaj E. do të paguaj qiran blerësit në vlerë prej 200 Euro deri në hyrje në banës , keshtu që asnjeher nga e dyshuara E.B nuk jan paguar për ketë vonës të ndertimit të banesës, lidhur me këtë e dëmtuara shton se nga ana e saj jan paguar 10.000 euro ku jan përmbushur të gjitha kushtet sipas kontratës,kurse nga ana e E. nuk janë përmbushur kushtetë kontratës, për çka ka kerkuar sqarim nga E. po çdo her duke nga e njëjta ka marur premtime të kota. Në fund e dëmtuara deklaron se për 4 vitë është shkatrruar tërsisht dhe gjithashtu në lidhje me ketë rastë dëshiron të realizoj kërkesen pasurore juridike .

I dëmtuari - dëshmitari S.M. në deklaratën e dhënë në Policin e Kosovës me datë 24.07.2014 ndër të tjerash është deklaruar se: pas dëgjimit të arrestimit të E.Bt ka ardhur në Polici të deklaroj se është i dëmtuar (viktim) e mashtrimit nga E., me të cilën ka lidhur kontratë me datën 08.10.2010 me E. B. për blerjen e banëse në M. . me sipërfaqë prej 71m² në katin e 6 në objektin A-I, me kushtet e kontratës që të paguhet avansi 10,000.00€ dhe menjëherë është filluar të paguhet kësti nga 200 euro në muaj në afat prej 15 vitë , afati i përfundimit të banesës ka qënë 15 muaj, ndërsa në kontratën e dytë që është ripërtëri ½ontrata me datën 05.08.2011 afati i përfundimi të banesës 15 muaj, mirëpo janë bërë disa ndryshime nga kati i gjashtë është zbritur në katin e katërt me sipërfaqë të njëjtë dhe në rastë të mos përfundimit objektit në afatit e caktuar inventoria ka pasur për obligim që ti paguaj nga 200 euro çdo muaj deri në përfundimin e objektit ose deri në hyrje të banesës që kjo asnjehërë nuk është bërë, për këtë marrëveshjei dëmtuari thekson që ka paguar 13.500 euro, kurse nga ana e E. nuk ju ka përmbushur kushtet e

kontratës, pas kësaj ngjarje të dështimit të E. i dëmtuari deklaron se të njëjtën e ka kontaktuar disa her dhe ka realizuar takime por nga e njëjta çdo her ka mar vetëm premtime të kota duke i thënë se do ti përfundoj objektin sa më shpejt . Në fund i dëmtuari deklaron se dëshiron të realizoj kërkesën pasurore juridike .

E dëmtuara — dëshmitarja V. H. në deklaratën e dhënë në Policin e Kosovës me datë 20.03.2015 ndër të tjerash është deklaruar se: S. F. B.i njihet shumë me herët i njëjti na ka lidhur me një femër nga Kosova E.B që në të investojmë në Kosove duke bërë ndërtimin e banësave në P. lagjen B.i D. dhe se kanë lidhur kontratë me shkrim me E. që në të bëjmë ndërtimin një marrëveshje që në fillimisht të investojmë me pas ajo do .ta merr një kredi dhe do të na i kthentë në parat por në sapo filluam morëm materialin ndërtimor ku ajo e ka gjetur kompaninë e matërialit ndërtimor dhe në kemi ber vetëm pagesën por në e kuptuam se ajo nuk është korrekte dhe e kemi ndërprerë pastaj pasi që në e kemi ndërprerë marrëveshjen me E. kemi emëruar përfaqësues të posaçëm S. B. që i njëjti të mund ti merrte parat nga E. që në i kemi investuar që shumë arrin deri në njëqind mijë euro, pastaj S. ka lidhur marrëveshje me E. që ti kthentë parat por E. ka vlerësuar investimin tonë vetëm 46,000.00 euro por në e kemi pranuar edhe vetëm 46,000.00 euro por nuk na e ka kompensuar as edhe një cent. Më tej dëshmitari deklaron se është lidhur kontrata në mes të S. dhe E. për blerjen e një banëse 85 nonë lidhjen M. . në vlerë prej 52.000.00 euro a ka qën si kompensim i investimit tuaj apo kjo para kontratë është nga Ilogaria e S. që për investimin që në e kemi ber ajo të na jep këtë banësës në lagjen M. por nuk ka arrit të ndërtojë, lidhur me këtë marrëveshjei dëmtuari deklaron se deri me tani kanë paguar rreth 100.000.00 euro dhe të gjitha parat janë bërë kesh, për këto pagesa shton se ka fatura por momentin nuk i ka se nuk i ka gjetur sepse e ka ndërruar zyrën dhe ende nuk i ka vendosur gjerat në vendet e tyre. Në fund e dëmtuara deklaron se pas këtyre ngjarjev E. më nuk i ka kontaktuar dhe as që është përgjigjur më, në kohën e lidhjes së marrëveshjes prezent ishin E. burri i saj Rr. E. dhe vllau i E. V.i dhe nusja e tij, po ashtu deklaron se dhe kërkon që të behet likuidimi sipas marrëveshjes që kanë bërë me E..

E dëmtuara - dëshmitarja S.H. në deklaratën e dhënë në Policin e Kosovës me datë 04.06.2014 ndër të tjerash është deklaruar se: pas dëgjimit të arrestimit të E.Bt ka ardhur në Polici të deklaroj se është e dëmtuar (viktim) e mashtrimit nga E., me të cilën ka lidhur kontrat nr 100/1 me datën 30.12.2010 me të për blerjen e banëse në M. . me sipërfaqë prej 71m² në katin e 6 në objektin A-4. Me kushtet e kontratës që të paguhet avansi 10,000.00 € dhe pastaj nga muaji shkurt i vitit 2010 të paguhen me kestë nga 200 euro në muaj për 15 vite , me afat të përfundimit të banësës prej 12-15 muaj nga momenti i nënshkrimit të parakontratës me nr.100/1 mirpo për çdo vonës pas afatit 12-15 muaj ajo ka premtuar se do ti paguaj qiran nga 200 euro deri të hyhet në banës, e dëmtuara deklaron se përpos shumë të avansit prej 10,000.00 euro ka paguar edhe tre muaj me rata nga 200 euro gjithsejt 10.600 € (Dhjetmij e gjashqindë) , lidhur me mos përmbushjen e marrëveshjes shton se ka kërkuar sqarim nga E. po çdo herë, ajo me manipulimet . e saja se kinse po i jep punën nje firmes tjetër dhe do të ndërtohen banëset , keshtu që në çdo her kemi shpresuar se nje dit do të ndërtohen banE..

I dëmtuari - dëshmitari Xh. Xh. në deklaratën e dhënë në Policin e Kosovës me datë 11.07.2014 ndër të tjerash është deklaruar se: pas dëgjimit të arrestimit të E.Bt ka ardhur në Polici të deklaroj se është i dëmtuar (viktim) e mashtrimit nga E., me të cilën ka lidhur parakontartën për blerjen e banëse me datën 23.10.2010 në M. . me sipërfaqë prej 71 m² në katin e 7 në objektin A1, me kushtet e kontratës që të paguhet avansi 5,000.00€ dhe shuma e kontraktuar prej 41,000.00 euro të paguhet me kështë për 15 Vitë nga 227 euro në muaj, me afat të përfundimit të banësës prej 15 muaj nga momenti i nënshkrimit të pra kontratës dhe në rastë të mos përfundimit të objektit në afatit e caktuar invensitorja ka pasur për obligim që të na paguaj nga 200 euro çdo muaj për qira

të banimit deri në përfundimin e objektit ose deri në hyrje të banësës për banim, që kjo asnjëherë nuk ndodhur që të me paguaj qiran, lidhur me këtë marrëveshjei dëmtuari shton se ka paguar avansi 5,000.00euro dhe kështë të cilat i ka paguar për katër muaj nga 227 euro, kurse nga ana e E. nuk janë përmbushur kushtët e kontratës , për këtë deklaron se ka kërkuar dhe ka pasur takime disa her me E. po me premtime e saj të kota duke na thënë se do ti përfundoj objektin sa me shpejt , po ashtu dy vëllezëritë E. V.i dhe E. me kanë premtuar se do të ndërtohen këto banësa. Në fund deklaron se kërkon që të realizon kërkesën e tij pasurore juridike.

E dëmtuara - dëshmitarja A. K. në deklaratën e dhënë në Policin e Kosovës me datë 30.05.2014 ndër të tjerash është deklaruar se: është e mashtruar nga E.B me rastin e kontraktimit të blerjes së një banëse me një sipërfaqë për 71 m² në lagjen M. . me numër të kontratës nr. ../..të datatës 30.12.201 Onë P. në shumën e kontraktuar të përgjithshme 46,000.00€ ku unë si avans ka paguar 10,000.00€ përmes transaksionit Bankar nga B.a Raiffeisen Bank. në xhirollogarinë me numërme datën 29.12.2010, me kushtët e kontratës kanë që të paguhet avansi 10,000.00€ pastaj menjëherë me kështë të paguajmë nga 200 euro gdo muaj, nëse nuk bëhet ndërtimi me kohë të kompenzohem me nga 200 euro në emër të qirasë për çdo muaj, po ashtu përpos shumës së avansit prej 10,000.00 euro ka paguar edhe tri rata për tre muaj rresht nga 200 euro që i bie se shuma totale e pagesës është 10,600.00 euro , e ku afati i përfundimit të banësës ishte prej 12-15 muaj. Më tej e dëmtuara deklaron se pas problemeve që kishtë E. nga ajo ka kërkuar sqarime por çdo her ka marur arsye të kota se ka problem dhe se puna do të kryhet, për këtë nga ajo ka kërkuar që ti kthejë paratë dhe ta anulojë kontratën dhe me të . kam lidhur tri Anëks Konfrata — deklaratë me shkrim (datë 17.04.2012, 05.06.2012, 17.07.2012) për ahulimin e parakontratës dhe që të mi kthejë mjetët mirëpo deri më tani në asnjë rast ajo asnjë cent nuk ma ka kthyer. Në fund e dëmtuara deklaron se kanë punuar me vitë të tëra dhe ka shitur një ffuall në Klinë me qëllim që t"iu sigurojë fëmijëve të saj një të ardhme më të mirë në kryeqëndër kështu që pse më ndodh kjo dhe mashtrohem nuk e ka besuar se kjo ndodhë kaq hapur, po ashtu shton se sa të jet gjallë asaj këtë kurrë nuk ja fali dhe në çdo kohë dëmshpërblinin që ma ka bërë.

I dëmtuari -dëshmitari A. S. në deklaratën e dhënë në Policin e Kosovës me datë 01.04.2015 ndër të tjerash është deklaruar se: pai që ka dëgjuar përmes mjetëve të informimit për ofertën e banësave është interesuar dhe e ka getur dhe ka biseduar me E. B. rreth kushtëve të cilat në atë kohë ishin të leverdishme, për qka ka lidhur kontratë për blerje të banësës 67m² , me datën 08.02.2010, në të cilën kontrat parashihej banësa prej 67m², në shum prej 40,000.00€, me këto kushtë: avansi fillestar 10,000.00€ është paguar me datën 08.02.2010, kurse pjesa e mbetur prej 30,000.00€ me kistë për 6 vitë nga 5,000.00€ në vit duke filluar nga 15 Shkurti 2011, me afat të përfundimit të banësës prej deri 15 muaj nga data e lidhjes së kontratës, për qka ka paguar vetëm avansin prej 10,000.00€. I dëmtuari deklaron se pas dështimit të E. ka prishur kontratën dhe nga E. i ka mar të gjitha mjetët prej 10,000.00€ që i ka paguar dhe atë dy herë nga 5,000.00€ që do të thotë gjithësej 10,000.00€.

I dëmtuari -dëshmitari B.G. në deklaratën e dhënë në Policin e Kosovës me datë 13.08.2014 ndër të tjerash është deklaruar se: pas dëgjimit të arrestirnit të E.Bt ka ardhur në Polici të deklaroj se është i dëmtuar(viktim) e mashtrimit nga E., me të cilën ka lidhur kontratë me 23.08.2010 me E.B për blerje të banësës në P. në Lagjen M. , 71m² , për qka fillimisht kur është lidhur kontrata me datën23.08.2010, ka paguar avans 10,000.00 euro dhe ka paguar kështë çdo muaj nga 200.00 euro që do të thotë ka paguar gjithsej 14,000.00 euro, të gjitha pagE. jan kthyer përmes Ilogarisë Bankare, po ashtu i dëmtuari shton se nga E. çdo her ka mar premtime se banësa do të kryhet brenda një viti dhe do të i merrni qëlsat në dorë, dhe nëse kryhet pagesa me rregull si shpërblim do ta ka një garazhë në podrum të ndërtësës, por banësa . nuk kryhet brenda një viti, atëherë, në bazë të kontratës, do të ju paguhet qiraja prej 200.00 euro në muaj.

I dëmtuari - dëshmitari Ç. K. në deklaratën e dhënë në Policinë e Kosovës me datë 06.02.2015 ndër të tjerash është deklaruar se: pas dëgjimit të arrestimit të E.Bt ka ardhur në Polici të deklaroj se është i dëmtuar(viktim) e mashtrimit nga E., me të cilën ka lidhur kontratë me datën 20.10.2010, pastaj pas dy apo tri ditë, se bashku me dI. kolegë të punës, kanë shkuar dhe vizituar vend punimin, aty kanë takuar E. B. dhe një inxhinier i cili në pika të shkurtëra na njoftoi se si do të zhvillohen punimet, më tej shton se kushtët e kontratës ishin banësa prej 71m², ka kushtuar 46,150.00€, dhe fillimisht është dashur që me datën 20.10.2010, ditën e lidhjes së kontratës të paguhet avansi prej 2,000.00€, Bes prej 8,000.00€ të paguhet me datën 01.11.2010, ndërsa kështë prej 200.00€ fillojnë të paguhen nga muaji Dhjetor 2010, me afat të përfundimit të banësës prej 15 muaj nga data e lidhjes së kontratës,për këtë marrëveshjei dëmtuari deklaroi se deri me tani ka paguar 18,000.00€, të gjitha pagE. përmes transferit Bankar, por pai që ka pritur deri në vitin 2012 dhe duke e parë se punimet nuk vazhdonin ka kërkuar nga E.B li kthehen paratë e paguara deri në muajin Prill 2011 në shumën prej 11,000.00€. E. disa herë i premtuar se do ti kthej mjetët por kjo nuk ka ndodhur asnjëherë, kështu që në muajin Korrik 2011, është takuar me E.B, në restorantin "R." rruga L. H., duke pritur që në këtë takim do ti kthehen mjetët por nuk ndodhi ashtu, po në atë takim pas shumë presionëve E. me ka propozuar që të vendosëm në një banesë në lagjen T., rruga "P. B." hy. ..., nr. . P., për këtë i dëmtuari shton se ka pranuar ofertën dhe jam vendosur në këtë banesë, që sipas E. kjo banesë është e sajë por me parë kishtë banuar vëllai i saj V.B, për këtë ka shkuar në banesë,dhe pai që i kanë pëlqyer kushtët e banësës , E. i kishtë ofruar mundësinë që ta blejë këtë banesë më ëmim prej 35,000.00€ dhe pas nëgociatave kanë rënë dakord që banesën ta blej me ëmim prej 33,000.00€ me kushtët e njëjta si të kontratës së parë për banesë në lagjen M. . në P.. Më tej i dëmtuari shton se për këtë me datën 06.10.2011 ka paguar 3,000.00€ dhe me datën 30.09.2011 ka paguar edhe 4,000.00€ në Ilogarinë e T. B.t, sipas kërkesës së E., me arsyetimin se në këtë banesë ka jetuar V.i dhe T. e edhe këto mjetë të shkojnë në Ilogarinë e T., për këtë pas insistimit nga i dëmtuari për rregullimin dokumentacionit, E. me datën26.10.2010 (Viti i lindjes ka qënë 2012) i ka nënshkruar një deklaratë më të cilën deklaroi se i jep në shfrytëzim këtë banesë deri sa të kryhet banësa në lagjen M. . në P.. Në fund i dëmtuari deklaroi se kërkon që nëse nuk i kthehen mjetet e paguara në shumën 18,000.00€, ti mundësohet që këtë banesë ta barti në emrin tim, kurse, ndryshimin prej 15,000.00€ do ta paguaja me ndonjë marrëveshje tjetër.

Nga të gjitha këto deklarata përveç kushteve dhe rrethanave në të cilat janë lidhur kontratat, vërtetohet edhe pjesëmarrja dhe roli i të akuzuarve E. dhe V.B dhe B.V.. Nga këto deklarata vërtetohet se E.B kishte rolin kryesor dhe se bisedat ishin zhvilluar me të e po ashtu edhe kontratat i kishte nënshkruar. Nga këto deklarata vërtetohet se u kishin kushte e ofruar të volitshme dhe me deklarimin e tyre se banesa. ishin për polic dhe zyrtar shtetëror i kishin joshur ashtu që ishin arritur të jo shtojë sigurin për të lidhur kontratat. Nga këto deklarata vërtetohet edhe se të akuzuarit V.B dhe B.V. përveç se ju kishin treguar vendin ku pretendohet se do të bëhej ndërtimi të njëjti, kishin qëndruar në zyre të E., dhe kishte raste kur e kishin shoqëruar E.. I akuzuari B. V.kishte marr pjes edhe me rastin e negociimit dhe se i kishte vu në kontakt me E. madje nepërmejet shokut të tij S. S..

Nga deklaratat e të dëmtuarve u vërtetua se arsyet e mos ndërtimit nuk u ishin thënë të njëjta. Dikujt i është thënë, probleme me pronarët e tokave, dikujt se kishin probleme me gypin, dikujt se kishin thënë se nuk po ju lëshohet leje, dikujt mungesa e financave etj.

Po ashtu në Policinë e Kosovës janë dëgjuar edhe të dëmtuarit:

E. V., F. A., F. U., F. M., F. E., Xh. P., M. K., Z. B., E.U., M., A. B., A. M. K., H. K., G., N. D., dhe R. M., si dhe të të dëmtuarve dhe dëshmitarve të etj, deklaratat e tyre janë përputhje me provat materiale të administruara dhe të dëshmitarëve të tjerë.

Dëshmitari N. B. para gjykatës kishte deklaruar vërtetohet se i njëjti kishte dhene dëshmi ne prokurori me dt. 12.02.2015, ka pasur marrëveshje për nje investim te përbashkët me familjaret e tij me E. B. . Ne restonatin “R.” me dt. 22.02.2009 ky bashke me vëllain etij S. B. dhe axhën B. B. ka ngren darkë me E. B.n dhe dhëndrin e tij S. S. dhe B.V.. Para këtij takimi S.i i kishte treguar se nje klienti i tij qe i dërgon veturat e Raffaizen Bankës me i rregulluar ka bere nje projekt për ndërtimin e banesave dhe çmimit do te jete te volitshme dhe projekti është i dedikuar për Policet e Republikës se Kosovës edhe për qytetaret e tjere, ju ka konvnuar dhe kane kërkuar te tekohen me te. Gjate darkës E. i ka paraqitur kushtet dhe këtyre ju ka konvnuar i kane thene se do te blejmë banesa dhe lokale i kane treguar se i kane te gatshme 200.000 mije euro, dhe sipas llogarive ka dal se i takojnë 571 meter katero, metri katror i bindet 300 deri 350 euro, parat ishin te familjes dhe ato ja kishte lene babai i cili kishte vdekur, dhe shumen prej 200.000 mij euro i kemi dhene ne dorë e jo nëpërmes Bankës, dhe prezent ka qene avokati B. M.. Ky ka pasur hizitim për të hyjë ne këtë marrëveshje mirëpo familjaret e tij kane qene te mendimit me e bo kete investim dhe atëherë edhe ky është pajtuar. Diten kur kane shkuar me nënshkruar marrëveshje ka pasur me u nënshkruar edhe B.V., mirëpo B.i ka thene se e ka parkuar keq veturën dhe nuk e nenshkruajti marrëveshjen dhe nga marrëveshje mund te shihet se është thatë pastaj E. dhe vëllai i tij ka thene se e nënshkruajnë me vonë. B.i ka qene dëshmitar ne kontrate dhe atë dëshmitar i E., ndërkaq ky ka qene si dëshmitar nga familja e tij. Aty E. i ka marrë parët dhe ne prezencën e avokati ka dal me i dërguar parët ne R. B.e, te mega store, ka qene ora 5-6 pas dite. E. është fytur ne B.e , B.a nuk punonte foli me rojet u ngjit lart dhe u kthy. Keta e kane pritur dhe vëllai i ka thëne se a po sheh se po ngutesh sepse ajo është punetore e Raffaizen dhe punon me kredi hipotekare. Por ky nga koleget e tij kisht e kuptuar e ajo nuk punonte ne Raffaizen Bankë Puna ne realitete lidhur me ndërtimin e banese i njëjti ka deklaruar se puna ne realiteti është kryer por nuk kane për te fituar nga se kane dal prej lojës është ndërtuar deri ne katin e 4, banesa është funksionale ka ndërtuar dikush tjetër. E kjo e ka ndërpre nuk e di pse u kane thene se ja ka ndërpre inspekcioni, mirëpo nga B. jo zyrtare ka marrë informat se e kane blere disa djem te Gjakoves. Objekti është ndërtuar dhe këta nuk kanë marrë asgjë. Te hollat nuk ua ka kthyer edhe pse kam biseduar me babain e saj i ka mashtruar u ka dhene fjale qe nuk i ka realizuar. Madje nje here ju ka thene se nuk mund te ju jap banesa kaq lirë. Arsyetimet e E. për mos ndërtim kane qene se ka dal ne nje vend tjetër për të ndërtuar. E. ju ka premtuar se do ti ktheje të hollat, por nuk i ka kthyer.

Dëshmitari i dëmtuari: N.B. në deklaratën e dhënë me datë 12.02.2015 në Prokurorin Speciale (PSRK) ndër të tjerash deklaroi se: përmes dhënëderit të tij S. S. ka ra në dijeni se E.B po ndërton dhe po shet banësa, më tej shton se pasi që familja e tij ishte e interesuar me ble banësa dhe lokale kanë kontaktuar E. në Restoranti Rings, dhe gjatë darkës e njëjta ua kishtë treguar kushtet e shitblerjes së banësave dhe lokaleve afaristë, për këtë dëshmitari thekson se pasi ju konvnuan kushtet e ishin mar vesh që të nësërmen të takohen tëk Avokati B. M. dhe të lidhin marrëveshjen për financimin dhe kryerjen e punëve investive me datën 23.02.2009, me këtë marrëveshje janë paguar 200.000.00 euro, e cila marrëveshje thekson në emër të vëllaut të dëshmitarit N.B., S. B. i cili përkohësisht jeton në I. me familje. Të hollat në vlerë prej 200.000.00 euro S.në prezencën të tij dhe të avokatit B. M. dhe të dëshmitarit B.V., ja ka numëruar E.Bt të gjitha të hollat të cilat kanë qënë në B.ë nota nga 500 euro, për këtë pas 10 ditë E. i ka dhënë vëllaut një para kontratë e cila mban datën 02.03.2009, gjeja se E. dhe S.B. ka hy

në marrëdhënie ndërkontraktore me M. B. dhe Z. B. si bashkë ndërtues pasi që M.i dhe Z.u janë pronar të truallit. Më tej dëshmitari deklaron se pasi që janë dalur nga zyra e avokatit drejt ai E. dhe vëlliu, kanë shkuar në lokalet e Raiffeissen Bankës tek Mega Sporti, aty E. me të holla në qantë ka hy në lokalet e Raiffeissen Bankës., duke u përshëndetur me rojatarët dhe ka hy në Bankë.ë ka shkuar në katin e dytë, e cila ishte vërejtur nga dritaret se vetëm u sill nëpër tavolina dhe u kthye shume shpejt, për këtë thekson që është i sigurt se të hollat nuk i ka deponuar në B.ë. Në fund Dëshmitari i dëmtuari: shton se pasi që ka vërejtur që E. ka dështuar në ndërtimin e banësave të njëjtën e kanë kontaktuar duke i thënë që të prishin parakontratën dhe të u a kthej të hollat, e cila ju kishte thënë se minimum duhet me prit 15 muaj që tja kthej të hollat, pastaj disa. herë e kanë takuar duke i shkuar në shtëpi në zyre, të prindt e saj, mirëpo pa sukses gjere me sot E. nuk u a ka kthyer asnjë cent, për këtë në cilësin e të dëmtuarve o kërkojm kompensimin e dëmit me kamat, prej momentit të marrjes e gjerë në datën e kthimit, njëherit shton se i bashkëngjiten ndjekjes penale.

Sipas dëshmisë së dëshmitarit N.B. vërtetohet se B.V. ishte dëshmitar i lidhjes së kontratës dhe për këtë duhej të nënshkruhej në kontratë por se i kishte ikur vendosjes së nënshkrimit. Nga këto deklarata dshmitarit – dëmtuarit N.B. vërtetohet se bëhet fjalë për një kontratë të dt.02.02.2009 periudh kohore kjo para datës së përfshir në aktakuzë dhe se sipas kontratës rezulton se S. B. vëllai i këtu dëhsmiritit ishte bashkë investitor me E.Bn. Kjo kontratë nuk ka të bëjë me Kompanin E. dhe V.- O-G.

I dëmtuarit R. Z.u ne seancën e dt. 21.05.2021 ka deklaruar se ka marrë kompenzimin nuk është i dëmtuar.

Ne seancën e dt. 21.05.2021 *F. B. ne emër te S. B.* ka deklaruar se nuk janë te dëmtuarë janë kompenzuar pas nje viti.

E dëmtuara *A. Ç.* ne seancën e dt. 21.05.2021 ka deklaruar se kjo dhe bashkëshorti i saj *A. Ç.* nuk janë te dëmtuarë janë kompenzuar.

I dëmtuar *A. S.hu* ne seancën e dt. 21.05.2021 ka deklaruar se është kompenzuar nuk është i dëmtuar.

I dëmtuari *M. U.* ne seancën e dt. 21.05.2021 ka deklaura se është kompenzuar nuk është i dëmtuar.

I dëmtuari *A. J.* ne seancën e dt. 21.05.2021 ka deklaura se nuk është i dëmtuar pasi qe është kompenzuar.

E dëmtuara *Gj. P.* ne sencen e dt. 21.05.2021 ka deklarua se nuk është e dëmtuarë asnjëherë nuk ka blere banese.

I dëmtuari *E. P.* ne seancën e dt. 21.05.2021 ka deklaruar se nuk e ndien vetem te dëmtuar pasi qe është kompenzuar.

Nga këto deklarata të dëmtuarve vërtetohet se janë komepnzuar dhe nuk kanë kërkesë për dëmshpërblim.

I dëmtuari - dëshmitari *S. B.* në deklaratën e dhënë në Policin e Kosovës me datë 23.06.2014 ndër të tjerash është deklaruar se: me të dyshuarën E.B ka lidhur Aneks Kontrat me datën 19.07.2012 për 52 ari tokë të cilën E. e ka shfrytëzuar në lënien e dheut për 3 jave dhe në qoftëse

lenja e dheut vazhdon me shumë se tri jave E. obligohet të paguaj qiranë prej 5,000 euro çdo muaj deri të hiqet dheu, qiraja do të filloj të paguhet prej datës 10.08.2012 në Ilogarinë Bankare të S. B. në Bankën Raiffeisen, por E. nuk e ka tërhequr dheun dhe se dheu prap është në pronën e tij dhe për pagës asnjëherë nuk ka e bërë, i dëmtuari shton se për këtë ka kërkuar sqarim nga E. por para pesë gjashtë muajve vëllai i tij V. B. ishte taku me E. për borgjin në fjalë e njëjta i ka ofru një marrëveshje prej kësaj ditë e tutje në kompensim të shfrytëzimit të pronës ti jap vllaut të tij banesë për këtë marrëveshje ka bërë kontratë me shkrim dhe është vërtetuar në gjykatë, ndërsa për borgjin paraprak deri në me ditët e sotëm nuk ka dhen asnjë sqarim.

I dëmtuari-dëshmitari *F. M.* në deklaratën e dhënë në Policin e Kosovës me datë 26.03.2014 ndër të tjerash është deklaruar se: E.B. e ka njohur përmes një investitori S. nga T.-. ku edhe ka punuar si sigurim privat prej vitit 2012 deri në vitin 2014, lidhur me këtë punë thekson që nuk ka lidhur kontrat, por rroga mujore ishet parapa të ishte 1000.00 euro të cilat E. nuk e ka pagur asnjëherë, po ashtu i dëmtuari deklaroi se ka lidhur kontratën me kompanin „V. O G. ” pronare E.B për blerjen e banesës në M.. - P. me sipërfaqë prej 85 m² bruto katin e tretë Objekti A-1 , kontratën e ka lidhur me datën 15.03.2013, për të cilën kontrat deklaroi se nuk i ka dhënë avans por ka paguar 52,000.00 euro për blerjen e banesës, por këto para ia ka dhënë kesh E. dhe si dëshmitar ka qënë S. nga Tirana, këtë shumë të parave ia ka dhënë në zyrën e E. në B. e D. në P., me afatë të dorëzimit të banesës prej 15 muaj nga dita e lidhjes se kontratës, i dëmtuari thekson se përveç pagesës prej 52.000.00 euro E. i ka borgj edhe nga 1.000.00 euro për dy vitë sa ka punuar tek ajo, për këtë në fund deklaroi se paraqet kërkesën pasurore juridike .

I dëmtuari -dëshmitari *F. Xh.* në deklaratën e dhënë në Policin e Kosovës me datë 26.02.2015 ndër të tjerash është deklaruar se: është i punuar që nga viti 2011 si Menaxher në kompaninë „ R. T. ” me seli në P. ndërsa në Q. kanë fabrikën e B., E. thekson se e njeh si klientë me të cilën kanë bërë një marrëveshje me shkrim për furnizim me beton në lokacionin e dytë në lagjen M. . në P., marrëveshja është bërë me datë 22.05.2013 e Cila është e vërtetuar nga Notërija Sevdije Karsniqi, në bazë të marrëveshjes E. ka marr 87.5 m³ ku çmimi për m³ ka qënë 65 .00 euro dhe për këtë mund të dëshmojnë edhe flet dërgesa dhe me faktuarën e pagesës, për këtë furnizim E. nuk e ka paguar për qka është paraqitur padi ndaj saj në Gjykatën Ekonomike në Prishtinë dhe shuma të cilën ajo na ka borgjë është 5.687.50 Euro, dhe për këtë edhe një herë deklarohen në kërkesën pasurore juridike

E dëmtuara - dëshmitarja *H. H.i* në deklaratën e dhënë në Policin e Kosovës me datë 26.03.2015 ndër të tjerash është deklaruar se: E. e ka njohur përmes djalit të burrit M., ku edhe ka punuar në zyrën e E. për ti pritur klientët të cilët kanë ardhur për të lidhur kontratat për blerjen e banesës, e dëmtuara deklaroi se të E. ka punuar nga 15.05.2013 deri në vitin 2014, me E. thekson se ka lidhur kontratën me „V. O G.” për blerjen e banesës në M. . - P. me sipërfaqë prej 71m² bruto katin e tretë Objekti A-2 , kontratën e ka lidhur me datën 15.05.2013, lidhur me këtë marrëveshje dëmtuara deklaroi që nuk ka paguar avans por ka punuar të E. ku ka qënë me marrëveshjepaga mujore ka qënë 500.00 euro, E. asnjëherë nuk me ka paguar dhe si për kompensim të rrogës E. ka dashtë ti jap banës kur të përfundon objektin, por me datë 18.12.2013 E. i ka dhënë para të gatshme 5000.00 euro, këtë shumë të parave i ka dhenë si huazim me kontrat të lidhur të notëri I.k .H.A.i, afati i përfundimit të banesës ishte 15 muaj nga dita e lidhjes se kontratës, për të cilën marrveshej e dëmtuara deri me tani ka paguar 5000 euro si huazim jo për blerjen e banesë dhe një vitë e gjysëm që ka punuar të E. që paga mujore ka qënë 500.00euro , për të gjith atë që u cek më lart e dëmtuara në fund deklaroi se don realizoj kërkesën pasurore juridike.

I dëmtuari dëshmitari *H. K.* në deklaratën e dhënë në Policin e Kosovës me datë 18.03.2014 ndër të tjerash është deklaruar se: pasi që ka pasur marrëdhënie të mira familjare me prinderit e *E., E.* e kishte lutur që të punojnë në kompanin e saj për mbajtjen e kontabilitetit me sugjerimin e babait të saj *A.*ut këtë detyrë e kishte pranuar, por nuk kishte pasur marrëveshje të shkruar mirëpo verbalisht ishin marr vesh që ti mbaj librat e kontabilitetit, me mujore të jetë 500.00 euro, që nga fillimi i muajit nëntor të vitit 2012 deri në dhjetor të vitit 2013, dëshmitari deklaroi se nuk ka pasur qasje në faturat e blerjes apo shitjes, po ashtu nuk di se sa është kapitali fillestar i kompanisë së *E.* Dëshmitari deklaroi se *E.* ka pasur libra të shitjes dhe të blerjes të cilat ja ka tregu por nuk ka pasur qasje në to, dhe çdo herë i ka thënë leje se ma von i shiqojm por kurr nuk i ka shiqu, dëshmitari po ashtu thekson që *E.* në ATK ka deklaruar me zero për shkak të marrjes së numrit fiskal, i dëmtuari gjithashtu deklaroi se i ka dhënë dI. herë para *E.* sipas kërkesës së saj dhe borgji i saj total ndaj tij arrin përafërsisht shumën 4,000.00 euro.

Gjykata i ka vlerësuar deklaratat *S. B.t, F. M., H. K.* dhe *H.e H.i* gjykata të cilët konstatuan se kishin punuar me *E.* por nuk ishin paguar, mirpo në raport me *E. B.* kishin një cilësi tjetër nga se kishin punuar me të, dhe të njëjtit nuk janë paraqitur në aktakuzë si të dëmtuar dhe nuk janë e klientve për blerje të banesave, siç përkon me dispozitivin e aktakuzës.

I dëmtuari - dëshmitari *D.H.i* në deklaratën e dhënë në Policin e Kosovës me datë 01.04.2015 ndër të tjerash është deklaruar se: pas vitit 1999 ka punuar në fotokopjen *R.*nga Viti 2001- 2002, nga Maji 2002 deri me tani punoj në *A. e P.* Me *E.B.* deklaroi se njihet që nga Viti 2003, fillimisht shton se e ka njohur vllaun e saj, *V.in* i cili ka punuar si kamarier në restorantin "*H.i d. R.*" , të *S.në D.i,* aty vetëm e ka parë *E.* dhe e ka njohur si motra e *V.it,* pastaj, në vitin 2003, gjatë punës në *Oborin e Rilindjes,* rastësisht e ka takuar *E.* dhe i ka thënë se po të njoh se je motra e *V.it,* sepse edhe *E.* ishte duke punuar me një zyre në kontejnëra, e nëse me kujtohet ka punuar në departamentin e procesimit të letërnjoftimeve- pasaportave, e në atë kohë *E.* ju kishte ofruar menjë ofertë për të investuar në një organizatë Amerikane e cila do të vijë në Kosovë për të investuar dhe se mjetët tona do të katërfishohen në një periudhë të shkurtë kohore, në atë kohë kishte pyetur për bazën ligjore të institucionit që do të investojmë dhe *E.* i ka prezentuar dI. dëshmi zyrtare të atij institucioni, për këtë i dëmtuari deklaroi se ai pas nja dy tri takimeve, si duket ka ra në lajthitje, dhe ka investova fillimisht fondet e tija personale dhe familjare në shumën prej 15,000.00€, pastaj paraqiti një ofertë të re për fitime edhe me të mëdha dhe duke na thënë se punët po shkojnë shumë mirë, dhe prap ka shkuar të disa miq të mijë dhe ka kërkuar mjetë hua. Shuma e mjetëve hua ka qënë: 25.000.00€ tek *I. K.* dhe 15,000.00€ tek *S. M.* (fotokopja "*R.*" ku kam punuar me heret).Që nga Viti 2003 kur ia kam dhënë mjetët *E.,* unë kam pritur rreth gjashtë në mënyrë që të me kthehen investimet. Duke e parë se investimet nuk po kthehen unë kam filluar të i bëj presion *E.* duke i thënë se nëse nuk i kthen mjetët do ta njoftoj familjen edhe organët e rendit.

Gjykata e ka vlerësuar deklaratën e këtij dëshmitari por për gjykatën, i njëjti ishte për një priudh të ma parshme që nuk përkon me atë të paraqitur në aktakuzë nga se ka të bëjë me pretendimin e tij për mashtrim për një periudhë shumë më parë.

Dëshmitari *S. S.* në shqyrtimin gjyqësor të datës 29.04.2021 ka deklaruar se me *E.Bn* janë takuar në restorantin "*M. B.*" në vitin 2008 ose në vitin 2009, me *B.in* njihen e ka pas si klient të tij në servis e tij dhe aty kanë vazhduar me shoqërimin. Me *B.V.n* kanë shkuar në restorantin "*M. B.*" bashkë me *B.in* dhe aty janë takuar me *E.* dhe *E.* ka qënë me një shoqe nuk i kujtohet emri i saj.Gjatë qëndrimit aty kanë komunikuar dhe prirë kafe, *E.* ka punuar në një Bankë amerikane *E.* i ka ofruar punë *B.it* me shërbyer për projektin me marr klient dhe mi dërgu te vendi i ndërimit. Te *E.* i ka dërguar 4-5 persona për me ble banesë, ka qënë *F.Sh.* të njëjtën e ka njohur sepse është marrë me marketing nuk e ka në marrëdhënie familjare, *V.K.* e ka njohur gjatë luftës

sepse ka qëndruar në Tetovë nuk e ka në mardhënie familjare, N. L. është djali i dajës babës e dinë që e ka dhënë një veturë e cila është vlerësuar me 10.000 euro por nuk e din si e ka bërë pjesën tjetër të pagesës, A. M. është djali i tezës së babait, I. B., gruan e tij e ka të familjes, ai ka dhënë një BMW-5, tjerat mjete nuk e dinë qysh i kanë dhënë, edhe L. E. e ka dërguar te E. dhe nuk e din se qysh e ka bërë pagesën, nëna e tij ka qenë mësuesja e fëmijëve të këtui dëshmitarit, nuk ka pasur premtim për shërbimin që ia ka bërë E.. Këtui dëshmitari ka qenë pjesë e blerjes së banesës e ka bërë një marrëveshje gojore, fillimisht ia ka dhënë një veturë Citroen Sara në vlerë prej 4.500 euro, dhe herë pas here ia ka dhënë mjetet E. në vlerë prej 13.000 euro, këto mjete ia ka dhënë për banesë , 2.000 euro ia ka dhënë në llogari Bankare, pjesën tjetër ia ka dhënë kesh. F.Sh. pagesën e avansit e ka bërë nëpërmjet këtui dëshmitarit dhe ato mjete ia ka dhënë E. në dorë. Në pyetjen se a ka qenë prezent kur N. L. ia ka dhënë B.V.t avansin në vlerë prej 10.000 euro dhe një xhip në vlerë prej 10.000, , i njëjti ka deklaruar se shumën e parave nuk e dinë e për veturën e mban mend dhe e dinë se ka qenë Mitsubishi dhe duket si xhip. V.K. ka bërë pagesën e avansit në shumë prej 10000 euro dhe shumën prej 300 euro e ka sjell te dëshmitari dhe i njëjti ia ka dërguar E. dhe i ka sjell dy herë nga tri rata, do të thotë dy herë ka 900 euro dhe këto ia ka dërguar E. dhe nuk ka marrë ndonjë dëshmi për dorëzim. Dëshmitari sqaron se F.Sh. ka qenë këtui me dëshmitarin S. dhe kanë qenë në Qendrën tregtare ku edhe dëshmitari e ka pasur në zyre dhe F. të hollat ia ka dorëzuar personalisht dëshmitarit në prezencë të S.it. Dëshmitari deklaroi se ka qenë i bindur se ka mu kry ky projekt se përndryshe nuk kishte me dërgu njerëzit e afërt për banesa.

Këtui deklaratë të dëshmitarit gjykata e mori për bazë dhe ia faliti besimin, më këtë u vërtetua se E. e kishte njohur përmes B.V.t të cilin e ka pas klijet pasi që ka dërguar automjete në servis in e tij. I kishte dërguar kate ose pesë klijet për të blerë banesa të gjithë ishin të njohur të tij dhe familjarë. Edhe pse i kishte dërguar të njëjtit nuk kishte ndonjë premtim ose shpërblim

Dëshmitari B. M. para gjykatës ka deklaruar: E. e njeh se i ka interesuar me ble një prone ne P., për shkaqe teknike nuk ka mundur me siguruara dokumentacion. E. ka qenë ndërmjetësuese ne vitin 2004 -2005. Ka kërkuar tokë për ndërtim e ka thirr E. ne telefon pastaj ka biseduar me pronarin. Me vonë nuk ka pasur raport me E.. Me vonë nëpërmes një shoku ka kontaktuar E. kam biseduar dhe E. i ka thënë se arsyea që nuk po muj ti kryej banE. me mjetet që i ka pasur. Pastaj është takuar me klientët e saj, ka qenë periudha para vitit te ri, dhe kjo ka qenë diku para 3 - 4 vite por saktë nuk e di. Takimi me klientët e E. ka ndodhur me një zyre dhe ky ju ka thënë se si te sigurohet leja e ndertimiti e merr për sipër obligimin nen kushtet që këta kane mbetur. Por lejen e ndertimitit është dashur te siguroi E., por pastaj kane dal probleme pronesore nga pronaret e tokës dhe nuk ka mundur me u pajisur me leje. Pas takimit me palët gjithë here ka qenë në kontakte dhe i ka njoftuar dhe po te zgjidhet leja e ndertimiti qëndron prape atyre që ju ka thënë edhe sot qëndroi prapa atyre që ju ka thënë. Nese do te sigurohet leja e ndertimiti ndërtesa ka pasur me u realizuar te projekti ku ka thënë E., por edhe nese kishte pasur ndonjë projekte me të volitshme. Aty nuk është lëshuar asnjëherë leja e ndertimitit nga se pronari i asaj parcelle ka një probleme me pronarin e trete. Hetuesija kur e kanë ftuar ky ka thënë se e merr për sipër me i ndertuar pasi që te pajiset me leje te ndertimitit. Ata i kanë thënë nese qëndron pranë saj aktakuza nuk do të ngritete. Dëshmitari duke u përgjigjur në pyetje të dëmtuarve ka deklaruar se une asnjëherë nuk kam marrë për obligim që do te ju ktheje te hollat por kam premtuar ndertimin nese sigurohet leja. Nuk e dine se kush mund te siguroi lejen, mirëpo nese kryet si proces dhe merret leja atëherë qëndron pranë obligime që ka marrë përsipër.

Deklarata e Dëshmitarit: B. M. kishte dhënë deklarat me datë 27.04.201516 në Prokurorin Speciale (PSRK) ndër tëjerash deklaroi se : para 7 apo 8 vitësh E. B.n e ka takuar dhe njoftur

gjerë sa ishte në Raiffeissen B., rreth punës së tij, po ashtu E. ja njoh të dy prindërit të cilët i kishtë takuar para një viti, kur ka marre iniciativë me i ndihmua E. lidhur me ndërtimet që kanë mbetur mbrapa, ku është mbajtur një takim në mës të E. dhe klientve të saj të cilët ishin afërsisht 100, e që data nuk i kujtohet, takimi ka qënë në zyre të Kompanisë së K.it në M. ., në takim ishte diskutuar me klientë rreth ndërtimit të banësave dhe mënyrës se si ata do të përgjigjen me pagesa të mbetura deri në përfundim të banësave, po ashtu për këtë takim janë njpoftuar edhe hetuesit e policisë, të cilët ishin të kyqur në rastin e E., ku në radhënë e policisë ka pasur klient të E. të cilët kanë qënë prezent atë ditë, më tej dëshmitari shton se prej atij takimi doli se E.B me firmën vet të njëjtit të ja mundësoj rregullimin e dokumentacionit, marrjen e lejes se ndërtimit, pastaj me vazhduar punën, me çrast nga hetuesit në polici është kërkuar mos me arrestuar E. për arsye se me zgjedh problemin dhe me i ndërtuar banësat, mirëpo këtë gjë nuk e morën parasysh, por prap në cilësin e dëshmitarit dua të shtoj se dua që të shpreh vullnëtin që pasi të merret leja ndërtimore jam i gatshëm që të startoj me punët ndërtimore. Më tej dëshmitari deklaron se në takim me klientët të njëjtve ju është dhënë mundësia që të marrin banësa në objektë të jera në Fushë Kosovë dhe në rrethin të P.s, rast konkret një prej klientëve e ka marre banësën në Fushë Kosovë. Dëshmitari, shton që do ta mbaj premtimin për ndërtimin e banësave por që kërkon nga E. të dëshmoj a është reale shuma e të hollave që ajo i ka prezantuar që ka marre prej klientëve, e cila shumë arrin rreth 1 milion e 700 mije euro, pasi që nëse shuma është me e madhe vështir është që të kryhen këto punë. Gjithashtu dëshmitari deklaoron se klientëve të E. B. ju ka premtuar se do të filloj punën dhe pas fillimit të punëve klientët duhet të fillojnë me pagE. e mbetura dhe në këtë formë arrin gjere të përfundimi i objektit, nuk ka kurrfarë intëresi edhe pse qëllimi ka qënë humanitar, kjo do të arrihet nëse me të vërtetë klientët i kanë borgj E. atë vlerë të cilën e njëjta ja ka prezantuar mu, me të cilën vlerë do ti përfundoj këto banësa, eventualisht me humbje prej 100 mije euro, me sa është i informuar E. ja kam borgj dhe 2 milion euro, dhe se tani për tani E. është në obligim rreth 136 klientëve. Në fund dëshmitari deklaron se kompania e tij ka 32 punëtor, ka mjetë punë për ndërtim të vrazhdët, me firma të tjera bashkëpunoj me beton dhe transport, me mjetë financiare qëndroj mirë, deri me tani ka ndërtuar rreth 80 objektë në Mitrovicë, përpos tri të fundit që janë në fazën përfundimtare, tani ka filluar të punoj në P. pasi që është pajisur me leje të Lagjia e Muhaxhereve.

Nuk kishte njohuri se a është ndërtuar apo kush e ka marrë banësën në lagjen M... Lokacioni ku ka pasur me u ndërtuar ende është ne atë gjendje. Ne rast se do te merret leja obligimet e kontratave me E. do te vlejne, mirepo do te behen kontrata te reja. Nuk është e vërtete që në takimin që ka pasur t'ju këtë thën që krejte obligimet e E. do ti merr për sipër dhe qe ju ka kërkuar me filluar me pagese. Nese bëhet ndrrimi i ri është e nvojshme te behet kontrata te reja nga se kur lëshohet leja duhet ti jepet numer validiteti. Me tutje dëshmitari ka deklaruar se nese do te behet ndërtimi do te ju jepen banesa ndërkaq ata qe nuk do te merrni banesa do te shiteshin banE. dhe do ti ktheheshin te hollat. Ky ka njohuri se vetem ne nje vend ku ka filluar ndërtimi është vendosur bazamenti për tjetër vend nuk di. Dhe kjo ka qen ne lagjen M. ., dhe ai objekt është ne atë gjendje. Ky edhe me përpara ka bere ndërtime ne M., ka bere ndërtime ne lagjen V. Se E. ka aplikuar për leje dhe nuk është paisur i ka thene E. dhe kete ja ka thene mbas takimin qe ka pasur ky me te dëmtuarit, por nuk e di a është e saktë.

Nga kjo deklaratë e dëshmitarit vërtetohet se E. e kishte ftuar për të bisedura me të dëmtuarit të cilët kishin blerë banës, dhe po ashtu vërtetohet se e akuzuara nuk kishe siguruar leje të ndërtimit. Në këtë pjesë të deklaratës gjykata ia fali besimin. Në pjesën tjetër ku i njëjti thekson se kontrata e reja duheshin të bëheshin pasi që ka ndruar lokacioni dhe se nuk kishte kërkuar të holla, gjykata nuk ia fali besimin pasi që bie në kundërshtim me provat materiale dhe deklaratat e të dëmtuarve. Shumica e kontratave të lidhura nuk përmbanin numrin e parcelës ku do të ndërtohej dhe as

kush do të ishte investitori, përveç dI. kontratave të lidhura në fund të vitit 2009 dhe në fillim të vitit 2010 ku ishin shënuar se do të ndërtohej në tokat e pronarve duke ua shënuar emrat L. G., I. D. etj.

Dëshmitari D. B. ne seancën e dt. 30.11.2021 ka deklaruar se ka qene pronar i kompanisë “A. G.“. Te akuzuarin Xh. A. e njeh, nuk i kujtohet sakt ku e ka takuar. Por e ka takuar kane fol, qëllimi i kontaktit ka qene për shkak se objekti ka qene i falimentuar dhe fillimisht është takuar me XH.A.n dhe E. e pastaj edhe me pronaret e tokave e ka pas me të gjithë pëlqimin për te vazhduar. Ka bere kontakte me Xh. pastaj edhe me pronaret e tokave, nuk e di pse ka qene e falimentuar dhe nuk i ka intersuar. Kontraten për ndërtim e ja lidhur me XH.A.n si i autorizuar. Edhe me pronaret e tokave ka pasuar marrëveshje. I kujtohet kontrata qe e ka lidhur me dt. 06.03.2021 me pronaret e tokave I. D., L. G., S. Z. dhe A. V.. Ne vendin ku ka ndërtuar ka pasur ndërtim paraprak kane qene 2 - 3 kate. Xh. A. ka qene i autorizur dhe është kujdesuar me u ba kompesimi i atyre 2 – 3 kate qe kane qene te ndërtuara ne baze te letrave, ngase sipas letrave operojnë. Xh. A.n e kane kompensuar nuk e di sa me shifra.

Ka pasur njohur se ka pasur kontrata te lidhura ne mes te personave tjere dhe E. por ky nuk ka pasur te beje me ta. Pjesen e ndërtimit e ka bere sipas marrëveshjes, ndërtimi ka përfunduar por me vonesa te mëdha nga se ka qene nje gyp dhe pas përfundimit te probleme me gypin ne vitin 2017 ose 2018 ka përfunduar dhe ndërtimit. Evitimi i problemit me gypin ka zgjatur 6- 7 vite. Aty ka pasur leje urbanistike por gypi ka qene ne mes dhe ka pasur pengesa. Aty është menduar me u ndërtua 4- objekte. Me pronaret qe janë marrë vesh i kane ndërtua dy objekte ndërkaq dy objekte te tjera i ka ndërtua firme tjetër. Keta kanë marrë leje te ndërtimit. Me tutje ka theksuar se ky ka vazhduar punimin me ndërtimin pasi qe firma paraprake ka falimentuar, dhe nuk i kujtohet se si ka ra kontakt mirëpo fillimisht Xh. e kishte kontaktuar pastaj kishte kontaktuar me E. dhe pronaret e tokave. Me E. ishte takuar se a është ajo e pajtimit dhe pëlqimit qe ky me vazhduar ndërtimin. Se i kujt ka qene i autorizuar Xh. shkruan ne letra. Nuk i kujtohet se çka ka biseduar E..

Lidhur me falimentimin dëshmitari ka deklaruar dhe se ka folur popullorqe jo se di se çka është falimentimin por me vete fakti se objekti nuk ka vazhduar konsideron se ka falimentuar. Kompenzimin për objektin qe ka qene ne ndërtim ja ka bere Xh. A.. Nderkaq me E. kur është takuar, është takuar por jo për kompesim. Banesa. i kane blere kontraktuesit e tjere qe ata kane bere kontrata me ta. Kontratat i ka lidhur ne vitin 2011 diku ne muajin e tret, por nuk e mbaj mend. Duke u përgjigjur ne pyetje se a ka ditur qe banesat janë te shitura, dëshmitari është përgjigjet se nuk do te pergjigjet ne këtë pyetje, pastaj ka deklaruar se banE. nuk kane qene te ndërtuara kane qene fushë. Duke u përgjigjur ne pyjet te akuzuarës E., dëshmitari deklaroi se kur e ka mare objektin për ndërtim ka qene nje podrum, dyqane dhe tri kate, koL.a pa tulla, ndërtim i vrazhd pa tulla dhe kete e ka kompensuar pasi qe ka rene dakordë. Aty ka qene rrëmihje për objektin e dyte, mirëpo andej ka ndërtuar firma “ H. “. Leje për ndërtim nuk ka pasur por këta e kane bere e kane marrë lejen e ndërtimit. Sa i kujtohet e kane marrë lejen ne vitin 2013 paqi i kane bere dI. ndryshime ne projekt.

Nga kjo deklaratë e dëshmitarit vërtetohet se ky kishte bërë ndërtimin e dy objekteve ku kishte me ndërtuar E.B dhe se kishte lidhur marrveshje me XH.A.n si i autorizuar dhe pronarët e tokave, gjë që nuk u kontestua në shqyrtim gjyqësorë. Lejen e kishte siguruar në viti 2013. Objektin kur e ka marr ka qenë i nërtuar podrumi dhe dy-tri kate. Për atë pjesë e ka kompenzuar XH.A.n sepse ashtu ka shkruar në letra. Nuk ka pas obligime ndaj kontraktuese të E.

Dëshmitari *B. G.* në shqyrtimin gjyqësor të datës 29.04.2021 ka deklaruar se E. e njeh si blerëse në vitet 2011-2012 dhe kanë pas raporte shitës-blerës, me një projekt në P., prindi i saj A. B. e ka blerë një truall prej këtu dëshmitarit në Qagllavicë Komuna Prishtinë në vitin 2008 ose 2009, është paguar dhe ju ka përkthyer krejt në rregull. Dëshmitari deklaron se të akuzuarin V.B nuk e njeh ndërsa E. ka ardhur me një person tjetër si blerëse i njëjti e identifikon dhe personi që ka qenë me E. ka qenë V. O.. V.i ka blerë Lagjen Q. nuk është larg zonës ku ka blerë A.u dhe e pranon si deklaratë të tij të dhënë në polici me datë 10.12.2014 dhe kjo deklaratë ka qenë më e freskët dhe qëndron pranë kësaj deklarate. V.in e njeh si blerës dhe të njëjtit si A.së ia ka shitur një parcelle rreth 8 ari afër A. B. mbrapa tij përafërsisht dy vite pasi që A.u iu ka blerë parcelën dhe posedojnë kontratë por nuk është në emrin e tij. Nuk i kujtohet kush e ka nënshkruar kontratën mundet me qenë V.i apo dikush me autorizim, sepse edhe vetë ka mundur mos me qenë personalisht por ka pasur raste edhe me autorizim e ka shitur pronën, por e dinë që është bërë transaksioni. XH.A.n e njeh si afarist ka pirë kafe me të dhe ka dëgjuar mirë për të. Dëshmitari deklaron se është pronar i kompanisë B. H. e cila është quajtur atëherë A. T. e B. M. është e bija e B. H.. Ndërkaq B. H. është pronar i B. M., B. M. merret me tregti të materialeve ndërtimore, vitet e fundit merret kompania B.H. kur ka ardhur V.i nuk e dinë me kënd ka qenë se a ka qenë vetëm apo me ndonjë person tjetër sepse me të kontaktet i ka pasur i autorizuari i këtu dëshmitarit, të autorizuarit e tij kanë qenë H.M. dhe J. Gj.. Me leje të Gjykatës i prezantohet kontrata e lidhur në mes të B. G. dhe F.O. në cilësi të blerësit dëshmitari deklaron se këtë kontratë e ka lidhur i autorizuari i tij J. Gj. dhe krejt ajo që është shënuar qëndron. Pagesa është bërë përmes Bankës. E. e njeh si blerëse të materialit ndërtimor, pagE. për material ndërtimor i ka bërë, e din që një projekt e ka filluar dhe i ka mbetur në gjysmë diçka tjetër nuk dinë.

Dëshmitari *J. Gj.* ne seancën e dt. 31.05.2021, ka deklaruar se nuk i kujtohet saktë se çka ka ndodhur para 12 viteve mirëpo i kujtohet se ka qene i autorizuar për B. G. ashtu qe ka bere shitje dhe inkasim. I kujtohet se F.O. e ka blere atë toke ne atë kohe dy troje dhe vlera e tyre ka qene 80.000euro, Inkasimi është bere nepermjete Bankës. Dhe gjithçka ka qene korrekte. Ne atë kohe ka punuar te B. G. ne sektorin e patundshmërisë. Gjate bisedave për shitjen e trojeve ka qene F. me vëllain e vete ku kishte shkuar dhe kishte pare trojet ka mbetur dy tre dite me menduar dhe pastaj kane ardhur dhe kane bere parakontraten. Te hollat janë paguar nepermes Bankës nga ana e F. dhe bartjen ne emër te F. e ka bere ky ne Gjykatën Themelore ne Prishtinë. Lagjja i ka pasur afërsisht 100 troje dhe ky ka qene i autorizur për shitjen e tyre. Shitja ka shkuar si me te gjithë te tjerët. Para se me ardh ne seancë e ka shikuar dosjen dhe pastaj kur ka ardhur këtu e ka pa edhe F. atëherë ju ka kujtuar i njëjti. Nderkaq nuk ka njohuri se si B. G. ka ardhur gjere te ajo prone para se ta shes, sepse nuk ka qene detyre e ti për ta ditë.

Nga këto deklarata të dëshmitarve B. G. dhe J. Gj. vërtetohet se dëshmitari e njohte E.Bn dhe po ashtu edhe V.O.n të cilët kishin shkuar te ai si blerësa. E. kishte blerë material ndërtimor babait të E. A.ut i kishte shitur një plac dhe V.i dhe F. kishin blerë një plac afërsisht 8 ari në lagjen Q. dhe për këtë kishte lidhur kontrat i autorizuari i B.it, J. Gj. me F.O.n, gjë që nuk ishte kontestuese.

Dëshmitari *V. V.* ne seancën e datës 31.05.2021 ka deklaruar se ne vitin 2006- 2008 e kane pasur me qera lokalin e V.O.t dhe A. te cilët janë vëllezërit e F.O.t. Kanë pasur marrëveshje gojore. Lokali ka qene furrë buke, çmimi i qeras qe e ka shfrytëzuar atë lokal ka qene 650 euro për muaj, dhe pagE. janë bere ne kesh çdo muaj. Marreveshjen e ka pasur me A. ngase atë e ka njohur me heret përmes nje punëtori. Ne afërsi te furrës ka qene market “ V. “ dhe ka punuar A. dhe F.. Furra ku ka punuar ka pasur emerin “ D.a “. PagE. ja ka dhene A., ndonjëherë edhe vëllait te vete por kryesisht A.Sa ka qene ne atë lokal ka paguar rryme edhe ujë por nuk ka qene ne emër te ti.

Dëshmitari S. K. ne seancën e dt. 31.05.2021 ka deklaruar se nga te akuzuarit e njeh F.O. nga se te i njëjti ka qene me qera. Ka qene me qera te firma “ K. Sh. “ ne vitin 2002 ne lokalin e F.t dhe kane qendur deri ne vitin 2004. Çdo muaj ja kane paguar 1350 euro, lokali ka qene afërsisht 300 metra katror, ne veprime ka qene shitje me shumicë te elektronikës. Pasi qe i shiqon foto e shtëpisë dhe lokalit i njëjti deklaroi se e ka shfrytëzuar përdheshen dhe katin e parë. Gjate periudhës sa ka qene ky aty ka qene edhe nje shitore ushqimore por nuk e di kujt ka qene. Për me ardhe ne këtë seancë është njoftuar nga ana e F.t dhe e ka ditur se ka me dhënë dëshmi për te dëshmuar se ka qene me qera. F. pagE. ja ka bere ne kesh, por ka ndodhur qe ja ka dhene dhe vëllait te ti. E ka pasur nje kontrate te shkruar me dore e ka kërkuar por nuk e ka gjetur për te sjellë. Firmen e ka pasur te regjistruar edhe lokalin e ka pasur te përcaktuar dhe adresën se ku gjenden. Ende vazhdon te punon e njëjta firme mirëpo ne vitin 2005 ja ka ndedhuar emerin dhe lokalin dhe vendin ku punon e ka te lajmëruar. Tani ka te lajmëruar ne ATK- e ne Fushe Kosove atëherë ka pasur te te lajmëruar ne ATK-e ne P. dhe lagja ka qene te pazari, tani është nje market dhe nuk e di se i kujt është a është i F.t apo i kujt.

Dëshmit e dëshmitarve V. V. dhe S. K. vërtetun se kishin lidhur kontrata me A. O. dhe F. O. e sa i përket të akuzuarit V.O. gjykata i vlerësoj si jo relevante.

Dëshmitari A. O. ne seancën e dt. 31.05.2021 ka deklaruar se janë 4 vellezer ky F., V.i dhe G.. V. dhe G. nuk J. ne K.. V.i J. ne D., ndërkaq G. ka jetuar ne F. dhe ne I. Para lufte prej viteve 80 –ta apo përafërsisht para fillimit te vitit 90 jane marrë me tregti dhe atë me shitblerje. Prej vitit 1995 - 96 kane punuar ne firme familjare. Ne vitin 1996 ka punuar ky vëllai dhe dy motra M. dhe V. Prej vdekjes se babait kujdesin me te madhe e kanë pas prej nënës. Kam punuar prej moshës rinore do te thotë edhe para lufte kam pasur para te kursyera, dhe i kane pasur diku 200.000 marka te kursyera. Pas lufte ka qene ne M., pasi qe është kthyer ka filluar punën ne firmë qe e kam pasur para lufte veprimtaria e tyre ka qene ushqimore me pakicë. Lokali te l. e P. e kane pasur deri ne vitin 1996 dhe kane filluar me punuar marketin e tyre. Sipërfaqja e marketit para lufte ka qene 60 metra katrore. Pas lufte e ka ndërtuar shtëpinë e tyre, lokali ka qene e parapare me u nda ne katër lokale, nga se ka qene 170 metra katrore si dhe podrumin prej 145 metra katrore, dhe dy kate i kane banim secili banim i ka 170 metra katrore. Ne vitin 2009 e kane pasur shtëpinë e babës ne rrugën “ L. e P. “, shtëpinë ne rrugën “ I. K. “ ne vitin 1997, truallin ne fshatin L. është blere ne vitin 2007, pronësia është e regjistruar. Prona ne rrugën “I. K. “ është në emër te ti, shtëpia e babës është ne emër te babës, dhe trualli ne fshatin L. është ne emër te V.it. Kanë hapur marketin kanë punuar te gjithë familjaret, V. dhe motra M. dhe V., dhe te ardhur vjetore kane qenen 13.000 , 14.000, 15.000 euro. Ne vitin 2009 e kanë blere nje prone ne lagjen “ Q.” te gjithë familjaret bashkarisht. Vlera e asaj prone ka qene 80.000 euro, dhe janë paguar nëpërmjet Bankës, te gjitha ato para për blerje te truallit kane qene kursime familjare. E. B. nuk e ka njohur. Njehere e ka pare ne automjet me vëllain e tij V., dhe aty e ka parë dhe e ka përshëndetur dhe ja ka marrë mendja se është E. por nuk është i sigurt. Asnjehere nuk ka qene ne shoqëri me E.. Q. O. është babai i ti dhe “ keni shop “ ka qene qeragji qe e ka marrë lokalin e tyre dhe atë prej vitit 2002 e deri ne vitin 2004. Pastaj e ka shfrytëzuar nje qeragji tjetër si Furrë Buke dhe atë prej vitit 2006 deri ne vitin 2008. Nga viti 2000 deri ne vitin 2021 ka pranuar te holla nga jashtë nga vëllai i ti G. dhe prej shokëve te G. Shumen e sakt nuk e di mirëpo mund te jete diku 27.000 euro. Te hollat janë dorzuar nëpërmjet W. U.. Trollin ne fshatin L. V.i e ka blere nga personi i quajtur N. K., pagesën e ka bere ne për mjete Bankës. V.i prej vitit 1990 ka jetuar jashte shtetit, ka qene i punësuar ne D.. Ne truallin qe është blere nga kursimet familjare janë ndërtuar dy shtëpi ne vitin 2010. Për E. B. nuk ka ditur asgjë dhe kur ka thene se e ka pare nje here me V.in

ne veturë me vone e ka kuptuar se është E. dhe atë pasi që ka filluar gjykimi. Pasuria ne rrugën " I. K. " është fituar ne vitin 1997 dhe është ndërtuar shtëpia. Nderkaq ne fshatin L. është blere ne vitin 2007 ose 2008. Parat e kursyera i kam pasur ne shtëpi e jo ne llogari Bankare. Vellai i ka dërguar para F. kesh ne Bankë. Dhe sa e di ne vitin 2009 ka lidhur kontratën dhe atë ne emër te F.. Dhe nuk e ka ditur se duhet me u nënshkruar te gjithë. Dhe deri para një viti kane jetuar bashkarishte ne rrugën " I. K. " ne një shtëpi ne një kulm. Duqani qe ka qene biznesi " K. Sh. " ka qene ne pronësi te tyre dhe akoma është ne pronësi te tyre. Ne lagjen " Q. " banon ky në një hyrje, dhe në hyrje tjetër J. F.. Vlera e shtëpisë është afër 100.000 euro dhe prej vitit 2006 e tutje ne asnjë njeri dhe me asnjë telashe nuk ka pasur me Ligjin dhe për asgjë.

Nga kjo dëshmi e dëshmitarit për veç se u vërtetua se V.in dhe F.n i kishte vëllezër dhe pasuris dhe pronave që kishin, gjykat në pjesën tjetër sa i përket të akuzuarit V. O. nuk ia fali besimin nga se i njëjti theksoj se V.i pronën në fshatin LL. e kshihte blerë në vitin 2007 dhe 2008 e kishte paguar nëpërmes B.ës gjë gje nuk ka prova për këtë në shkrE. e lëndës dhe i akuzuari V. nuk kishte ofruar dëshmi. Ndërkaq, nga provat rezulton se prona ishte në fshanin IL. ishe regjistruar në emër të V. O. kishte kaluar në emër të tij në vitin 2012.

Vlerësimi i provave materiale

-Nga kontrate per ndertimin e perbashket te kompleksit te lokaleve afariste dhe banesave të dt.15.04.2009 vërteohet E. B. kishte lidhur kontratë me pronar te tokave dhe atë: I. D., L. G., S. Z., A. V.. Kontrata ishte lidhur ne Gjykatën Komunale ne Prishtinë dhe është shënuar numri VR.NR./....., dt. 04.05.2009 dhe i nënshkruar si nënpunes për vërtetime I. A.. I. D. ishte pronar i ngastrës .../., me numer te fletës poseduese vendi Nj. M. P., L. G. pronar i ngastrës/. me pjesëmarrjes ½ me numer te fletës poseduese .../. vendi Nj. M. P.. S. Z. pronar i ngastrës .../. me pjesëmarrjes ½ me numer te fletës poseduese .../. vendi Nj. M. P.. A. V. pronar i ngastrës ... me numer te fletës posedues e vendi L. M. P.

Me pas kishte lidhur kontrate edhe me pronaret e tokave I. D., B. M., N. S., A. S., dhe I. D. kontrata nuk përmban datën se kur është lidhur mirëpo e njëjta është vërtetuar ne Gjykatën Komunale ne Prishtinë me dt. 07.05.2009, dhe përmban numr VR.nr./....., kontrata është vërtetuar nga nenpunesi për vërtetime I. A.. I. D. pronar i ngastrës ... me numer te fletës poseduese ... ne sipërfaqe prej 1675 metra katror ne bashkëpronësi ½ vendi I. M. P.. B. M. pronar i ngastrës ... me numer te fletës poseduese ... ne sipërfaqe prej 1675 metra katrore ne bashkëpronësi prej ½ vendi I. M. P., dhe ngastrës .../., me numer te fletës poseduse s ... me sipërfaqes prej 1200 metra katror vendi Nj. M. P. . N. S. pronar i ngastrës .../., me numer te fletës posedues 170 me sipërfaqe prej 752 metra katror, ne bashkëpronësi prej ½ vendi L. M. P.. A. S. pronar i ngastrës .../., me numer te fletës posedues ... me sipërfaqe prej 752 metra katror, ne bashkëpronësi prej ½ vendi L.M. P., dhe I. D. pronar i ngastrës 777/2, me numer te fletës poseduese 2051 ne sipërfaqe prej 300 metra katrore vendi L. M. P..

-Nga joftim per pezullim te kontrates te lidhur per bashkeinvestim ne ndërtimin e përbashkët të kompleksit te lokaleve afariste dhe banesave 12.05.2010, vërteohet se pronarët e tokave I. D., L. G., B. M., N. S., A. S., dhe I. D., S. Z., A. V., B. I., e ksinin njoftuar të E.B për ndërprerje të bashk investimit, pasi nuk ishte marr leja dhe nuk po ndërtohej sipas projektit dhe kushteve të parapara.

- Nga marreveshje mbi shkëputjen e kontrates për ndërtimin e përbashkët të kompleksit të lokaleve afartiste dhe banesave vërtetohet se dt. 15.06.2011 pronarët Isa D., B. M., N. e A. S. dhe I. D. shkëpusin kontratën me lidhru me dt.15.04.200, pranuesi me XH.A..

- Nga marreveshje mbi shkëputjen e kontrates për ndërtimin e përbashkët të kompleksit të lokaleve afartiste dhe banesave vërtetohet se dt. 15.06.2011 pronari I kokës B. B. shkëput kontratën e lidhru me dt.15.04.200, pranuesi me XH.A..

- Nga aktvendimi i Komunës së Prishtinës Drejtoria e Urbanizimit Mbrojtjes dhe Mjedisit me numër ...-..... te dt. 25.06.2010, është caktuar kompozimin për rregullimin e tokës ndertimore pronareve B. M., A. V., I. D., B. B., B. M., S. Z., L. G., A. S., dhe N. S. nga Prishtina dhe investitori " V. O G. " me menaxhere E. B., nga Prishtina për ndërtimin e objektit shumë banesore me afarizëm (A1) B +SU+P+8+NK si faza e parë nga tërësia e objekte afariste sipas kerkese 05 nr. ...- te dt. 03.06.2010 që ngastrat katastrale .../, .../, ..., .../, ..., .../, .../,.../.shuma prej 246.204.84 euro, kompesimi nga pika 1 është llogaritur në sipërfaqe bruto të objektit. Kjo shumë e caktuar si kompensim është kusht për marrjen e lejes

I akuzuari B.V. e deklarata e ti te dhëne ne prokurori dhe ne polici e ka mohuar fajësinë duke pretenduar se vetëm punëtor. I akuzuari nuk e mohon se nga E. kishte marr një gjip te cilin e kishte marrë nga një blerës te banese dhe se veturën e kishte ne emër te ti, dhe ne polici ka deklaruar se veturën e kishte shitur ne vitin 2009 ne shume prej 9.000 euro, me pëlqimin e E.. Ndërkaq me rastin e dhënies se deklaratës ne prokurori ne lidhje me automjetin i njëjti kishte thënë se E. e kishte një automjet Volvo ne posedim dhe fillimisht nuk e ka ditur se ku e ka marr mirëpo me vone e ka kuptuar se e kishte marrë si kompensim nga një blerës vlere e automjetit ishte 19.000 euro dhe se E. ja kishte dhënë makinën me regjistruar ne emër te ti. Ne këtë pjese i njëjti bje ne kundërshtim pasi që kur njoftohet se vet i dëmtauri R. S. kishte deklaruar se B.i ka shkuar e ka marrë automjetin, pas kësaj i njëjti theksuar se ka shkuar me marrë automjet sipas sugjerimeve te E.. Po ashtu i njëjti ne polici kishe theksuar se E. ja kishte huazuar 7.000 euro te cilët ajo nuk ja kishte kthyer, te njëjtat ja kishte dhënë jo te gjitha përnjëherë por brenda dy - tri deteve nga 2.000 apo 3.000 euro, kjo kishte ndodhur ne vitin 2012. Ndërkaq ky kur ishte martuar ne prill te vitit 2010 E. për dasem ja kishte dhëne 1.200 euro ose 1.500 euro si huazim dhe ja kishte blere dhe dhomën e fjetjes. Nga vet deklarate e tij kuptohe se i njëjti kisht në marrveshje me E. kishte regjistruar automjetin në emër të tij, e po ashtu kishte pranuar edhe dhomën dhe pagesesë e cekur për dasëm . Andaj, shtrohet pyetja pse u regjistrua automjeti në emër të tij nëse ishte i firmës dhe përdorej siç pretendohej për punët e firmes? Pse duhej E. të ia paguaj dhomën dhe për dasëm nëse ai ishte vetëm punëtor në vendpunishte?

I akuzuari V. O., me deklaratën e ti te dhënë ne prokurori me dt. 04.09.2015, bije ne kundërshtim me deklarata e ti te dhëna para gjykatës si dhe me deklaratës e te akuzuarës E. B.. I njëjti kishte theksuar se E. e njihte diku kah viti 2009 ndërkaq e akuzuara E. kishte theksuar se V. e njihte qe ne kohen kur ka punuar ne Raffaizen Bankë, ku e njëjta kishte thënë se V. e kishte pasur shokë, pastaj ka hy ne lidhje dashurie me te. Lidhur me te hollat prej 16.000 euro qe i kishte pranuar nga E. B. neper mes W. U. ne D. brenda 2 vite, i njëjti thekson se “16.000 euro nuk ja merr mendja ndërsa 2.000 euro ose 3.000 euro ka mundur me ndodh”. Ndërkaq i njëjti ne këtë deklaratë përveç te hollat qe i kishte pranuar nga A.B. qe ja kishte dërguar E., nuk përmend faktin se ai kishte pranuar te holla kinse për shkak te borxhit qe ja kishte pasur E. siç ka deklaruar ne shqyrtim gjyqësor.

Lidhur me automjetin xhip H. X. i njëjti ka theksuar se E. e kishte blere dhe e kishte vendosur ne emër te ti. Te cilin e kishte drejtuar, sa kishte qene ne Kosovë, ndërkaq kur ai nuk kishte qene ne Kosovë e kishte drejtuar vëllai i ti F., dhe ne vitin 2013 ja kishte kthyer E. sipas kërkesës se saj. Me vete këtë kuptohet se qëllimi i regjistrimit ne emër te akuzuarit V.O.t nëse nuk ishte i tij, a ishte ky qëllimi i fshehje dhe ku kishte mbetur ky automjet pastaj?

Pra me vet faktin se të akuzuarit V.O. dhe B.V. kishin lejuar qe automjetet të regjistrohen në emër të tyre vërtetohet qëllimi i konvertimit, maskimit dhe transferimit. Pse këto automete nuk u regjistrua në emër të firmës por në emër të V. O. dhe B.V.t nuk ishin të tyre dhe sipas tyre kishin bërë shërbim E. pasi që nuk kishte patent shofer? Pra me këtë vërtetohet qëllimi i mshefjes pronës dhe pasurisë e cila ishte fituar me aktivitet kriminal.

Bazuar nga të gjitha të lartëcekurat gjykata mbrotjtje së të akuzuarit E. B., V.B, B.V., Xh. A., dhe V. O., i vlerësoj si të pa bazuara pasi që me administrimin e provve u vërtetua ndrysh gjendja faktike. Gjykat vlerësoj se të njëjtit mohimin e fajësisë e kanë bërë me qëllim të ikjes nga përgjegjësia penale.

Vlersimi ligjorë

Gjykata nga te gjitha provat e cekura si me lart te administruara ne shqyrtim gjyqësore i ka vlerësuar te njëjtat ne raport me elemente te veprave penale që u vihen te akuzuarve.

Vepra penale e mashtrimit nga neni 335 par 5 lidhur me par 2 dhe par 1 te KPRK-se, sipas këtij neni vepra penale e mashtrimit parashihet :

Paragrafi 1 : përveç siç parashihet nga neni 336 te këtij kodi, kushdo qe me ane te paraqitjes se rreme te fakteve apo duke fshehur fakte me qellim te përvetësimit te dobisë pasurore për vete apo personit tjetër, ose për te shkaktur dem materiale personit tjetër e mashtron apo vazhdon lajthimi me personin tjetër dhe me kete e nxit nje person qe te kryej apo te mos kryerj një veprim ne dem te pasurisë së ti apo pasurisë së personit tjetër dënohet me gjobe ose me burgim deri ne 3 vjet.

Paragerafi 5 nese vepra penale nga paragrafi 1 rezulton ne dobi pasurore te kundërligjshme ose shkakton dem qe tejkaL. 50.000 euro kryesi dënohet me gjobe ose me burgim prej 3 deri ne 10 vjet.

Vepra penale krimi i organizuar 283 para 1 te KPRK-se, *kush do qe me dashje dhe me dijeni qoftë te qëllimit dhe veprimtarisë së përgjithshme te grupit kriminale te organizuar ose qëllimit te Grupit për te kryer një apo me shume vepra penale te cilat janë te dënueshme me burgim prej se paku 4 vjet, aktivisht merr pjese ne veprimtari kriminale te Grupit duke ditur se pjesëmarrja e tille do te kontribuojnë ne realizimin e veprimtarive kriminale te Grupit dënohet me gjobe deri ne 250.000 euro dhe burgim se paku 7 vjet.*

Paragrafi 2 *kush do qe organizon themeL. mbikqyer menagjon ose drejton veprimtari te Grupit kriminale te organizuar dënohet me gjobe deri 500.000 euro dhe me burgim prej se paku 10 vjet.*

Nocioni Grupi t kriminal të orga izuar sipas dispozitës së nenit 120 të KPRK:

13. Grupi kriminal i organizuar - *B. i strukturuar, që ekziston për një kohë të caktuar, i tre apo më shumë personave për kryerjen e veprave të caktuara penale, që vepron në bashkëpunim me qëllim të kryerjes së një apo më shumë veprave të rënda penale për përfitim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dobisë financiare apo dobisë tjetër pasurore.*

14. *B. i strukturuar - B. i cili nuk është formuar rastësisht për kryerjen e menjëhershme të veprës penale, por nuk është e nevojshme që anëtarët e këtij B.i të kenë role formalisht të përcaktuara, vazhdimësi të anëtarësisë së tyre apo strukturë të ndërtuar*

Me provat e lartëcekura u vërtetua se në veprimet e të akuzuarve E. dhe V.B dhe B.V. me veprimet e tyre kishin plotësuar elementet e veprës penale të krimit të organizuar. Pasi për një periudh të caktuar kohore me paraqitje të rrejtshme të fakteve në Grup të organizuar kishin mashtruar të dëmtuarit e cekur me lartë kinse do te ndërtoheshin banesa fillimisht ne lagjen M. në një lokacion, pastaj duke ju dhënë arsye te ndryshme te dëmtuarve kinse nuk mund te vazhdojnë punimet dhe duhet ndërruar lokacionin. Vepër kjo e dënueshme mbi katër vjet. Sipas kodit penale, 1 deri në 10 vjet, e më kodin e përkohëshem penale 1 deri në 5 vjet.

U vërtetua se të akuzuarit vepronin si një Grup kriminal i organizuar, pasi që përbëheshin prej tre anëtarve, Grupi kishte struktur, nga se E.B kishte rolin e organisueses dhe mbikqyrtes së Grupit, ndërsa dy të akuzuarit B.V. dhe V.B ishin antarë të Grupit të cilët të cilët kishin detyra dytësore në kuadër të Grupit.

Mashtrimin fillimisht me regjistrimin e biznesit “ E. “ e pastaj kishte mbyllur te njëjtën dhe kishte hapur “ V. O G” e njëjta e kishte regjistruar kompanin ne emër te saj. Pastaj me marrjen e kushteve dhe kishte zhvilluar te gjitha procedurat për marrjen e lejes, mirpo nuk kishte paguar kompensimin e caktuar për leje. Me lidhjen e kontratave me pronar te tokave dhe me kinste fillimin e punimeve u vërtetua se blersësit ishin joshur dhe mashtruar duke menduar se vërtetë do të bëheshin ndërtime. Pastaj edhe me hapjen e informacionit se banE. do të bëheshin për polic dhe zyrtar të institucioneve me rroga të vogla.

Te akuzuarit njiheshin ne mes vete, pasi qe e akuzuara E. B. e kishte vëlla V.B, ndërkaq me B.V. niheshin për një kohe te gjate dhe kishin marrëdhenje te mira shoqerore. Çka do të thot se kishin besim brenda Grupit në njëri tjetrin, nga se ekzistonte lidhja familjare dhe shoqësore.

E akuzuara E. B. bashke me dy te akuzuarit e tjerë kishin paraqitur rrejshëm faktete kinse po shesim banesa me çmime te volitshme dhe atë për personat qe punojnë polic dhe ne institucione te tjera qe kane rroga te vogla. Banesa që nuk u ndërtuan.

Se Grupi i organizuar kriminal kishte për qëllim përfitime pasurore dhe finaniare vërtetohet se me mashtrimin e të dëmtuarve kishin përfituar shumën prej 1 milion. 872 mij 719 euro, të gjitha të realizuara në emërt të ndërtimit të banesave të cilat nuk janë ndërtuar dhe as nuk u janë kthyer të hollat.

Grupi kishte vepruar nga shtatori i viti 2009 e gjer në me 15 maj të vitin 2014, gjatë kësaj kohe kishin kryer vepra penale të mashtrimit të llogaritura në vazhdimsi. Çka do të thos se nuk bëhet fjalë për një vepër penale por që e njëjta logaritet në vazhdimësi pasi që ishte për një periudh të ckatuar kohore, mënyra e njëjtë e kryerjes dhe krysit e njëjtë (dispozita ligjore një apo më shumë vepra penale).

Se te akuzuarit B. V. dhe V.B me E. ishin gurpi i organizuar kriminale vërtetohet nga te të gjitha provat e cekura më lartë. E veçanërisht nga të dëmtuarit dhe dëshmitaret e degjuar ne shqyrtim gjyqesore dhe në procedurë parapake. Nga deklarata të dëmtuarve dhe dëshmitarve u vërtetua rolin i V.B dhe B. V. ku te njëjti i kishin dërguar te demturait për te pare vend punime ku pretendohej te ndërtohej, ndërkaq ne disa raste kishin qene prezent bashke me E. ne zyret e saj apo e kishin shoqëruar edhe ne restoran, dI. nga te dëmtuarit B. V. i kishte informuar se knse banesat do të ndërtoheshin nga E.B duke i njoftuar për kushtet. Pronaret e tokave deklaruan se B. V. dhe V. B. e kishin shoqëruar çdo here E., kishin marr pjesë në bisedime me rastin e shkëputjes se kontratës se ndërtimit. Nga të njëjtit e siç pranon edhe vet e akuzuara E. B. i kishte qene personi qe e kishte gjetur truallin dhe e kishte vend në kontakt me pronarët e tokave. Çka do të thot se të akuzuarit ishin pjesë e Grupit kriminal të organizuar me dijenin e tyre pasi që të njëjtit kishin njohuri dhe ishin prezent në të gjitha rrethant përveç që nuk kishin nënshkruar kontratat, detyrë kjo e E.Bt.

Sipas dispozitës ligjore nuk pritet që Grupi formalisht ti ketë të përcaktuara rolet do të thotë të shkruar. Mirpo nga provat e administruar u vërtetua se akuzuara E. B. kishte rol kryesor do te thotë ishte organizuese dhe mbikqyrese e këtij Grupit te organizuar kriminale ngase u vërtetua se e njëjta kishte marrë përgjegjësi ashtu qe kishte regjistruar kompanin “ V. o G “ ne emër te saj e njëjta te gjitha kontrata i ka lidhur ne emër te saj po ashtu dhe ka zhvilluar bisedata. Nderkaq te akuzuarit V.B dhe B. V. kishin rol dytësor si pjesemarrë ne këtë Grup kriminal te organizuar pasi qe te njëjtit kishin marrë pjesë dhe kishin përgjegjësi brenda Grupit edhe pse jo ne menyre formale me veprimet e cekura me lart. Pra do e thotë se Grupi ishte i strukturuar dhe ne rastin konkrete nuk ishte bashkuar rastësisht. Te njëjtit ishin bashkuar ne Grup për nje kohe te caktuar me q ellim te kryerjes se veprave penale te mashtrimit,. Ky Grup i organizuar kriminal njiheshin ne mes veti, E. dhe V. i marrëdhenje familjare ndërkaq me te akuzuarin B.V. ne marëdhenje shoqerore për nje kohe te gjatë. Andaj mund te thuhet se ne mes tyre ka ekzistuar edhe besimi reciprok.

Se është fjala për Grupin dhe jo për individ e vërteton edhe emri i biznesi të përdorur për “ V. O- G “ e që në dI. kontrata është shënuar V. O G., e po ashtu ishte edhe shenja identifikuese V. O G. edhe statuti i këtij biznesi të cilin gjykat nuk e kishte të kompletuar vërteton se se bëhet fjalë edhe për anëtarë, po ashtu e në fund shkruan se u miratua pas mbledhjes së majtur se në mbledhjen e majtur 21.09.2010 nga mbledhja e përgjithshme te cilën e ka nënshkruar drejtori E. B..

Nga të gjitha provat e cekura më lart u vërtetua se biznesi në fjalë ishte themeluar me qellim të mashtirimit dhe jo me qellim të ndonjë biznisi normal për ndërtim nuk kishte kapital, në qertifikaten e regjistrimit të biznesi shenonet kapitali i përgjithëshem 5000 euro. Të gjitha të hollat sapo janë paguar në Bankë nga të dëmtuarit janë tërhequr, ndërtimi nuk ishte bërë.

Nga të gjitha të lart cekura gjykata ka ardhur në përfundim se të njëjtit janë fajtorë dhe se në veprimet të akuzuarve E. B., V. B., B. V., janë plotësuar të gjitha elementet e veprës penale të krimit të organizuar konform nenit 283 par 1 të KPRK-se në raport me E. B.n para 2 të KPRK-se, e lidhur me veprën penale mashtirimit nga neni 335 par 5 lidhur me par 2 dhe par 1 të KPRK-se pra gjykata ka bërë rikualifikimin e veprës penale konform Kodit penal Kosovës që ishte në fuqi nga viti 01.01.2013. Gjykata ka gjetur se vepra penale e mashtirimit ishte kryer në vazhdimsi, por pasi që është e mundur me krim të organizuar e që krimi i organizuar përfshin një kohë të caktuar e jo aty për aty ka vlerësuar se nuk mund të përdoret edhe dispozita të verpat penale në vazhdim sepse vetë krimi i Organizuar nënkupton se Grupi kriminal organizuar vepron merret me aktivitete kriminale për një periudhë të caktuar siç është në rastin konkret.

Vendim i gjykatës lidhur me rikualifikimin e veprës penale të krimit të organizuar .

Sa i përket veprave penale të krimit të organizuar në lidhmëri me veprën penale të mashtirimit ku periudha e kryerjes së veprës penale shtator të vitit 2009 e gjer me 15 maj të vitit 2014 periudhë kjo që përfshin dy kode penale, Kodin e Përkohëshem Penal që ka qenë në fuqi deri me 31.12.2012 dhe Kodin Penal që ka hyrë në fuqi nga 01.01.2013.

Sipas prokurorisë të akuzuarve E.B, V.B dhe B.V. të akuzuar për veprën penale *krimi i organizuar* nga neni 274 par.1 lidhur me par 2 e në raport me E.Bn par.3 i KPK-së lidhur me veprën penale *mashtirim* të kryer në vazhdim nga neni 261 par.1 lidhur me par 2 të KPK-së,(kodi i përkohëshem penal).

Gjykata ka bërë rikualifikim të veprës penale pasi që të akuzuarit nuk mund të shpallen fajtorë në bazë të kodit i cili nuk ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, e kur bëhet fjalë për dispozita më të favorshme mund të aplikohen në mënyrë retroaktive. Në këtë rast nuk mund të aplikohen dispozitat e kodit të përkohëshem penal pas vitit 2012 pasi ishte i shfuqizuar që nga 01.01.2013.

Andaj gjykata ka bërë rikualifikim të veprës penale konform dispozitave të kodit penal që ishte në fuqi “krimi i organizuar“ nga neni 283 par 1 të KPRK-se, e në raport me E. B. par 2 të KPRK-se, e lidhur me veprën penale “mashtrimi” nga neni 335 par 5 lidhur me par 2 dhe par 1 të KPRK-se.

Gjykata me rastin e rikualifikimit të bërë është bazuar në udhëzuesin e gjykatës Evropiane të drejtave të njeriut lidhur me nenin 7 i dt.30 prill 2017.

Ky udhëzues lidhur me veprat penale në vazhdim thekson:

Gjykata është shprehur: “ *kohët e fundit e mendimit se fakti që juridiksionet e brendshme e kanë dënuar një person për një veprën penale të futur me rastin e një reforme të Kodit Penal, ndër të tjera edhe për arsye aktesh të kryera përpara hyrjes në fuqi të kësaj reforme, dhe të cilësuar si veprën penale “e vazhdueshme” në të drejtën e brendshme, nuk përbënte një zbatim prapaveprues të një ligji penal në dëm të të akuzuarit, Ajo ka shënuar se, sipas së drejtës së brendshme në fjalë,*

një veprë penale “e vazhduar” përbënte një akt të vetëm, cilësimi i të cilit duhej të vlerësohej me kutin e rregullave në fuqi në datën kur ka përfunduar shfaqja e fundit e tij, mjafton që edhe aktet e kryera në kohën e ligjit të mëparshëm të kenë qenë gjithashtu të dënueshme. Zbatimi nga ana e juridiksioneve kombëtare i nocionit të veprës penale “të vazhduar”, të futur në Kodin Penal përpara aktit të parë të kryer nga i interesuari, kishte qenë madje mjaft i parashikueshëm në vështrim të së drejtës kombëtare Gjykata ka verifikuar gjithashtu se masa e dënimit që i ishte dhënë të interesuarit mbi bazën e veprës penale “të vazhduar” nuk ishte më e rëndë sesa ajo që do t’i ishte dhënë atij në qoftë se aktet e kryera prej tij përpara reformës legislative do të ishin vlerësuar në mënyrë të veçuar nga ato të kryera pas saj(Rohlena k. Republikës Çeke [DhM], §§ 57-64) (po aty, §§ 60-64).

Pra sipas këtij udhëzuesi rreth nenit 7 të Konventës evropiane për të drejtat dhe lirit themelore të njeriut që ndërlihet me zbatimin e ligjit penal, udhëzues ky që brenda tij ka vendime që janë shqyrtuar e që kanë konstatuar se, termi –zbatimi- nënkupton shqiptimin e dënimit. Andaj për të gjitha këto arsye gjykata ka gjetur se në rastin konkret duhet aplikuar kodi penal që ka qenë në fuqi nga janari 2013 kur është fjala për veprën penale të krimit të organizuar në lidhje me mashtirmin.

Vepra penale e shperlarjes së parave nga neni 32 sipas ligjit për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit lidhur me nenin 31 të KPK-se.

2.Kushdo që, duke e ditur ose që ka arsye për të ditur se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, pasuri kjo e cila në të vërtetë fitohet me veprë penale apo kushdo që, duke besuar se pasuria e caktuar fitohet nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal bazuar në përfaqësimet e bëra si pjesë e një hetimi zbulues të zhvilluar në pajtim me Kapitullin XXIX të Kodit të procedurës penale të Kosovës:

2.1. konverton, transferon ose përpigjet të konvertojë apo transferojë pasurinë me qëllim të fshehjes apo të maskimit të natyrës, B.it, vendit, dispozicionit, lëvizjes ose pronësisë së pasurisë;
2.2. konverton, transferon ose përpigjet të konvertojë apo transferojë pasurinë me qëllim të ndihmës së personit i cili është i përfshirë në të ose që, siç pandehet, është i përfshirë në kryerjen e veprës penale që ka shkaktuar shmangien e pasojave ligjore apo të pasojave të qarta ligjore të veprimeve të tij/saj;

2.5. merr, posedon ose shfrytëzon apo përpigjet të marrë, të posedojë ose të shfrytëzojë pasurinë;
2.6. fsheh ose maskon natyrën e vërtetë, B.in, vendndodhjen, sistemimin, lëvizjen, të drejtat në lidhje me, apo pronësinë e pasurisë, ose nga një akt i pjesëmarrjes në veprimtari të tilla;

2.8. kryen veprë penale të dënueshme me një afat burgosjeje deri në dhjetë (10) vjet dhe me gjobë deri në tri (3) herë më të madhe në vlerë të pasurisë e cila është subjekti i veprës penale.

Gjate shqyrtimit gjyqësor u vërtetua se në veprime të akuzuarve E. B., B.V., Xh. A. dhe V.O. janë plotësuar të gjitha elementet e veprave penale të cekur si më lart e në bashkëkryerje. Bashkryerja e të akuzuarës E. në veprën penale të shperlarjes së parave në raport me me tre të akuzuarit e tjerë ishte veç e veç.

Nga se u vërtetua se secili në bashkryerje me E. B. kishin konvertuar transferuar me qëllim të fshehjes së pasurisë të fituar nga aktiviteti kriminal. B.i nga E. kishte pranuar dhe regjistruar automjetin në emër të tij Volvo, pastaj shpenzimet për dasem e shpenzime të tjera për pushime kishte pranuar në banesë. Automjetin më vonë e ka shitur dhe parat nga shitja e

automjetit i kishte ndalur kinse ne emër te kompesimit për punën qe ka kryer nga E. B.. Te gjitha këto tregojnë se këto mjete qe kishin B.in nga aktivitetit kriminali Grupit të organizuar brenda të cilit ishte edhe vet i akuzuari B. vërtetohet se ishin bere me qellim te fshehjes dhe maskimit, konvertimit dhe transferimit te pasurisë te fituara nga aktivitetit kriminale. Prokuroria nuk ka identifikuar banësn të cilën e kishte blerë i akuzuari B. V. në bashkëkryerje E. gjë që rrezulton nga raporti i përgjimeve ku akuzuara E. kishte thënë se të akuzuarit B.V. ia kishte blerë një bansë.

Po ashtu me veprimet e te akuzuarit XH.A. ne raport me E. B., si bashke kryes u vërtetua se te njëjtit me qellim te fshehjes se pasurisë se fituar nga aktivitetit kriminale do te thotë ndërtesës e cila ishte ndërtua deri ne katin e katër me parat e marra nga mashtrimi i dëmtuarave i njëjti kinse me autorizim dhe me emër te borxhit qe i kishte E. kishte pranuar autorizimin ashtu qe kishte lidhur kontratën me kompanin “A. G. “ dhe me pronaret e tokave edhe pe e ka ditur se e akuzuara E. kishte obligimet ne raport me personat e tjer për objektin ne fjalë. Nuk u kontestua se e akuzuara E.B objektin A1 i filluar në laxhen M.. pasi që e njëjta gjatë mbrotjes së saj thekson se një pjesë të mjeteve të dëmtuarve ka shkuar në ndërtim-investim. Cila është ishte arsyeja që i gjithë investimi në atë objekt ti transferohet të akuzuarit XH.A. dhe të lihen anash të dëmtuarit që kishin paguar mjete për to?

Nga provat e administruara u vërtetua se E. B. me V. O.n kishin bashkëpunuar me qellim te maskimit dhe fshehjes se pasurisë te cilën e kishte fituar me vepër penale do te thotë te mashtrimit e të kryer në Grup të organizuar kriminal. Nga se nga raportet e B.ës dhe deftes pagE. e B.ës të cekura më lartë të akuzuarit i ishin transeruar e neper mes gjirollogari W. U. kishte panuar mjetet financiar ne vlere prej 16.000 euro, kohë pas kohe, po ashtu i njëjti kishte pranuar shumen e te hollave ne vlere prej 14.600 euro nga i dëmtuari. Po ashtu i njëjti kishte pranuar te regjistrohet vetura ne emër te tij Xhp H. X .. ne vlere prej 35.300 euro, si dhe një truall prej 5 ari ne fshatin L.. Se pasuria e cekur ishte transferuar në emër të V.O. nuk kontestohet nga ana e të tyre.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor u vërtetua se e akuzuara E.B nuk kishte mjete të veta, përveç mjeteve të realizuara nepërmjetë kompanis “V. O G.”, dhe në fillm disa të hyra nga kopania “E.” adaj të gjitha këto transfere ishin bërë nga mjetet e realizuara ndepërmjet aktivitetit kriminal.

Po ashtu u vërtetua se e akuzuara E. dhe V.O. bashkarisht kishin shkuar te personi B. G., ku E. dhe i akuzuarin V. nuk e kontestojnë kete, dhe po ashtu edhe dëshmitari B. G. kishte deklaruar se E. kishte shkuar bashke me V.in. Prandaj bazuar në faktin e pretenduar se prona ne fshatin L. i paguar nga vete i akuzuari dhe pasuria familjare nuk qëndron pasi qe kjo nuk u vërtetua gjate shqyrtimit gjyqësore dhe poashtu nuk u vërtetuar se pagesa e këtij truallit është bere neper mjete B.ës. Siç pretendohet nga ana e të akuzuarit dhe dëshitarit A.O.. Nuk u vërtetuan as pretendimet se prona ishte blere para vitit 2009. Prandaj duke pas parasysh lidhje e tyre dashurore dhe faktin se bashkarisht te B. G. gjykata ka ardh në përfudnim se prona në fshatin LL. është blerë nga E.B e V. B. nga paraat e fitura nga Grupi kriminal do të thot nga aktiviteti kriminal nga se ishte regjistruar në emër të V.O.t me dt. 20.02.2012 gjatë periudhës të përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Prandaj, nga të gjitha të lartëcekurat u vërtetua se në veprimet e të akuzuarës E.B, B. B., XH.A., V.O. janë plotësuar elementet e veprës penale të secili ne bashkëkryerje ne raport me E. B., Shpërlaja e Parave nga neni 32 pika 2.1, 2.2, 2.5 dhe 2.6 sipas ligjit për Parandalimin e Shpërlarjes se Parave dhe Financimit te Terrorizmin lidhur me nenin 31 te KPK-se. Edhe sa

i përket kësaj vepre penale vlen arsyei i cekur si më lartë të veprat penale në vazhdim i marrë nga udhëzuesi i gjykatës evropiane për të drejtat e njeriut.

Rrethanat për dënimin

Duke Vendosur mbi vendimin mbi dënim konform nenit 73 të KPRK-së, gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që ndikojnë në llojin e dënimit. Nga rrethanat lehtësuese gjeti rrethanat se të njëjtit më pare nuk kanë qenë të dënuar pasi gjykat nuk ka prova për këtë, rrethanat familjare . Nga rrethanat rëndues gjykata gjeti, shkallen e lartë të përfshirjes së të akuzuarve secilin veç e veç në veprat penale për të cilat u shpallen fajtorë e veçanarisht shkallen e lartë të përfshirjes së të akuzuares E.B në raport me veprën penale Krim I oraganizuar e pasta edhe vepren penale të shpërlarjes së parave.

Andaj gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të akuzuarin e gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë dhe është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit e që është pengimi i të akuzuarit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale konform nenit 41 të KPRK-së.

Mbi kërkesën pasurore juridike

Të gjithë personat e cekura si në dispozitiv të këtij aktgjykimi kanë cilësin e personave të dëmtaur të cilët ishin ishin mashtruar kinse do tu ndërtoheshin banesa, mirpo disa nga ta kanë arritur që sëpaku ti arrijn ti kthejnë të hollat e veta në një mënyër apo tjetër, prandaj gjykata lidhur më kërkesën pasurore juridika ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata ne bazë dispozitave te cekura me lart konform nenit 463 te KPPRK-se, ka vendos qe te dëmtuarit e cekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi për kompenzimin, të ju kompenzohet demi ne shumat e caktuara si ne dispozitiv pasi qe ato ishin shuma te paguar nga te dëmtuarit dhe nuk ishin kontestuese. Te gjitha u provuan me dokumente Bankare e po ashtu me deklarata për kthimin e borxhit, ne deklarata për pranimin e pagesave gjë që pëcakton edhe ekspertiza financiar.

Te dëmtuarit: Rifat Z., F. S. B., A. Ç., B. M., E. Gj., E. P. , A. A., A.G., G. dhe V. H., S. K., S. B., L. P., Ilir G., L.B. te njëjtit nuk u udhëzuan ne kontest civil pasi qe te njëjtit ishin kompensuar.

Të dëmtuarit A. K., Sh. K., M. S., Sh. G., A. J., A. B., M. U, L. M., B. P., A. S., A. J., për shumën e paguar në total 172.700 euro, me kontrate për transferimin e pronës e vërtetuar të noteri Safadin Blakaj, me numer RLP/ref :...-.. /....., me numer katastrale P-.....-.....-.. ju është transferuar prona e cila ishte në emër të babait t akuzuarve E. dhe V.B dhe qe është llogaritur për borxhin qe ju kishte E. ne vlerën prej 172.700 euro, gjithenje sipas kontratës te cekur te noteri (e akuzuara E. pretendon se shtëpia i është marr babait të saj nën presion, dhe babai i saj ka menduar se më dhënien e shtëpisë do të pushojnë problemet).

Të dëmtuarit të cilët nuk ju është gjykuar dëmi i shkaktuar në mungesë të provave për të vërtetuar saktësisht lartësin e pagesave, gjë që rrezullton edhe sipas ekspertizës mungesa e provave, dhe të dëmtuarve që ju është gjykuar kërkesa pasurore juridike përtjej kërresës së gjykuar udhëzohen në kontest civil.

Të V. I., I. I., nuk janë gjetur prova për cilësinë e tyre si të dëmtuar edhe pse janë paraqitur në aktakuzës. A. H. nuk është konstatuar si e dëmtuar, pasi vetëm ka deponuar të holla për të dëmtuaren F. H.. S. B. dhe N.B. rrjedhë se njëjtit janë paraqitur si të dëmtuar nga ana e prokuroris në këtë rast, mirpo gjykata ka konstatuar se S. B. kishte nënshkruar kontratën si investitor në muajin e Shkurt të viti 2009 për një investim në lagjen e spitalit ajo periudhë kohore nuk është paraqitur në aktakuzë dhe si të dëmtuar nuk kishin të bënin me kompanin V. O G. dhe E.

DI. nga të dëmtuarit janë bashkëkontraktues ose baktë të dëmtuar, ndërkaq për S.M. (e njer) është paraqitur djali K. G., për dëmtuarin I. S. K. T., andja gjykata i ka cekur në dispozitiv të këtij aktgjykimi si palë të dëmtuara. Të gjithë të dëmtuarit nuk kanë qenë prezent në seancë pasi që kanë munguar adresë e sakta

Mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke u bazuar në nenin 450 të KPPRK-së e obligoi të akuzuarit E.B, V.B dhe B.V. në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor.

Konform nenit 39 par.1,2,3 nën par. 3.1 të Ligjit për kompensim të viktimave të krimit e obligoi të akuzuarit E.B, V.B dhe B.V. në paguarjen e kompenzimit në emër të viktimave të krimit.

Mbi vendimin për paraburgim

Pas shpalljes së aktgjykimit gjykata të E.B, V.B dhe B.V. u ka caktuar masën e paraburgimit dhe arsyet për caktimin e masës së paraburgimit janë dhënë në me aktvendimin PKR.nr.06/19 të dt. 15.06.2022.

Vlerësimi i provave në raport me pjesën e dytë II –pjesën liruese

Gjykata ka dëgjua në cilësi të dëshmitarit përfaqësuesin e ATK-së si dhe ka administruar si provë raportin e ATK- të përshkruar më lartë.

Gjykata po ashtu ka urdhëruar ekspertizën financiare lidhur me shmangien e tatimit nga e akuzuara E. B. dhe nga ekspertiza ka rezultuar se të hyrat e kompanisë “V. o G.” në gjirrollogari e “V. -o- G.” ka konstatuar se shmangie e tatimit është llogaritur për vitin 2009- 2012, ashtu që për llogarit e E. B., Era B., T. B., E. B. T. B. dhe V. B. “V. o G” SHPK, kishte konstatuar borxhi tatimor i mbetur është 80.616.97 euro.

Gjykata ka vlerësuar në raport me provat e lart cekura dhe veprën penale që i vihet në barrë të akuzuarës E. B., dhe atë veprën penale të shmangies së tatimit nga neni 249 par 1 lidhur me par 2 të KPRK-se, dhe ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarës nuk ekzistojnë elemente e veprës penale të shmangies së tatimit pasi që gjykata ka ardhur në përfundim se qëllimi i të akuzuarës nuk ka qenë shmangia e tatimit e njëjta të ardhurat i kishte fituar neper mjet aktivitetit kriminale si Grup i organizuar kriminal e me anë të mashtrimit. Andaj gjykata ka konstatuar se nuk mund të konsiderohet si biznes i rregullt, e që qëllimi i saj të ketë qenë shmangia e tatimi. Për të ekzistuar kjo veprë penale duhet që kryesi që me anë të shmangies së tërësishme apo të pjesshme të tatimit të jep shënime të pavërteta mbi faktete relevante për të shmangur tatimit tarifave dhe kontributeve. Meqenese gjykata ka konstatuar se në veprimet e të akuzuarës është kryer vepra penale e krimit të

organizuar e ne lidhje me veprën penale te mashtrimit atëherë gjykata ka konstatuar se qëllimi kryesor i saj ka qene përfitimi me anë te aktiviteteve te kundër ligjshme dhe te mashtrimit duke vepruar në Grup të organizuar,

Në rastin konkret nuk ka dëshmi qe e njëjta te ketë paraqitur ndonjë fakt te pa vërtete pranë administratës tatimore, apo të ketë marr ndonjë veprim me qëllim të shmangjes së tatimit. Të dëmtuarit pjesën më të madhe të të hollave e kishin deponuar nëpërmjet Bankes.

Gjykata i ka vlerësuar provat e administruar ne shqyrtim gjyqësore ne raport me vepër penale te shkaktimit te falimentimit nga neni 234 te KPRK-se, dhe ka vërtetuar se ne rastin konkrete nuk janë vërtetuar elemente te veprës penale. Gjatë shqyrtimit gjyqësor gjykata nuk kishte prova do të vërtetonin se e njëjta kishte hapur ndonjë procedure te falimentimit dhe me këtë rast te këtë dëmtuar kreditorët. Edhe ne këtë rast gjykata sikurse për veprën e lart cekur nuk e ka vërtetua qëllimin e te akuzuarie për te falimentuar pasi qe me provat e administruar u vërtetua se e njëjta nuk kishte ndonjë qellim për një biznes serioz. firme e njëjta kompanin “ V. O G. “ e kishte hapur vetëm sa për te krijuar kushte dhe për te kryer aktivite kriminale kinse ne emër te ndërtimit te banesave dhe me qëllim te bindjes se blerësve për te hyre ne këto raporte kontraktuale me qëllim te përfimit.

Andaj ne mungese te provave gjykata ka konstatuar se e njëjta duhet te lirohet nga aktakuza për këto dy vepra penale në munges të provave dhe veprimeve konkrete të cilat do të përmbushnin elementet e këtyre dy vepra ve penale qe i vihet ne barrë, konform nenit 364 par.1 të KPRK-së gjykat e liroj pjesërisht nga aktakuza të akuzuarën E.B dhe atë për vepër penale shkaktimit te falimentimit nga neni 234 te KPRK-se dhe vepër penale 249 par 1 lidhur me par 2 te KPRK-se.

I akuzuari F.O.

Gjykata provat e cekura me lart i ka administruar dhe i ka vlerësuar ne raport me veprën penale shpërlarja e parave e cekur si me lart ne raport me te akuzuarin F.O.. Mirpo ka ardhur në përfunim se për të akuzuarin F.O. se prokuroria nuk i ka përshkruar dhe me provat e ofruara nuk ka arritur të provoj veprimet e të këtij të akuzuari në raport me veprën penale të shpërlarjes së parave nga neni 32 pika 2.1, 2.2, 2.5 dhe 2.6 sipas ligjit për Parandalimin e Shpërlarjes se Parave dhe Financimit te Terrorizmin lidhur me nenin 31 te KPK-se. Nuk ka dhënë porva as arsy se si i njëjti ka bashkunar me E. dhe si kishte ardhur deri të lidhja e kontratës, a njiheshin të njëjtit? Vetëm fakti që kishte lidhur kontratën me B. G. nuk e provon faktin se i njëjti kishte bashkpunim me E..

Andaj në munges të figurës së veprës penale që duhej të shprehej përmes një përshkrimi faktik të bazuar në prova gjykata ka ardhur në përfundim se i akuzuari F.O. duhet të lirohet nga aktakuzasa në munges të provave dhe të gjitha dyshimet duhet interpretuar në favor të akuzuarit.

Andaj ne mungese te provave gjykata ka konstatuar se i njëjti duhet te lirohet nga aktakuza dhe vepra penale qe i vihet ne barrë sipas aktakuzës PPS.04/2015, konform nenit 364 par.1 të KPRK-së.

Vendimi për konfiskimin

Gjykata ka vlereusuar propozimin e prokurorisë sa i përket konfiskimit te pronave dhe atë pronës ne emër te F.O. qe te konfiskohen dy shtëpi dy kateshe ne lagjen “ Q. te cilat janë te ngritura ne zonën katarale ne Q. dhe atë ngastrave kadastrale/. ne sipërfaqe prej 0.04 ha, dhe/..., vendi i quajtur sh. ne sipërfaqe prej 0.03.50 ha, te blera ne mes te shitësit

B. G. dhe F. O., sa i përket pronës të cekur për konfiskim të F.O. prokuroria nuk ka arritur ta provoj se kur saktësisht janë blerë këto prona dhe këto prona të jenë realizuar nga aktiviteti kriminal siç u cek më lartë.

Prokuroria në dispozitivin e aktakuzës ka pretenduar se trualli në fshatin L. i takon V.O.t, ndërkaq në pjesën e propozimeve thotë se trualli në fshatin L. në emër të F. O., dhe atë trualli në sipërfaqe 500 metra katror në vendin e quajtur L. Komuna e Prishtinë sipas qertifikates nr. P-.....-.....-, gjatë shqyrtimit gjyqësor me prova të administruara nuk është provuar se F.O. ka pronë në fshatin LL.. Eshhtë vërtetuar se prona në fashti LL. i përket të akuzuarit V.O. gjë që u vërtetuar si më lartë (gjë që nuk ishte kontestuese), por prokuroria nuk ka propozuar konfiskim të pronës së V.O.t. Me rastin e verifikimit nëse është fjala për gabim teknik në emër, mirpo gjykat nuk ka mundur të konstoj se numri i listës poseduese P-.....-.....- . a përkon me numrin e ngastrës në emër të V. O., pas verifikimit të parashtrës së Drejtoria për Kadastër të Komunen e P.s të dt.18.03.2014.

Gjykata lidhur me propozimin për konfiskim kishte kërkuar nga prokuroria që verifikoj këte pjese të aktakuzës që ka të bëjë me propozimet dhe sçarime të tjra lidhur me pronat e konfiskuar, pasi që ish-in në kundërshtim me dispozitivin, por prokurorja ka mbetur pranë fjalës përfundimtare ka mbetur pranë propozimeve si në aktakuzë.

Sipas dispozitë së neni 281 para 2, prokurori ka obligim që në kërkesën për konfiskim të shënon të gjitha të dhënat dhe rrethanat e rëndësishme për përcaktimin e dobisë pasurore të përfutur me vepër penale, të sendeve të fituara nga vepra penale ose dhenjes se kundër ligjshëm të shpërblimit dhuratës apo përfutimit.

Andaj duke i pasur parasysh të gjitha këto gjykata është dashur ta refuzoj kërkesën për konfiskim pasi që gjykata nuk mund të veprojnë në dëm të akuzuarve dhe vetë të përckatojnë pronat apo ngastrat se cilat duhet konfiskuar.

Në shkruar e lëndës në procedure parapake gjendet aktvendimi PPR.KR.234/2014 i dt.18.06.2014, me të cilin i është konfiskuar përkohshëm objekti në emër të Xh. A.t në lagjen M. në P. B. A., (pika b) për F.O.n u shtjellua ma lartë) si dhe parandalimi i shitjes shkëmbimit të pronësisë së ndërtesës në lagjen M. ngastrën .../, .../ dhe .../ në sipërfaqe prej 25 ari vendi Ara e r. M. P. në pronësi të E.Bt. Për të cilat prokuroria në propozimet e saj për konfiskim nuk ka propozim qoft për konfiskim apo lirim të pronës, gjykata me parashtrës kishte kërkuar që nga prokuroria për këtë, për të ditur nëse të njëjtat vazhdojnë të jenë të konfiskuara apo eventualisht ka ndonjë vendim tjetër për këtë pasi që lënda është delaguar nga Gjykata Themelore në Prishtinë nga shkresa e prokurorisë e dt.06.06.2022, rezulton se i është drejtuar Komunës së Prishtinës nga e cila ka marr informacion se në emër të Xh. A.t nuk evidentohet ndonjë ndërtesë në Lagjen M., e sa i përket ndërtesës në ngastrat e lartëcekura rezultojn edhe avkendime të tjera në çështje civile masa të përkohëshme C.nr.37/12 i dt.31.05.2013 dhe C.nr.406/2015 dt.30.10.2017. Në fjalën përfundimtare prokuroria lidhur me këtë nuk ka bërë ndonjë propozim e në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet pranë propozimit si në aktakuzë.

Duke i pasur parasysh të lartë cekurat gjykata nuk ka pasur mundësi të vendos për këtë, qoft për konfiskim apo lirim të pronës.

Gjykata bazuar në të gjitha të lartë cekura ka vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimit konform neni 364 dhe 365 të KPPRK-se.

DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA,

2020:156726, 24.08.2022

Kryetarja e trupit gjykues

Violeta Husaj Rugova

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në P., nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.